

UNITED
NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 13, 14 DHE 17 KORRIK 2006

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 13, 14 I 17 JULA 2006 GODINE

KORRIK – JULI 2006

MEMORENDUM ZYRTAR

СЛУЖБЕНИ MEMOREI

PER / ЗА / TO	<i>Deputetët e Kuvendit</i>	DATA	07 korrik 2006
	<i>Посланике Скупштине</i>	ДАТУМ	07 јула 2006.
	<i>Members of the Assembly</i>	DATE	година 07 july 2006
		<i>Reference</i>	
NGA / ОД / FROM	Kolë BERISHA Kryetar i Kuvendit / Председник Скупштине / President of Assembly		
SUBJEKT ПРЕДМЕТ SUBJECT	Mbledhja e Kuvendit / Заседање Скупштине / Meeting of the Assembly		

Ftoheni të merrni pjesë në seancën plenare, e cila mbahet:

**të enjtën, me 13 korrik 2006, në orën 10:00
në sallën e Kuvendit të Kosovës**

Propozimi i rendit të ditës është i bashkangjitur.

Позивате се да присуствувјете на пленарну седницу, која ће се одржати:

**у четвртак, 13 јула 2006, у 10.00 часова
у сали Скупштине Косова**

Предлог дневног реда је у прилогу.

The next meeting of the Assembly, will take place on:

**thursday, 13 july 2006, at 10.00 am
Assembly Hall, Assembly Building, Pristina**

All members of the Assembly are invited to attend.

The draft agenda for the meeting is attached.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
3. Pyetjet e deputetëve për Qeverinë e Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Lirinë Fetare në Kosovë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat Nr. 2003/07,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardizim Nr. 2004/12,
8. Shqyrtimi i Raportit për punën 100 ditësh të Qeverisë së Kosovës,
9. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime të Kryesisë për Qendrën Administrativo – Protokollare në Gërmi.
10. Shqyrtimi i propozimit të procedurave për emërimin e anëtarit të pestë të Këshillit të Komisionit të pavarur për media,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të kandidatëve për drejtor të Agjencionit Kosovar të Antikorrupsionit.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika sa prošle sednice,
3. Poslanička pitanja za Vladu Kosova,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o verskoj slobodi na Kosovu,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o prekidu trudnoće,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o arhivskoj gradji i arhivama Br. 2003/07,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o standardizaciji Br. 2004/12,
8. Razmatranje Izveštaja o stodnevnom radu Vlade Kosova,
9. Razmatranje Izveštaja sa preporukama Predsedništva o Administrativno-protokolarnom centru u Grmiji.
10. Razmatranje predloga postuaka o imenovanju petog člana Saveta nezavisne komisije za medije,
11. Razmatranje preporuke kandidata za direktora Kosovske agencije protiv korupcije.

AGENDA

1. Approving the agenda,
2. Approving the minutes from the previous session,
3. Questions of deputies for the Government of Kosova,
4. Second reading of the Draft law on Religious freedom in Kosova,
5. Second reading of the Draft law on Termination of Pregnancy,
6. Second reading of the Draft law for changing and fulfilling the Law on Archive Material and Archives Nr. 2003/07,
7. Second reading of the Draft law for changing the Law on Standardization Nr. 2004/12,
8. Reviewing the report for the 100 day work of the Government of Kosova,
9. Reviewing the report with recommendations made by the Presidency for the Administrative Protocol Center in Germia.
10. Studying the proposed procedures for nominating the fifth member for the Council of Interim Media Commission,
11. Studying the recommendations given for the candidates for the director of the Kosova Anti-Corruption Agency.

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja filloi në orën 10 në sallën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhjen e kryesoi kryetari Kolë Berisha

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju njoftoj se rendi i ditës i propozuar nga Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim ose në konsultim me shefat e grupeve parlamentare së bashku me materialin e keni marrë dhe është shpërndarë me kohë.

Andaj propozoj që të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Në pajtim me rregullën 6 dhe 23 të rregullores së punës Kryesia e Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit i propozon rendin e ditës për seancën plenare sipas ftesës dhe pikave shtesë që u janë shpërndarë deputetëve.

Me që Kryesia nuk ka marrë asnjë propozim tjetër me shkrim për plotësimin e rendit të ditës atëherë në pajtim me rregullën e re 23.2 konstatoj se rendi i ditës është i miratuar. Fjalën e kërkon Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA - Faleminderit z. kryetar, i nderuari kryeministër, anëtarë të kabinetit qeveritar, deputet të nderuar. Lidhur me rendin e ditës Grupi parlamentar i Aleancës ka shtruar para Kryesisë dy kërkesa, një kërkesë ka të bëjë me zbatimin e vendimit të Kuvendit të Kosovës lidhur me hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe kërkesa e dytë lidhur me procedimin e projektrezolutës për organizimin e diasporës Kosovare dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës, lus që në seancën e radhës konform kërkesës me shkrim që e kemi shtruar të futet në rendin e ditës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Kërkesën do ta ketë parasysh Kryesia dhe do ta shqyrtojë.

Vazhdojmë më tutje.

Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, kryeministër të nderuar deputet. Ne në grupin parlamentar të Partisë Demokratike e kemi shqyrtuar rendin e ditës dhe kemi ardhur në përfundim që pika e 8 e rendit të ditës mos të trajtohet si interpelancë, por si shqyrtim dhe të mos kufizohet e drejta e deputetëve për të debatuar mbi bazën e rregullores së punës së Kuvendit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit. Në cilësinë e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së kemi marrë pjesë në dy mbledhje konsultative me kryetarin e Kuvendit, Kryesinë e Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare. Ky rend i ditës i cili është marrë nga Kryesia e Kuvendit është rend dite me të cilin janë pajtuar të gjithë në mbledhjen e fundit konsultative me Kryesinë e Kuvendit. Jemi pajtuar edhe për kohëzgjatjen e debatit dhe jemi pajtuar edhe në ndarjen e kohës sipas fuqisë politike në

Kuvendin e Kosovës, andaj kërkoj që për LDK-në i kemi të rezervuar 47 minuta për debat për raportin e Qeverisë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislmi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar, kërkojë që Qeveria të marrë masa dhe të garantoj furnizim të rregullt me energji elektrike gjatë transmetimit të seancave, të respektohet e drejta elementare e njeriut dhe e qytetarit tonë për informim. Qytetari ynë ka të drejtë ta ndjek punën e këtij Kuvendi t'i dëgjoj dhe t'i njoh përfaqësuesit e tij dhe qëndrimet e tyre. Raporti për 100 ditëshin është ngjarje e shënuar në çdo vend, prandaj trajtimi i kësaj pike si interpelancë është krejt i pa pranueshëm për Kuvendin dhe është diçka që ne nuk mund ta pranojmë, ne kërkojmë që ashtu siç është formuluar pika shqyrtimi i raportit të hapet debat dhe të mos kufizohet koha, por të respektohet rregullorja siç është paraparë me rregullore.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – I nderuar z. kryetar, i nderuari kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputet, për deri sa po diskutojmë për rendin e ditës edhe ne si grup parlamentar e kemi analizuar atë dhe sigurisht që konform rendit të ditës e kemi zënë edhe pozicionin tonë si grup parlamentar, mendojmë se diskutimi për punën e Qeverisë është një ngjarje në Kuvend, në çdo Kuvend, prandaj është një ngjarje edhe në Kuvendin e Kosovës, qoftë ai diskutim për 100 ditët e punës, qoftë për 550 ditët e punës, qoftë edhe për një raport 1 vjetor, sidoqoftë në këtë rast dhe në këtë moment ky raport nuk mund të trajtohet si interpelancë siç është paraparë në Kryesi, pavarësisht se Kryesia është një organ koordinues i punës së Kuvendit nuk është Kuvendi, sepse e ka në dorë punën e mirëfilltë dhe kujdesin për punën e mirëfilltë.

Z. kryetar protestoj për këtë mënyrë të udhëheqjes së seancës, ndërprerja e fjalës kur diskutohet për rendin e ditës është krejtësisht e pa pranueshme, nuk mundet një teknik atje të ma ndërpres fjalën mua këtu, ju duhet të ma tërhiqni vërejtjen nëse nuk mund ta zgjas e jo një teknik atje me një trusje të pullës atje të ma ndërpres mikrofonin, kjo është e pa kuptimtë, ju lutem merrni masa ndaj këtyre njerëzve që punojnë në teknik, është e pa pranueshme që kjo çështje të interpretohet interpelancë, ne duhet të diskutojmë për punën e Qeverisë z. Alush Gashit i mjaftojnë 47 minuta për ta përshëndetur ose duartrokatur Qeverinë, neve na duhen nga 10 minuta secilit deputet për ta shprehur mendimin tonë për këtë Qeveri, nëse LDK-së i mjaftojnë 47 minuta, neve na duhen 10 minuta siç e parasheh rregullorja e punës, prandaj insistojmë që çdo deputet ta ketë të drejtën e fjalës deri në 10 minuta.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Jashari, po zbatohet rregullorja që është në fuqi, nëse dikujt nuk i pëlqen ndonjë dispozitë e rregullores duhet ta inicioj procedurën për ndryshimin e saj, për ndryshe deri sa është në fuqi kjo rregullore do të veprojmë sipas kësaj dhe unë e kam një propozim për pikën që është kontestuese, kur të

vijmë te kjo pikë e rendit të ditës mund të bisedojmë për te, të mbetet apo të mos mbetet në rend dite apo të rritet kohëzgjatja, do të bisedojmë atëherë.

Fjalën e ka z. Sabit Rrahmani

DEPUTETI SABIT RRAHMANI - Ju faleminderit z. kryetar. Grupi parlamentar për integrim mbështet kërkesën e PDK-së dhe kërkesën e grupit parlamentar Ora që kjo çështje të mos trajtohet si interpelancë dhe të mos kufizohet debati i deputetëve, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI - Z. kryetar ju në fjalën tuaj thatë se nuk keni propozim tjetër për ndërrim ose shtim të pikave të rendit të ditës. Ne para vetes kemi një material, një kërkesë që të ketë pika shtesë në rendin e ditës për të cilat këtu nuk u fol ose unë nuk kam dëgjuar mirë. Nën një shqyrtimi i propozimit të procedurave për emërimin e anëtarit të pestë të Komisionit të Këshillit të pavarur për media dhe pikën tjetër Shqyrtimi i rekomandimit të kandidatëve për drejtor të Agjencisë Antikorrupcion. Unë kërkoj që për këtë çështje që e kemi marrë si material për këtë çështje që e kemi marrë si material si shtesë për rendin e ditës për këtë seancë të diskutohet dhe të futen ose të mos futen në rendin e ditës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Të gjitha këto pika që janë përcaktuar për sot janë bërë në konsultim me shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës dhe në cilësinë e Kuvendit dhe janë pajtuar të gjithë me këtë. Prandaj vazhdojmë me procedura.

Fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Z. kryetar unë mendoj se në bazë të rregullores së punës së Kuvendit duhet ta vëni në votim propozimin nga ana e PDK-së dhe të mbështetur nga të tjerët, pas votimit ne do ta mbajmë qëndrimin tonë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka profesor Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar, ky është Kuvend dhe është e drejta e deputetëve që të kenë mendime të nuancuara rreth mendimeve të shefave të grupeve parlamentare, me gjithë atë ekziston një disiplinë parlamentare që është ushtruar, unë do të thosha deri në kufijtë e fundit të demokracisë. I gjithë ky rend dite është pranuar nga të gjithë shefat e grupeve parlamentare me koncensus nga edhe nga Kryesia dhe më duket se është kohë e humbur që ne të vazhdojmë në këtë mënyrë të diskutojmë për rendin e ditës, ju lutem shumë ta nxirrni në votim të hapur ose si të doni rendin e ditës për seancën e sotme, le të votojnë si të donë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Këtu është kontestuese kohëzgjatja e diskutimit e jo pikat e rendit të ditës.

Fjalën e kërkon Naim Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU - Z. kryetar, të nderuar deputet, kjo seancë është përgatitur në mënyrë që janë mbajtur dy takime me shefat e grupeve parlamentare si ndryshim i rregullores së punës së Kuvendit, ndryshim pozitiv që e ka miratuar së bashku dhe të gjitha këto pika të rendit të ditës janë harmonizuar në këto dy takime të Kryesisë me të gjithë shefat e grupeve parlamentare, duke marrë parasysh edhe pikën e tetë të rendit të ditës ku është propozuar dhe është miratuar vendimi që kohëzgjatja e debatit për këtë pikë të kufizohet në dy orë dhe ndarja të bëhet sipas fuqisë së grupeve parlamentare në Kuvend të Kosovës. Vijnë tash propozime që bije ndesh me mendimet e shefave të grupeve parlamentare. Nga rupet parlamentare këtu në Kuvend, z. kryetar unë propozoj që shefat e grupeve parlamentare të merren vesh se si të organizohet mbledhja e Kuvendit, si të organizohen pikat e rendit të ditës, për në të ardhmen ne jemi marrë vesh që me shefat e grupeve parlamentare të diskutohet rendi i ditës, të propozohet për seancën e radhës dhe të miratohet rendi i ditës, kjo është bërë, në qoftë se dy grupe parlamentare kërkojnë që marrëveshja për të cilën janë pajtuar të hiqet, ajo është tjetër, por tani nuk duam të merremi vesh.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, është e vërtetë se ne jemi marrë vesh për të qenë debati 2 orë, kemi biseduar me grupin parlamentar të PDK-së dhe vendimin që e kemi marrë është në kundërshtim me rregulloren e punës, Rregullorja e punës ia lejon çdo deputeti diskutimin deri në 10 minuta.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit , fjalën e ka z. Kuçi.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Unë mendoj se për z. Maloku dhe për të tjerët këtu ka të drejtë çfarë thotë ai, por duhet ta ketë të qartë se në rregullore grupet parlamentare dhe Kryesia i propozojnë Kuvendit, nuk marrin vendim për rendin e ditës. Vendimin për rendin e ditës e merë Kuvendi, andaj si propozues mund të ndryshohet në çdo rast. Ky Kuvend ka të drejtë me e ndryshuar propozimin dhe me marrë vendim tjetër dhe karakterin e propozuesit mos ta marrim si karakterin e vendimmarrësit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Sipas normave të rregullores së punës rendi i ditës është i aprovuar, mund të votojmë vetëm për kohëzgjatjen e pikës së tetë. Fjalën e ka z. Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. kryetar, unë kisha ndërmend të bëj dy vërejtje, njëra konsideroj se u apostrofua nga parafolësi, unë do të shtoja se Kryesia siç u tha mund të propozoj një rend dite, mund të propozoj një qasje, por me gjithë atë duhet të vendosë Kuvendi dhe e dyta edhe Kuvendi duhet të vendos në pajtim me rregulloren e punës dhe këto vërejtjet kanë të bëjnë pikërisht me këtë, a janë propozimet dhe po të jenë ashtu të Kryesisë në pajtim me Rregulloren e punës. Vërejtja e dytë që e dëshmon këtë që e thash është se po përzihen në mënyrë të palejueshme çështja e interpelancës me raportin e Qeverisë, janë dy çështje të ndryshme dhe duan trajtim të ndryshëm, ne kërkojmë që

këto çështje të trajtohen konform rregullave të procedurës, raporti si raport, kur të vijmë te interpelancat ato të shqyrtohen edhe në procedurë tjetër, por edhe atëherë pa cenuar të drejtat e deputetëve që kanë trajtim dhe të drejta të barabarta. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Z. Hyseni në pajtim me rregullën 6 dhe 23 të rregullores së punës Kryesia e Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit i propozon rendin e ditës për seancën e sotme plenare sipas ftesës dhe pikave shtesë që u janë shpërndarë deputetëve me kohë. Me që Kryesia nuk ka marrë asnjë propozim tjetër me shkrim për plotësimin e rendit të ditës atëherë në pajtim me rregullën e re 23.2 konstatojmë se rendi i ditës është i aprovuar. Këto janë rregulla të cilat i kemi aprovuar me 1 qershor dhe në pyetje mund të jetë vetëm kohëzgjatja e debatit për këtë çështje.

Fjalën e ka z. Buja.

DEPUTETI RAMË BUJA – Z. kryetar ju vetë e lexuat dhe aty thotë shumë qartë dhe nuk kemi pse debatojmë, mua po më duket një gjë e pa kuptimtë e përsëritjes së gjërave, andaj nëse është që Kryesia propozon rendin e ditës, propozon thuhet ty, që e thatë ju mirë tash, atëherë seanca ka të drejtën për të vendosur për rendin e ditës, pse hidhet në votim nëse nuk është kështu, pse hidhet në votim rendi i ditës, andaj unë ju them se kjo gjë le të hidhet në votim propozimi i PDK-së dhe votohet apo nuk votohet është shumë e qartë dhe e kuptueshme dhe shkojmë përpara, ose ndalemi në vend.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Seanca propozon por nëse brenda kohës së caktuar nuk bihet ndonjë propozim tjetër me shkrim për plotësimin e rendit të ditës konsiderohet se rendi i ditës është i aprovuar dhe kjo është me ndryshimet që i kemi bërë në rregulloren e punës me 1 qershor, mund të votojmë vetëm për çështjen e kohës. Fjalën e ka Gjergj Dedaj.

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – I nderuari z. kryetar, kryeministër, ministra deputet. Unë këto ditët e fundit kamë lexuar së paku në media se Qeveria e koalicionit ka deklaruar se këto 100 ditë kanë qenë shumë të suksesshme dhe nuk e shoh të arsyeshme që t'i frikohen debatit nga 10 minuta për secilin deputet, bile me që është aq e suksesshme do të duhej të insistonit bash ju që të jenë 20 minuta debat për secilin deputet në mënyrë që këto suksese t'i bëni shumë publike, Unë mendoj se deputetëve të cilët e kanë zgjedhur kryeministrin dhe këtë Qeveri nuk mund t'ua mohoni të drejtën për debat nga 10 minuta që t'i shprehin shqetësimet dhe të gjitha ato lëvdata ose jo lëvdata për punën e Qeverisë së Kosovës edhe pse siç tha zëdhënësja Lama Qeveria është në dijet dhe ne duhet me qenë të kujdesshëm që mos me e dëmtua shumë Qeverinë dhe ministrat sepse mund të pësojnë nga kjo dietë që e kanë në kohën e fundit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Dedaj. Kush është për propozimin që debati për këtë pikë të rendit të ditës të zgjatë 2 orë, ju faleminderit. Kush është kundër, ju faleminderit, kush abstenon nuk ka.

Për debatin 2 orësh votojnë 47 deputetë

Kundër janë 42 deputetë

Dhe abstenon 1 deputet.

Prandaj shkohet me kohëzgjatjen e propozuar në marrëveshje me grupet parlamentare dhe me Kryesinë.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Ju njoftoj se e kemi kuorumin që mund të punojmë, dëshira do të ishte që të bëhet një konsultë me shefat e grupeve parlamentare edhe njëherë, në mënyrë që ta kemi edhe opozitën brenda, të bëjmë edhe një përpjekje.

Po them se kemi mundësi të punojmë sepse e kemi kuorumin.

Pika e 2 e rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 29 qershor 2006.

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 29 qershor 2006 u është shpërndarë të gjithë deputetëve, lus deputetët nëse kanë vërejtje me gojë apo me shkrim.

DEPUTETJAS GJYLNAZE SYLA – Z. kryetar pjesa ku unë kamë biseduar në seancën e kaluar thotë mungon incizimi, d.m.th nuk është incizuar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Dikush tjetër, është fjala për procesverbalin e jo për transkriptin.

Pika e tretë e rendit të ditës

3. Pyetjet e deputetëve për Qeverinë e Kosovës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores të punës së Kuvendit koha për pyetjet e deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta, pyetjet e dërguara Qeverisë u janë shpërndarë të gjithë deputetëve. Ju njoftoj se koha për pyetje zgjatë 1 minutë. Ju lutem ta respektojme këtë se nuk do të lëshojmë pe.

Përgjigja e ministrit zgjatë 3 minuta.

Pyetja plotësuese 1 minutë, dhe

Përgjigja plotësuese 2 minuta.

Deputeti Ramadan Kelmendi ka bërë 2 pyetje për kryeministrin Çeku. Nëse dëshironi t'i përsëritni z. Kelmendi mundeni. "Jo nuk ka nevojë", e presim përgjigjen e kryeministrit.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, ministra, të nderuar të pranishëm. Unë Qeverisë së Kosovës, gjegjësisht kryeministrit të Kosovës i kamë parashtruar këto pyetje: "A do të ndërmerë Qeveria e Kosovës ndonjë veprim juridik apo politik në procedurë të rregullt të Kuvendit që punëtorëve të larguar me dhunë nga Serbia nga vendet e tyre të punës t'ju njoh stazhin e punës prej datës 30. VIII.1990 deri më 30. VI. 1999 si e drejtë e patjetërsuar nga marrëdhënia e punës dhe e njohur me të drejta ndërkombëtare" e kamë paraqitur arsyetimin dhe më duket se nuk është e arsyeshme të vonohet. Pyetja e dytë "A ka ndërmarrë ndonjë veprim juridik apo procedural Qeveria e Kosovës, gjegjësisht zyra ligjore e kryeministrit për të nxjerrë

librezën e punës për të gjithë të punësuarit sepse pa këtë dokument kemi keqpërdorime, dy punësime dhe forma tjera të njohjes së asistencës sociale me çka do të reduktohej apo do të racionalizohet shfrytëzimi i buxhetit të Kosovës të kategorisë së dytë”. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, prandaj e keni ministër përgjegjës, urdhëroni z. ministër.

MINISTRI IBRAHIM SELMANAJ - Faleminderit z. kryetar. Z. kryeministër, të nderuar kolegë ministra, deputetë. Me gjithë respektin për pyetjet që i ka parashtruar z. Kelmendi, në të gjitha takimet dhe nivelet që i kemi pasur përfshirë këtu edhe partnerët social, si është organizata ndërkombëtare e punës, Bashkimin e Sindikatave të Pavarura, Odën Ekonomike, kemi të bëjmë me një çështje që nuk është përsëritur në vendet e tjera, sepse ne ballafaqohemi me një situatë që nuk është më e lehta. Duke pasur parasysh implikimet e larta buxhetore dhe buxhetin e limituar të Kosovës Qeveria e Kosovës është e pa përgatitur që të bëjë kompensimin për 10 vitet që kur punëtorët janë të larguar nga puna. Ekziston një përshtypje se duhet të respektohet edhe cigareshitësi i cili ka punuar për këtë periudhë kohe, qoftë edhe një qytetarë i rëndomtë i cili është marrë edhe me një treg në rrugë. Krejt çka mund të bëjmë në këtë kohë Qeveria mund të njoh stazhin e punës për 10 vite, por duke pasur parasysh edhe skemën pensionale e cila aplikohet sot në Kosovë që nuk parashihet në kuadër të kësaj skeme profesioni dhe përvoja e punës ne nuk mund të marrim një vendim të caktuar që të bëjmë njohjen e stazhit të punës përpos të kësaj periudhe dhe më shumë të jetë një akt moral. Unë konsideroj se me zhvillimet dhe bisedimet që bëhen në Vjenë dhe diskutimet për statusin do të jetë një çështje e hapur dhe se në të gjitha nivelet dhe me organizatën e pensionistëve dhe me shoqatën e pensionistëve ne kemi një strategji të cilën do ta drejtojmë dhe do ta orientojmë drejtë dhe krejt në fund, janë implikimet e larta financiare që nuk mund ta marrim këtë veprim.

Pyetja tjetër që ka të bëjë me librezën e punës. Ne jemi në hartim të ligjit të punës, në fakt grupi qeveritar, grupi punues qeveritar e ka përfunduar punën dhe pritet që së shpejti duke pasur parasysh edhe agjendën e hartimit të legjislacionit do të jetë për diskutim në Qeveri ligji i punës dhe nëse më kujtohet neni 90 i ligjit të punës parashih që secili punëtor i cili punon në Kosovë duhet të jetë i pajisur me librezën e punës. Në këtë kuadër nuk i kemi të përcaktuar formën se si do të duket librezja e punës, por janë dy mundësi me akte nënligjore ose me një ligj të veçantë do ta përcaktojmë se si do të jetë librezja e punës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër.

Deputeti Berat Luzha, nuk është këtu, Deputeti Emrush Xhemajli ka po ashtu pyetje për ministrin e rendit.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – I nderuari kryetar, i nderuar kabinet Qeveritar. Pyetja ime për ministrin e rendit është kjo: “Kush e ka urdhëruar SHPK-në të intervenoj kundër protestuesve në Merdar dhe Mitrovicë dhe a janë ndërmarrë masa kundër policëve të SHPK-së që kanë rrahur protestuesit në stacionin policor të Prishtinës më 28 qershor pasi janë pranuar në këtë stacion”.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni ministër.

MINISTRI JONUZ SALIHAIJ – I nderuar deputet Xhemajli, të nderuar deputet i nderuar kryetar. Qëndron fakti se ka pasur dallime lidhur me ardhjen, kohën dhe reagimet e mundëshme që do të nxitë një vizitë e tillë në këtë fazë e kryeministrit të Serbisë si dhe vlersimet se personi në fjalë vizitën e proklamuar si private do ta keqpërdorë për qëllime politike. Unë edhe me këtë rast shpreh vlerësimin tim për SHPK-në në kuadër të detyrave të mëdha që bëjnë për rendin, sigurinë dhe lëvizjen e lirë për të gjithë qytetarët që janë tregues për stabilitet dhe ndërtimin e demokracisë. Për njoftimin tuaj Shërbimi Policor i Kosovës menaxhohet dhe vepron vetëm nën urdhërat e Komisarit të policisë, po ashtu për protestën në Merdare unë kam shprehur mospajtimin tim me veprimin që tejkalojnë kodin e sjelljes për policinë, mbi imunitetin e deputetit të Parlamentit të Kosovës, z. Emrush Xhemajlit si dhe me rastin e marrjes dhe mbajtjen e tij në lokalet e policisë. Lidhur me këtë dhe bazuar në komizën e përgjegjësive kam kërkuar një raport të veçantë nga Komisari i policisë lidhur me protestën dhe rastin në fjalë. Vlerësimin dhe masat që parashihen si formë e transparencës dhe përgjegjësive konkrete duke përcjellë një informatë për Qeverinë dhe Parlamentin të cilën e keni në dispozicion në formën e shtruar nga Komisari i policisë ku jepen sqarime dhe veprimet konkrete ligjore që priten. Kjo informatë nga komisari i është dërguar kryetarit të Parlamentit dhe kryeministrit si dhe juve personalisht me 10 korrik 2006. Gjithashtu kam kërkuar nga përgjegjësit dhe shpresoj se rastet e tilla të mos përsëriten sepse synimi ynë është ngritja, zhvillimi dhe arritja e standardeve policore në bazë të parimeve më të larta demokratike, shërbim besnik për qytetarët, transparencë dhe përgjegjësi të plotë në punë, si të policit po ashtu edhe të oficerit, e shumë e shumë interes për sigurinë e vendit që të gjitha institucionet të përkrahin rezultatet, progresin dhe forcimin e SHPK-së, por edhe si qytetarë t'i respektojmë sa më shumë emblemat dhe rregullat e shtetit ligjor. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEREISHA – Ju faleminderit z. ministër, Emrush Xhemajli prap ka një pyetje.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Nuk jeni përgjigjur se a janë marrë masa kundër policëve të SHPK-së që i kanë rrahur protestuesit pasi i kanë arrestuar, është shkelje e rëndë e patolerueshme e policisë që t'i rrahë dikush pasi që të merren në stacion të policisë, në këtë nuk je përgjigjur fare. Në Kuvend e dinë se je ministër i rendit dhe jo delegat dhe ndërmjetësues për çështje të rendit për të dërguar dhe përcjellur letra.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEERISHA – Ju faleminderit.

Deputeti Emrush Xhemajli e ka fjalën.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Kjo ka qenë thelbi i pyetjes.

KRYEETARI I KUVENDIT KOLË BEREISHA – Fjalën e ka ministri Fatmir Rexhepi
MINISTRI FATMIR REXHEPI – Unë shkurt lidhur me këtë për arsye se në pajtim me punën dhe letrat e adresuara mendoj se kjo punë është në vazhdim e sipër sa i përket

procedurave të mëtutjeshme lidhur me mbajtjen në arrestime dhe masat që duhet të ndërmerren dhe atë njoftim e keni në shkrimin të cilin e keni këtu, prandaj ato vazhdojnë dhe në pajtim me veprimin konkret dhe në qoftë se ato bien ndesh me ligjin masat ndërmerren, nëse ato nuk ndërmerren, prandaj e keni sqarimin konkret dhe në fund thuhet duke pasur parasysh të gjitha këto zhvillime policia, gjegjësisht komisionari ka iniciuar një hetim të brendshëm për të shqyrtuar rolin e policit, rezultatet do t'u përcillen me kohë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka Emrush Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Për ministrin e drejtësisë është fjala Ardhja e udhëheqjes serbe në Kosovë më 28 qershor ka qenë politike, nuk ka qenë i bazuar në ligjet e këtij vendi. Me çfarë ligje janë mbrojtur udhëheqësit serb këtu. Të disponuar armiqësisht dhe me veprimtari kontinuitive kundër Kosovës edhe tash kur po flasim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni z. Ministër.

MINISTRI JONUZ SALIHAIJ – I nderuari kryetar i Kuvendit i nderuar kryeministër, ministra, unë e kam pyetjen të formuluar pak më ndryshme, me gjithë atë esenca është i njëjtë. I nderuari deputet Xhemajli, Nuk ekziston asnjë ligj i aprovuar nga Parlamenti i Kosovës pas konstituimit të IPVQ-ve që mbron Serbinë në Kosovë thjesht, kjo ka të bëjë me kompetencat e rezervuara të PSSP-së sipas kreut 8 të Komizës Kushtetuese. Kryeministri i Serbisë z. Koshtunica nuk ka asnjë dyshim se e ka keqpërdorur vizitën private me karakter fetar për qëllime politike duke prejudikuar statusin politik të Kosovës në kundërshtim me parimet e grupit të kontaktit dhe me vullnetin e popullit shumicë të Kosovës. Pasi nuk është hera e parë që ai e bën këtë, ai do të duhej të shpallej person nongrato. Sa i përket pjesës së dytë të pyetjes me të cilin ligj dënohen ata që protestojnë kundër këtyre, kjo çështje është sanksionuar me nenin 20 alineja 1.3 të ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike i shpallur në gazetën zyrtare të ish Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në bazë të ligjit mbi masat kundërvajtëse neni 73, 74, 199 dhe 267, Ligji është i vitit 1981, ligji i dytë i vitit 1979 që janë ligje të aplikueshme me një rregullore të UNMIK-ut dhe ne po bëjmë përpjekje që këto ligje t'i zëvendësojmë me ligje të reja. Kjo është përgjigja. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

MINISTRI FATMIR REXHEPI - I nderuari kryetar pyetja e deputetit prof. Alush Gashit është: "Në cilën fazë janë përgatitjet për themelimin e shërbimit të zbulimit dhe të kundërzbulimit". I nderuari deputet Gashi Sipas njoftimit të kryeministrit z. Agim Çeku ka filluar punën për formimin e shërbimit të inteligjencës së Kosovës. Deri më tani është caktuar një këshilltar ndërkombëtar pranë zyrës së kryeministrit. Ky ekspert do të ndihmojë në punën e themelimit, por kjo do të bëhet në bashkëpunim me aleatët tanë strategjik në fazën në vijim të cilët po ashtu kanë caktuar ekspert dhe ata po punojnë në këtë drejtim. Për Ministrinë e punëve të Brendshme, ndërtimi dhe konsolidimi i sektorit të sigurisë është se në mesin e prioritetëve ku modaliteti i ndërtimit të shërbimit të

inteligjencës kërkon një angazhim dhe koordinim të aktiviteteve të Qeverisë dhe institucioneve tjera me theks të veçantë vendosjen e kontrollit efektiv demokratik apo parlamentar mbi këtë agjenci shumë specifike. Intelejencia dhe shërbimet e sigurisë në Kosovë duhet të ndërtohen dhe të veprojnë brenda Kornizës ligjore të re të cilën duhet ky Parlament ta hartoj dhe aprovoj dhe të jetë kompatibil me zhvillimet e demokracisë në vend. Mbetet në përgjegjësinë e institucioneve vendore që kjo agjenci e inteligjencës të ndërtohet dhe të jetë ekskluzivisht profesionale si dhe në asnjë mënyrë ndonjë variant i mentalitetit të ish policive sekrete dhe me dyshime që në start për qytetarët për të cilët unë do të angazhohem si ministër. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër. Alush Gashi i drejtohet ministrit të planifikimit hapësinor z. Ardian Gjini, urdhëroni z. ministër.

MINISTRI ARDIAN GJINI – I nderuar z. kryetar i Kuvendit. Z. kryeministër, ministra, të nderuar deputet të Kuvendit të Kosovës. Para se të fillojë dua edhe njëherë ta falënderoj profesorin Gashi deputetin e nderuar për pyetjen. Kjo pyetje nxjerrë edhe një herë temën e ujërave në Kuvendin e Kosovës që është në esencë diçka shumë e mirë. Pyetja është se çka është duke u ndërmarrë për trajtimin e ujërave të zeza në pjesën e Batllavës liqe akumulues ose në eliminimin e tyre. Unë do t'i paraqes ato që janë marrë deri më tani, pra përgatitjet dhe paraprojektet dhe do t'i bëjë edhe disa komente të cilat kanë të bëjnë me ujërat e zeza në Kosovë për shkak se është një çështje e cila duhet të na preokupoj në vazhdimësi. Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor së bashku me Qeverinë Finlandeze e kanë hartuar një studim mbi strategjinë e trajtimit të ujërave të zeza në qershor të vitit 2004 në tërë territorin e Kosovës, nga kjo ka dalë një e dhënë të cilën e kam përsëritur disa herë në Kuvendin e Kosovës e ajo është se, trajtimi i ujërave të zeza në Kosovë do të kushtoj pak më pak se 700 milion euro, ndërsa buxheti që i ndahet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për ujërat është 100.000 € edhe kjo mendoj se e shpejgon situatën në të cilën gjendemi ne sa ju përket ujërave të zeza sot. Për gjithë rajonin e Prishtinës duke përfshirë liqenin e Batllavës dhe të Badovcit shuma e paraparë për zgjidhjen e këtij problemi shkon në 198 milion euro për shkak se është pjesa më e madhe e trajtimit që do të duhet, me këtë do të trajtoheshin diku 260 mijë metra kub ujë në ditë, vetëm për rajonin e Podujevës paralogaria është 16 milion euro, sidoqoftë në shtator të vitit 2005 në Bruksel të gjitha impiantet rajonale të përfshira në këtë studim kanë hyrë në listën e prioriteteve për programin rajonal për rindërtim mjedisor të paktit të stabilitetit, po ashtu kemi financime prej qeverive të ndryshme në lidhje me studimet që i bëhen për trajtimin e ujërave të zeza p.sh nga Qeveria Çeku për rajonin e Podujevës, kemi disa kompani rajonale të cilat edhe vetë kanë bashkëpunuar me institucione të ndryshme ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza, projektet e ndërmarra deri më sot do t'i radhis shumë shkurtimisht duke i numëruar, janë përfundimi i studimit mbi strategjinë e ujërave të zeza, prezantimi i saj donatorëve në Kosovë, futja në listën e projekteve prioritare të impianteve për institucionet financiare në kuadër të RREP-it, fillimi i ndërtimit të impiantit të parë në Skenderaj me ndihmën e Agjencisë Evropiane të Rindërtimit, përgatitja për ndërtimin e impiantit të dytë në Lipjan pak me ndihmën e AER-it, përfundimi i studimit për trajtimin e ujërave të zeza në qytetin e Prizrenit me ndihmën e Bankës Botërore e shumë projekte të tjera të cilat tregojnë se në departamentin e ujërave të Ministrisë së mjedisit është menduar shumë. Nga e gjithë kjo strategjia që

ekziston në Ministri të mjedisit është që trajtimi i ujërave të zeza duhet të ndodh nga zonat e larta në zonat e ulëta dhe kryesisht në zonat të cilat kemi akumulim të ujit të pijes, këto janë kryesisht në këtë fazë më me rëndësi, Batllava dhe Radoniqi që do të thotë, Podujeva me rrethinë dhe Deçani. Në lidhje me këto unë i kamë pasur disa vizita edhe jashtë vendit, i kamë vizituar impiantet e trajtimit të ujërave të zeza në Monako, duhet të ketë investime private në këtë drejtim, këto investime private i kanë dy probleme në Kosovë, problemi i parë është garancitë sovrane dhe problemi i dytë është inkasomi, që do të thotë se është vështirë që dikush të hyjë e të investoj dhjetëra miliona euro nëse nuk do të ketë inkasim nga shfrytëzuesit e ujit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – A ka pyetje plotësuese, deputeti Alush Gashi ka pyetje për ministrin e Arsimit.

MINISTRI AGIM VELIU – I nderuari z. kryetar, kryeministër, të nderuar kolegë ministra. I nderuari deputet z. Gashi, ju falënderoj për pyetjen dhe interesimin për dy çështje të ndjeshme siç janë: "Analfabetizmi" dhe problemi i trashëguar nga vitet e mëparshme dhe prej shumë faktorëve të tjerë, sipas statistikave të vitit 1999 – 2000 paraqitet rreth 21 deri 25% e popullatës analfabete në Kosovë, si dhe problemi i dhunës në shkollë si diçka që shqetëson, por njëherit edhe duhet të na mobilizoj të gjithëve për parandalimin dhe përpjekjet e shumëfishta për zhdukjen nga përditshmëria jonë. Analfabetizmi, Ministria e Shkencës dhe teknologjisë duke pasur parasysh strukturën, moshën dhe nivelin e ngritjes arsimore në Kosovë ofron dy forma të mësimin, mësimin e rregullt në shkollë i cili sipas ligjit për arsimin para fillor dhe ligjit për arsimin fillorë dhe të mesëm të ulët ju ofron mundësi të shkollimit të gjithë qytetarëve nga moshë 5 deri në moshën 19 vjeçare, qytetarëve të cilët për arsye të ndryshme nuk kanë arritur ta mbarojnë arsimin e obliguar sipas ligjit, Ministria e Arsimit ka bërë përpjekje që të ofrojë mundësinë e dytë nëpërmjet formave të arsimit jo formal. Ministria e Arsimit, shkencës dhe teknologjisë ka hartuar ligjin për arsimin e të rriturve që Kuvendi i Kosovës e ka miratuar në korrik të vitit 2005 dhe i cili mundëson organizimin korrekt të mësimin për të rriturit. Ministria e Arsimit që nga viti 2004 ka filluar arsimin jo formal që organizohet në shkollë, në 24 komuna të Kosovës. Në këtë formë të mësimin janë të regjistruar gjithsej 3.295 vijues, prej tyre në arsimin fillorë 664, ndërsa të tjerët janë në arsimin e mesëm. Ministria e Arsimit në bashkëpunim me UNESCO-n, UNICEF-in ka hartuar projektin shkrim – lexim bazik për gra dhe vajza i cili është hartuar sipas standardeve evropiane. Projekti zhvillohet sipas standardeve evropiane, Projekti zhvillohet nga viti 2001 në 19 komuna dhe në të janë të përfshirë 2500 gra dhe vajza kryesisht nga viset rurale. Qëllimi i këtij projekti është ofrimi i arsimit bazë, niveli i shkollës fillore të ulët dhe njohja e vijuesve me vlerat dhe normat e jetës shoqërore. Grupet punuese të përbëra nga ekspertët e Ministrisë së Arsimit dhe UNESCO-s kanë punuar për akreditimin e programit, standardet dhe hartimin e tekstit përfundimtar që do të organizohet gjatë muajit gusht të këtij viti, janë kryer të gjitha përgatitjet, kjo me qëllimin e mirë që këtyre vijuesve t'u jepet mundësi për vazhdimin e shkollimit ose mundësinë për punësim. Sa i përket pyetjes së dytë "Dhuna në shkollë". Në kontekstin kosovar këtë çështje e shikojmë karshi ngritjes së nivelit të respektimit të të drejtave të fëmijëve në familje, shkollë dhe në sferat tjera që fatbardhësisht kemi ndryshime pozitive, mirëpo kemi edhe vështirësi sepse ende po përballemi me pasojat e luftës dhe pozitën e rëndë ekonomike e që në Kosovë janë

faktorë kryesor që reflektojnë shkeljen e të drejtave. Dhuna në shkollë është e ndaluar me ligj, e kemi kodin e mirësjelljes dhe udhëzimin administrativ, "Ndalimi, ndërprerja dhe iniciimi i procedurës disiplinore për personelin edukativo arsimor që sanksionojnë dhunë në shkollë", pastaj Ligjin e inspeksionit të arsimit dhe zyrën për inspektimin në Ministrinë e Arsimit që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit dhe të akteve tjera nënligjore në fushën e arsimit. Në këtë aspekt janë realizuar disa programe për aftësimin e mësimit në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe vazhdojnë të realizohen. Në vitin 2004 sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ka caktuar një detyrë për një studim i cili i ka rrënjët në të drejtat e fëmijëve, në të drejtën e mbrojtjes së tyre në çfarëdo forme të dhunës i cili studim ka pasur si qëllim promovimeve të parandalimit dhe eliminimit të dhunës ndaj fëmijëve, ky hulumtim është realizuar edhe në Kosovë si një realizim i përbashkët i Ministrisë së Arsimit, UNICEF-it dhe disa organizatave tjera ndërkombëtare. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Keni pyetje plotësuese z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryetar unë nuk kam pyetje plotësuese, u falënderohem ministrit Rexhepi dhe Ministrit Gjini për përgjigje korrekte si dhe ministrit Veliu për një përgjigje ekstensive. Inkurajoj ministrin e Arsimit shkencës dhe Teknologjisë, z. Veliu që këtë çështje kaq të ndjeshme të provojë përmes televizionit publik dhe medimeve tjera që ta ngrit nivelin e senzivilizimit. Po ashtu shfrytëzoj rastin që ta përgëzoj për rezultatet e arritura për zbatim të Ligjit në Universitet, duke shprehur gatishmërinë që të marrin pjesë aktive me promovimin e mësimit dhe eliminimit të analfabetizimit dhe dhunës në shkollë, falënderojmë edhe njëherë në përgjigje korrekte.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Deputeti Alush Gashi ka një pyetje për kryeministrin Çeku, urdhëroni z. kryeministër.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – Z. kryetar, të nderuar deputet, ministra, i nderuari profesor. Pyetja ka të bëjë me motive të angazhimit të dy këshilltarëve nga Kroacia të cilët janë edhe deputet të Kuvendit të Kroacisë. Përgjigja ime është kjo: "Disa nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës, dy nga prioritetet janë: "Realizimi i reformave të domosdoshme për ecjen përpara në kuadër të integritimit Evropian si dhe ndërtimi i mirëbesimit në mes komuniteteve dhe krijimi i kushteve për integritimin e minoritetit serb në veçanti në institucionet e Kosovës dhe në jetën e përditshme në Kosovë". Në këto përpjekje na nevojitet mbështetja e fuqishme e ekspertëve që kanë ekspertizë dhe eksperiencë të pa kontestueshme dhe të pranuar ndërkombëtarisht që kanë kuptim të mirë të situatës dhe të nevojave që ka Kosova. Kroacia ka një përvojë të mirë dhe jo fort të largët në procesin e integritimit evropian si dhe me çështje të minoriteteve, të ngjashme në disa aspekte me situatën nëpër të cilën po kalon Kosova, kështu që si konsultant të jashtëm, apo si këshilltar të jashtëm në zyrën e kryeministrit janë të angazhuar z. Neven Nimica i cili si ish ministër i integritimeve evropiane në Qeverinë e Kroacisë tani deputet në Kuvendin e Kroacisë dhe kryetar i Komisionit për integritimeve evropiane dhe njëkohësisht ka qenë edhe kryesues i Ekipit Negociator të Kroacisë për marrëveshjen e stabilizim-asocimit, kurse këshilltari i dytë është z. Millorad Pupovac, kryetar i partisë demokratike serbe me kombësi nga Kroacia, profesor i shkencave politike në

Universitetin e Kroacisë, njeri i cili që nga pavarësimi i Kroacisë ka shpreh një lojalitet ndaj Qeverisë, ndaj vullnetit të shumicës në Kroaci dhe ka filluar veprimtarinë politike të tij dhe e ka zhvilluar në integrimin e komunitetit serb me pushtetin kushtetues ligjor të Kroacisë dhe njohjen e këtij pushteti, në njohjen e shtetit të tyre dhe integrimin e plotë të tyre. Me veprimtarinë e tij politike ka fituar besimin dhe respektin të popujt shumicë në Kroaci, të administratës në pushtet në Kroaci dhe sot si pakicë serbe është në koalicion me partinë e cila është në pushtet. Është e rastit që të dy ekspertët kroat që u përgjigjeshin këtyre kriterëve janë aktualisht edhe anëtarë të Parlamentit Kroat, këtë unë nuk e shoh si problem për deri sa ata gjithmonë më këshillojnë në këto pika dhe ndajnë kohë që edhe të vijnë kohë pas kohe edhe në Kosovë. Dua ta cekim që z. Mimica ka qenë gjithashtu i angazhuar edhe të tre paraardhësit e mi dhe ka bashkëpunuar afër me ta. Këto shërbime dhe këshillime janë duke u mbështetur financiarisht nga organizatat ndërkombëtare apo programe bilaterale të shteteve anëtare të Bashkimit evropian, kjo pra tejkalon marrëdhëniet bilaterale të Kosovës me Kroacinë, pra këto këshillime më tepër përkojnë me një skemë më të gjërë të mbështetjes që i bëhet Kosovës për të marrë pjesë me sukses në procesin e stabilizim -asocimit dhe për të përparuar në përmbushjen e standardeve në integrimin e minoriteteve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Nuk kemi pyetje plotësuese. Deputeti Alush Gashi i drejtohet me një pyetje ministrit të Ekonomisë dhe Financave.

MINISTRI HAKI SHATRI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputet. Deputeti Alush Gashi për ministrin e financave ka parashtruar pyetjen se: “Kur Qeveria e Kosovës Ministria e Financave do ta paraqes Projektbuxhetin për vitin 2007 para Kuvendit”. I nderuari deputet siç jeni në dijeni edhe nga shqyrtimet e raporteve për buxhetin e vitit paraprak dhe nga diskutimet që janë bërë për miratimin e buxhetit për këtë vit. Ministria e Financave ka konsoliduar një sistem buxhetor të tillë i cili garanton që procedurat buxhetore të zhvillohen në bazë të dispozitave të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e këtyre dispozitave t’u përgjigjet saktësisht edhe me kohë. Për këtë qëllim Ministria e Financave dhe Qeveria kanë bërë përgatitjet paraprake për paraqitjen e projektbuxhetit për vitin 2007 para Kuvendit. Përgatitjet kanë filluar në vitin e kaluar me nxjerrjen dhe nënshkrimin e një dokumenti që quhet letra e qëllimit, pastaj me përgatitjen e kornizës afatmesme të shpenzimeve publike për vitin 2007 dhe dy vitet që pasojnë, dokument i cili është përmirësuar në vazhdim edhe në këtë vit deri në fillim të prillit kur është mbajtur në konferencë me donatorë dhe kur ky dokument është vlerësuar shumë pozitivisht nga Fondi monetar dhe Banka Botërore dhe komisioni Evropian, të gjitha këto po i përmendi si hapa përgatitor të cilët e orientojnë drejtimin e shpenzimeve buxhetore për vitin 2007, pra i kanë krijuar një rrugë, një trase Ministrisë së Financave dhe Qeverisë që të vazhdojë me hapa tjerë konkret. Për qëllime të konkretizimit të dokumentit në fjalë Ministria e Financave punën e vetë e ka filluar në fillim të Marsit me dërgimin e një letre që quhet korniza buxhetore nr. 1, dokument i cili u është shpërndarë të gjitha organizatave buxhetore dhe i cili për të gjitha organizatat buxhetore paraqet rrugën dhe veprimet që duhet të ndërmarrin deri në rumbullakimin e dokumentit të buxhetit për vitin 2007. Në mes tjerash përveç që jepen parametrat makroekonomikë që duhet të respektohen në këtë qarkore buxhetore është paraqitur edhe kalendari buxhetor për përgatitjen e buxhetit për vitin 2007. Në këtë kalendar është

paraparë fundi i prillit, Qeveria të paraqet prioritete që Qeveria i ka provuar, në maj është nxjerrë qarkorja buxhetore nr. 2 dhe janë nxjerrë dy qarkore buxhetore për komunat. Në qershor bëhet dorëzimi i deklaratave dhe strategjive nga organizatat buxhetore. Në korrik bëhet dorëzimi i kërkesave nga organizatat buxhetore. Në shtator bëhet dëgjimi i organizatave buxhetore për kërkesat e tyre. Më 25 shtator e deri në fund të shtatorit kryhet dëgjimi i ankesave të organizatave buxhetore dhe definitivisht me 30 tetor në bazë të Ligjit Kuvendi duhet ta merë në shqyrtim dokumentin e buxhetit për vitin 2007 për miratim, në mënyrë që të ketë 2 muaj për shqyrtim dhe miratim. Shpresojmë se kjo punë do të shkoj sipas kalendarit të paraparë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka z. Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASI – Z. kryetar, falënderoj ministrin për komentimin, pyetje nuk kamë, qëndron ajo se edhe në vitet e kaluara ka ekzistuar kjo dinamik e hartimit, por ne kemi ardhur në pozitë që njëra prej pjesëve më të rëndësishme të veprimtarisë së Kuvendit siç është miratimi i buxhetit që të miratohet 1 apo 2 net para vitit të ri dhe mendojmë se tash janë të gjitha parakushtet që ajo të mos ndodh. Ne jemi të interesuar që ta kemi ndikimin në hartimin e buxhetit dhe jo vetëm ta votojmë buxhetin që e themelon dikush jashtë Kuvendit, andaj ju inkurajojmë që t’ju përmbaheni datave të parashtruara.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Qeveria ka qenë e gatshme t’u përgjigjet edhe pyetjeve të deputetëve tjerë që nuk janë në sallë, janë ata Xhevat Bislimi dhe Sala Berisha - Shala, pasi nuk janë deputetët në sallë nuk mund të jepen edhe përgjigje, do të mbeten për seancën e ardhshme.

Shkojmë në 15 minuta pauzë, ndërsa i ftoj anëtarët e Kryesisë së Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare që të vijnë në zyrën time nja 15 minuta.

P a u z a

Fillimi i seancës pas pauzës

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA– Më në fund mund të konstatojmë se është formuar kuorumi që mund të punojmë më tutje.
Vazhdojmë me pikën e 4 të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Lirinë Fetare në Kosovë

Miratimi në parim i Projektligjit është bërë më datën 20.05.2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendi i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet dhe amendamentet për këtë projektligj.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese kanë vlerësuar se Projektligji për liritë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë ka bazën juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për liritë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se Dispozitat e Projektligjit për liritë fetare dhe pozitën juridike të bashkësive fetare në Kosovë dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve..

Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryetar besoj se do të ishte shumë e udhës që në një farë mënyre të bëhet një sqarim qoftë për seancën, qoftë për opinionin e gjerë, për vazhdimin e punës së seancës. Ne e patëm takimin ku u mbarëm vesh që kjo seancë të vazhdoj deri te pika 8, te pika 8 të ndërpritet dhe të vazhdohet pas një miratimi të një seance me kohë normale të punës, pra të mos krijohet një opinion që grupi parlamentar Ora ka ardhur në seancë dhe nuk ka dalë kot nga seanca, por ka dalë për një arsye parimore, për shkak se një praktikë parlamentare e cila e konsideruam se nuk është e zakonshme për Kuvendin tonë u instalua me anë të votimit, prandaj mendoj se ky sqarim është dashur të jepet në fillim të vazhdimin të punës që të mund të vazhdojmë normalisht me punë.

KRYEETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Jashari, këtë e kemi bërë para se të fillojmë tash, kur është dhënë pauza ma herët është sqaruar, nëse ka nevojë të përsëritet mund të përsëritet edhe njëherë, por është sqaruar, prandaj shkojmë me punë në pikat e rendit të ditës të cilat i kemi paraparë për sot deri te pika 8 e rendit të ditës për të cilën nesër do të shqyrtohet ose do të merret vendim i ri.
Në sallë janë 62 deputet, vazhdojmë.

Amendamenti I

Janë dy propozime, Propozimi i komisionit funksional dhe propozimi i Qeverisë së Kosovës.

Shkojmë me propozim të parë.

Fjalën e kërkon Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI - Z. kryetar i Kuvendit, kamë hetuar se në këtë ligj ka shumë alternativa, ka disa amendamente me dy e tri variante, unë mendoj se në shumicën e herëve variantet janë në mes të komisionit funksional dhe Qeverisë që të shpjegoj paraprakisht ose secilën herë përfaqësuesi i Komisionit funksional pse janë këto dy variante. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, a ka propozim tjetër ,
Fjalën e ka Sadudin Berisha

DEPUTETI SADUDIN BERISHA - Në mungesë të kryetarit të Komisionit unë dua të jap sqarimet rreth alternativave të cilat janë dhënë në Projektligjin që është në leximin e dytë. Komisioni për legjislacion ka pasur parasysh amendamentet të cilat janë ofruar nga Qeveria dhe një grup i caktuar i deputetëve dhe komisioni ka vlerësuar se amendamentet që janë të komisionit funksional duhet të miratohen dhe njëherit të mbështeten amendamentet që janë bërë nga komisioni i Qeverisë së Kosovës, pra alternativa e parë gjithnjë duhet të mbështetet, është rekomandim i Komisionit që duhet të mbështetet në

Kuvend, kështu që nuk ka nevojë nga amendamenti në amendament të jepen shpjegimet, d.m.th mbështeten amendamentet e Komisionit funksional të bëra nga Komisioni funksional dhe amendamentet janë të Qeverisë por të mbështetura nga Komisioni funksional. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEREISHA – Vazhdojmë me amendamente me radhë.

Amendamenti 1

Është propozimi i Komisionit funksional, përgatitemi për votim dhe votojmë tash.

Disa deputet nuk kanë kartela dhe votojnë me vota të hapëta dhe

Për 59

Kundër 0

Kalon amendamenti.

Në raste të këtilla nuk ka objekt për të votuar për alternativën e dytë.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për62

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për61

Kundër 0

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4

I komisionit funksional

Votojmë tash:

Për 61

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5

I mbështetur nga Komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 62

Kundër 0

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6

I mbështetur nga Komisioni funksional.

Kërkon fjalën z. Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar, me që jam propozues i amendamentit, njëra prej tri alternativave, para se të hyhet në votim kisha pasur dëshirë ta arsyetoj shkurt amendamentin. Në këtë amendament janë përfshirë në esencë 2 amendamente të miat, i pari ka të bëjë me lirinë për mësim të një feje apo besimi në vendet e përshtatshme ashtu siç është paraparë edhe në propozimin e Komisionit funksional për lirinë e mësimin të një feje apo besimi në vendet e përshtatshme për këtë qëllim, unë kamë vetëm plotësim. Shkollat publike në pajtim me vendimin e prindërve, hulumtimet e fundit kanë dëshmuar se një e treta e vetëvrasjeve në Kosovë në periudhën 2000-2005 janë të kryera nga ana e adoleshentëve, ky fakt brengosës paraqet vetëm njërin prej treguesve serioz të krizave të rënda emocionale nëpër të cilat aktualisht janë duke kaluar një numër jo i vogël i rinjëve tanë. Sipas përvojës së shumë shteteve zbatimi i lëndës së mësimbesimit në shkollat publike paraqet njërën prej mënyrave më të sigurta për parandalimin e kësaj dukurie dhe shumë dukurive të tjera dramatike në shoqërinë tonë siç janë sëmundjete e varsisë, trafikimi i qenive njerëzore, korrupsioni etj. Amendamenti im është në pajtim të plotë me dokumentin referent evropian për këtë çështje, udhëzimet e komisionit të Venedikut të miratuar në vitin 2004 në sesionin e 95 plenar të Komisionit evropian për demokraci nëpërmjet ligjeve. Me votimin e këtij amendamenti ju do ta renditni Kosovën në mesin e 20 shteteve të bashkësisë evropiane ku lënda e mësimbesimit që moti zbatohet në shkollat publike si lëndë fakultative ose obligative, në mesin e tyre të përmendi të gjitha shtetet skandinave, shtetet e Beneluksit, Austrinë, Çekinë, Spanjën, Hungarinë, Italinë, Gjermaninë etj. Ky ishte arsytimi i shkurtër i amendamentit 1 nenin 3 paragrafin 1 pika (e), ndërsa në kuadër të amendamentit 6 për të cilin do të botohet është edhe pika e re të cilën e kamë propozuar e që ka të bëjë me lirinë për paraqitjen në vende publike me veshje të përcaktuar me norma të fesë ose të besimit përkatës. Në mesë të shumë dokumenteve ndërkombëtare që sigurojnë këtë liri fetare me këtë rast do t'i veçoja vetëm 2. Nenin 18.1 të konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike i cili thotë se çdonjëri ka lirinë e vetëm ose në bashkësi me të tjerët në vend publik ose private të manifestoj fenë ose besimin e tij ose të saj në adurim në përcjellje në praktikum dhe në mësim, dhe dokumenti i dytë neni 9.2 i konventës evropiane mbi të drejtat e njeriut që siguron që liria fetare mund të kufizohet vetëm me ligj dhe vetëm në situatën kur kjo është e domosdoshme për shkak të interesit të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik të shëndetit dhe të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve. Rrjedhimisht liria për paraqitje në vende publike me veshje të përcaktuar me normat e fesë ose të besimit përkatës paraqet të drejtë elementare të njeriut që në asnjë mënyrë nuk mund të cenohet, mbështetur në këtë ju thërras që unanimisht ta votojmë këtë amendament që është me dokumentin referent evropian për këto çështje. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka nënkryetari i komisionit Sadudin Berisha.

DEPUTETI SADUDIN BERISHA – Komisioni ka pasur në shqyrtim propozimin e deputetit Agani, ka vlerësuar se është i pa pranueshëm si i tillë dhe rekomandon komisioni që të votohet alternativa (a) e Komisionit funksional.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, sipas marrëveshjes në fillim ne votojmë për variantin e parë për tekstin që e ka mbështetur komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për54

Kundër7

Kalon amendamenti

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për 52

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për55

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për..... 60

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 60

Kundër..... 0

Abstenim1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 11

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 55

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 12

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për57

Kundër 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 13
I mbështetur nga komisioni funksional
Votojmë tash:
Për 59
Kundër 0
Kalon amendamenti.

Amendamenti 14
I përkrahur nga komisioni funksional.
Votojmë tash:
Për 59
Kundër 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 15
I përkrahur nga Komisioni funksional.
Votojmë tash:
Për 57
Kundër 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 16
I mbështetur nga komisioni funksional.
Votojmë tash:
Për 59
Kundër 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 17
I mbështetur nga komisioni funksional.

Fjalën e kërkon z. Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Me qenë se edhe në këtë amendament e keni versionin që e kamë parashtruar unë të jap vetëm një arsytim të shkurtër, mendoj se amendamenti që e kamë parashtruar unë determinon obligimin e bashkësive fetare që në emërtimin e tyre të përmbajnë emrin Kosovë. Në përcaktimin ligjor të bashkësive fetare në mënyrë të obligueshme të përmbajë emrin Kosovë në asnjë mënyrë nuk cenohet liria fetare e bashkësive fetare, e asnjë bashkësie fetare. Qëllimi i këtij amendamenti është që bashkësisë së caktuar fetare që selin e saj qendrore mund ta ketë edhe jashtë Kosovës të vëhet në mënyrë të qartë brenda Kornizave juridike të shtetit të Kosovës. Konsideroj se ky amendament ka rëndësi të veçantë për sigurimin e veprimit harmonik të të gjitha

subjekteve fetare në territorin e Kosovës gjithnjë në favor të interesit të përbashkët shtetëror. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, shkojmë me amendamentin numër 17

Amendamenti 17

Të përkrahur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 37

Kundër 21

Kalon amendamenti.

Amendamenti 18

I mbështetur nga Komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 53

Kundër 3

Kalon amendamenti.

Amendamenti 19

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 58

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 20

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 58

Kundër 0

Kalon amendamenti.

Amendamenti 21

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 58

Kundër 3

Kalon amendamenti.

Amendamenti 22

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për 56

Kundër 4

Kalon amendamenti.

Amendamenti 23

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për53

Kundër1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 24

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për52

Kundër2

Kalon amendamenti

Amendamenti 25

I mbështetur nga komisioni funksional versioni nën (a)

Votojmë tash:

Për52

Kundër1

Kalon amendamenti i versionit (a)

Amendamenti 26

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për58

Kundër4

Kalon amendamenti.

Amendamenti 27

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për53

Kundër5

Kalon amendamenti.

Amendamenti 28

I përkrahur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për55

Kundër5

Kalon amendamenti.

Në sallë kemi 63 deputet. Ftojë deputetët që të votojmë për tekstin në tërësi me amendamente.

Përgatitemi për votimin e tekstit në tërësi me amendamente.

Votojmë tash:

Për57

Kundër5

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi ligjin për liritë fetare në Kosovë.
Ju faleminderit.

Vazhdojmë me pikën e 5 të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më datën 6. IV. 2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe kornizë kushtetuese ka vlerësuar se projektligji për ndërprerjen e shtatzënisë ka bazën juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e projektligjit për ndërprerjen e shtatzënisë dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Shkojmë në aprovimin e amendamenteve një nga një.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për60

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për54

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për57

Kundër1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për57
Kundër 2
Kalon amendamenti.

Amendamenti 5

I mbështetur nga funksioni funksional.

Votojmë tash:

Për58

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Fjalën e kërkon Zylfije Hundozi

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Unë jam caktuar nga Komisioni funksional si raportuese për këtë projektligj, rusisht janë përvjedhur nja 3 gabime gjatë amendamentimit dhe kisha dashur të ndërhyjë. Në këtë rast në fund të amendamentit 6 shtohet vetëm fjala “menstrual” se “ciklit” nuk po dihet se cilit cikël, ndoshta është harruar se ka pasur paragjykime, por për mjekësi është një gjë normale dhe po e lexoj krejt: “Ndërprerja efektive e shtatzënisë mund të bëhet deri në fund të javës së 12 të shtatzënisë duke llogaritur nga dita e parë e ciklit të fundit menstrual”.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë z. Sadik Idrizi.

MINISTRI SADIK IDRIZI – Ono što je rekla doktorka Hundozi, međutim ovo je u suprotnosti sa zakonom o zdravstvu u kojem stoji 10 nedelja, mi smo imali od naših stručnjaka primedbu da bude 10 a ovde setoji 12 znači je u suprotnosti, član 107 zakona o zdravstvu stoji 10 nedelja.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e kërkon Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë desha ta paraqes vërejtjen të cilën e paraqiti edhe z. ministër dhe mendoj se ky amendament nuk ka vend, prandaj propozoj që ky amendament të mos miratohet, po të ngel teksti fillestar i propozuesit, d.m.th i Qeverisë, sepse Ligji sistemor i shëndetësisë e përcakton shumë qartë kufirin deri kur mund të bëhet ndërprerja efektive e shtatzënisë. Kjo është java e 10 –të. Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për shëndetësi. Ndërsa sa i përket kualifikimit të shtatzënisë është shumë e qartë se si llogaritet shtatzënia, d.m.th. prej kur deri kur dhe mendoj se nuk ka nevojë të përsëritet dhe të thuhet prej ditës së parë deri në ditën e fundit, ditës së parë të ciklit menstrual sepse ai definicion profesional shkencor është i njëjtë në të gjitha shtetet, kështu që mjafton të thuhet vetëm deri në fund të javës së dhjetë të shtatzënisë dhe kjo mjafton.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit doktor. Urdhëroni znj. Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – E vërtetë është që në komision kemi pasur shumë debate lidhur me këtë, mirëpo i kemi konsultuar edhe dokumentet e Organizatës Shëndetësore Botërore dhe në atë definicion për lejimin e abortit efektiv është deri në javën e 12, në ligjet e mëparshme në kohën e socializmit ka qenë java e 10, po tash është java e 12 se edhe në gjinekologji llogariten muajt lunarë të shtatzënisë e nuk llogaritet koha kur ka ndodhur menstruacioni, se atë nuk mund ta dijë askush, kur ka ndodhur, mirëpo ditën e fundit të ciklit menstrual e mban mend secila grua edhe pse tash me ultrazë mund saktë të caktohet se cila javë e shtatzënisë është. Megjithëkëtë jemi bazuar në dokumentet e Organizatës Shëndetësore Botërore që i njeh krejt bota dhe Komisioni Funkcional ka vendosur që amendamenti të mbetet kështu.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit .U dëgjuan propozimet e ndryshme dhe kalojmë në votim.

Varianti i propozuar nga komisioni funksional.

Amendamenti 6

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për35

Kundër25

Kalon amendamenti.

Amendamenti 7

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për58

Kundër..... 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 8

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për57

Kundër 2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 9

I mbështetur nga komisioni funksional.

Votojmë tash:

Për55

Kundër 1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për 58

Kundër 1
Kalon amendamenti.

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Për59

Kundër2

Kalon amendamenti.

Fjalën e kërkon Zylfije Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Për amendamentin 12 ne jemi marrë vesh që në tërë tekstin e Projektligjit fjala “Grua” të zëvendësohet me fjalën: “femër” që këtu është përvjedhur. Në rast se mjeku nuk pranon ta ndërpresë shtatzëninë efektive, institucionet shëndetësore publike dhe ato të përziera janë të obliguara të sigurojnë zgjidhje të përshtatshme. Këtu po shkruan për “gruan” e duhet “femrën” brenda të njëjtit institucion. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – E dëgjuat propozimin, votojmë për amendamentin me vërejtjen.

Amendamenti 12

Votojmë tash:

Për53

Kundër3

Kalon amendamenti.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Për57

Kundër2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 14

Votojmë tash:

Për58

Kundër0

Kalon amendamenti.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Për58

Kundër1

Kalon amendamenti.

Fjalën e kërkon deputetja Zylfije Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Kjo është ndërhyrja e fundit për amendamentin 16. Ky teknikisht është përvjedhur. Ndërprerja e shtatzënisë për arsye krimnologjike bëhet : “për arsye krimnologjik” gjer në javën e 22 të shtatzënisë dhe lindja e ndikuar edhe më vonë me rekomandim mjekësor dhe pas konfirmimi nga institucionet kompetente të cilat janë të autorizuar të përcaktojnë nëse shtatzënia është pasojë e ndonjë veprë penale në vijim”. Kjo është përvjedhur se ka qenë “me aftësi të dëmtuara” nuk ka kuptim ajo, kurse tash për arsye krimnologjike.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit doktoreshë, fjalën e ka ministri Sadik Idrizi.

MINISTRI SADIK IDRIZI – Posle 4 taçke u ovom članu dodaje se 5 tačka koja bi bila: „osobe sa ograničenim sposobnostima rasuđivanja”.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Këtë që e propozoi z. ministri është në nenin 4.4, vetëm e kemi paraparë këtu dhe atje e kemi hequr.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Kalojmë në votim për amendamentin 16 me vërejtjet e deputetes Hundozi.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Për55

Kundër2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Për55

Kundër2

Kalon amendamenti.

Fjalën e kërkon Nurishahe Hulaj.

DEPUTETJA NURISHAHE HULAJ – Një sqarim të amendamenti 18, në rreshtin e 4 jo për” madhësinë e fëmijëve”, por për numrin e fëmijëve, të intervaleve kohore të lindjeve, sepse është fjala për planifikim familjar. Profesionalisht e di për numrin e fëmijëve për planifikimin familjar, fëmijë të dëshirueshëm për familje të shëndoshë, d.m.th. unë personalisht mendoj se jo për madhësinë e familjeve, por për numrin e fëmijëve.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BEERISHA – Kemi votuar për propozimin e komisionit funksional.

Amendamenti 18
Votojmë tash:
Për48
Kundër 1
Kalon amendamenti.

Amendamenti 19
Votojmë tash:
Për53
Kundër1
Kalon amendamenti.

Amendamenti 20
Votojmë tash:
Për55
Kundër.....1
Kalon amendamenti.

Amendamenti 21
Votojmë tash:
Për53
Kundër0
Kalon amendamenti.

Lus deputetët që të votojmë për tekstin në tërësi së bashku me amendamentet e ofruara.
Në sallë janë 62 deputete.

Votojmë tash:
Për58
Kundër3
Kalon projektligji për ndërprerjen e shtatzënisë.

Kalojmë në pikën e radhës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lëndën arkivore dhe për arkivat ,Nr. 2003/07.

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 1. 06. 2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raporte dhe rekomandime me amendamente.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/07 ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/07 për lëndën arkivore dhe arkivat dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2003/07 për lëndën arkivore dhe arkivat dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

I lus deputetët që kanë dal nga salla që të kthehen se nuk kemi kuorum të votojmë.

Fjalën e kërkon z. Rrahmani.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Z. kryetar unë e kam një propozim. pasi që disa po dalin të pinë kafe, disa nuk janë dhe nuk ka kuorum. Ta vazhdojmë punën nesër me kuorum të plotë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Unë e respektoj mendimin tënd, por sot do të vazhdojmë kështu.

E kemi kuorumin.

Në sallë i kemi 61 deputet.

Amendamenti 1 dhe i vetmi i këtij Projektligji.

Votojmë tash:

Për55

Kundër2

Kuvendi miratoi ligjin me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për lëndën arkivore dhe arkivat nr. 2003/07.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardizim nr. 2004/12

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 15. 6. 2006. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/12 për standardizimin, ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/12 për standardizimin dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/12 për standardizimin dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Shkojmë në aprovimin e amendamenteve një nga një.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për58

Kundër0

Kalon amendamenti.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për50

Kundër2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për57

Kundër2

Kalon amendamenti.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për57

Kundër1

Kalon amendamenti.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për61

Kundër0

Kalon amendamenti.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për60

Kundër1

Kalon amendamenti.

Shkojmë me votimin e tekstit në tërësi me amendamentet e aprovuara.

Votojmë tash:

Për61

Kundër0

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për standardizimin nr. 2004/12.

Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë.

Propozoj që të shkojmë me dy pika të rendit të ditës të fundit që i kemi pasur të parapara për sot, pasi pika 8 mbetet për nesër.

9. Shqyrtimi i propozimit të procedurave për emërimin e anëtarit të pestë të Këshillit të Komisionit të pavarur për media.

A pajtoheni që të shkojmë me këtë pikë.

Në pajtim me nenin 4.3 të Ligjit për komisionin e pavarur për media, Kuvendi i Kosovës emëron anëtarin e 5 të këshillit të Komisionit për media duke u bazuar në procedurat e hapura dhe transparente. Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim me OSBE-në ka përgatitur dhe Kuvendit i ka propozuar tekstin e procedurave për emërimin e anëtarit të 5 të këshillit të Komisionit të Pavarur për Media. Materiali u është dërguar me kohë deputetëve.

E hapi debatin.

Pasi nuk ka të interesuar që të marrin fjalën, votojmë:

Kush është për aprovimin e procedurave për emërimin e anëtarit të 5 të Komisionit të pavarur të mediave.

Votojmë tash:

Për57

Kundër3

Në momentin kur në sallë janë 64 deputetë konstatoj se procedurat për emërimin e anëtarit të 5 të Komisionit për media aprovohen me shumicë.

10. Shqyrtimi i Rekomandimit të kandidatëve për drejtor të Agjencisë Kosovare të Antikorrupsionit

Fjalën e kërkon deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryetar mendoj se ne sot si Kuvend edhe në kushte pak sa të vështira e kryem një punë të mirë në aspektin e miratimit të disa ligjeve, prandaj e kam një propozim konkret që pikat e mbetura të mbesin për nesër, kur do të shpresojmë se seanca do të jetë complete, sepse nuk mendoj se do të ishte e hijshme qoftë ta emërojmë dikë me një numër të kandidatëve ose të deputetëve të mangët në seancë dhe në qoftë se vendimet tjera janë të rëndësishme për mbarë Kuvendin që të merren pa qenë Kuvendi në përbërje maksimale, prandaj ju kisha lutur që ta ndërpresim seancën këtu dhe të vazhdojmë nesër me raportin e Qeverisë dhe pikat tjera më pastaj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ne votuam për pikën e 10 të rendit të ditë.

Fjalën e kërkon deputetja Besa Gaxherri

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Faleminderit z. kryetar, unë e kisha lutur kolegun tim që të jemi korrektë, sepse nuk është më i rëndësishmi një person që po duam me e zgjedhë tash për këtë Agjenci sesa ligjet që i votuam. Vazhdojmë punën edhe ashtu e kemi rendin e ditës dhe t'i kryejmë këto pika. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e kërkon deputeti Sabit Rrahmani.

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Z. kryetar Grupi Parlamentar për integrim mbështet propozimin e grupit parlamentar Ora për vazhdimin e seancës nesër.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Propozoj që të mbetet edhe kjo pikë për nesër.

Ju faleminderit për mirëkuptim.
Nesër seanca vazhdon punën në orën 10,00.
Mbledhja mori fund në orën 15,20 minuta.

VAZHDIMI I SEANCËS PLENARE MË 14.7. 2006

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju dëshiroj mirëseardhje. Vazhdojmë seancën e djeshme. I lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre. Kryesia e Kuvendit, së bashku me shefat e grupeve parlamentare, sot ka pasur një mbledhje dhe kemi debatuar rreth kohëzgjatjes së pikave të rendit të ditës, kryesisht për debatin që ka të bëjë me punën 100-ditësh të Qeverisë.

Jemi marrë vesh që secili deputet ta shfrytëzojë të drejtën e diskutimit prej 10 minutash që e ka, prandaj vazhdojmë punën.

Në sallë momentalisht janë 85 deputetë.

Në pajtim me kreun 9.3.1 të Kornizës Kushtetuese, Qeveria e Kosovës e ka përgatitur Raportin për punën 100- ditësh dhe Kuvendit të Kosovës ia ka dërguar për shqyrtim, që përfshin aktivitetet e saj që nga emërimi i z. Agim Çeku kryeministër të Kosovës, që nga data 10 mars 2006. Raporti u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Ju njoftoj se në mbledhje të përbashkët të Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare u mor vendimi, për të cilin ju njoftova më herët.

Ftoj kryeministrin ta marrë fjalën.

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU – I nderuari kryetar i Kuvendit të Kosovës, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Ju përshëndes dhe e arsyetoj mos prezencën e disa ministrave, ngase është duke vazhduar takimi i 10-të i mekanizmit përcjellës të stabilizim- asocimit. Prezent janë z. Pribe, drejtor i Drejtoratit për Zgjerim. Disa ministra do të vijnë më vonë, disa do të shkojnë përsëri, por sidoqoftë do t'i përgjigjemi kërkesës suaj.

Më lejoni që të paraqes një përmbledhje të raportit të cilin e kemi hartuar dhe që ua kemi dërguar për punën tonë në këto 100 ditët e para. Kur më 10 mars nga ky Parlament morëm votëbesimin për të udhëhequr Qeverinë e Kosovës, jam zotuar për përgjegjësinë e rëndë të qeverisjes së vendit në një moment kyç se do ta ushtroj me përkushtim dhe me qëllimin që të rikthej besimin e shqiptarëve të Kosovës në ekzekutivin e vendit dhe që me angazhimin tonë t'i japim shtyrje realizimit të procesit të definimit të statusit.

Po ashtu, jam zotuar për forcimin e mëtejshëm të institucioneve, për përmirësimin e kushteve ekonomike të qytetarëve të Kosovës, për forcimin e stabilitetit politik dhe të sigurisë, përmirësimin e qeverisjes dhe kuadrit ligjor, dinamizmin e punës rreth përmbushjes së standardeve. Më tej kam theksuar se si qeveri do të jemi të hapur ndaj të gjitha detyrimeve, duke u ballafaquar me sfidat e qeverisjes, pa e harruar se për punën tonë duhet t'u japim llogari këtij Parlamenti dhe qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, unë jam caktuar për ta përmbushur këtë zotim dhe për të prezantuar para jush dhe qytetarëve të Kosovës disa nga veprimet e të arritura të Qeverisë gjatë punës 100 - ditësh, që në fakt janë të arritura të përbashkëta, mendoj jo vetëm të Qeverisë, por edhe të Parlamentit dhe institucioneve të tjera.

Gjatë këtyre 100- ditëve Qeveria i ka kryer obligimet dhe detyrat e veta dhe unë e vlerësoj pozitivisht punën dhe angazhimin e ministrave në këtë periudhë. Gjatë kësaj periudhe janë shënuar suksese, të arritura të shumta, të cilat janë reflektuar pozitivisht në zhvillimet rreth Kosovës dhe për Kosovën. Mbështetja e procesit të definimit të statusit politik të Kosovës, zbatimi dhe vlerësimi pozitiv i standardeve, ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve, transparenca institucionale dhe aktivitetet e shumta, me qëllim të përshpejtimit të zhvillimit ekonomik, janë disa prej angazhimeve kryesore të Qeverisë në këtë periudhë. Gjatë këtyre 100- ditëve Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare, ka arritur ta avancojë funksionimin e institucioneve demokratike, ta ruajë stabilitetin politik dhe sigurinë, ta përmirësojë dhe ta rrisë imazhin dhe kredibilitetin ndërkombëtar të Kosovës.

Serioziteti dhe dinamika e re e krijuar në punën e Qeverisë, bashkëpunimi dhe partneriteti i Kosovës me komunitetin ndërkombëtar në Kosovë dhe qendrat e jashtme vendimmarrëse kanë shënuar një qasje më të pranueshme dhe më shumë rezultate.

Gjatë këtij 100- ditshi, Qeveria e Kosovës ka qenë e angazhuar në mënyrë intensive dhe të shumanshme në procesin rreth përcaktimit të statusit. Me angazhimin e saj dhe me procesin e bisedimeve ajo ka kontribuar në këto fusha:

Në pjesëmarrjen dhe punën e Delegacionit të Kosovës në Vjenë dhe punën me Grupin politik strategjik, posaçërisht rreth përcaktimit të politikave dhe të strategjive negociuese, ruajtjen e koherencës dhe të unitetit në kuadër të Delegacionit të Kosovës dhe rritjen e konstruktivitetit, zbatimin e politikave të brendshme qeveritare dhe prodhimin e argumenteve që mbështesin kërkesën tonë për pavarësi, që u mundësojnë Kosovës një bazë të mirë negociuese dhe një mbështetje të duhur për Grupin Negociator në arenën ndërkombëtare.

Aktiviteti i shtuar diplomatik, i përqendruar në çështjen e statusit dhe me qëllim të promovimit të dhe argumentimit të synimit tonë për pavarësinë e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, Qeveria e Kosovës e ka përshpejtuar procesin për përmbushjen e standardeve për Kosovën, sepse i konsideron këto standarde si element të rëndësishëm në përshpejtimin e proceseve të statusit final, ashtu edhe në shkurtimin e rrugës tonë për integrim në Bashkimin Evropian.

Kosova ka arritur që ta sigurojë raportimin më pozitiv deri më tani për punën në implementimin e standardeve para Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si vlerësim teknik i përpiluar nga UNMIK-u dhe institucionet tona. Gjithashtu edhe në raportin politik të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Kofi Anan, vlerësohet pozitivisht puna e Qeverisë së Kosovës në përmbushjen e standardeve.

Qeveria, përveç procesit të zbatimit të standardeve, në vazhdimësi ofron Kosovën pranë standardeve të BE-së dhe po i siguron partnerët ndërkombëtarë se ne jemi të gatshëm të marrim përgjegjësi të plotë që na takojnë.

Ndërkohë, Grupi i Kontaktit ia ka prezantuar Qeverisë së Kosovës një listë prej 13 prioritetesh për të cilat kërkohen veprime të fokusuara kryesisht në përmirësimin e kushteve për minoritetet.

Qeveria i është përgjigjur këtyre kërkesave me plan veprimi dhe me implementim të përshpejtuar. Qeveria është në fazën e përmirësimit të 13 pikave dhe shpreh vendosmërinë për përfundimin e tyre para afateve të kërkuara.

Qeveria gjatë këtij 100- ditshi e ka intensifikuar angazhimin për krijimin e kushteve për ndërtimin dhe forcimin e besimit ndëretnik, duke i dhënë një kuptim më praktik nocionit të ndërtimit të besimit. Gjatë 100- ditshit janë ndërmarrë një varg nismash për rindërtimin e pronës dhe të objekteve të kultit, fushata vetëdijesimi. Janë bërë vizita të shumta nëpër vendbanimet e komuniteteve pakicë dhe janë organizuar debate të shumta me qytetarë, si dhe janë themeluar mekanizma konkret në funksion të këtij qëllimi siç janë : Grupi veprues për ndërtimin e besimit dhe Këshilli për sigurinë e komuniteteve. Përveç angazhimeve të lartpërmendura kjo periudhë 100- ditësh karakterizohet me një angazhim të shtuar në përmirësimin e vetëqeverisjes, ngritjen e transparencës dhe të llogaridhënies institucionale, luftën kundër korrupsionit, menaxhimin më të mirë të buxhetit, si dhe uljen e shpenzimeve të Qeverisë, me qëllim të kthimit të besimit të qytetarëve në Qeveri. Gjatë kësaj periudhe, Qeveria ka krijuar mekanizmat e komunikimit me qytetarë nëpërmjet tryezës për komunikim me qytetarë, zyrës për ankesa, botimin e Gazetës Zyrtare, fjalimin javor të kryeministrit, udhëzimet administrative për qasje në dokumentet zyrtare etj. Një varg aktiviteteve janë ndërmarrë me qëllim të përmirësimit të gjendjes së të drejtave të njeriut, luftës kundër korrupsionit, kujdesit më të mirë ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe barazisë gjinore. Është ftuar Zyra e auditorit të përgjithshëm për auditim të Qeverisë duke filluar nga Zyra e kryeministrit dhe ky auditim ka përfunduar. Jemi duke pritur rezultatet e auditimit për Zyrën e kryeministrit.

Vazhdon me ministrinë e tjera. Gjatë këtij 100- ditshi është funksionalizuar puna e Këshillit për Emërime të Larta Publike. Deri më tash kemi pasur disa vendime, disa takime dhe nuk kemi asnjë ankesë në vendimet tona. Po ashtu, ne kemi vënë në fokus aktivitetet me qëllim përmirësimi të mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik të njohur si platforma e tri E-ve. Dua të ritheksoj se platforma e tri E-ve paraqet një vizion që synon që në mesin e parametrave të ndryshëm t'u japë prioritet atyre që sigurojnë kapitalizimin më të shpejtë dhe me efektiv të dy resurseve kryesore të Kosovës, e ato janë burimet natyrore të nëntokës dhe burimet njerëzore.

Zhvillimi i sektorit të energjisë lehtëson prodhimin industrial. Në të njëjtën kohë është gjenerues i vendeve të reja të punës dhe një rrjet i tërë shërbimesh. Nga të ardhurat e siguruara nga prodhimi i energjisë duhet të formohet një fond i veçantë zhvillimor për sektorët e tjerë, siç janë sektorët e infrastrukturës, sektori i arsimit etj. Jemi të vetëdijshëm se është esenciale të maksimalizohet profiti prej shfrytëzimit të pasurive të vendit. Këtë gjë mund ta bëjë më së miri një gjeneratë njerëzish të arsimuar e të aftë duke vënë në përdorim arritje teknologjike dhe duke shfrytëzuar pasurinë intelektuale të njerëzimit. Prandaj e shohim si imperativ të Qeverisë reformimin dhe

investimin në sistemin edukativ , me qëllim që ai të përgatisë kuadro të gatshëm që do të përballen me sfida të zhvillimit dhe konkurrues në tregun global të punës. Nuk janë të panjohura për ne shembujt e vendeve që thjeshtë duke menaxhuar burimet njerëzore ia kanë dalë të sigurojnë progres të vendit. Në raport me to Kosova ka një avantazh shtesë, e kjo është pasuria e jashtëzakonshme natyrore e vendit.

Binomi energji - edukim është shtyllë dhe garanci për perspektivë të qëndrueshme ekonomike të Kosovës. Platforma e tri E-ve përmbledh strategjitë për çdo E. Vizioni ynë i përgjithshëm ka një bosht kryesor orientimi, agjendën e integritetit evropian. Evropa, pra përmban E-në e katërt të programit tonë. Kjo platformë kërkon kohë dhe angazhim të jashtëzakonshëm dhe njëqind ditë janë periudhë shumë e shkurtër për të bërë përparime të dukshme, megjithatë Qeveria e Kosovës edhe gjatë kësaj periudhe të shkurtër ka bërë disa hapa të rëndësishëm në funksion të kësaj platforme.

Në fushën e energjisë, Ministria e Energjisë dhe e Minierave, së bashku me UNMIK-n arritën një marrëveshje me Bankën Botërore për politikën për të tërhequr kapitalin e jashtëm privat në sektorin e energjisë në Kosovë. Rezultat i menjëhershëm i kësaj marrëveshjeje ka qenë një donacion prej 8.5 milion € dhe hapja e Zyrës së projektit drejtues për termocentralin Kosova C. Kjo marrëveshje, si dhe miratimi i strategjisë për energji, paraqet një zhvillim të rëndësishëm për resurset minerale të Kosovës dhe kapacitete gjeneruese të energjisë ,pra tregon dhe ka një të ardhme që ofron shumë mundësi për rritje ekonomike.

Gjatë kësaj periudhe është përfunduar rehabilitimi i termocentralit Kosova A -4, është përmirësuar furnizimi me energji elektrike, janë duke u bërë të gjitha përgatitjet për një furnizim sa më stabil gjatë dimrit.

Në fushën e edukimit, Qeveria ka vazhduar aktivitetet e rregullta në procesin e reformave në të gjitha fushat dhe nivelet arsimore. Aktiviteti parësor ka qenë i përqendruar në rivendosjen e ligjshmërisë dhe në reformën e Universitetit të Prishtinës. Për këtë qëllim janë miratuar udhëzimet dhe vendimet përkatëse administrative të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë dhe të Qeverisë, që e ka përkrahur zhvillimin e zgjedhjeve të lira në Universitetin e Prishtinës, konstituivën e organeve drejtuese të Senatit dhe Këshillit Drejtues, si dhe zgjedhjen e rektorit. Ky proces ka qenë në pajtim me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe se përfundimi suksesshëm i tij , i hap rrugë anëtarësimit të Universitetit të Prishtinës në Asociacionin e Universiteteve Evropiane.

Qeveria do ta mbështesë Universitetin e Prishtinës në rrugën e integriteteve, ngritjen e cilësisë, përmirësimin e infrastrukturës dhe në ngritjen e vazhdueshme profesionale dhe shkencore të stafit akademik. Gjithashtu, do ta inkurajojmë Universitetin që sa më shpejtë të hartojë një strategji zhvillimore ,që bazohet në strategjinë për zhvillimin e arsimit të lartë në periudhën 2005-2015, të miratuar nga Qeveria e Kosovës.

Qeveria e Kosovës , gjatë këtij 100- ditshi i është qasur me shumë seriozitet hartimit të planit dhe të strategjisë zhvillimore të Kosovës, që do të jetë një ofertë e fuqishme e

Kosovës që nga dita e parë e pavarësisë. Nëpërmjet kësaj strategjie ne do t'i kanalizojmë investimet kapitale për të krijuar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Sa i përket aktivitetit të përshpejtimit të zhvillimit ekonomik, vlen të theksohet organizimi i konferencës së donatorëve në prill të këtij viti ku Qeveria e Kosovës arriti të sigurojë 55 milion € përkrahje buxhetore për vitet 2006-2007.

Qeveria gjatë këtij 100- ditshi ka ndërmarrë aktivitete të përkrahura me biznese vendore , ku vërehet rritje e importit të mallrave për investime që janë si rezultat i lirimit nga obligimet tatimore të atyre mallrave. Procesi i privatizimit ka vazhduar me privatizimin e disa ndërmarrjeve më të rëndësishme , trendët e përgjithshme shfaqin një stabilizim të treguesve kryesor me rritje të disa prej tyre , por mbetet për t'u bërë edhe më shumë në balancimin e bilancit tregtar.

Qeveria gjatë kësaj periudhe ka arritur lartë në agjendë objektivin e përmbushjes së kriterëve për afrim me Bashkimin Evropian. Gjatë kësaj kohe është përpiluar plani i veprimit për partneritet evropian. Është harmonizuar legjislacioni kosovar me atë evropian dhe është punuar në ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e agjendës evropiane.

Qeveria ka themeluar Agjencinë për Integritet Evropian dhe ka ndërmarrë nismën për hapjen e Zyrës Ndërlidhëse në Bruksel. Është mbajtur një takim i mekanizmit përcjellës të stabilizim- asocimit dhe tjetri është duke u mbajtur sot. Përveç këtij mekanizmi vlerësohet progresi ynë drejtë përafritimit me Bashkimin Evropian dhe se deri më tani vlerësimet janë pozitive.

Edhe Pakti i Stabilitetit ka vazhduar punën në ngritjen e bashkëpunimit rajonal. Qeveria e ka intensifikuar veprimtarinë në rritjen e bashkëpunimit me vendet fqinjë dhe ka dhënë mesazhe të qarta, se shteti i Kosovës do të prodhojë stabilitet, do të ndërtojë marrëdhënie të fuqishme të fqinjësisë së mirë me të gjitha vendet e rajonit.

Ky bashkëpunim ka ndihmuar në nxitjen e tregtisë së lirë në rajon. Qeveria ka nënshkruar një varg marrëveshjesh me Shqipërinë, Maqedoninë, Turqinë, Bosnjë- Hercegovinën dhe disa tjera janë në procedurë e sipër.

Këto janë disa nga të arriturat e përbashkëta të Qeverisë gjatë këtij 100- ditshi Janë shënuar rezultate të shumta dhe në çdo sektor ,që evidentohen edhe në raportin që keni përpara. Do t'i përmend vetëm disa prej tyre.

Në sektorin e ekonomisë dhe të financave, përveç të arriturave që përmenda më lartë, janë shënuar edhe këto të arritura: janë finalizuar dokumentet bazike lidhur me programin e investimeve publike dhe kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2007-2009. Komisioni Evropian, Banka Botërore dhe donatorët e tjerë i kanë vlerësuar pozitivisht proceset buxhetore dhe dokumentet përkatëse. Janë rritur të hyrat e mbledhura brenda në vend si rezultat i ngritjes së shkallës së deklarimit nga ana e tatimpaguesve , si dhe rritjes së kontrollit prej ATK-së.

Realizimi i shpenzimeve është sipas nivelit të paraparë me Ligjin e buxhetit dhe projeksionet tona deri në fund të vitit janë që do të realizohet afërsisht sipas planit, krahasuar në vitin e kaluar vërehet se në shumicën e kategorive kemi ulje të shpenzimeve.

Në sektorin e industrisë dhe të turizmit, është finalizuar projekti i Bankës Botërore i quajtur BETA. Kanë vazhduar punimet e infrastrukturës të parkut industrial në Drenas, është realizuar projekti i inkubatorit të biznesit në Deçan dhe Gjilan, në bashkëpunim me Agjencinë Evropiane të Rindërtimit dhe është në përfundim edhe projekti në Shtime.

Krijimi i uan stop shopeve (qendrave lokale të biznesit), këto qendra do të jenë stacioni i parë dhe më i afërt i bizneseve nëpërmjet të cilave do të lehtësohen të gjitha procedurat për biznese.

Është përfunduar faza e pilot-projektit të skemës së këshillimeve dhe trajnimeve mbi bazën Voqerve e financuar nga AER-i. Ministria gjatë kësaj faze ka përgatitur këto projektligje:

Projektligji për fondet e investimeve,
Projektligji për zonat e lira industriale,
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për standardizim
Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë
Ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për patentën.

Gjatë kësaj periudhe , janë mbajtur tri rundet e privatizimit ku janë privatizuar gjithsej 57 ndërmarrje shoqërore. Mbi 400 ndërmarrjeve u është dhënë leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë projektuese apo prodhuese. Departamenti për Turizëm ka përgatitur pjesën analitike të strategjisë për zhvillimin e turizmit në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur tri raundet e privatizimit ku janë privatizuar gjithsej 57 ndërmarrje shoqërore. Mbi 400 ndërmarrjeve u është dhënë leja e punës për ushtrimin e veprimtarisë projektuese apo prodhuese. Departamenti për Turizëm ka përgatitur pjesën analitike të strategjisë për zhvillimin e turizmit në Kosovë.

Në sektorin e energjisë dhe të minierave, përpos atyre që i thamë më lartë, është përgatitur Projektligji për hulumtime gjeologjike në Kosovë. Është ky studimi për vlerësimin paraprak të hidro-potencialeve të Kosovës. Me këtë është krijuar mundësi për tërheqjen e investimeve private edhe në këtë fushë. Është themeluar Instituti Sizmologjik i Kosovës. Ky institut tashmë ka filluar ta realizojë projektin e rjetit sizmik të Kosovës. Ka filluar hartimi i strategjisë për zhvillimin e sektorit të xehetarisë, faza përgatitore është kryer. Është përgatitur dokumenti: „Strategjia e Kosovës për ristrukturimin e Trepçës”.

Në sektorin e arsimit, Ministria e Arsimit ka vazhduar aktivitetet të rregullt në procesin e reformave në të gjitha fushat dhe në të gjitha nivelet arsimore, sipas politikave zhvillimore të parapara në strategjinë zhvillimore të arsimit të Kosovës 2002/2007.

Në Departamentin e Arsimit Para universitar janë realizuar të gjitha aktivitetet e parapara me planin e punës . Në arsimin e lartë aktiviteti kryesor ka qenë përqendruar në Universitet. Ka filluar zbatimi i projektit të OSBE-së për avancimin e proceseve të planifikimit, menaxhimit dhe të raportimit të financave në Universitetin e Prishtinës .

Ka filluar punën Grupi i ekspertëve për themelimin e Qendrës për Inovacione dhe Transfer të Teknologjisë. Janë kryer të gjitha përgatitjet për themelimin e Agjencisë së Akreditimit. Në kuadër të bashkëpunim ndërkombëtar gjatë kësaj periudhe kohore janë realizuar këto aktivitete: nënshkrimi i marrëveshjes me CESES italiane për themelimin e Institutit Pedagogjik dhe nënshkrimi i programit ekzekutiv me Ministrinë e Arsimit të Maqedonisë.

Në bashkëpunim me Zyrën franceze ,Universitetin e Shtullit dhe Universitetin e Parisit 12, është iniciuar procesi për krijimin e programit të magjistrimit për punonjësit e institucioneve të Kosovës në fushën e studimeve të administratës publike.

Në Sektorin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe të Zhvillimit rural është përgatitur projekti për themelimin e Fondit për zhvillimin rural, që do të sigurojë grante plotësuese për fermerët , si dhe për ndërmarrjet rurale. Janë marrë të gjitha masat për parandalimin dhe evitimin e gripit të shpezëve. Është themeluar Enti i Verërave. Është nënshkruar memorandumi me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit , që ia lejon Ministrisë të drejtën e menaxhimit me pyjet dhe tokat pyjore publike. Është bërë licencimi i 45 ordinancave private të cilat kryesisht merren me preventivat, shërimin e sëmundjeve dhe përmirësimin e shëndetit të kafshëve etj.

Gjatë kësaj periudhe , Ministria ka hartuar këto projektligje:

Projektligjin për mbrojtjen e bimëve,
Projektligji për peshkatari,
Projektligji për mbrojtjen e varietetit.

Në Sektorin e Kulturës ,Rinisë dhe Sportit, ka filluar implementimi I fushatës "Ruaje-është jotja", për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë. Është nënshkruar marrëveshja me Bankën Botërore për ndihmë në sektorin e rinisë me vlerë për 2 milion dollarësh për tri vjetët e ardhshëm. Ka filluar implementimi i fondit me vlerë prej 1 milion eurosh për integrim social dhe pjesëmarrje të të rinjve të grupeve të marginalizuara , të rinjtë minoritarë, vajza të reja, të rinjtë me aftësi të kufizuar dhe të rinjtë e viseve rurale.

Kanë filluar punimet restauruese , konservuese në tri tërësi: Katedra e Shën Xhorxhit në Prizren, Kisha e Shën Nikollës në Prishtinë dhe Manastiri i Deviçit. Është themeluar Qendra Kinematografike dhe si pas Ligjit për kinematografinë, Ministria e ka bërë zgjedhjen e drejtorit dhe e ka filluar organizimin administrativ të këtij institucioni.

Është organizuar gjysmë- maratona me karakter ndërkombëtar në atletikë, dhe janë mbështetur aktivitete të shumta sportive brenda dhe jashtë vendit. Janë bërë investimet në infrastrukturë sportive në; Klinë, Dardanë, Skënderaj, Fushë Kosovë dhe Podujevë. Në Sektorin e Transportit dhe Post- Telekomunikacionit, janë marrë masa për sanimin e gjendjes dhe hapjen e rrugës Prishtinë -Hani i Elezit. Masat emergjente kanë pasur për qëllim sigurimin e pjesës së dëmtuar të rrugës dhe hapjen e rrugës anësore, kontribut ky i Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe KFOR-it.

Ka filluar studimi i vizibilitetit për sanimin e përhershëm të gjendjes së kësaj rruge dhe pritet që ky sanim të përfundojë deri në nëntor të këtij viti. Është bërë shpallja e tenderit për kompaninë konsulente për telefoninë mobile. Janë shpallur të gjitha tenderët për investime kapitale në infrastrukturë rrugore që janë planifikuar për këtë vit.

Është nënshkruar marrëveshja për zonën apo hapësirën e përbashkët të aviacionit me Bashkimin Evropian dhe me shtetet Evropës Juglindore. Është bërë licencimi i auto-shkollave dhe i instruktorëve dhe janë kryer përgatitjet për fillimin e punës për patentë shofer në të gjitha kategoritë.

Në Sektorin e Mbrojtjes, të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, është hartuar Ligji për vlerësimin strategjik të mbrojtjes së mjedisit dhe është bërë amendamenti i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit. Është në fazën e implementimit plani i Kosovës për veprim në mjedis. Ka përfunduar diskutimi publik i planit hapësinor të Kosovës. Është përgatitur Propozim- udhëzimi për kushtet e përkohshme të rregullimit të zonës së Prevallës në Parkun Nacional -Malet e Sharit. Është hartuar Ligji për parqet nacionale dhe Ligji për zhurmën. Janë inauguruar dy objekte të reja për banorët e kampit të Plemetit, si dhe janë siguruar mjetet e nevojshme për mbylljen e tërësishme të këtij kampi.

Në Sektorin e Shëndetësisë- në Sektorin e Politikave Zhvillimore të Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë është fokusuar në përpilimin e strategjive për avancimin e shëndetësisë në Kosovë, formulimin e legjislacionit përkatës, posaçërisht të spitaleve rajonale dhe Qendrës Klinike Universitare.

Është themeluar dhe është funksional Bordi për licencimin e institucioneve shëndetësore private. Është themeluar Inspektorati Shëndetësor dhe ka filluar punën. Është hartuar strategjia për parandalimin e gripit. Janë bërë përgatitje të nevojshme për mbikëqyrjen e sëmundjeve të veçanta të etheve hemorragjike.

Në Sektorin e Shërbimeve Publike, ka përfunduar faza e parë e hartimit të strategjisë për reformën e administratës publike dhe është bërë drafti i parë i raportit për gjendjen aktuale në administratën publike. Janë bërë përgatitjet intensive për mbajtjen e regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Me qëllim të rikonstruktimit të kadastrit të tokave janë përfunduar termat e referencave. Është hartuar Udhëzimi administrativ për unifikimin, organizimin e koeficienteve të pagave në shërbimin civil të Kosovës. Është finalizuar Projektligji për shndërrimin e poseduesve në pronarë. Në kuadër të planit të Institutit Kosovar për Administratën Publike (IKAP), për

periudhën mars- maj 2006, janë kryer 23 programe trajnimi me 852 pjesëmarrës dhe me 224 ditë trajnimi në shtatë fusha.

Në Sektorin e Pushtetit Lokal, është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme puna e kuvendeve komunale në zbatimin e ligjshmërisë, nëpërmjet pjesëmarrjes së rregullt në punën e seancave komunale. Ka filluar dhe identifikimi i ligjeve që prekin kompetencat e komunave dhe është bërë përgatitja e doracakut të ligjeve për të ndihmuar komunat në njohjen dhe zbatimin e ligjeve që lidhen me pushtetin lokal. Është dizajnuar raporti vjetor- statistikor i komunave për të monitoruar efikasitetin e komunave në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Janë ndihmuar pilot- njësit komunale në procesin e hartimit dhe miratimit të statuseve të tyre.

Në fushën e zhvillimit të legjislacionit janë hartuar disa projektligje dhe udhëzime administrative.

Në Sektorin e Kthimit, gjatë 100 -ditëve të fundit në fokus të Ministrisë së Kthimit ka qenë edhe realizimi i programit të vetëdijesimit për kthimin e qëndrueshëm dhe përfshirja e pakicave në institucionet e Kosovës . Ka filluar projekti i ndërtimit të 86 shtëpive në fshatin Babush të Ferizajt. Fillimi i projektit në fshatin Klinave të Klinës për ndërtimin e 26 shtëpive, fillimi i ndërtimit të 28 shtëpive në komunën e Leposaviqit, në fshatrat: Bisticë, Cerajë dhe Koshtovë.

Është realizuar kthimi individual i të zhvendosurve serbë e të tjerë në shumë komuna të Kosovës , si në Pejë, Istog, Klinë etj. Janë ndarë 1 milion € nga buxheti i ministrisë për projekte të ndryshme të kthimit.

Në Sektorin e Politikave Sociale, gjatë këtij 100- ditshi, ka vazhduar puna në vendosjen e standardeve të duhura për shërbimet dhe mbrojtjen sociale, mbështetjen e gjerë dhe të qëndrueshme financiare të qytetarëve me nevojë, duke u zbatuar kriteret e ligjshme dhe transparente për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Në kuadër të shërbimeve sociale një kujdes i veçantë është duke u treguar për fëmijët e braktisur dhe pa kujdes prindëror. Gjithashtu, bashkimit dhe strehimit familjar, strehimit të përkohshëm në shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur e adoptimin dhe formave tjera të mbrojtjes.

Është punuar në mbrojtjen e fëmijëve me sjellje asociale dhe delinkuentëve të mitur. Gjatë kësaj periudhe ka pasur 22 raste të strehuara të cilat përcillen nga qendra për punë sociale dhe divizioni i shërbimeve sociale. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, me UNDP-, në projekt programin projekt për gjenerimin e punësimit, është duke u realizuar punësimi afatgjatë i punëkërkuesve. Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të këtij projekti, janë punësuar 61 l persona në të gjithë Kosovën. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Odën e Avokatëve të Kosovës është duke realizuar projektin për punë praktike për juristë në të cilin janë angazhuar 20 juristë praktikantë në tërë komunat e Kosovës.

Në Sektorin e Sigurisë gjatë këtij 100- ditshi janë bërë disa hapa të rëndësishëm në fushën e sigurisë. Janë themeluar Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe ka filluar kalimi gradual i kompetencave në këto ministri. Është intensifikuar puna në procesin e rishikimit të Sektorit e Sigurisë që do të rezultojë me definimin e sistemit nacional të sigurisë në Kosovë. Në këtë kuadër ka filluar puna edhe në krijimin e Shërbimit Inteligjent të Kosovës.

Është themeluar Këshilli për Siguri të Komuniteteve, i cili është paraardhës i Këshillit Nacional të Sigurisë. Është punuar në krijimin e bazës së mirë ligjore për funksionimin dhe koordinimin e aktiviteteve të Ministrisë së Punëve të Brendshme me Shërbimin Policor të Kosovës.

SHPK-ja gjatë kësaj periudhe ka vazhduar me kontinuitet aftësimin dhe zhvillimin profesional. Në kuadër të transferimit të kompetencave dhe rritjes së efikasitetit, me një urdher të veçantë është bërë gradimi i pesë kolonelëve në gradën gjeneral, me qëllim të shtrirjes sa më të gjerë që SHPK-ja ka krijuar në 9 nënstacione të reja. Trupat e Mbrojtjes së Kosovës me sukses kanë vazhduar zhvillimin, aftësimin dhe profesionalizimin e mëtutjeshëm dhe ndonëse TMK-ja është e drejtë e rezervuar, Qeveria ka gjetur mundësi dhe hapësirë për të bashkëpunuar me TMK-në në projekte të rëndësishme të infrastrukturës, ndërtimin e besimit ndërmjet komuniteteve dhe në planifikimin dhe disejnimin e strukturës së ardhshme dhe trajtimin e pjesëtarëve aktual të TMK-së që mund të mos jenë pjesë e strukturës së re.

Këto janë disa nga të arriturat e Qeverisë gjatë 100- ditshit me të cilat ne kursesi nuk mund të mburremi, por megjithatë mund të theksojmë se në përputhje me kushtet me të cilat kemi vepruar kemi bërë përparim të prekshëm që qartazi evidencohen në këtë raport.

Këto përparime janë vlerësuar edhe nga bashkësia ndërkombëtare, që gjithnjë e më shumë po bindet në aftësinë e Kosovës për të qenë shtet stabil dhe funksional.

Gjatë 100 ditshit të parë, Kosova i është afruar pavarësisë. Fundi i 100 ditshit të dytë përputhet me 15 nëntorin, kr pritet publikimi i rezultateve të procesit të statusit.

Qeveria e Kosovës do të fokusohet në përgatitjen e Kosovës për të qenë një shtet stabil, funksional dhe inkluziv.

Në 100 -ditshin e parë kemi të arritura të prekshme. Tani Qeveria do të vazhdojë të përballet me sfidat që dalin në lidhje me kthimin, zbutjen e papunësisë, të gjendjes sociale, zhvillimin ekonomik dhe të sektorit energjetikës, përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës dhe luftimin e korrupsionit.

Pos përmirësimeve sektoriale, Qeveria do të rrisë përkushtimin në lidhje me fazën përfundimtare të procesi të statusit final. Qeveria do të synojë të forcojë unitetin e faktorit kosovar në këtë proces, si dhe të ofrojë garanci për pjesëtarët e minoriteteve që të kyçen në jetën institucionale dhe shoqërore të Kosovës.

Në këtë fazë shumë të rëndësishme të historisë së Kosovës, Qeveria e Kosovës llogarit në përkrahje të Kuvendit të Kosovës, UNMIK-ut dhe të shoqërisë civile, për ruajtjen e stabilitetit politik dhe institucional. Për ruajtjen e stabilitetit dhe sigurisë presim angazhim të shtuar të KFOR-it , UNMIK-ut, SHPK-së dhe TMK-së.

Jemi para realizimit të ëndrrës për të qenë të pavarur dhe Qeveria e Kosovës do të punojë që Kosova të hyjë menjësisht dhe e sigurt në ditën e parë të Pavarësisë.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Kryeministër. Fjalën e ka deputeti Alush Gashi në emër të LDK-së

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar, zonja dhe zotërinj deputetë, kryeministër dhe Kabinet qeveritar.

Pas shqyrtimit të raportit të Qeverisë në gjitha nivelet organizative të LDK më lejoni t'ju konfirmoj që LDK e mbështet punën e Qeverisë dhe kërkon angazhim të shtuar për realizimin e programit.

Ftoj deputetë e Grupit Parlamentar të LDK të marrin pjesë në debat lidhur me raportin e shtruar nga ana e kryeministrit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, z. Gashi. Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së z, Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, i nderuar ministër z. deputetë. Edhe Grupi Parlamentar i PDK-së ka lexuar me vëmendje të shtuar raportin 100- ditor të kryeministrit dhe na vjen mirë që pas gati dy vjetësh vitesh Qeveria del me një raport 100- ditor para Parlamentit. Unë do t'i them disa fjalë në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Ajo që bie në sy është se më se paku kemi të bëjmë me një raport 100- ditor të punës së kabinetit Çeku. Raporti po të lexohet më kujdes, në veten e tij ngërthen të gjithë punën që është bërë gjatë këtyre shtatë vjetëve të administrimit të pasluftës në Kosovë, së dyti raporti nuk është në koordinim as më Programin e Qeverisë – për të cilin punuan tre kryeministra.

Kryeministri nuk ka treguar se cilat kanë qenë detyrat që ju ka dhënë ministrave të Kabinetit të tij për të cilat është bërë shumë zhurmë në fillim të mandatit të tij dhe si pasojë nuk tregon as çka është realizuar nga ato detyra të dhëna, nëse vërtet ka pasur detyra. Ky do të ishte raporti 100- ditor i kabinetit Çeku.

Në raport nuk thuhet asnjë fjalë për politikën ekonomike të kryeministrit të ri. Çka ka bërë gjatë kësaj kohe për të stimuluar prodhuesit vendorë? A ka politika lehtësuese

fiskale për t'i stimuluar prodhuesit vendorë? A mund të mendohet zhvillimi ekonomik pa stabilizimin e energjisë elektrike? Cilat janë rezultatet e tregtisë së lirë për të cilën bëhet shumë zhurmë? Çka ka bërë për të zbutur papunësinë, për ta ndërprerë diferencimin në Shërbimin civil, për të depolitizuar e reformuar arsimin? Sa ka ndryshuar punën e Këshillit për emërimet të Lartë publike e ligjit të Shërbimit Civil 2001/36? Sa ka ndihmuar Këshillin e Pavarur Mbikqyres të bëhet i pavarur e në mbrojtje të të larguarve pa të drejt nga puna.

Kryeministri tha se nuk ka ankesa nga shërbyesit civilë për KELP-in.. Po ju përkujtoj që kryeministri që në raportin e Sektorit për Siguri të Brendshëm dhe besoj që fjalën e ka: për Këshillin e Lartë për Emërimet thuhet: Po e citoj: "Nga 11 sektretarët e përherëshëm të emëruar nga KELP-i gjatë vitit 2003 vetëm dy vazhdojnë të jenë në vendin e punës, të tjerëve ose nuk u është vazhduar kontrata ose janë shkarkuar. Vetëm dy vjet pas krijimit KELP-i de facto u transformua nga një institucion i emërimeve dhe garantues i stabilitetit në një miratues të shkarkimeve, duke i kontribuar kështu jostabilitetit në shërbimin civil.

Ministria e SHP ka përjetuar lëkundjet më radikale me përjashtimin e mbi 95% të shërbyesve civilë në pozita të nivelit të lartë, përfshirë edhe sekretarin e përhershëm...." Ndërsa kryeministri thotë se nuk ka ankesa. Natyrisht njerëzit nuk kanë besim në këtë Qeveri dhe për ata as nuk kanë ankesa. Ndërsa në të njëjtin raport për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës thuhet për : "... ai të bëhet organ i pavarur që do t'i raportojë Kuvendit të Kosovës. Mandati i tij duhet t'i përfshijë të gjitha nivelet e shërbimit civil me autorizime të obligueshme për të marrë masa në rast të shkeljes së ligjit". Në raport do të duhej të thuhej, në raportin e Qeverisë- Çka ka bërë Qeveria në eliminimin e tri sistemeve të drejtësisë apo çka ka ndërmend të bëjë?

Dihet se në Kosovë veprojnë tri sisteme të drejtësisë, sistemi i kaluar, sistemi i drejtësisë i UNMIK-ut dhe ligjet që miratohen në Kuvend dhe që janë të pazbatueshme. Në raport tri herë flitet për privatizimin, një herë kryeministri ia mvesh suksesin veti, kështu bëjnë edhe dy ministra të tjerë. Ky proces edhe pse ka defekte të shumta, sidomos rreth Feronikelit, ku ka pasur e kanë mbetur shumë defekte që po të vepronte ligji do të duhej të hetohej kjo lëndë tepër e dyshimtë. Kjo lëndë është e AKM-së jo e Qeverisë. Nëse ka sukses në privatizim ai është meritë e AKM-së, asesi e Qeverisë. Nëse Qeveria e merr "suksesin" ajo duhet ta marrë edhe përgjegjësinë për të gjitha defektet dhe ato defekte nuk janë të pakta në privatizim.

Procesin negociator Qeveria ia mvesh veti, kurse tërë bota e di se ky proces është duke u udhëhequr nga Grupi i Unitetit. Aty është hisja e institucioneve të tjera ku nuk mungon as hisja e opozitës. Në raport ka edhe përvetësime të tjera edhe nga sferat që kanë qenë e vazhdojnë të jenë në kompetencat e UNMIK-ut, të donatorëve të ndryshëm dhe iniciativat e tjera të institucioneve të pavarura të sferës së kulturës, të sportit dhe të fushave të tjera. Qeveria sikur më shumë është kujdesur në numrin e faqeve të shumta se sa në punët e kryera.

Çka ka bërë kryeministri i ri në shpërbërjen e strukturave paralele në siguri, gjyqësi, arsim e shëndetësi? Për këtë nuk thuhet kemi asnjë fjalë. A ka bërë diçka që të ketë

lidhje më të drejtpërdrejta ndërmjet Auditorit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë Publike? As këtu nuk jepet asnjë sqarim. A ka Qeveria ndonjë plan për reformimin e sistemit të drejtësisë e të sigurisë? Çka ka bërë për të mundësuar sundimin e ligjit?

Më e mira e këtij raporti është gatishmëria e kryeministrit për të dalë me një raport para Kuvendit të Kosovës, anipse ky nuk është raport 100- ditor dhe tepër pak ngjet me raport të detajuar, konkret e transparent për të bërat e të pabërat e Kabinetit të ri qeveritar.

Raporti nuk tregon as edhe për një pengesë që ka mundur t'i dalë në rrugë Qeverisë, nuk tregon as edhe për një projekt të porealizuar Mendoj që po të lexohet programi i Qeverisë shihet se aty ka shumë projekte që kanë mbetur të panisura e mos të flasim të paaralizuara. Qeveritë e koalicionit në fuqi, gjatë këtyre dy vjetëve sapo bëhen nuk arriten asnjëherë të na ofronin as edhe një raport në kuptimin më të mirë të fjalës. Të shpresojmë në ardhjen e një qeveri që di të bëjë raport të punës. Qytetarët e Kosovës janë duke e pritur një qeveri të tillë! Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, z. Krasniqi. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit, i nderuari z. kryetar z. kryeministër, ministra, deputetë të nderuar.

Z. kryeministër, ju faleminderit për gatishmërinë që të raportoni para Kuvendit me ç' rast po dëshmoni integritet të lartë në punë.

Grupi Parlamentar i Aleancës e vlerëson se raporti për punën 100- ditësh është inkurajues me trend pozitiv. Grupi Parlamentar i Aleancës përgëzon kryeministrin dhe ministrat e Qeverisë të Kosovës për punën dhe seriozitetin e treguar në angazhimet e tyre.

I nderuari kryetar, pas qeverisjes 100- ditësh të Qeverisë Çeku lirisht mund të nxjerrim një bilanc të padiskutueshëm pozitiv. Treguesit evidencojnë rritjen e stabilitetit në fushën politike ekonomike dhe të sigurisë. Pas tre muajsh qeverisje kryeministri Çeku ka forcuar besimin e popullit dhe të bashkësisë ndërkombëtare në institucionet e Kosovës. Qasja dinamike e punës qeverisëse ka bërë që Qeveria e Kosovës të vlerësohet pozitivisht si nga popullata ashtu edhe nga institucionet e huaja relevante. Qeveria Çeku ka dhënë impulset e para të stabilitetit politik, ekonomik dhe social si dhe afirmimit të çështjes së Kosovës. Këtu duam t'i përmendim sidomos të arriturat në vijim.

1. Duke pasur parasysh autoritetin dhe kredibilitetin e padiskutueshëm të kryeministrit, Qeveria e Kosovës ka qenë e pranishme dhe e përfaqësuar në shumë takime ndërkombëtare dhe bilaterale. Këtu vlen të theksojmë vizitat në SHBA dhe takimi me sekretaren e Shtetit Kondoliza Rajs, me nënsekretarin e Shtetit Nikolas Berns dhe takimet me përfaqësuesit e lartë të Bashkësisë Evropiane si ministrin e Punëve të Jashtme të Austrisë z. Plasnik, përfaqësuesin e lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri z. Solana si dhe takimi me ministrin e Jashtëm gjerman Shtajner.

1. Aktivitetet diplomatike në këtë nivel të takimeve kanë hapur një kapitull të ri të politikës së jashtme të Kosovës dhe afirmimit të zgjidhjes së statusit të Kosovës. Gjithashtu janë zhvilluar aktivitete dhe veprime për avancimin e agjendës së Kosovës për integrimet evropiane.
2. Përparime të dukshme janë evidencuar në implementimin standardeve për Kosovën, raporti i PSSP-së para Këshillit të Sigurimit ka qenë pozitiv. Po ashtu vlerësimi politik i standardeve nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara z. Anan ka qenë i lartë.
3. Për shkak të qasjes transparente dhe të paparagjykimeve Qeveria ka arritur ta stabilizojë situatën e tensionuar në Universitetin e Prishtinës. Janë bërë hapat e parë drejt legjitimitimit të strukturave universitare dhe depolitizimit të këtij institucioni shumë të rëndësishëm.
4. Është shtuar intensiteti i angazhimeve për integrimin e minoriteteve dhe janë marrë masa për stimulimin e besimit ndëretnik dhe afrimin e komuniteteve.
5. Është vërejtur gjithashtu transparencë e shtuar në punën e Qeverisë dhe afrimit të strukturave qeveritare me popullin.
Këto i kanë mundësuar vizitat e kryeministrit dhe ministrave në vendet e ndryshme të Kosovës, kërkesat e kryeministrit për auditim të përgjithshëm të Qeverisë, hapja e Zyrës për komunikim me qytetarët si dhe komunikatat javore të kryeministrit drejtuar qytetarëve të Kosovës.
6. Qeveria gjithashtu, me sukses është duke përfunduar bartjen e kompetencave në fushën e rendit dhe të drejtësisë nga UNMIK-u. Ky proces është intensifikuar falë qasjes konstruktive të Qeverisë dhe transferimi i kompetencave në këtë fushë ka arritur një zhvillim të mirë.
7. Një e arritur e rëndësishme së posaçme është bërë në Sektorin e Energjisë, marrëveshja e arritur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, UNMIK-ut dhe Bankës Botërore mundëson tërheqjen e kapitalit të jashtëm privat në sektorin e energjisë. Kjo paraqet një zhvillim të rëndësishëm për Kosovën, sepse hap perspektivën për zhvillim ekonomik në të ardhmen. Kjo do të mundësojë krijimin e vendeve të reja të punës për qytetarët, buxheti do të përfitojë nga tatimet e reja dhe nga termocentrali i ri do të eksportohet energjia jashtë. Edhe pse Qeveria ka bërë përpjekjet meritore Kosova ka një mori problemesh që kërkojnë qasje të menjëhershme.

Problemet kryesore janë në sektorin e ekonomisë, të punësimit, të pronave, në shëndetësi dhe drejtësi. Këtu Qeveria e Kosovës në tremujorin e ardhshëm duhet të tregojë përkushtim edhe më të madh dhe së bashku me Kuvendin e Kosovës t'i qaset zgjedhjes së këtyre problemeve. Një pjesë e konsiderueshme e legjislacionit në këto fusha është

përgatitur nga Qeveria dhe miratuar nga Kuvendi, kështu që duhet të bashkëveprojnë për përmirësimin e gjendjes në këta sektorë relevant të shoqërisë.

Përveç angazhimeve të lartpërmendura inkurajojnë Qeverinë që në tremujorin e ardhshëm të vazhdojë me qasjen dhe ritmin edhe në sektorët ku është arritur sukses i konsiderueshëm. Kështu implementimi i standardeve sidomos të 13 pikave të caktuara nga Grupi i Kontaktit duhet të vazhdojë. Angazhimet për procesin e statusit final të Kosovës, për Kosovën e pavarur dhe sovrane duhet të vazhdojnë dhe të intensifikohen. E njëjta gjë vlen edhe për përfundimin e reformave në Universitetin e Kosovës, vazhdimin e angazhimeve në sektorin e energjisë, ngritjen e transparencës së punës së Qeverisë.

Në këtë kontekst Grupi Parlamentar i Aleancës veçon 6 prioritete për tre muajt e ardhshëm.

1. Pika e parë, buxhetin për vitin 2007
2. Finalizimi i planit për zhvillimin ekonomik.
3. Stabilizimi i situatës në shëndetësi
4. Çështja e pronave dhe
5. Statistika dhe reforma gjyqësore

Hartimi i buxhetit do të bëhet ndryshe nga ai i deritashëm, si nga aspekti formal, ashtu edhe nga aspekti përmbajtësor. Limitet kohore dhe diskutimi i buxhetit si kondita ligjore duhet të respektohen.

Të njëjtën kohë grupi ynë parlamentar qëndron pas konceptit buxhetor të prezantuar gjashtë muaj më parë, ku kërkohet konsolidimi nëpërmjet të ardhurave të qëndrueshme dhe buxhetit që në radhë të parë do të kontribuojë ngritje të impulseve ekonomike dhe investimeve në projekte të leverdishme. 2. Finalizim i planit zhvillimor ekonomik që ka filluar para dy vjetësh.

Stabilizimi i situatës në shëndetësi, jetësimi i reformave shëndetësore, ngritja e cilësisë së shërbimeve, krijimi i sistemit të sigurimit shëndetësor janë të nevojshëm, po ashtu çështja e pronave si çështje më problematike në shoqërinë kosovare.

Grupi Parlamentar i AAK-së mbështet kryeministrin dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës në angazhimet e tyre në fushat e përgjegjësisë, që ushtrojnë, po ashtu, inkurajon Qeverinë që t'ju qaset këtyre problemeve dhe të shfrytëzojë komunikimin me Kuvendin e Kosovës në drejtim të implementimit të reformave të nevojshme. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka z. Veton Surroi

DEPUTETI VETON SURROI – I nderuari z. kryetar, z. kryeministër e nderuara Qeveri, zonja dhe zotërinj.

Jam befasuar kur në ftesën që e kemi marrë për këtë mbledhje e kemi marrë edhe ftesën për raportin 100- ditor të Qeverisë. Në fakt është dashur të kemi një raport 500- ditor

apo 600- ditore të Qeverisë, Qeveria nuk ka ndryshuar thellësisht, kanë ndryshuar kryeministrat.

Mund të thuhet që ndoshta ka ndryshuar mënyra e qeverisjes, e kjo është më shumë çështje e stilit se sa substancës, por në thelb kemi një formë qeverisjeje që nga dita e parë e saj është karakterizuar me esencën improvizues në atë se çka do të bëjë me një program i cili më as që mbahet në mend. Kemi dëgjuar raportin e kryeministrit, por nuk kemi dëgjuar asnjë citat nga programi, çka nga ai program është realizuar deri më sot.

Qeverisja pa koncept është qeverisje që mbështet në imputet politike në menaxhimin politik dhe kjo qeveri dhe qeveritë e kaluara kanë qenë të atilla qeveri që kanë pasur obligime të përmbushin standarde dhe të cilat në mënyrë të përhershme bëjnë dy gjëra.

1. Lexojnë gazeta për të parë se çfarë është reciprociteti i auditoriumit publik dhe
2. Dëgjojnë raportet që mund të bëhen në një apo në tjetrën zyre për sa i përket përmbushjes së standardeve.

Raporti megjithatë kishte shumë të arritura dhe një raport i atillë tregonte për një gjendje të mrekullueshme në qeverisje në Kosovë, ndoshta edhe mund të jetë i tillë ndoshta mund të jenë të arritura të gjitha ato që i tha kryeministri por për fat të keq realiteti nuk po i dëgjon raportet, realiteti është krejt tjetër prej asaj realitetit të qytetarëve tonë është krejt tjetër prej asaj se çka dëgjojnë në raport. Në 500 ditët e kaluara kemi dëgjuar se si zbatohet ky standard ai standard se si bëhet kjo lëvizje ky takim politik, ose ai tjetri, por nuk kemi dëgjuar për një shifër makro sociale do të thosha edhe ekonomike të vendit tonë. Ajo është se çdo i dyti qytetar është i varfër dhe shkalla e varfërisë së skajshme ka shkuar prej 13 po i afrohet diku 18%. Pra brenda një viti çdo i pesti kosovar do të jetojë në varfëri të skajshme.

Kur kemi këso elementesh atëherë nuk mjaftojnë përshkrimet për një takim apo për takimin tjetër politik për një tërë Qeveri dhe tërë një Parlament fakt. Në fakt duhet të debatojnë për atë se si të zvogëlohen këto parametra.

Ne kemi marrë një raport ku na jepet përshkrimi se si i kanë avancuar negociatat, negociatat për fat të keq kanë shërbyer procesi i statusit ka shërbyer për të tria qeveritë e këtij koalicioni ose për të tre kryeministrat e këtij koalicioni si mburojë ndaj mos angazhimit ose angazhimit të mangët ose mungesës së plotë të angazhimit në sferat tjera. Statusi në fakt ka të bëjë me një të arritur politike të Kosovës ku pushteti dhe opozita punojnë së bashku, por ma së paku ka të bëjë me atë se çka bënë Qeveria, është vërtetë Qeveria e kaluar ose kryeministri, qeveria me kryeministër të kaluar është përmendur në kontekst negativ në raportet e sigurimit, kjo qeveri nuk është përmendur në kontekst negativ, por pozitiv, por në fakt procesi i negociatave udhëhiqet në strukturë politike e jo në atë qeverisëse.

Ajo çka ndoshta do të duhej përmendur në këtë raport është se Kosova nuk ka kryeministër. Kryeministri Çeku dha raport dhe dha në emër të Qeverisë, por kryeministri Çeku nuk ka të drejtë t'i ndërrojë ministrat e vet, sepse këtë nuk do t'ia lejojë koalicioni qeverisës. Në këto kushte kjo është qeveri me një zëdhënës qeveritar. Z.

Çeku u vu në pozitë të keqe që t'u japë raport ministrave të tij ,të jetë zëdhënës i ministrave të tij, por jo edhe të një qeverie të cilën ai do të udhëhiqte.

Në raport u përmend zbritja e papunësisë dhe për këtë dua të analizoj së paku minimalisht se duhet kujdesur çka thuhet. Në fakt as kjo qeveri as ato të mëparshmet nuk kanë pasur as më të voglin gjest për zbritje të papunësisë. Zbritja e papunësisë nuk bëhet me akt ,me dekret, por me ndryshimin e strukturës ekonomike të Kosovës. Në mënyrën se si menaxhohet edhe paraja publike edhe ajo private se si qarkullon ajo.

Për këtë qasje sipërfaqësore si p.sh. zbritja e papunësisë kemi në këtë raport edhe në segmentet e tjera, të arritura të mëdha në shëndetësi, por kemi një kolaps në sistemin tonë shëndetësor, të arritura në arsim ku në fakt edhe do përkrahur hapat në Universitet. Megjithatë nuk kanë çuar një ristrukturim të Universitetit apo të sistemit universitar në Kosovë. Kosova ende nuk ka ose Universiteti i saj publik ende nuk funksionon sipas ligjit. Ndonëse funksiononte me ligj në sistemin socialist, natyrisht se duhet të kujdesemi me fjalët e mëdha siç janë sundimi i ligjit.Në këtë qeveri rrinë dy ministra që janë të lidhur me çështjen e Svis Kazinos. Si e dini Svis Kazino nuk është një ndërmarrje e pastër funksionale ekonomike, kjo është një çështje që e ka dëmtuar imazhin dhe një çështje që ka treguar paligjshmëri ,por ka treguar paligjshmëri në Qeveri dhe nga Qeveria.

Çështja është tash si do të sundojë ligji nëse tolerohet shkarja nga ligji brenda Qeverisë. Në këtë raport është dashur doemos të përmendet në mos për asgjë tjetër, atëherë për ta përmendur Mitrovicën. As kjo Qeveri as ky Kuvend sot nuk ka bërë shumë për atë qytet të ndarë dhe kemi hyrë në proces negociator me një qytet të ndarë, duke u përpjekur në fund të atij procesi i negociatave ta shpëtojmë qytetin si tërësi. Në këtë raport është dashur të tregohet diskrepanca e madhe në formën se si mbushet arka publike. I tërë raporti do të bjerë poshtë në momentin kur kuptojmë se të ardhurat publike të Kosovës menaxhohen ose mblidhen në të njëjtën formë si janë mbledhur para 4 ose 5 vjetësh, me formë të njëjtë të mbledhjes së të ardhurave publike me sasi të njëjtë të ardhurave publike Kosova do të funksionojë jo më mirë do të funksionojë kështu si do të funksionojë sot, mund të ketë qeveritarë më të talentuar, por nga aspekti i funksionimit ,nga aspekti i asaj se sa disponon me para publike, do të jetë e njëjtë.

Këtu përmenden dhe këtu dua t'ju tërheq vërejtjen për lehtësinë me të cilën tregojmë për rezultatet siç është marrëveshja e tregtisë së lirë. Nuk ekziston koncept më i mirë në zhvillimin e ekonomisë së tregut,kanë kapacitet eksportues e kjo do të thotë zvogëlim i mëtutjeshëm i buxhetit , kjo do të thotë cilësi më e vogël e shërbimeve publike.

Nëse kjo Qeveri mbetet do t'i rekomandoja, që ta ruajë këtë raport që të na e lexojë vitin e ardhshëm, gjendja do të jetë e njëjtë. Ju faleminderit!
KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Surroi. Fjalën e ka Mahir Yagcilar

DEPUTETI MAHIR JAGXHILLAR – Ju faleminderit z. kryetar, Sayın Meclis Başkanı, sayın Başbakan, Bakan ve milletvekiller

Her Hükümet için ilk yüz günlük çalışma raporu çok önemlidir. Hükümetimiz ve aynı zamanda tümümüz için de 100 günlük çalışma Raporunun önemli olduğunu biliyoruz.

6+ Parlamenter Grubu olarak biz, geçen 100 günlük dönem süresinde, istikrarlığın sağlandığını ve standartların uygulanması ve ve Güvenlik Konseyi ile tüm diğer uluslararası etmenler tarafından ortaya atılan olumlu değerlendirmeleri bakımından, ileriye doğru adımların atıldığını düşünüyoruz. Bu olumlu değerlendirmeler ve gerçek durum Kosova vatandaşlarının çoğunun dilediği gibi Kosova'nın bağımsız bir devlet statüsüne formal olarak da sahip olmasını sağlayacaktır.

Rapor'da da vurgulandığına göre, azınlık toplulukları için çok önemli olan Türk dilinde ders kitaplarının basılması, Türk dilinde eğitim süreci, Türk dilinde de resmi gazetenin yayınlanması, kültür enstitülerine ve derneklerine sunulan destek gibi sağlanan olanaklar açısından çok sayıda olumlu ve başarılı adımları vurgulamak isterim.

Ancak, yasaların hazırlanması ile görevli çalışma gruplarına dahil edilmeyişimiz gibi yanlışlıklar hala tekrarlanmaktadır. Özellikle, Toplulukların güveni ile ilgili Danıştayın kurulması konusunda hiçbir bilgimizin olmaması ve aramızdan hiçbirimizin bu gruba katılmayışı, topluluklara ait hiçbir sermaye projelerinin olmayışını yetersiz buluyoruz. Özellikle, Pirane-Mamuşa yolunun inşaatı konusunda destekten mahrum kaldığımızı vurgulamak istiyorum. Ayrıca, koalisyon partnerleri olarak bu konularda danışman statüsünden yoksun kaldığımızı ve Kosova için önemli olaylara dahil edilmememizi de vurgulayarak, topluluğumuz için çok önemli olan Türk dilinin daha geniş boyutta kullanılması konusundaki daha büyük duyarlılık istiyoruz.

Türk topluluğunun temsilcisi olarak, prensipsel olarak Raporu destekliyoruz ve aynı zamanda, gelecek dönemin, toplulukların katılımı açısından daha verimli ve başarılı olacağına inanmaktayız. Bundan başka topluluklar anılırken, sadece Sırp topluluğunun göz önünde bulundurulmaması gerektiğini de vurgulamamda yarar vardır sanırım.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Për Grupin për Integrim ,Sabit Rrahmani

DEPUTETI SABIT RAHMANI – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar, të nderuar deputetë

Meqenëse Grupi Parlamentar për Integrim ka iniciativë që të forcohet pozita e minoriteteve në institucionet e Kosovës, unë fillimisht do t'i prek disa çështje vetëm të minoriteteve, kurse besoj që kolegët do t'i përfshijnë gjërat e tjera që janë me rëndësi.

Z. kryeministër, ju me të vërtetë keni pasur një vullnet mjaft të bujshëm që të punoni në interesin e komuniteteve, ne ju urojmë për punën që keni bërë deri më tash. Ndoshta 100- ditë nuk mjaftojnë që të ambientohesh në një drejtim krejt tjetër ,duke marrë

parasysh me atë që e ke pasur, por ne jemi të kënaqur me punën tënde dhe me vullnetin që e ke, por jo me të arriturat në përgjithësi.

Ka pasur ngecje në implementimin e standardeve për pakica dhe ky ka qenë edhe reagim i Grupit të Kontaktit ku Qeverisë ia ka prezantuar edhe 13 pika shtesë në përmirësimin e kushteve të minoriteteve. Qeveria, para disa ditësh pohoi që vetëm dy prej tyre janë në përfundim e sipër, kjo është thënë në media. Ne shpresojmë që ju do të insistoni edhe më tepër që pozita e minoriteteve të jetë sa më pozitive në këtë drejtim.

Kabineti flitet që është mundur të ndërtojë dhe ta forcojë besimin ndëretnik, ende z. kryeministër, ndoshta edhe si pasojë se vetë kabineti juaj nuk ka të emëruar asnjë pjesëtar nga komuniteti pakicë në cilësinë e këshilltarit, unë mendoj që ky veprim me siguri do të ndikonte pozitivisht që të emërohej një këshilltar për çështjet e minoriteteve nga pakicat, që nuk e keni. Po ta kishit emëruar ndoshta do të ishte edhe një shembull për të tjerët që vetë kryeministri dhe kabineti i tij është në gjendje të forcojë besimin ndëretnik, por ju nuk e keni bërë këtë. Ne shpresojmë që do ta bëni së paku gjatë mandatit që e keni, së paku një këshilltar për çështje të minoriteteve të jetë nga pakicat e jo nga shumica, meqenëse ai merret me problemet e pakicave.

Po ashtu pakicat e tjera në krahasim me komunitetin serb janë kryesisht të anashkaluara dhe ende jo seriozisht Qeveria fillon të merret me pakicat jo serbe. Këtë e them për faktin që edhe në raportin e juaj flitet që ju e keni ngritur Këshillin e Sigurisë për Komunitete. Pra, ne jemi në dijeni gjithë për këtë, ku thuhet që për përmirësimin e kushteve të jetesës në Kosovë me përkrahje të veçantë për serbët e Kosovës. Thënë të drejtën, ndoshta pakicat e tjera nuk i prek, por mua më prek personalisht. Pakicat e tjera e kanë dhënë provimin para juve, gjithmonë janë të përfshira në institucione me ju, ju përkrahin për pavarësinë e Kosovës, por prapë serbët edhe pse e kundërshtojnë statusin final të jetë pavarësia, i kundërshtojnë institucionet, nuk marrin pjesë në institucione Qeveria e Kosovës prapë më së shumti i përkrah ata se neve, edhe është fakt se një ndërkombëtar para disa ditësh tha në televizion që pakicat e tjera në institucionet e Kosovës janë pjesë e kategorisë së dytë.

Po ashtu kampi i Plemetinit dhe ai i Mitrovicës ende mbeten njollë e zezë për Kosovës, sepse janë dedikuar mjete shumë gabimisht. 7 milion euro z. kryeministër nga UNDP-ia janë marrë nga ministria e komuniteteve dhe kthimit. Ministri i juaj Slavisha Petković thotë - Unë nuk kam qasje tek ato mjete, thotë pyetni institucionet e Kosovës pse. Unë nuk kam qasje, thotë, se nuk di çka do të bëhet me ato mjete, kanë qenë të autorizuar që 7 milion € prej Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit t'ia japim UNDP-is. Plus asaj thotë vetë në Qeverinë këta e kanë thënë në takimin e komisionit parlamentar për komunitete dhe kthim kolegët janë këtu.

Ne kemi të identifikuar 37 familje që janë kthyer prej diasporës, por pjesa më e madhe janë vendosur prapë në kampe. Këtu flitet që kampi i Plemetinit është në përfundim e sipër, kjo nuk është e vërtetë, sepse ata nuk kanë shtëpi, pjesa më e madhe i tyre i kanë shtëpitë e uzurpuesc, ne bëjmë kërkesa. Nga 23 kërkesa që ia kemi bërë Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit asnjë nuk ka marrë përgjigjeje, duke u arsyetuar se nuk ka

mjete se 7 milion euro menaxhon UNDP-ia jo Ministria e Komuniteteve, edhe pse ato mjete janë të Ministrisë së Komuniteteve që janë të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Plus asaj 1 milion e 800 mijë euro. Z. kryeministër kemi informacione zyrtare nga ministri që janë dhënë për trenin humanitar në kohën kur minoritetet janë në situatë shumë të vështirë, 1 milion e 800 mijë euro ndahen prej fondit të minoriteteve. Ne këtë informatë e kemi marrë para dy dite në takim zyrtar. Unë nuk e di pse Qeveria lejon që mjetet e komuniteteve t'i jap për tren humanitar, ai tren humanitar paguhet. Paguhet me një shumë simbolike 1 euro, por kryesorja paguhet. Atëherë pse janë dhënë 1 milion e 800 mijë euro, le të jetë edhe transporti gratis, ato para janë marrë prej komuniteteve, d.m.th. nuk janë dedikuar në vendet ku ka nevojë, p.sh. në kampin e Plemetinit, në kampin e Mitrovicës, por janë dhënë për trenin humanitar. Ne e dimë që Kosova ka pak para, por minoritetet kanë më së paku dhe nuk është dashur që ato mjete t'u merren minoriteteve.

Z. kryeministër, disa zyrtarë në Ministrinë e Komuniteteve dhe të Kthimit të merren edhe me fushata elektorale në rast të një kërkese që e bëjnë, merren me fushata elektorale partiake nga zyrtarët madje fyhen në baza nacionale. Ne kemi informata. Një njoftim të tillë e kemi marrë edhe ju me shkrim edhe vetë ministri, por nuk ka pasur përgjigjeje deri më tash. Kjo ka qenë para tre muajve dite nëse nuk gaboj diku 18 ditë pasi që ju jeni zgjedhur kryeministër.

Z. kryeministër, ministri i Komuniteteve dhe i Kthimit në shumë takime është ftuar në takim nga komisioni parlamentar për interesat e komuniteteve, por asnjëherë nuk është përgjigjur. Kurrë nuk është përgjigjur me përjashtim të një ftese kur e kemi marrë edhe ju. E shohim si të arsyeshme mos prezencën tuaj, meqenëse kemi agjentë mjaft të ngjeshur dhe e dimë që si kryeministër kemi obligime të mëdha, por ai kur ka marrë vesh që ju në atë kohë ka ardhur, ndoshta është frikësuar, por nuk e di pse. D.m.th. ka ardhur dhe është absurde se si është përgjigjur para deputetëve. Ai thotë që për 7 milion euro mund t'i pyesni kryeministrin dhe Qeverinë, për 1 milion e 800 mijë euro thotë, mos më pyet mua, pyetni ata që më kanë dhënë leje me i nda, për 1 milion e 300 mijë euro thotë ne me ato jemi në dispozicion.

Dhe nuk di tjetër çka të thënë. Neve nuk na vjen çudi se është ministër me shkollë të mesme, e ka kryer shkollën e mesme ekonomike. Askund në Evropë nuk ka ministër me shkollë të mesme. Pra, faktikisht nuk di të përgjigjur më tepër.

Plus asaj flitet për kampin e Plemetinin Z. kryeministër. E dimë se ju nuk jeni fajtor, por objekti nuk është menaxhuar si duhet, mbarëvajtja e punëve në objekt. Njerëzit janë vendosur pa pranim teknik dhe si shkas i kësaj ka vdekur nga rryma një fëmijë 3- vjeçar dhe nuk janë marrë masa lidhur me te, për shkak të rrymës, tu e fik rrymën, ai është lënduar, i ka kërcitur, vetëm se janë blerë telat 30 cent, nuk ka pasur Qeveria para më shumë.

Plus asaj, në Magurë z. kryeministër objekti për komunitete. Ju e dini që ai objekt edhe pse kanë hyrë njerëzit në te nuk ka ujë. Njerëzit shkojnë me kanta të thjeshta. mbushin ujë te shkolla. Pasi që është ndërtuar objekti pse atëherë nuk ka kanalizim, nuk ka

ujësjellës, njerëzit vetëm janë vendosur aty." Rrini pa ujë, hani, pini, neve nuk na intereson asgjë." D.m.th. nuk është në rregull edhe ajo.

Më 8 maj z. kryeministër ju keni marrë pjesë në atë inaugurimin e atij objekti pa kontrollim teknik, për mua është absurde tepër. Keni ngritur Këshillin e Sigurisë për Komunitete. Thashë, aty thuhet që në veçanti që do të kujdeset për serbët. Sipas raportit aty nuk është asnjë përfaqësues i komuniteteve, thuhet që janë të UNMIK-ut janë të UNDP-is, të institucioneve të përkohshme, të Qeverisë, por nuk flitet a ka komunitete. Ai është Këshill për Sigurinë e Komuniteteve . A ka pasur të drejtë që dikush prej deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nga minoritetet të jetë në atë grup? Unë mendoj se po. Pse nuk është bërë kjo, arsyet nuk dihen .

Z. kryeministër, në administratën civile, në secilës ministri që keni të punësuar njerëz nga shumica shqiptare janë të punësuar në emër të pakicave, ata janë shqiptarë, por në aplikim janë të punësuar në emër të pakicave. Ne kemi fakte lidhur me këtë dhe ju kur të jeni të nevojshëm për ata dokumente ne mundemi me ju sjellë. Është shqiptar por në emër të pakicave dhe Qeveria thotë që është përmbushur përqindja nga minoritetet që janë të punësuar nëpër institucione. Në dy apo tri ministri ju keni njerëz të punësuar prej pakicave, prej shumicës në emër të pakicës kombëtare. Ju thashë se nëse ju nevojiten ato dokumente mundemi me ju sjellë.

Secilës ministri po ashtu edhe juve ju kemi dërguar para dy muajve nga një kërkesë, ju kemi dërguar për me u pranuar nga dy punëtorë nga komuniteti hashkali. Vetëm ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit na u ka përgjigjur - do të mundohemi me bë diçka , asnjë ministër së paku nuk na e ka kthyer përgjigjen, bile s'ka mundësi. Ofrimi i mbështetjes institucionale për të kthyerit, nuk është e vërtetë z. ministër, njerëzit kthehen dhe shkojnë në kampe, nuk kanë shtëpi, bëjnë kërkesë në Ministrinë e Komuniteteve dhe të Kthimit, thonë- Nuk kemi para, njerëzit detyrohen ose me zënë shtëpi me qira ose kthehen në kamp ose një pjesë e tyre kanë shtëpi të uzurpuara. Nuk është në gjendje Ministria e Rendit... edhe se tash është formuar, ndoshta janë kompetenca të UNMIK-ut dhe të Habitatit t'i lirojnë shtëpitë.

Në raport të komunitetet flasin për problemet që i kanë, Ne flasim, por rezultate nuk ka. D.m.th. nuk është e nevojshme vetëm me fol, por për veprime konkrete. Ato vetëm në teori ,por praktikë absolutisht nuk janë. Në Ministrinë e Arsimit z. Veliu edhe kjo është e fundit kjo që po them, zyrtarja për komunitete nuk e ka mbështetjen e plotë për komunitetit hashkali. Edhe mu për atë arsye që nuk ka pasur tash një projekt frik e kemi dorëzuar.. Thotë që nuk ka mjete për shkak mllëfit që unë, në fund e shpreh mllëfin e vetë pse nuk na ndihmon. Një shoqatë joqeveritare, në fund e shpreh mllëfin vetëm se ju jeni kështu dhe në komunën e Ferizaj nuk më keni përkrahur . unë nuk ju ndihmoj. Unë besoj se ata njerëz nuk e kanë vendin, nëse e ka zënë vendin si zyrtarë, duhet të jemi të barabartë. Ju faleminderit për qasje, z. kryeministër. E keni mbështetjen tonë . Shpresoj që do të merrni hapa konkret dhe absolutisht nuk dyshojmë në ju. Ju faleminderit.
KRYETARI I KOSOVËS KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Bajram Rexhepi

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – I nderuari kryetar i Parlamentit, i nderuar kryeministër, ministra ,të nderuar kolegë deputetë,

Me rastin e prezantimit të programit qeveritar, kryeministri Çeku u përcaktua për vazhdimësi të programit qeveritar të prezantuar nga ish- kryeministri Haradinaj dhe të vazhduar nga Kabineti qeveritar Kosumi. Kjo ishte e pritshme, sepse qeverisjen e vazhdoi i njëjti Kabinet qeveritar me kryeministër të ri.

Risi nga kryeministri Çeku ishte se lansoi tri prioritetet kryesore qeveritare të përmbledhura në tri shkronja E E E: Ekonomi, Edukim, Energjetikë. Të gjitha këto fusha tejet të rëndësishme për perspektivën zhvillimore të Kosovës .Fatkeqësisht në 100 ditët e para të qeverisjes u harrua plotësisht ky premtim i proklamuar me pompozitet dhe nga e tëra mbeten rezultatet tejet modeste.

Raporti i përpiluar është konfuz, joprofesional, është i stërngarkuar me përshkrime të aktiviteteve rutinore të shërbyesve civilë nëpër ministri dhe kryeministri, që më së paku varen nga Kabineti qeveritar dhe është joserioze të zënë vend në një raport të tillë. Shumë veprimtari të realizuara nga agjencitë ndërkombëtare për zhvillim si USAD-i, AER-i, institucionet financiare si: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, ose organizatat joqeveritare, i atribuojnë vetes si sukses të Qeverisë që është jo korrekte dhe e paqëndrueshme. Në raport ka vend edhe për mashtrim ose mosinformim të Kabinet qeveritar, ngjashëm me atë të Qeverisë Kosumi, që deklarojnë se për herë të parë është përpiluar korniza afatmesme e kufijve buxhetorë 2006/2009. Sa për informim tuaj dhe të opinionit ,korniza afatmesme e kufijve buxhetor është përgatitur më 2002 për periudhën 2002/2005. Këtu nuk ka vend për lavdërim, për arsye se këto korniza përgatiten në bashkëpunim me ekspertët e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe thënë më qartë, kryesisht nga ata. Qëllimi i kësaj vërejtje është të lirohemi nga logjika se çdo gjë fillon nga kjo Qeveri.

E konsideroni si sukses organizimin e Konferencës së Donatorëve në prill të vitit 2006 edhe pse organizues ishin Komisioni Evropian me përkrahje të Bankës Botërore, USAID-it dhe donatorëve të tjerë, ku realizohet premtimi prej 57 milion eurove për mbulim të deficitit buxhetor për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2006/2007.

Qëllimi i vetëm i këtij donacioni është të mundësojë funksionimin e institucioneve dhe ta shpëtojë nga falimentimi i plotë buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Ky është një kthim prapa derisa buxhetet e vitit 2002/2005 realizoheshin kryesisht nga të hyrat vetjake gati 100%, tash duhet të bazohemi në donacione për ta mbuluar deficitin buxhetor.

Të gjithë parametrat ekonomikë shënojnë rënie progresive, si GJIDIPI-ja rënie e zhvillimit ekonomik nga ai i projektuar 4% dhe i korrigjuar në 2.5% në vlera reale që nuk e kalojnë 1%. Deflacioni vazhdon edhe më tutje, si pasojë e rënies së fuqisë blerëse, pra thellimit të varfërisë dhe papunësisë. Shpenzimet buxhetore edhe më tutje janë joracionale, ku mbi 34% e buxhetit të konsoliduar të Kosovës harxhohet për shërbyes civilë dhe administratë publike dhe ka tendencë të rritjes, duke themeluar agjenci, këshilla edhe aty ku nuk ka nevojë realisht. Pra në vend se të inkurajohet biznesi për

krijimin e vendeve të punës, Qeveria shërben si byro për punësim dhe stërngarkim të buxhetit. Sa për informim kjo kategori shpenzuese është më e larta në rajon. Në Maqedoni është rreth 16%, në vendet e Unionit Evropian 90%. Shpenzimet e shërbimeve dhe të mallrave janë në pozicionin e dytë, ndërsa investimet kapitale rreth 8%, pra një Qeveri shpenzuese, pa strategji dalëse nga ky rreth vicioz, komunat nuk arrijnë t'i plotësojnë buxhetet nga të hyrat vetjake as 30%. Çka mund të konsiderohet si ambicie pozitiv?

Përpjekja për përpilimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të Kosovës, kjo mund të konsiderohet si rifillim i iniciativave të mëparshme të mbështetura financiarisht nga donatorët kryesisht AER-i, nuk jam fortë optimist se kjo iniciativë do të jetë e suksesshme për disa arsye. Së pari nuk është saktësuar sa është strategjia e zhvillimit ekonomik afatmesëm që duket se është duke u bazuar në periudhën kohore 2007/20013, por nëse pretendohet të përgatitet pra programi nacional i zhvillimit ekonomik ai duhet të përfshijë periudhën kohore për së paku 15 deri 20 vitet e ardhshme.

Se cili është orientimi strategjik i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Arsye tjetër për skepticizëm është afati i shkurtër rreth 6 muaj i përgatitjes që është jo real, arsye tjetër e skepticizmit është se nuk mund të përgatitet plani nacional i zhvillimit ekonomik pa parametrat e domosdoshëm siç janë: regjistrimi i popullsisë, plani hapësinor i Kosovës dhe një ent i mirëfilltë statistikor.

Mund të konsiderohet si iniciativë pozitive themelimi i Qendrës për Koordinimin e Donacioneve dhe themelimin e bazës së të dhënave, edhe pse në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ka ekzistuar Zyra për koordinim të donacioneve prej vitit 2002.

Dua të besoj se nuk është dyfishim i stafit dhe harxhimeve. Iniciativë pozitive mund të konsiderohet edhe parku industrial në afërsi të Drenasit dhe parku i biznesit në Mitrovicë, ky është një vullnet politik, por pak i realizueshëm për fitime ekonomike.

Dhe në fund implementimi i standardeve është ngadalshëm, e njëjta vlen edhe për 13 standardet parësore të caktuara nga Grupi i Kontaktit. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENIDT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Afrim Arzuallxhiu, le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI AFRIM ARZUALLXHIU – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra, kolegë të nderuar.

Është një raport ku pretendohet të cekën vetëm sukseset dhe arritjet, prandaj mendoj se mungesa kryesore e raportit është se nuk ka autokritikë, nuk ka vetëkritikë. Do të ishte shumë normale dhe njerëzore që në raport të cekën edhe mosrealizimet, dështimet, gabimet e mundshme. Nuk është e mundur që Qeveria nuk ka pasur gabime, nuk ka pasur dështime, sepse askush, as kjo qeveri nuk ka shkop magjik për t'i zgjedhur gjitha problemet menjëherë, mirëpo është dashur të ketë guxim dhe të pranojë edhe gabimet edhe dështimet, çka mendoj se mungojnë në këtë raport.

Prandaj, konstatimi në hyrjen e raportit se gjatë 100 ditëve të Qeverisë Çeku janë shënuar suksese dhe arritje të shumta që janë reflektuar pozitivisht në zhvillimet e Kosovës dhe për Kosovën, them më së buti është jo reale.

Vetë fjalia në pasusin e fundit të hyrjes së raportit ku thuhet nuk mund të mburremi me arritje të gjertanishme po në përputhje me kushtet të cilat veprimet kemi bërë përparime të prekshme, pranohet në formë të mbuluar se rezultatet nuk kanë qenë aq edhe inkurajuese.

Në diskutimin tim do të përqendrohem në pjesën e raportit ku bëhet fjalë për politikën fiskale dhe agrobiznes. Para një viti e patëm seancën e Kuvendit me temën gjendja ekonomike në Kosovë. Diskutimet e bëra kanë dëshmuar se gjendja ekonomike është jashtëzakonisht e vështirë nëse problemi, një prej problemeve kyçe sipas shumicës së diskutuesve ka qenë politika e gabuar ekzistuese fiskale, gjegjësisht politikën tatimore dhe doganore. Politikën që momentalisht janë ende duke e destimuluar dhe dekurajuar, pse mos të them se janë duke e diskriminuar prodhuesin vendor. Në fakt, prodhuesi kosovar për shkak të këtyre politikave fiskale nuk është i barabartë as në tregun kosovar me mallrat e importuara nga prodhuesit maqedonas apo serbë. Këto politika të gabuara fiskale nuk kanë ndryshuar fare në ndërkohë. Nuk di asnjë shtet në botë që stimulon importin dhe që destimulon prodhimin vendor, siç ndodh te ne. Nuk mund që edhe pas 7 viteve tarifën doganore dhe TVSH-ja të jenë ende të njëtrajtshme uniforeë. UNMIK-u para 7 vjetëve ka vendosur tarifën e njëtrajtshme për hir të administrimit më të lehtë. Për hir të stimulimit të prodhimit vendor kjo duhet urgjentisht të ndryshohet dhe dogana të jenë selektive. Repromaterialet e veçanta dhe gjysmëprodhimet dhe prodhimet e gatshme, nuk mund të jenë të njëtrajtshme.

Zoti kryeministër, a mund ta paramendoni një vend që synon zhvillim të hovshëm ekonomik dhe të jetë tërheqës për investitorët e huaj me detyrimet ekzistuese që investitorët e huaj duhet të paguajnë 26.5% doganë dhe TVSh për pajisje në hyrje.

Për 1 milion euro nëse dëshirojmë të investojmë në Kosovë në kufi duhet të paguhet 265 mijë euro për TVSH dhe doganë.

Mendoj se në këtë nuk ka asgjë tërheqëse për investitorët e huaj. Përkundrazi. Nëse marrim parasysh edhe faktorët e tjerë rëndues, problemin e rrymës, ujit etj., atëherë duhet të mendojmë për ndryshime të shpejta në këtë drejtim. Është në raport dhe kam dëgjuar shumë shpesh prej zyrtarëve të Qeverisë që kur flasin për politikën fiskale në Kosovë, krenohemi se kemi politikë fiskale të qëlluar, të mirëfilltë stimuluese dhe krenohemi me nivelin më të ulët të tatimeve në regjion.

Shikoni, diskutimet që kanë qenë për gjendjen ekonomike në Kosovë, atëherë mund të vëreni se kjo politikë nuk është as e qëlluar, as e mirëfilltë, e sidomos nuk është stimuluese për prodhuesit vendorë.

Sa i përket nivelit më të ulët të tatimeve në rajon, sipas mendimit tim, politika fiskale është e lidhur shumë ngushtë edhe me gjendjen sociale të popullatës. Për mua politika fiskale është aq e mirë sa është e mirë gjendja sociale e popullatës.

Me politikën fiskale dhe me tatimet e ulëta mund të mburremi vetëm atëherë nëse kemi edhe gjendjen sociale për t'u mburrur. Mirëpo, nëse analizojmë gjendjen sociale të pensionistëve, të familjeve të dëshmorëve, të invalidëve, të bonjakëve etj. ku mbi 50% e popullsisë jeton në varfëri, një pjesë bukur e madhe në varfëri të skajshme, atëherë mburrja me tatime më të ulëta në rajon është vetëm një ironi.

Paramendoni të keni rroga 40 euro dhe të jetoni me to. Më mirë është të keni tatime pak më të larta, por gjendje sociale më të favorshme. A keni menduar se politikat ekzistuese stimulojnë derdhjen e parave jashtë vendit dhe se deri kur Kosova do të mund të durojë këtë derdhje të parave jashtë vendit, si për shembull parat e Fondit të Pensionit që për çdo muaj rriten dhe shkojnë jashtë vendit. Paratë e privatizimit për çdo valë të privatizimit, nga disa miliona, nga disa dhjetëra miliona derdhen jashtë.

Paratë që derdhen për importin e mallrave në Kosovë, sepse për çdo ditë para të mëdha derdhen jashtë Kosovës pa kthim dhe për çdo ditë Kosova është më e varfër për disa miliona euro, kurse në anën tjetër të hyrat nga bashkatdhetarët tanë që janë jashtë vendit për çdo ditë zvogëlohen për shkak se edhe gjendja e tyre po keqësohet.

Duke marrë parasysh këtë që thashë, Qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë hap në ndryshimin e politikave ekzistuese fiskale për stimulimin e prodhimit vendor, e sidomos të eksportit. Prandaj, kemi situatën që importi sot në Kosovë të mbulohet vetëm në masën për 4% sipas statistikave, mirëpo, sipas mendimit tim, nuk është as 2% duke marrë parasysh realitetin.

Të gjitha këto shkaktojnë që borxhi i brendshëm për çdo ditë është duke u rritur, përkatësisht për çdo ditë rritet jolikuiditeti i brendshëm për shkak të mungesës së parave që shkaktohet për shkak të derdhjes së parave jashtë vendit. Sipas meje është një gjendje me të vërtetë alarmante, prandaj duhet të ndryshojnë urgjentisht politikat fiskale, që prodhuesi vendor në fakt të ketë leverdi të prodhojë dhe që të ketë stimulime për eksportin, ashtu që ky debalanc mund ta zbutë.

Sa u përket bujqësisë dhe agrobiznesit, Qeveria nuk po u përkushtohet sa duhet. Buxheti i Ministrisë dëshmon për këtë, përkundër faktit se në këto fusha ka shumë mundësi të zbutjes së menjëhershme të papunësisë, sepse ka shumë tokë të pashfrytëzuar, ka shumë industri përpunuese të pashfrytëzuar, ka njerëz të papunë, e çka është më me rëndësi ka treg, sepse Kosova për momentin ende importon mbi 80% të produkteve ushqimore dhe ka shumë mundësi për eksport në këtë lëmi. Pra, janë të gjithë parametrat për punë të suksesshme, por që nuk shfrytëzohen. Problem është se nuk ka politika stimuluese as në agrobiznes. Pozita e bujkut kosovar, krahasuar me pozitën e bujkut në rajon, nuk është e njëjtë, nuk është i barabartë.

Prandaj, me qëllim që të ndikojmë sadopak në stimulimin e bujkut dhe të agrobiznesit në Kosovë, ne si Komision parlamentar inicium një iniciativë për heqjen e TVSH-ës për produktet bujqësore të grumbulluara vetëm nga fermerët vendorë. Për këtë iniciativë, së pari biseduam me Ministrinë për Bujqësi në nëntor të vitit 2005. Kjo iniciativë u pranua nga Ministria si e qëlluar dhe u propozua që të bisedohet edhe me Ministrinë për

Ekonomi dhe Financa, çka e bëjnë në maj të vitit 2006. Edhe nga përfaqësuesi i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa u vlerësua si iniciativë e qëlluar, por problemi mbeti se kush duhet ta bëjë analizën dhe propozimin. Nëse pritet nga Komisioni atëherë është shumë vështirë. Kjo iniciativë nuk mund të ketë aq ndikim negativ në buxhetin e Kosovës, por do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e pemëtarisë dhe të blegtorisë, përkatësisht të agrobiznesit në përgjithësi dhe zbutjes së papunësisë. Prandaj, do t'ju lutesha që të bashkëpunoni me të dy ministrinë që të realizohet kjo iniciativë.

Sa i përket iniciativës për formimin e fondit për çdo individ, është iniciativë e qëlluar, por nuk është e caktuar se kur do të formohet dhe frikësohem se mos po ngel vetëm në letër kjo iniciativë.

Z. kryeministër, kam shpresuar se për 100 ditë do të bëni kthesë të madhe si në politikat ekzistuese ashtu edhe në

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Do ta zbatojmë Rregulloren. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet deputeti Fehmi Mujota.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, kolegë të nderuar deputetë.

Raportin e punës 100 ditëshe unë e kam vlerësuar nga gjendja faktike dhe mundësitë reale në momentin për të cilin bisedohet. Nga raporti i punës 100 ditëshe të Qeverisë së Kosovës, por edhe nga realiteti në terren vërehen trende pozitive të punës së Qeverisë së Kosovës dhe këtë më së miri e thonë edhe qytetarët e rëndomtë, edhe ata që janë të varur nga shumë vendime dhe qëndrime të Qeverisë.

Në veçanti duhet theksuar se Qeveria e Kosovës ka arritur që të avancojë funksionalizimin e institucioneve demokratike të Kosovës në nivelin qendror dhe në veçanti në atë lokal, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit politik, të përmirësimit të sigurisë e qytetarëve, pa dallim, ta avancojë imazhin e pozicionin e Kosovës në nivelin rajonal, çka është shumë me rëndësi dhe në atë ndërkombëtar.

Në veçanti Qeveria e Kosovës në këtë periudhë ka dhënë një kontribut të duhur në mbështetjen e Ekipit Negociator për përmbushjen e standardeve me të vetmin qëllim të finalizimit të procesit të statusit të Kosovës, që është një ndër kërkesat më të mëdha e sublimë të të gjithëve. Në kuadër të çdo ministrie janë evidente punët pozitive dhe efektet funksionale të tyre në shërbim të qytetarëve. Për vlerësimin pozitiv për punën 100 ditëshe të Qeverisë së Kosovës flasim edhe shumë përfaqësues ndërkombëtarë të niveleve të ndryshme dhe në veçanti edhe qendrat e vendosjes, të cilat janë prezente në rrjedhat dhe proceset politike të Qeverisë dhe të Kosovës në tërësi. Megjithatë këto të arritura, më lejoni të jap një vlerësim, që në raportin e punës së Qeverisë së Kosovës, mendoj, se ka qenë dashur të zihet në fjalë edhe problemi i Mitrovicës dhe decentralizimi i kësaj komune, si dhe problemet e shumta që e ngërthejnë këtë komunë në kuadër të proceseve politike që zhvillohen tani.

Po ashtu nuk kemi vlerësim të qëndrueshëm dhe qëndrim afatgjatë të Qeverisë së Kosovës lidhur me veprimet e mëtutjeshme në Kombinatin Trepça, apo në Korporatën Trepça, si një begati natyrore dhe kombëtare, shtetërore e Kosovës, ngase për Trepçën pozicionet e Serbisë janë shumë më të fuqishme për të elaboruar dhe fatkeqësisht mund të informoj, që shumica e dinë, se tani edhe një kontest gjyqësor në Londër e kanë fituar lidhur me investimet që kanë bërë atje dhe do të ishte mirë të dihej këtu pozicioni që dihet, por dua të theksohet.

Unë disa herë e kam ngritur çështjen e Mitrovicës dhe pjesës Veriore të Kosovës, ku ende nuk kemi qasje institucionale, ngase atje ende zhvillohet një jetë paralele, edhe pse më e zvogëluar në intensitet se pak më parë. Konkretisht, Qeveria e Kosovës nuk e ka realizuar kthimin në Veri të shqiptarëve, të cilët që 7 vjet jetojnë refugjatë në qytetin e tyre dhe në pjesët e tjera të Kosovës. Nuk kemi një plan konkret për t'i ndihmuar këta qytetarë. Edhe pse u është premtuar, nuk ka filluar ndërtimi i asnjë shtëpie në disa lagje të pjesës veriore të qytetit të Mitrovicës dhe me theks të veçantë të shqiptarëve, çka ndikon në procesin e mëtutjeshëm të decentralizimit. Nuk ndihmohen këta qytetarë në punësim dhe në forma të tjera stimuluese. Nuk është bërë ajo që është edhe më fundamentale - siguria e lëvizjes së lirë jug - veri, ndërsa në veri - jug është në nivelin e duhur. Në këtë drejtim nuk është arritur që edhe regjistrimi i automjeteve të bëhet me KS, ngase me të vërtetë ky problem është shumë i hapur dhe shkakton irritimin e qytetarëve. Shqiptarët nuk kanë qasje në shkollë, në spitalin rajonal dhe në vendet e punës. Për të gjitha këto mendoj se ka pasur vend në raport dhe natyrisht se këto lëshime nuk janë produkt vetëm i kësaj Qeverie, janë produkt tani 7 vjet të mosangazhimit të tërësishtëm. I theksova këto probleme të hapura që janë të njohura për Qeverinë e Kosovës, që janë të njohura për planin e tyre për t'i zgjedhur, t'i kenë parasysh për fazat vijuese. Në fazat vijuese duhet t'i përmbushin kërkesat dhe obligimet dhe përgjegjësitë tona dhe të qytetarëve.

Unë kam shumë shpresë se nuk do të mungon vullneti i Qeverisë së Kosovës për angazhim në përmirësimin e gjendjes ekzistuese në tërë pjesën e Kosovës, ashtu siç janë realizuar shumë çka në pjesët tjera të Kosovës. Këtë ndarje nuk e bëjë për ndonjë qëllim politik, por për gjendjen faktike që vërtetë është obligim edhe i Qeverisë. Unë mbështesë këtë raport si pozitiv si shumë optimist dhe në veçanti si i realizuar për shumë çka. Ju faleminderit për dëgjim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fehmi Mujota, le të përgatitet deputeti Genc Gorani.

DEPUTETI FEHMI MUJOTA - Faleminderit z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë dhe deputete.

Është një ditë e mirë besoj që sot kemi mundësi të shqyrtojmë raportin e punës 100 ditore të Qeverisë në krye me kryeministrin Çeku. Natyrisht që në fillim dua të shtroj pyetje se çka ofron raporti i punës dhe në qoftë se shtrojmë pyetje, se çka afron raporti i punës duhet të kemi përgjigjen: a ka program të Qeverisë mbi të cilën vlerësohet puna 100 ditore e kësaj Qeverie. Menjëherë duhet kuptuar vështirësinë e hartimit të këtij

raporti nga ana e Qeverisë, sepse kemi kundërshtime të shumta në mes fazave të punës, që në një mënyrë a tjetër, i gjithë opinioni duhet kuptuar në mënyrë të drejtë këtë raport si një vlerësim të shumë mekanizmave që veprojnë në Kosovë dhe natyrisht edhe të institucioneve të Kosovës. Këtu nënkuptohet se vlerësohet edhe Qeveria, vlerësohet edhe Kuvendi, vlerësohen edhe partitë politike, vlerësohen edhe mekanizmat ndërkombëtarë: KFOR-i, OSBE-ja edhe shumë çka tjetër.

Prandaj, po shohim më në thellësi veprimin dhe raportin që po afron Qeveria sot. Mund të përmbledh dy, tre fjali që pastaj na nxjerrin diskutime më të gjera. Raporti është si një lloj vërejtje, është më tepër përshkrues, është i zbrazët në lëndën e obligimeve që ka Qeveria, në vende të theksuara ka subjektivizëm, ka në ndonjë vend edhe emocionalizëm, që nënkupton tendencën për personalizim që anashkalon ose nuk përfill institucionet e tjera në Kosovë.

Prandaj, realisht them pritjet tona nuk kanë qenë tjetër fare dhe do të duhej të ishin shumë pretendues të mëdhenj, prandaj ta presim një raport tjetër në këtë moment, në këtë fazë të angazhimit që e kemi në Kosovë. Por gjithsesi raporti fillon me ato që kemi pritur të gjithë, me dy s-ja, me statusin politik për Kosovën dhe me standardet. Natyrisht këtë çështje duhet parë në dritën e vlerësimeve të përgjithshme, duhet parë në dritën e vlerësimeve që ka bërë Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara për Kosovën. Këtë duhet vlerësuar pozitivisht që bënë Kosova për standardet dhe për realizimin e tyre që e kanë bërë edhe qytetarët e Kosovës dhe institucionet e saj, por assesi nuk duhet lënë anash atë që puna e statusit politik të Kosovës dhe standardeve të Kosovës nuk janë çështje e një Qeverie, nuk janë çështje të një ministrie, nuk janë çështje të një institucioni të veçantë, por janë çështje të një populli dhe të një ..., përkatësisht një e drejte që duhet të të realizohet. Prandaj nuk duhet të harrojmë si sugjerim për Qeverinë që të gjitha çështjet e tjera madhore që bëjnë pjesë në fushën e punëve të përditshme, të obligimeve të përditshme dhe detyrave të tjera, që duhet të përfshihen në raport. Obligimet që merr nga Parlamenti dhe nga programi i vet që ofron Qeveria nuk duhet të hudhen rastësisht në shportën e imtësive. Nuk guxojmë ta quajmë të tillë, p.sh. ta marrim angazhimin për ekonominë, për edukimin, për arsimin, për kulturën, për shërbimet publike dhe natyrisht edhe për shumë segmente të tjera të jetës, të cilat janë, natyrisht, në këtë moment kërkesa shumë minimale për qytetarët e Kosovës. Ata kanë të drejtë për edukim të drejtë, kanë të drejtë për energji, kanë të drejtë për dritë, kanë të drejtë për kulturë, kanë të drejtë për shërbime cilësore dhe këtu duhet me pa se cilat janë ngecjet tona, ku kemi ngelur dhe kah është rruga që duhet ndjekur.

Qeveria në këtë rast ka bërë një gabim, mendoj në trajtimin ose në përshkrimin e disa gjërave. Unë po përmend vetëm disa sosh dhe mendoj se është çështje e atyre e që kanë shkruar. Nuk bën të themi tani se Kosova po i afrohet realizimit të ëndrrës së saj, populli i Kosovës nuk ka pasë një ëndërr, por populli i Kosovës ka të drejtë për realizimin e pavarësisë dhe këtë nocion duhet hequr nga përdorimi, ashtu siç është tani në zhargonin e përditshëm të kombëtarëve, kjo është e pakuptueshme.

Një gjë tjetër që duhet ta heqë Qeveria në këtë moment nga fjalori i vet dhe mendoj se është një gabim elementar kur Qeveria thotë se po i afrohem 100 ditë më afër pavarësisë, do të thotë se 100 ditshi tjetër do të koincidojë më 15 nëntorin, atëherë kur

Organizata e Kombeve të Bashkuara do të nxjerrë vendimin për statusin e Kosovës. Mendoj se ky është një konkludim shumë i panevojshëm, madje, madje do të thoja se është amator në politikë dhe hiq diplomatik dhe këtu është mendimi im që duhet hequr sa më parë dhe mos ta përdorim në raste të tjera.

Qeveria është përqendruar në funksionalizimin e këshillit për emërimet e larta. Z. kryeministër kjo çështje ka mbet akoma një pikë e zezë e Qeverisë. Edhe s'dua të përsëris ato që i tha më herët shefi i Grupit Parlamentar. Qeveria ka iniciuar politika a thua në drejtim të themelimit të fondit të zhvillimit rural me qëllim të zhvillimit të bujqësisë, tha kolegu paraparakisht, por unë do të thoja të zbresim deri te secili bujk në Kosovë e të shohim se kjo është një përsëritje e vazhdueshme për dy vjet nga Ministria e Bujqësisë dhe nuk ka realizim konkret.

Do të shtoja edhe një çështje tjetër që besoj se Qeveria duhet të ketë parasysh. Nuk duhet Qeveria të kërkojë ose të presë, ose në një mënyrë të llogarisë në mbështetjen e Parlamentit për realizimin e synimeve tona. Qeveria do të ishte më mirë të thotë se jemi të gatshëm, bashkë me institucionet e tjera edhe si pjesë që i përgjigjen Parlamentit, t'i kryejmë obligimet tona të përditshme, do të krijojmë standarde dhe favore më të nevojshme para përcaktimit të statusit politik të Kosovës, por jo që të jetë në anën e një subjektivizmit sikur parlamenti dhe grupet tjera janë grupe punuese të Qeverisë, rolet dihen, mos të bëjmë gabime elementare në praktikat parlamentare.

Edhe unë do të fokusohem në çështje të pushtetit lokal me pak fjalë. Ministria e Pushtetit Lokal është e vërtetë se ka angazhime të shumta përballë momentit që po e kalojmë dhe përballë procesit të negociimit, por Ministria e Pushtetit Lokal ka afruar para nesh në këtë raport si një lloj pune për shpejtimin e hartimit të legjislacionit që rregullon fushën e pushtetit lokal. Në fakt dihet një gjë. Në Kosovë akoma veprohet dhe punohet me Rregulloren 2000/45, e cila shkakton shumë probleme nëpër komuna. Ndërsa hartimi i legjislacionit pse nuk është bërë dhe pse nuk është ardhur në procedim në Qeveri dhe në Parlament, ka qenë korrekte të përmenden dy apo tri fakte. Është dashtë të përmendet fakti se jemi në procesin e negociimit, akoma nuk kemi të ditur numrin e saktë të komunave, organizimin territorial të tyre dhe nuk kemi regjistrim civil në Kosovë, prandaj këto janë çështje të cilat kanë dëmtuar këtë proces dhe Ministria e Pushtetit Lokal është dashur të jetë ajo që do të kishte ngritë zërin në rend të parë, e jo të mbulojë këto gjëra në bazë të atyre që ka bërë hartime në kuptim të brendshëm. Udhëzimet administrative janë një e metë e Qeverisë. Në qoftë se zbresim në komunat e Kosovës dhe shohim se cilat janë efektet e udhëzimeve administrative, ju do të vëreni se atje kemi një ngatërrim të tërë, një kaos të tërë. Po e marr një shembull. Në qoftë se nuk bëjnë ndërrime të shpejta në Ligjin për prokurim dhe Ligjin për financa publike, atëherë sigurisht që komunat do të jenë shumë të dëmtuara, ato nuk kanë bërë plane, përkatësisht hartime buxhetore në kohë për të zbatuar dhe udhëzimet administrative, të cilat vinë nga ministritë ato shpeshherë kanë komplikime buxhetore. Prandaj ministritë nuk kanë bërë veprimet e tyre të duhura që të kenë edhe mbështetjen buxhetore për ato udhëzime administrative, të cilat i kanë dërguar.

Një problem tjetër që mendoj se është për t,u përmendur në sferën e pushtetit lokal, është ajo që thuhet, janë ofruar mbështetje ligjore dhe këshilla për komunat, sidomos përmendet komuna e Gjakovës, Malishevës, Klinës dhe ndonjë komunë tjetër. Në fakt, këtu kemi një lloj kontradikte. Komuna e Gjakovës, përkatësisht Kuvendi komunal i Gjakovës dihet një gjë që nuk funksionon ka 8 muaj e më tepër, dhe këtu është vënë pikëpyetja legjimiteti i Kuvendit. Disa kuvende është vështirë të funksionojnë, ndërsa edhe më keq gjendja është pas shpalljes së vendimit ose marrjes së vendimit për shtyrjen e zgjedhjeve lokale, tani është prezantuar në opinion dhe tek njerëzit që zbatojnë ligjin në qeverinë lokale edhe mundësia e delegjitimitit të tyre, por edhe vështirësitë e tjera që mund të vijnë. Prandaj në këtë fushë besoj që Ministria e Pushtetit Lokal është dashtë të ngritë zërin e para në kuptim të asaj që zgjedhjet lokale, një e drejtë demokratike, një proces demokratik dhe që u jep legjimitet kuvendeve komunale dhe qeverive komunale, kjo gjë nuk ka ndodhur, prandaj këtu do të kemi vështirësi shtesë dhe Ministria është dashtë të marrë një lloj përgjegjësie.

Mendoj se në këtë drejtim një vështirësi tjetër z. kryeministër është ajo që e keni personin që është edhe zëvendëskryeministër edhe ministër i Pushtetit Lokal, si një rol të dyfishtë. Mendoj se zëvendëskryeministri, nëse në mandatin e kaluar ishte një vend i veçantë, pse mos të jetë edhe në këtë rast, edhe ministri i Pushtetit Lokal të jetë i fokusuar në çështjet që i takojnë atij, të jetë i përqendruar në punën, të rregullojë çështjet dhe mbështetjen për pushtetin lokal, kjo gjë nuk po ndodh, prandaj duhet të ndërmerri urgjentisht diçka të tillë.

Dhe krejt në fund është ajo, se procesi i negociimit për decentralizimin dhe çështje të tjera që lidhen me statusin e Kosovës nga pak ose shumë, mendoj se janë personalizuar dhe nga pak ka ndodh një lloj marrje e meritave, përkatësisht një lloj jomarrje e përgjegjësi. Nëse duhet të marrim merita duhet të marrim edhe përgjegjësi për këtë gjë.

Prandaj, mendoj që Grupi Politik Strategjik i Kosovës dhe Ekipi Negociator i Kosovës nuk janë grupe punuese të Ministrisë së Pushtetit Lokal, por është e kundërta. Qeveria dhe Ministria e Pushtetit Lokal janë pjesë aktive dhe marrin përgjegjësi në bazë të kompetencave që kanë.

Prandaj, unë mendoj se duhet vlerësuar një gjë në kuadër të Ministrisë së Pushtetit Lokal. Vlerësimi i punëtorëve shërbyes civilë në Ministrinë e Pushtetit Lokal mendoj se ka qenë një gjë e mirë, sepse nuk ka ndodh asnjë shkurtim i vendit të punës, gjë që nuk ka dashtë ta politizojë këtë gjë, siç ka ndodhë në ministri të tjera. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Genc Gorani, le të përgatitet deputeti Ibush Jonuzi.

DEPUTETI GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryetar. I nderuari z. kryetar, z. kryeministër, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj deputetë.

Mendoj se në këtë raport jashtëzakonisht të detajizuar mungojnë edhe disa të arritura. Në aspektin e Shërbimeve Publike përmendet shumë shpesh rregullimi i qasjes në dokumente publike dhe në fakt me këtë rregullim të ri është arritur që qasja në

dokumentet publike të jetë aq e mirë sa që këto dokumente praktikisht të mos dalin kurrë jashtë sirtarëve të vet. Është arritur faktikisht të sigurohen dokumentet, por të mos sigurohet përdorimi i dokumenteve. Shërbimi civil kthehet në një punëdhënës masovik (me shumicë), vërtet disa probleme të preferencave partiake dhe të nepotizmit ekzistojnë, por është më e rëndësishmja të kemi punësim. Në arsim, si e arritur numër një në këtë dokument të juaj, thuhet se është arritur që të bëhet organizimi i ditës së presidentit dhe të javës së Bibliotekës Kombëtare. Me marrë me shikuar, kjo vërtet është e arritura më e madhe, mirëpo s'po potencohet sa duhet.

Mbyllja e shumicës së institucioneve parashkollore që ka ndodhë kohëve të fundit është një e arritur për ekonomizim të buxhetit, mirëpo sa konsekuenca kemi në atë aspekt, kjo nuk përmendet. Ndoshta kjo pak më vonë do të shihet. Relacioni i ministrit të Ministrisë së Arsimit ndaj Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji është jashtëzakonisht, si të them, e ka një farë stili të veçantë. Po jua tregoj një shembull shumë të thjeshtë. Një zyrtar i lartë i Ministrisë para do kohe ia dërgoi me shkrim një opinion të vetin Komisionit, duke i thënë në fund të fundit, në dashit merrni pjesë në një proces shumë të rëndësishëm të hartimit të politikave të shkollimit para universitar, dashit ju edhe ashtu komisioni s'ka hajr prej tij. Këtë shqetësim tonin, se në Komision jemi shqetësuar nga pak, e kemi ngritur në nivel të Kryesisë së Kuvendit. Kjo kryesi ia ka përcjellë, po supozoj, nivelit ekuivalent në Qeveri, pra ju z. kryeministër dhe Kabineti i juaj ka tre muaj që nuk jeni përgjigjur, me siguri se meritojmë atë përgjigje.

Në kulturë vazhdon sponzorimi i festivaleve private me paratë publike, pse jo, jeta është e shkurtër, duhet zbavitur. Meqenëse duhet të pranoj se stili ka ndryshuar, por mbeti një farë parfemi i neototalitarizmit.

Në transport dhe në telekomunikacion çështja e hapjes së rrugës Prishtinë – Elez Han, nuk besoj se dikush e ka harruar këtë episod, për ato ditë që i janë dashë ministrisë ta hapë rrugën, që është arterie esenciale e zhvillimit dhe e funksionimit të ekonomisë së Kosovës, edhe një breshkë do ta kishte kaluar atë segment të rrugës më shpejtë se sa ministria me një buxhet të pakufizuar për ta kryer atë punë.

Ngritja e antenave të telefonisë mobile të kompanive nga Serbia, dikush po e shikon këtë si alarmante. Më duket se ka kaluar koha të themi se është alarmante, sepse ka një kohë të gjatë që po ndodh, ndoshta është koha tash me thanë, ndoshta është pjesë e standardeve, merreni këtë futuri në standarde, ndoshta po na ndihmon, se, si duket, askush nuk lodhet për atë punë, sa janë humbjet, sa është humbja e kredibilitetit edhe sa tregohet me këtë pafuqia e Qeverisë.

Politikat sociale së shpejti do të jenë konflikte dhe të vetmet politika, në të cilat Qeveria do të vazhdojë të punojë, sepse politika tjera praktikisht janë inifikase.

Në fund të fala të përzemërta nga banorët e Prizreni. Në disa aspekte, në aspektin e rendit publik është një qetësi jashtëzakonisht e madhe pas ekzekutimit makabër të një eks komandanti të Brigadës së rrethit të Prizrenit, për çështje thjesht të nderimit. Qetësia është jashtëzakonisht e mirë, askush nuk guxon praktikisht as ta komentojë këtë, madje

as në çështje jashtëzakonisht private. Ndoshta edhe Ministria e Rendit do t'ia shch hajrin kësaj, s' do të ketë më shumë telashe prej atyre që bëjnë telashe.

Po ashtu të fala nga Instituti për meteorologji që 50 – 60 vjet e ka kaluar një kohë jashtëzakonisht interesante. Në fund të fundit po i mbyll dyert dhe i gjithë personeli, z. kryeministër ju jeni në dijëni për këtë, ka dhënë dorëheqje e kalon, urdhëroni merreni e dërgojeni ku të doni, pas 60 vitesh të funksionimit. Kjo s' është fjala e fundit në lidhje me këto tema, mirëpo e ndjeva për detyrë që të ju tregoj tash e masë.

Z. kryeministër tërë kohën ju drejtova praktikisht Juve, sepse vetëm ju jeni i ri në këtë Qeveri. Edhe mes jush edhe ne personalisht, më lejoni të individualizoj pak këtë fjalë, kemi një gjë të përbashkët, ju e doni jashtëzakonisht Kosovën, jam i bindur, por binduni edhe ju për mua. Aty ku dallohem jashtëzakonisht është, thua, se keni ra në dashni me ministri. Pra, këtu dallohem ne. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ibush Jonuzi, le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër, ministra, deputetë të nderuar, përshëndetje.

Kur flasim për 100 ditshin e punës së Qeverisë, të gjithë e kemi parasysh intensitetin e shtuar në përmbushjen e standardeve, për çka meriton përkrahjen e plotë. Gjithashtu kemi vëmendjen edhe te projektligjet e shumta për të cilat Qeveria dhe ministrinë përkatëse duhet të jenë më të kujdesshëm në procesin e hartimit të tyre për të qenë në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Në anën tjetër Qeveria me mekanizmat e vet duhet definitivisht ta jetësojë zbatimin e ligjeve, sepse vetëm në një vend ku funksionon shteti ligjor favorizohet çdo segment i jetës. Çdo fushë, gjithsesi, hap rrugë më të mira për investime nga jashtë për vende të reja të punës. Kështu mund t'i kontribuojmë zhvillimit ekonomik mbi bazën e të cilit zhvillohet edhe super struktura shoqërore.

Këtu do të ndahesha në disa çështje të cilat më preokupojnë për punën time. Për krijimin e infrastrukturës ligjore për hulumtime gjeologjike, sektor mjaft i rëndësishëm për Kosovën, për rimkëmbjen e minierave, për hartimin e një plani operativ më të qartë e më të zbatueshëm për sanimin e gjendjes së energjetikës, mendoj se për këto e çështje dhe çështje të tjera Qeveria duhet të punojë me seriozitet të shtuar. Për strategjinë e zhvillimit të energjetikës Ministria e Energjetikës dhe e Minierave po bënë punë të mirë dhe jep shpresë për tejkalimin e problemeve në këtë fushë aq të rëndësishme për zhvillimin e vendit.

Me pak fjalë, secili institucion dhe individ le të jenë në nivel të detyrës dhe të rolit që kanë dhe punën në çdo hap ta dinë ta monitorojnë për tu shmangur gabimeve dhe për t'i tejkaluar problemet dhe pengesat për të ecur përpara. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet Ramë Buja.

Urdhëro Nexhat Rexha.

DEPUTETI NEXHAT REXHA – I nderuari z. kryetar, z. kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë.

Raporti i Qeverisë së Kosovës për punën 100 ditëshe të saj është një pasqyrë e kësaj periudhe, i cili në 84 faqet e tij tregon se mund të punohet edhe më tepër. Konsideroj se ministratë ekzistuese të Kosovës kanë paraqitur detaje të rëndësishme për punën e bërë, duke pasur parasysh se shumë çështje kanë lidhshmëri nga afatet e kaluara për të finalizuar projektet e paraqitura.

Në këtë raport keni pasqyruar shumë projekte, jeta e të cilave vazhdon me vite të tëra p.sh. unë do të marrë një shembull nga komuna e Dardanës. Palestra sportive në Dardanë është në fazën e nevojave të mëdha dhe mund të them edhe kritike, sepse mos finalizimi i saj dhe i disa të tjerave në Kosovë paraqet rrezik, jo vetëm të prishjes, por edhe të stërngarkimit të buxhetit të tyre. Në disa raste kemi përsëritje të disa projekteve, por është shumë me rëndësi shtruarja e tyre në raport, sepse kështu shihen qartë investimet e ndryshme nëpër komunat e Kosovës.

Angazhimet e Qeverisë Çeku shihen në bazë të raportit, se ato janë fokusuar, me theks të veçantë, në përmbushjen e standardeve të Kosovës e që ato kanë për objektiv arritjen e qëllimit final të Kosovës, çka mendoj, se rezultatet janë të pranishme nga dy faktorë kryesorë, ai vendor dhe nga ai ndërkombëtar.

Vlen të theksohet parashtrimi i projektit afatgjatë për ndërtimin e termocentralit Kosova C, si domosdoshmëri për të ardhmen e një stabiliteti të Kosovës.

Çështja e ligjeve duhet të intensifikohet dhe të mbikëqyret zbatueshmëria e tyre në praktikë në të gjitha nivelet e institucioneve të Kosovës. Duke pasur parasysh faktorin kohë, në të cilën është duke ecur populli dhe politika e Kosovës gjithnjë në koordinim me faktorin ndërkombëtarë, konsideroj se raporti 100 ditore jep shenja pozitive për zhvillim më të begatshëm për të ardhmen e vendit tonë. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramë Buja, le të përgatitet deputetja Safete Hadergjonaj.

DEPUTETI RAMË BUJA – Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari z. kryetar, ministra dhe kryeministër.

Unë do të përpiqem që mos t'i përsëris kolegët e mi edhe pse është tepër vështirë, por e them se kryeministri edhe Qeveria me siguri këtë fjalën time nuk do ta marrin as ironike e as nihiliste, por to ta marrin diçka të jetë vërtet një sinjal qëllimshëm, edhe pse pozitë opozitë është një qëllim i përbashkët që e dimë të gjithë. Por, i them z. kryeministër jemi shumë të vjetër dhe e njohim relativisht mirë, ose mirë, njëri tjetrin. Vazhdoj të kem disponimin që kam shfaqur edhe para ndërkombëtarëve dhe para miqve të mi, se më vjen keq për z. Çeku, për pozitën në të cilën është, sepse është futur nëpër deriçkë të vogël për

një çështje shumë të madhe dhe këtu vazhdoj të jem me keqardhje edhe me këtë raport mbi 100 ditësh të tij, në fakt i përfolur si 600 ditësh dhe kjo sinqerisht më vjen keq përsëri dhe u përpoqa dhe më erdhi keq për kohën që kalova duke e lexuar këtë raport. Por, sinqerisht po ju them, megjithatë, u përpoqa që të ndajë realitetin që është në Kosovë në përputhje me të, ta ndërlihdh disi me këtë raport që në fakt, kur e dëgjon dhe e lexon, del se ne jemi mrekullia vetë nga të gjitha të mirat e mundshme që i ka bota dhe që na janë futur në Kosovë. Dhe kjo del, analizojeni vetë, s'dua ta cilësoj, se "sukses ma i madh i kësaj Qeverie" është ruajtja e kësaj strukture, që më së paku ose hiq nuk është dashur të ruhet si qeveri, dhe unë, vërtet, mos qofsha në lëkurën e z. Agim Çeku, se i ka duar dhe këmbë të lidhura, sepse jam shumë i sigurt, po të kishte qenë i lirë në veprimet e veta, do të kishte bërë gjera të mira, të mëçme, të urta dhe profitabile për Kosovën. Por, ja që është në pozicionin që është dhe, po e përsëris, mos qofsha në lëkurën e tij. Sukseset e tjera, cilat janë? Ndoshta, cilësimi më i mirë i mundshëm ka qenë – identifikimi i problemeve, por jo i sukseseve në këtë lëmë, sepse, në fakt, nuk kanë ekzistuar. T'ia atribuosh vetvetes suksesin për plotësim standardesh dhe raportin pozitiv në Këshillin e Sigurimit, e dimë bashkë, pa e përfolur dhe pa e sqaruar përfundimisht, sepse a ka ndodhur ky cilësim pozitiv, e kemi ditur një muaj përpara se kështu do të ndodhë në KS. S'dua t'i përfoli këto gjera. E dimë mirë nivelin e zhvillimit ekonomik dhe dua t'i përmend tri e-të dhe pjellën e e-së së katërt. Janë shumë simpatike tri e-të – ekonomi, edukim dhe energjetikë. Më thoni ju lutem, sa unë kam të dhëna dhe sa e di, ekonomia është në rënie dhe kjo është nën zero. Nëse unë kam përsëri të dhëna për energjetikën, unë mbrëmë isha tre orë e gjysmë pa rrymë, dmth. po e them kështu drejtpërdrejt. Arsimi ose edukimi. Më thoni cila është lëvizja nga ajo zero që është në gjuhë, dhe unë po e pranoj. Është shumë logjike që këto tri e-të e suksesshme të lindin e-në e katërt për në Evropë. Është larg kjo. Tepër larg kjo të thuhet. Dhe, unë do të kisha dëshiruar, sepse, duke qenë të suksesshëm ju zotëri kryeministër dhe qeveria-ekzekutivi i Kosovës, si Kosovë, pavarësisht se ne do ju kishim sfiduar shumë si opozitë, kjo nuk do të prishte punë, do të ecnim bashkë përpara. Fliten dhe përfliten si rezultate vizitat dhe takimet etj., etj. Kanë ato ngapak rezultate, ngapak efekte pozitive që i dimë bashkë të gjithë dhe nuk kemi nevojë t'ia sqarojmë njëri tjetrit? Por, këto të futen në raportin 100 ditësh, përsëri nuk është diçka që meriton për tu futur. Dhe, diçka që vërtet më pëlqeu, që u përmend edhe nga z. Ramadan Kelmendi, kolegu im i dashur, që u tha se asnjë fjalë të vetme as që kemi bërë gjë e as që jemi përpjekur për të bërë diçka për 17,5% të territorit të Kosovës që është i ekskomunikuar nga ne. Qeverisë i ka takuar ta thotë së paku se burra, ju të tjerë kolegë deputetë dhe qeveritarë, nuk kemi mundur të bëjmë bash asgjë, siç është realiteti, por jemi shpërfillur në këtë raport. Flitet për TMK-në, për ShPK-në e tjera, e tjera. Ne i dimë këto raporte dhe mundësitë e ndikimit, prandaj do të ishte shumë korrekte të mos futen në këtë raport, sepse i dimë limitet e ndikimit dhe mundësitë e ndikimit dhe po kështu se sa mund të futen në një raport qeveritar këto gjera. Flitet për do fushata të vetëdijësimit. Unë përsëri nuk dua t'i nënvizoj, por po ju them sinqerisht, të shihet, të dëgjohet raporti i sotëm këtu, ekspozoja e kryeministrit që ishte shumë simpatike dhe po të ishte kjo krejt e qëndrueshme dhe vërtet edhe do të ishte shumë gëzim për opinionin qytetar të Kosovës, por fatkeqësisht është paksa më ndryshe, ose shumë çka më ndryshe, dhe unë do ta kisha lutur z. kryeministër që të ketë kujdes në këto gjera, sepse duke i thënë vetëm të mirat dhe duke u përpjekur për të përmendur vetëm të mirat e caktuara, do të ishte shumë më korrekte, shumë më përmbajtjesore, shumë më kolegiale dhe më e

frytshme që të thuhej – këto i kemi bërë, këto jemi përpjekur për t'i bërë dhe këto s,i kemi bërë fare, e ka shumë, shumë që s'është bërë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj, le të përgatitet deputeti Berat Luzha.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Kryeministri në fjalimin që e mbajti para deputetëve me datën 10 mars, ditën që u zgjodh kryeministër, është zotuar që Qeveria që do ta udhëheqë ai, do të përqendrohet në përmirësimin e kushteve të punës, në rritjen e punësimit, në furnizimin stabil me energji elektrike, ngritjen e pagave të punonjësve, në arsim, në shëndetësi, në ngritjen e policisë, të ushtrisë dhe në ngritjen e pensioneve.

Bazuar në raportin që kemi përpara duken tepër cinike deklaratimet e kryeministrit Çeku, sepse nga ky raport 100 ditore shihet qartë se nuk ka iniciativa për të bërë atë që ka premtuar në lidhje me këto çështje që i thashë më lartë. Ne do të donim që puna juaj z. kryeministër, vërtet, të rezultojë me sukses në të gjitha sferat, por ju e dini nga disa hulumtime që janë bërë në Kosovë, se pakënaqësia e qytetarëve për gjendjen e keqe të ekonomive të tyre familjare vetëm sa është rritur.

Edhe me ju në krye nuk erdhi ndonjë e mirë për qytetarin, por përkundrazi u thellua kriza ekonomike. Si duket zotimi i juaj se qeverisja nën udhëheqjen tuaj do të jetë e bazuar në mirëqenien e qytetarit, do të mbetet vetëm një frazë boshe. Meqë ishit respektuar nga pozita prej nga erdhe, është për të ardhur keq, që edhe ju z. kryeministër, ashtu si paraardhës juaji, z. Kosumi, në vend që të sillni risi në qeverisje, u bëtë mburojë e mirë e strukturës qeveritare, që në vazhdimësi ka shkelur ligjet, rregulloret, udhëzimet dhe procedurat tjera të menaxhimit financiar me paranë publike të strukturës që ke instaluar në institucion, me ryshfetin, me nepotizmin, me mashtrimin, me përvetësimin dhe me shpërdorimin.

Dëshmia më e mirë se ju nuk bëtë diç konkrete për të arritur të paktën atë që keni deklaruar me qenë se program të qeverisjes tuaj nuk keni, është edhe pika 6 dhe 6.1. e këtij raport të punës.

Korniza afatmesme të shpenzimeve nuk është produkti i punës 100 ditëshit po ashtu Qeveria nuk e ka përmbushur obligimin e vet, siç ka premtuar me programin qeveritar që Kosovën ta bëjë në strategji të zhvillimit ekonomik edhe pse për këtë qëllim janë duke u harxhuar mjetet të konsiderueshme financiare.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave konsideron si të arritur se e ka filluar procesin e buxhetit dhe ka lëshuar qarkoren buxhetore 1 dhe 2. Kjo është punë rutinore dhe cilido ministër apo kryeministër që vie e ka këtë punë obligative. Qeveria që me keqmenaxhimin e buxhetit, shkaktoi deficitin buxhetor dhe në vend që suficiti i viteve të kaluara të përdoret për projekte investive u orientua në mbulimin e deficitit, nuk shqetësohet dhe nuk ndërmerri kurrfarë masash për ta shtuar buxhetin. Lavdërohet se

paska bërë projeksionin buxhetor për vitin 2007 në vend që të shqetësohet se ka projektuar një buxhet në 10 milion euro në pak se sa në këtë vit.

Po ashtu lavdërohet se në konferencën me donatorët ka marrë përkrahjen që deficitin buxhetor i vitit 2007 do të financohet nga komuniteti ndërkombëtar.

Z. kryeministër do të ishte mirë që në raport të tregoni çfarë keni bërë me mjetet e grumbulluara të investohen aty ku duhet në arsim, në shëndetësi, në infrastrukturë, çfarë keni bërë që buxheti tërësisht konsumuesi i deritashëm të ketë rol nxitës në zhvillim përmes projekteve investuese publike dhe të ketë ndikim në krijimin e politikave të qëndrueshme zhvillimore.

Kryeministri e di se në tremujorin e parë të këtij viti nga buxheti janë shpenzuar më se 1 milion e 100 mijë euro për telefon, mbi 600 mijë euro për udhëtime brenda e jashtë vendit, mbi 2 milion euro për naftë, mbi 2 milion e 700 mijë euro karburante për vetura, mbi 1 milion e 200 mijë euro janë shpenzuar për mirëmbajtjen e veturave, mbi 1 milion e 100 mijë euro për qira.

Në raport thuhet se rëndësi e veçantë i është kushtuar zvogëlimit të shpenzimeve, por nuk vërehet se cilat janë masat konkrete z. kryeministër që ju keni ndërmarrë gjatë këtyre 100 ditëve të qeverisjes suaj për t'i reduktuar këto shpenzime dhe për një shfrytëzim racional dhe efektiv të buxhetit.

Në raport është paraqitur një grafikoni ku shihet se në periudhën janar – maj janë rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime, kurse ka një rënie të dukshme të shpenzimeve kapitale dhe nga kjo paraqitje grafike nuk vërehet se është bërë diç konkret në reduktimin e shpenzimeve. Ndoshta gjatë tremujorit të dytë Qeveria ka qenë në dietë, ashtu siç është dal dje në mjetet e informimit, por druaj se shpenzimet janë edhe më të mëdha pasi ushqimi dietal kushton edhe më shtrenjtë.

Nga ky raport vërehet se Qeveria nuk ka arritur të krijojë politika fiskale të favorshme, thuhet në raport se reforma në Administratën Tatimore të Kosovës ka për qëllim të arrijë standardet e Bashkimit Evropian. Por nuk thuhet asgjë se cilat masa janë ndërmarrë gjatë këtyre 100 ditëve për eliminimin e vazionit fiskal për pengimin e aktiviteteve biznesore jolegale dhe zvogëlimin e ekonomisë joformale. Çfarë ka ndërmarrë Qeveria të krijojë politika fiskale të favorshme, ne nuk e shohim këtë raport.

Në raport thuhet se trendet aktuale gjatë kësaj periudhe tregojnë një stabilizim të treguesve kryesorë makroekonomik, me një tendencë të rritjes së disa prej tyre nga aspekti pozitiv i ekonomisë.

Qeveritarët duhet ta dinë se treguesit makroekonomikë jepen në shifra, atëherë cilët tregues janë rritur dhe sa janë rritur?

Papunësia është problem kryesor me të cilën përballet Kosova. Qeveria e di se në tregun e punës në vitin e kaluar janë evidencuar mbi 30 mijë veta si fuqi e re e punës, kurse shkalla e papunësisë është më e lartë se një vit më parë.

Të dhënat e publikuara, qoftë nga Fondi Monetarë Ndërkombëtarë, qoftë nga Banka Botërore japin shifra në rritje, qoftë të varfërisë së skajshme, qoftë të popullsisë që jeton në varfëri, do me thënë nuk është lehtë të jetohet me më pakë se një euro apo me një ero e gjysmë.

Kjo varfëri është produkti i papunësisë. Në raport thuhet se Qeveria ka ndërmarrë hapa në uljen e papunësisë, cilët hapa i ka ndërmarrë Qeveria dhe cilat janë rezultatet e këtyre hapave të ndërmarra? Thuhet se Ministra e Ekonomisë dhe Financave ka filluar 19 auditime të brendshme. Ne si deputetë kemi shumë pak informacione, qoftë për auditimet e brendshme, qoftë për auditimet e jashtme, pasi ende nuk kemi kurrfarë raporti të auditimit për periudhën e qeverisjes së koalicionit qeverisës.

Por për shpenzimin e parave publike por që shpenzimet e këtyre parave (publike) i përcjell jo transparenca dhe kamuflimi i të dhënave dhe i fakteve, shkeljet e shumta të ligjeve e ka dëshmuar vetë ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, kur i numëron shkeljet që kanë ndodhur në këtë Ministri në letrën dërguar kryeministrit për ish-sekretarin permanent të kësaj Ministrie shumë kohë pasi ka pasur raportet e auditimit të brendshëm.

Z. kryeministër kur do të keni mundësi apo do të kenë qasje deputetët në raportet e auditimit Në faqen 24 të këtij raporti Qeveria jep objektivat për rritje ekonomike pozitive në vitet e ardhshme, me një rritje prej 2.5% të GDP-së në vitin 2008 dhe 3% në vitin 2009. Duhet t' ia kujtoj Qeverisë se ka premtuar se në vitin 2006 se rritja e ekonomike do të jetë 4 deri 6%, sipas të dhënave të Fondit Monetar të Bankës Botërore dhe UNDP-së në vitin 2005 kemi pasur trend negativ të rritjes ekonomike për 0.5% e në mungesë të masave adekuate ky trend negativ vetëm sa do të thellohet.

Hipokrizia i këtij koalicioni s'ka fund. Për të realizuar standardin për ekonomi ministri i Ekonomisë dhe i Financave kërkon nga qytetarët e Kosovës mirëkuptim për sakrificën që duhet bërë në dëm të realizimit të shumë projekteve me rëndësi. Pra, qytetarët duhet të kenë mirëkuptim ndaj Qeverisë, të durojnë edhe më tutje varfërinë dhe skamjen, të heshtin edhe atëherë kur haptas keqpërdoren paratë publike, kur nuk ka kurrfarë perspektive për ta. Duhet të kenë mirëkuptim qytetarët ngase pushtetarët nuk mund të heqin dorë nga luksi shfrenuar për vete, kështu që më lehtë është të sakrifikojnë qytetarët ngase ata sipas ministrit s'qenkan mësuar në luks dhe e dinë të sakrifikojnë në momentet e duhura, por se deri kur qytetarët do të lejojnë luksin e të zgjedhurve të tyre mbetet të shihet në të ardhmen. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, le të përgatitet deputeti Fetah Berisha.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Faleminderit z. kryetar. Në fillim të mbledhjes kemi pasur jo një, por dy raporte paralele për punën e Qeverisë, njërin raport të kryeministrit dhe tjetrin të kryetares së Grupit Parlamentar të AAK-ës.

Nuk e mora vesh se cili ishte më i mirë. Duke lexuar raportin 100 ditore u ndala në pjesën për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural dhe pashë se në këtë sektor vërtet nuk është bërë asgjë. Ajo çka karakterizohet në këtë pjesë të raportit, por edhe në raportin e tërësishëm, është se nuk bëhet në asnjë paraqitje aktiviteti i Qeverisë ,përkatësisht e Ministrisë brenda periudhës 100 ditore. Por kemi një material konfuz të përgjithësuar dhe të papërcaktuar në kohë, plot me frazeologji të kota dhe të pakuptueshme. Kështu në vend se raportit të përshkruaj punën, aktivitetin, sukseset apo mosesukseset e Qeverisë për kohën e caktuar raportuese që përfshin periudhën 10 mars- 20 qershor të këtij viti, këtu na dalin përpara gushti 2005, shkurti 2006, raporti i periudhës mes viteve 2002, 2005, plani i zhvillimit 2007, 2013 na del si tharja pritë që deri në vitet 2009 ose 2010 do të bëhet kështu e kështu, dhe na dalin disa ëndrra të bukura qeveritare.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe e Zhvillimit Rural jo vetëm në 100 ditshin raportues ,por as gjatë vitit të kaluar që kur e ka marrë mandatin nuk ka realizuar asnjë projekt të vetin të investimit. Kjo Ministri si po shihet ekziston vetëm sa për t'i paguar pagat e qindra të punësuarve në të.

Sivjet në Kosovë ka pasur vërshime të shumta të tokave të mbjella me kultura bujqësore, por para tyre Qeveria i ka mbyllur sytë, ashtu si i mbylli edhe kur breshëri shkretoi arat në disa rajone të Kosovës, ashtu siç nuk sheh kur para syve i humbin mijëra hektarë tokë të punës në vit, ashtu siç i mbyll kur AKM-ja i shet apo i privatizon tokat private, do me thanë tokat që kanë pronarë të ligjshëm siç ngjau në komunën e Kaçanikut.

Megjithatë një aksion do të kisha veçuar si mjaft pozitiv, atë të ngrënies publike para kamerave të mishit të pjekur të pulës nga qeveritarët në një ditë të bukur pranverë. Që nga ajo ditë e shënuar gripi vendosi të mos vijë fare në Kosovë, në mënyrë që kosovarët më në fund mund të hanë mish sa të donë pa pyetur sa kushton ai dhe pa u frikësuar se edhe atyre do t'i bie sëmundja e pulave.

Çështja e pyjeve është problem në veti, një problem shumë i madh i Kosovës- se, pyjet po shkatërrohen vazhdimisht ,madje me intensitet të shtuar - kurse Qeveria me papërgjegjësi tashmë e karakterizon dhe raportin për dy punëtorë të pezulluar nga puna për 218 kontrollime për gjoja vetëm 3912 metra kub dru dëme dhe për vetëm 612 metra dru të konfiskuara, kurse pyjet kanë mbetur pa zot, kanë mbetur pa roje, ka mbetur pa mbrojtjen e domosdoshme fizike dhe ligjore. Krijimi i 17 pikave mobile të kontrollit ashtu siç thuhet në raport në vendet më të frekuentuara dhe më të atakuar nga ndërprerit ilegale i largon edhe ato pak roje nga pyjet dhe i vendos rrugëve aty ku prerësit ilegale duke e ditur vendin nuk bien në to.

Edhe disa fjalë për përgatitjen e ligjeve nga Qeveria.

Duke e konsultuar edhe një herë listën apo evidencën e ligjeve të proceduara dhe të miratuara në Kuvend del se në periudhën 100 ditore Qeveria ka dorëzuar në Kuvend vetëm 10 ligje plus dy plotësim -ndryshim të ligjeve ekzistuese që në fakt janë amendamentimi i tyre. Shihet pra se edhe në këtë drejtim ka ngecje të madhe. Nëse vazhdon kjo dinamikë e ngadalshme e bërjes së ligjeve, atëherë vaj halli për Kosovën,

Kosova do të ngeçë edhe më shumë në të gjitha fushat e zhvillimit të saj dhe sidomos do të ngeçë në plotësimin e standardeve të kërkuara nga Bashkësia Ndërkombëtare.

Z. kryeministër në një mbledhje të Kuvendit e mbajtur para dy, tre muajve keni premtuar se do ta shikoni dhe do të përgjigjeni se çka është bërë me Ligjin për lojërat e fatit. Ky ligji siç dihet padrejtësisht është pezulluar me një vendim të njëanshëm të Qeverisë, ka një vit që një pyetje e imja kuvendore për këtë ligj është biseduar në Kuvend por ajo asnjëherë nuk ka marrë përgjigje, pse. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha, le të përgatitet deputetja Sala Berisha Shala.

DEPUTETI FETAH BERISHA – Ju faleminderit. i nderuari z. kryetar, i nderuari z. kryeministër, ministra kolegë deputetë, respekt për ju atje që e përcjellin seancën.

Sot në këtë seancë kemi para vetes raportin e Qeverisë së Kosovës për punën 100 ditësh të Qeverisë i cili po shqyrtohet. Në këtë raport mjaft të thuktë është bërë përpjekje për të pasqyruar punën dhe rezultatet e arritura të Qeverisë së Kosovës. Në raport është bërë përpjekje dhe kjo është arritur të tregohet realizimi i programit të Qeverisë në të gjitha fushat e jetës. Gjithashtu për 100 ditët e funksionimit të saj shihet se janë shënuar rezultate të lakmueshme ,sidomos te prioritetet siç janë: realizimi i standardeve, përpjekja për funksionimin e ... institucioneve demokratike në Kosovë, pastaj të drejtat e kthimit të minoriteteve ,në veçanti të minoritetit serb, liria e lëvizjes etj.

Pastaj shihet se është bërë punë e madhe në avancimin e statusit të Kosovës drejt pavarësisë së saj. Pastaj, Qeveria ka arritur suksese të mëdha në takimet e ndryshme sidomos dhe ndërkombëtare, ku vazhdimisht është potencuar edhe statusi i Kosovës. Mirëpo, asnjë raport dhe as ky sa do që të jetë gjithëpërfshirës nuk ka mundur t'i përfshijë të gjitha gjërat dhe tani unë e kam dalluar disa nga këto:

Në seancat paraprake, në këtë Kuvend disa njerëzve të opozitës u janë bërë akuza të mëdha në adresë të Qeverisë për korrupsion dhe për involvim në krimin e organizuar. Pastaj nga shtypi jemi informuar se janë përpiluar dosje të ndryshme denoncuese kundër ministrave të caktuar, ku janë përmendur edhe emrat e tyre. Në këtë raport ma thotë mendja është dashur të paraqiten edhe shpjegime për to se këto akuza kanë mbështetje në argumente reale apo janë sajime të qëllimta për ta kompromentuar Qeverinë dhe punën e saj.

Nën 2. në debatin që është bërë në këtë Kuvend, sidomos atëherë për decentralizimin dhe pilot- komunat të gjithë jemi pajtuar se decentralizimi është i nevojshëm për Kosovën, por realizimi i tij duhet të jetë gradual dhe afatgjatë. Pastaj, të gjithë jemi pajtuar se decentralizimi i mirëfilltë në Kosovë dhe formimi i komunave mund të jetë i mirëfilltë vetëm pas pavarësisë së Kosovës dhe regjistrimit të popullsisë së Kosovës. Gjithashtu këtu është thënë se decentralizimi nga ana serbe ka për qëllime që t'i ruajë strukturat paralele të saj dhe të formojë komuna etnikisht të pastra. Mua ma merr mendja se edhe ky element është dashtë të fshihet dhe të sqarohet pak më thellë edhe më thuktë në raport.

Nën 3 Atje ku flitet për arsimin ma thotë mendja se është thënë shumë pak për arsimin në diasporë ,sepse atje kemi një numër të madh të bashkatdhetarëve tanë, atje fëmijët e njerëzve tanë duhet që të jenë të lidhur me kulturën dhe gjuhën tonë, sado që atje janë të integruar. Prandaj, duhet të gjejmë vend më tepër ,sepse diaspora jonë ka qenë shtyllë e Kosovës edhe në pikëpamje financiare edhe pikëpamje politike. Qeveria e Kosovës duhet të jetë edhe Qeveri e diasporës, ajo duhet të jetë në kontakt me njerëzit atje, edhe kur vinë këtu.

Nën 4 Edhe në programin e Qeverisë edhe në këtë raport,aty ku flitet për bujqësinë, nuk është folur sa duhet për segmentin e vreshtarisë, ngase ashtu si nuk mund të flitet për ekonominë pa bujqësinë, nuk mund të flitet për bujqësinë pa segmentin e vreshtarisë, sepse stimulimi dhe rikultivimi i hardhisë së rrushit në kodrinat bukolike të Podrimës me dëshirë që të kultivohet dhe të punohet kjo kulturë njëvjeçare dhe verërat e kualitetit të lartë të Rahovecit të gjejnë vend në tregun evropian të Gadishullit Ilirik edhe më gjerë. Prandaj është për çdo lëvdatë themelimi i Entit për Analizën dhe Punimin e Verërave të Rrushit në Rahovec nga ana e Qeverisë .

Qeveria ka bërë punë të madhe edhe për realizimin e standardeve të ndryshme, por sidomos edhe për të drejtat e minoritarëve. Mirëpo, unë kam përshtypjen nga një herë se minoritarët e tjerë në Kosovë lihen prapa në krahasim me minoritetin serb. Ja për shembull këtu kam një dokument, në komunën e Rahovecit deri tani gjithë personeli arsimor serb është furnizuar me dy paga, një nga Qeveria e Kosovës dhe një nga Qeveria e Serbisë. Tani këto ditë kur bëhet fjalë për përmbushjen e standardit të kthimit të serbëve në trevat e tyre ata të organizuar me nënshkrime heqin dorë nga pagat që t'i marrin në Kosovë ,por duan t'i marrin qëllimisht në Serbi. Unë mendoj se kjo ka edhe prapaskenë politike.

Gjithashtu edhe kur është diskutuar këtu në këtë Kuvend për Universitetin ma thotë mendja se është bërë pak për minoritetet e tjera, siç janë : minoriteti rom, ashkali, turk, mysliman dhe të tjerë dhe nuk është thënë asnjë fjalë sa nxënës, sa studentë, cilat janë programet e tyre, cila është literatura e tyre etj. Ma merr mendja se në të ardhmen kjo punë duhet të zë vend.

Megjithëkëtë Qeveria e Kosovës, përkatësisht kryeministri ka bërë një raport të thukët gjithëpërfshirës, të gjithanshëm dhe të ngjeshur me brumë të thukët dhe me faktologji 100 ditësh të jetës së tij. Prandaj, ne i shprehim përgëzimet tona kryeministrit dhe gjithë ministrave të tjerë të ministrive që edhe në të ardhmen këtë gjë ta avancojnë edhe më përpara. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Me kartelën e deputetes Sala Berisha – Shala flet deputeti Bajrush Xhemajli. Le të përgatitet deputeti Jonuz Kastrati.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryetar, përshëndetje për ju z. kryeministër, ministra, kolegë deputetë.

Sa i përket vështrimit të përgjithshëm të raportit nuk do të ndalem se pajtohem me vlerësimin e parafolësve nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Unë do të ndalem në çështje konkrete edhe atë në disa segmente të punës së Qeverisë, pasi edhe ashtu nuk mjafton koha për t'u detajizuar.

Në rend të parë do të theksoj faktin se ju, z. kryeministër në prioritetet e Qeverisë keni pasur edhe energjinë më të drejtë, me ç'rast keni premtuar stabilizim në furnizimin me energji, por në këtë raport edhe në prezantimin tuaj sot shihet qartë se nuk e keni arritur objektivin të cilin e keni paraparë dhe nuk keni arritur që sado pak ta përmirësoni gjendjen në vend, pavarësisht se ju i keni dhënë shumë hapësirë kësaj çështjeje me lëvdata të shumta gjëja për suksesin. Edhe më tutje janë prezentë të gjitha problemet që ishin në këtë fushë, para se ju, z. Çeku, të vini kryeministër, madje në 100 ditshin tuaj janë shtuar edhe probleme të reja.

Gjendja nuk ka ndërruar në menaxhmentin tuaj tejte të dobët e jo kredibil të KEK-ut, të cilin e përkrah pa rezervë, Qeveria e juaj. Si rezultat i këtij menaxhimi nuk është rritur në mënyrë të ndjeshme as faturimi dhe as inkasimi dhe nuk janë zbutur këto probleme të mprehta në korporatë. Problemet në sferën e faturimit dhe të inkasimit nuk janë shtuar drejt as nga Qeveria dhe as nga drejtuesit e KEK-ut, pasi fajtor kujdestar i lënë konsumatorët e amvisërisë dhe inkasantët, të cilët realisht janë më së paku fajtorë. Them kështu, sepse konsumatorët janë ata që më shumë harxhojnë, sepse konsumatorët komercialë janë ata që më së shumti harxhojnë e nuk paguajnë, ata kanë borxhe me dhjetëra qindra mijëra euro ashtu si edhe institucionet shtetërore shumica e të cilave nuk paguajnë rrymë.

Inkasantët, të cilëve u lihet faji më kot bëjnë padi penale, sepse menaxhmenti vendor e ndërkombëtar i fsheh borxhlinjtë dhe vjedhësit e mëdhenj të rrymës dhe i mbron borxhlinjtë e institucioneve. Qeveria në vend se të përqendrohet në konsumatorët e mëdhenj komercialë u bie në qaftë atyre më të dobëtëve dhe atyre më me pak peshë.

Në 100 ditshin e qeverisjes suaj, z. kryeministër, është komplikuar edhe më shumë gjendja në sferën e energjetikës për shkak të betejës së Qeverisë suaj për të marrë kompetencat nga Zyra e Rregullatorit të Pavarur të Energjisë, në mënyrë që ta tenderojë qoftë riparimin e blloqeve të termocentralit Kosova A, qoftë tenderimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese me ç'rast Qeveria ngurron ta japë një mega tender, ku do të ndërtoheshin kapacitetet e reja prodhuese prej 2 mijë e 100 megavatesh energji elektrike.

Kjo betejë e papërfunduar ende ka bërë që Qeveria të ngeçë për të riparuar blloqet e termocentralit Kosova A e që kjo vonesë Kosovës po i kushton tepër shumë.

Kabineti juaj vazhdon të merret me promovimin bombastik të mediave për efekte propagandistike për ndërtimin e termocentralit të ri me kapacitet 2100 megavatesh, i cili nuk mund të fillojë të japë rezultate para shtatë vjetësh, ndërsa nuk merret seriozisht me zgjedhjen e problemeve emergjente para një dimri të rëndë energjetik që na pret.

Në faqen 29 të raportit e merr si sukses lëshimin në punë të bllokut të 3 të termocentralit Kosova A pas kryerjes së punëve në riparimin gjeneral. Mossuksesi i parë i këtij blloku është se janë vonuar shumë punimet dhe e dyta nuk është bërë riparim gjeneral, por riparim i pjesshëm dhe jo cilësor, prandaj edhe ka ndodhur prishja pas dy ditësh të lëshimit në punë për disa ditë me radhë. Këto prishje jam i bindur do të jenë vargore e njëpasnjëshme nëpër kohë të ndryshme, për shkak të fyteve të ngushta që janë dhe që nuk janë riparuar.

Ju e dini z. kryeministër Çeku se unë jam nga të rrallët që ju kam përkrahur në riparimin e këtyre blloqeve, besoj me të drejtë ,por unë nuk do t'ju përkrah në riparime shkel e shko dhe sa për të thënë që i bëni, por vetëm atëherë kur i riparoni vërtet në mënyrë gjenerale, pra në të gjitha hallkat dhe në mbrojtje të mjedisit nga ndotjet. Për të fshehur të gjitha dështimet e Qeverisë për zgjidhjen e problemit energjetik është orkestruar një fushatë propagandistike edhe në media, madje u tha edhe këtu nga kryeministri dhe nga disa të painformuar ,do të thosha për t'ia bërë qefin kryeministrit dhe ministrit përkatës lidhur me gjoja suksesin që paska arritur Qeveria në fushën e energjetikës.

Në rastin e një marrëveshje e cila edhe ashtu u quajt e kompromisit ndërmjet Qeverisë, Bankës Botërore USAID-it dhe AER-it ku qenka arritur harmonizimi që në muajin korrik të bëhet shpallja e shprehjes së interesit, do me thanë, është arritur shpallja e shprehjes së interesit me të cilin ftohen investitorët potencialë privatë që të shprehin interesimin e tyre për investime në Kosovë, merret vesh tash, në fakt është bërë shumë zhurmë për asgjë. Kjo punë i ngjan asaj thënies popullore Peshku në det e fulterja në zjarr.

Z. kryeministër, me ato 8 milionë e diçka që s'e besoj që fulteren keni për ta blerë e peshkun me këtë punë nuk besoj ta gjeni kund, se këto janë fjalë në erë , Qeverisë i tregon fakti se edhe tani gjat sezonit veror kur konsumi i energjisë është më i vogël se në çdo stinë tjetër dhe kur kushtet për prodhimin e energjisë janë më të mira, prapëseprapë gjithë konsumatorët e dinë dhe e ndjejnë në lëkurën e tyre për çdo ditë se nuk ka furnizim të rregullt dhe të mos flasim për sezonin dimëror që na pret së shpejti.

Të nderuar deputetë, në faqen 30 të raportit, flitet për qëndrimet e Qeverisë ndaj zhvillimeve në Trepçë. Ju qeveritarë të koalicionit, një të metë tepër të madhe lerë më që nuk e keni pranuar si dështim, por do të duhej ta pranoni më së paku, por edhe e keni paraqitur si sukses. Në fakt ju i referoheni qëndrimit tuaj në raport ndaj strategjisë së ristrukturimit dhe falimentimit të Trepçës që në fakt jeni shumë kontravers në kontekst të fjalëve me veprimet që bëni. Kjo strategji e ristrukturimit dhe e falimentimit të Trepçës e di z. ministër këtu është e AKM-ës dhe për strategjinë tuaj që shkruani këtu unë nuk jam në dijeni ,por e keni përmbledhur aty dhe mund të referohen në atë çka keni thënë se ju kërkoni nga UNMIK-u dhe AKM-ja që të mos nxitohen procesi i riorganizimit dhe të shqyrtohen politikat lidhur me Trepçën. Gjithashtu kërkohet që Qeveria të ketë të drejtën e vetos në marrjen e vendimeve strategjike lidhur me këtë proces. Është e vërtetë që keni deklaruar kështu, por keni vepruar plotësisht ndryshe, faktikisht veprimet të njëpasnjëshme kanë qenë në kundërshtim me këto deklarime që ju i keni bërë këtu në raport, pasi e keni aprovuar dokumentin strategjik të AKM-ës dhe ardhjen e një administratori të huaj për ta implementuar këtë dokument, i cili është shkatërrimtar dhe

katastrofal për Trepçën. Unë kam dhënë mendim në vazhdimësi për këtë dokument që e cilësoj si të tillë. Ju po mohoni me kokë z. ministër por unë po e marr bile replikë këtë dhe po ju them se përfaqësuesit e Qeverisë suaj. të cilët janë në AKM kur nuk e kanë kundërshtuar, madje vetë janë pjesëmarrës në atë dhe qysh po mund atje po e përkrahin një dokument që është në kundërshtim me dokumentet tuaja dhe janë pyetur për këtë çështje z. Shatri është këtu dhe ka thënë as që dimë për atë, nëpërmjet mediave, fillimisht ka thënë dhe pastaj këto janë fakte të cilat vazhdimisht kanë qenë edhe nëpër shtyp, por ju nuk i keni kundërshtuar dhe përkundrazi i keni aprovuar, jeni shumë kontravers në këto që i bëni. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Jonuz Kastrati, le të përgatitet deputetja Selvije Halimi.

DEPUTETI JONUZ KASTRATI – Faleminderit,. i nderuari kryetar, i nderuar kryeministër, ministra të nderuar deputetë.

Nga vetë të dhënat që janë pasqyruar në raportin 100 ditsh të Qeverisë Çeku, shihet që këtë 100 ditsh e karakterizon një proces mjaft dinamik në të gjitha fushat e përgjegjësisë të kësaj Qeverie. Duke filluar nga angazhimet në procesin e statusit final, vazhdimin e plotësimin të standardeve për Kosovën. por edhe angazhimet e ministrive veç e veç.

Duke u ndërlidhur me punën dhe rezultatet e ministrive shoh që Ministria e Arsimit vërtet ka arritur mjaft rezultate siç është edhe angazhimi i përbashkët me Qeverinë në procesin e rivendosjes së ligjshmërisë në Universitetin e Prishtinës. Por ne presim nga kryeministri dhe ministri i Arsimit që shumë shpejtë të rivendoset ligjshmëria edhe në institucionet arsimore parauniversitare, sepse nuk mund të vazhdohet edhe më tej me dyfishim drejtorësh nëpër shkolla dhe nga i njëjti buxhet i konsoliduar i Kosovës të paguhen dy persona për të njëjtin vend pune.

Në pjesën e raportit për Ministrinë e Pushtetit Lokal thuhet se janë dhënë këshilla ligjore për zgjidhjen e konflikteve administrative dhe ligjore për disa komuna që i përmendi kolegu Mujota si dhe rekomandimet e duhura, por nuk përmendet se çfarë hapa janë ndërmarrë kur komunat nuk i kanë respektuar ato këshilla dhe rekomandime. Kolegu Mujota përmendi Gjakovën unë nuk po përmend Malishevën që për tetë muaj resht nuk ka mbajtur asnjë mbledhje të kuvendit komunal. Shpresojmë që në raportin tjetër do të përfshihen edhe këto veprime të Ministrisë.

Sa i përket politikës sociale në raport konsideroj se është përfshirë mjaft pak. Këtu përmendet zbatimi i kriterëve të ligjshme dhe transparente, siç thuhet për të gjithë qytetarët e Kosovës. Nuk janë përmendur fare problemet që ekzistojnë në qendrat për punë sociale nëpër komuna si çështje suspendimi dhe mandej kthimi në punë i menjëhershëm i drejtorëve të këtyre qendrave, ani pse keqpërdorimet janë të vërtetuara.

Si mund të quhen kriteret të ligjshme dhe transparente kur një person me tre të punësuar në familje të ngushtë merr edhe ndihmën sociale, do ta kisha përgëzuar ministrin nëse do ta ushtronte ndikimin e tij që lista të përfituesve të ndihmave sociale të jenë publike ani

pse sipas listave ato nuk mund të jenë, në mënyrë që së bashku të shohin se kush janë ata përfitues, sepse edhe vet ministri është në dijeni. Për këtë është i njoftuar edhe zyrtarisht me shkresë se këto keqpërdorime vijnë edhe nga udhëheqësit komunal bile edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë po që nuk e kam të qartë se ministri këtu ka heshtur.

Shpresoj se në raportin e ardhshëm të Qeverisë puna dhe angazhimet e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale të jenë të shënuara më në detaje dhe vërtet të bindemi për ligjshmërinë dhe transparencën. Sidoqoftë puna e Qeverisë në këto 100 ditë ka dhënë mjaft rezultate dhe janë bërë përparime të dukshme kuptohet duke pasur parasysh kushtet me të cilat veprohet, për më tepër që këto përparime janë vlerësuar edhe nga vetë Bashkësia Ndërkombëtare.

Shpresojmë që në raportin e ardhshëm Qeveria të përfshijë edhe realizimin e aspiratave shumëshekullore të Kosovës për të qenë shtet i pavarur dhe demokratik.

Le të më lejohet që në fund pasi që u përmendën disa të dhëna nga terreni unë në mënyrë më të sinqertë dhe këtë jam i obliguar që në emër të Gjinnazit "Abdyl Frashëri" në Malishevë të falënderoj publikisht kryeministrin dhe Qeverinë në përgjithësi e me këtë edhe në emër të 15 prindërve të maturantëve që humbën jetën në Fusha Arzë për aprovimin e projektit më në fund për rregullimin e varrezave të 15 maturantëve, premtim i cili ishte dhënë nga Qeveria e atëhershme ditën e varrimit. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi, le të përgatitet deputeti Hajredin Kuçi.

DEPUTETI SELVIQE HALIMI – I nderuari kryetar, i nderuari kryeministër dhe ju kabinetit qeveritar, të nderuar kolegë deputetë.

Unë paraprakisht e përgëzoj kryeministrin për një iniciativë të re që ndoshta do ta futnim në praktikë në të ardhmen që çdo tre muaj të raportojë edhe përkundër faktit se nuk e obligon asnjë ligj apo akt nënligjor, por e ka ndier obligim moral që të raportojë për punën e tij. Kjo është për t'u përshëndetur.

Mirëpo për të dhënë një vlerësim real lidhur me punën 100 ditëshe ne është dashur paraprakisht të kemi një pikë fillestare, qoftë ajo zero 2, 3 e tutje prej ku është filluar dhe deri ku është arritur. Nuk mund të themi se është arritur shumë kur asnjëherë nuk u bënë publike se cilat ishin prioritetet e Qeverisë për 100 ditët e para. Në fund të këtij raporti shihen disa prioritetet për 100 ditët e ardhshme, ndoshta raportin pas 100 ditëve të tjera do ta kemi më lehtë ta vlerësojmë.

Nga raporti i paraqitur në fjalë shihet se Kabineti qeveritar si i tërë ka punuar do të thotë nuk ka ndejtur. Mirëpo, po që se shohim se sa është papuna dhe rezultatet e punës së tyre te qytetarët e Kosovës, kjo është një gjë tjetër, për të cilën ata i dhënë komentet e tyre çdo herë duke ofruar edhe ankesa nëpër media, duke ofruar edhe ankesat e ne deputetët pa padysim edhe te Kabineti qeveritar.

Një vështrim më të përgjithshëm do ta vë në këtë raport te pika 6.8 e paraqitur në faqen 47 dhe 48 që flet për punën në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Më vjen keq që ministri nuk është i pranishëm, por e ndiej si obligim t'i paraqes shqetësimet e mia: çdo gjë që është paraqitur në këtë raport është vazhdimi i punës dhe asgjë nuk shihet se ka qenë prioritet për këto 100 ditë.

Unë ministrit të Mjedisit kisha me ia bë pyetjen më se 270 punëtorë më se 35 makina zyrtare, a vetëm këto punë i paskan bërë për 100 ditë. Duke pas për bazë faktin se s'kemi prioritete por kemi një vazhdimësi të punës, unë mendoj se në këtë raport është dashur të ofrohet raporti për monitorimin e mjedisit tokë, ujë dhe ajër dhe raport për pikat e rrehta Trepça, KEK.

Raport për çështjet e pronës, raport për problemet me implementimin e ligjeve dhe raport për kompletimin e ligjeve me akte të tjera përcjellëse. Këtu vetëm shihet se është punuar në amendamentimin e Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, pse u dashtë të amendamentohet Ligji për mbrojtjen e mjedisit, ku ishin ato pengesa që nuk u implementua deri tash ai ligj edhe pse u dash që të pritët më se 2 vjet për amendamentim kur është thënë që në start, sepse ka probleme në implementim.

Pastaj, është dashur të paraqitet një raport për dislokimin e banorëve të fshatit Hade dhe konkretisht gjatë këtyre 100 ditëve sa kërkesa erdhën nga këta banorë për dëmet që ju bënë gjatë rivlerësimeve të pasurisë së tyre.

Si dhe raporti tjetër për vërshimet që ndodhën në pranverë dhe publikisht u është premtuar atyre të cilët kanë pësuar dëme se dëmet do t'u kompensohen, çka është bërë lidhur me këtë?

Çështja tjetër është për dy gjëra mjaft kapitale. Këto ditë flitet se është në diskutim publik plani hapësinor i Kosovës. Nuk shihet në raport se sa është punuar në politikat integruese të planifikimeve në nivel komunal me këtë planin hapësinor të Kosovës. Sa do të jetë i qëndrueshëm plani hapësinor i Kosovës kur ende nuk është plani zhvillimor i Kosovës. Ne nuk e dimë se nga do të shkojë orientimi apo nga do të orientohet zhvillimi i Kosovës. Pa plan zhvillimor të Kosovës nuk mund të ketë plan hapësinor të qëndrueshëm të Kosovës.

Pastaj, kam pyetje strategjia për mbrojtjen e Mjedisit është përfunduar më se një vit dhe publikisht nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është thënë se kjo strategji do të shkojë në Qeveri dhe prej Qeverisë do të vijë në Parlament për miratim, kjo strategji ende, sa kam unë informata, nuk ka shkuar as në Qeveri mirëpo nuk ka ardhur as në Parlament, do me thanë zotimi publik nuk është mbajtur nga Ministria në fjalë.

Dhe këtu flitet për planin e Kosovës për veprim në mjedis është në fazën e implementimit.

Të nderuar kolegë, plani i Kosovës për veprim në mjedis është një fazë që rrjedh nga apo një plan që rrjedh nga strategjia për mbrojtjen e mjedisit se mund të jetë një plan për

veprim në implementim kur strategjia bazë, prej ku buron, flet se ai plan nuk është i aprovuar.

Unë sinqerisht po ju them se është shqetësuese paraqitja e këtij raporti për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor . Dyshoj se ministri e ka pasur në dorë këtë raport, që e ka afruar që t'u vijë deputetëve, sepse nuk ma merr mendja ndoshta që kish me lejue që të vijë një raport i tillë.

Është edhe një çështje tjetër që ka mund të rregullohet gjatë këtyre 100 ditëve, pse në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ende ka ngecje në paga, do të thotë punëtorët e kësaj ministrie janë për një pagë në minus, ku është arsyeja?. Dhe çka ka bërë kjo Ministri dhe a ka të qartë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor se çdo veprim nga njeriu si individ i vetëm dhe çdo veprim nga grupi dhe institucionet qoftë nivelit e bashkësisë lokale, nivelit lokal si komuna dhe nivelit qendror duhet të shkojë nëpërmjet saj . Me fjalë të tjera Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor lirisht mund të konsiderohet si një lloj filtrimi për të gjitha veprimet ,në mënyrë që ta ruajnë mjedisin që të dimë se çka po ndodh me pronat që të kemi një plan hapësinor të qëndrueshëm për të ardhmen. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Me qenë se kemi edhe 25 deputetë që janë paraqitur ta marrin fjalën, mendoj të marrim pauzën tash në orën një deri në orën 2,30, por me kusht që në orën 2,30 të fillojmë punën me diskutime e tjera.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA: Ju njoftoj se prezentë janë 64 deputetë në sallë, do të thotë ka mundësi të vazhdojë puna. Me qenë se deputeti Hajredin Kuçi nuk është në sallë, do ta bëjë një kapërcim të arsyeshëm dhe fjalën do t'ia jap doktor Ferid Aganit.

z. Agani, e keni fjalën

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit për mirëkuptim z. kryetar, E di se e kam kaluar rendin, por një situatë e jashtëzakonshme, ka ndërruar jetë sot kryetari i Degës të Partisë të Drejtësisë në Ferizaj dr. Tefik Idrizi dhe për atë arsye duhet të largohem më herët. Kërkoj falje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ngushëllime

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit! I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe deputete,

Periudha e qeverisjes së kryeministrit Çeku filloi në mënyrë tejet të pavolitshme pas ndryshimeve të shpejta dhe në një mënyrë të papërgatitur institucionale, që ndonëse të nevojshme, si të tilla nuk mund të sjellin rezultate të pritura , posaçërisht , jo brenda një periudhe të shkurtër kohore. Me gjithë respektin për angazhimin individual të kryeministrit Çeku, puna e Qeverisë vazhdoi të cilësohet me mungesë të vizionit, me improvizime dhe me veprime afatshkurtra, që te qytetarët nuk ka arritur ta krijojë përshtypjen se Qeveria është duke siguruar parakushte themelore për daljen nga situata e rëndë në të cilën gjendemi dhe për krijimin e një vizioni më të mirë dhe e më të qartë

për ardhmëri. Me këtë rast, lidhur me raportin e punës 100 ditësh të Qeverisë, do t'i kisha veçuar tri çështje: dy në rrafshin vendor dhe njëën që ka të bëjë me shumë në rrafshin ndërkombëtar.

Duke theksuar që në fillim se qëllimi i fjalës sime nuk është kritika e thatë për interesa meskine politike, por kontributi për përparimin e proceseve demokratike në një periudhë tejet të ndjeshme për Kosovën.

Çështja e parë ka të bëjë me moszbatimin e ligjeve në fuqi. Përcjellja ditore e zbatimit të ligjeve në fuqi paraqet instrumentin më të fuqishëm të çdo qeverie në përparimin e rrjedhave të gjithmbarshme shoqërore. Moszbatimi i ligjeve paraqet diversionin më të rëndë për proceset politike të ndërtimit të shtetit të pavarur të Kosovës. Kjo çështje është drejtpërsëdrejti e lidhur me çështjen e korrupsionit dhe të plotësimit të standardit të dytë - sundimit të ligjit.

I nderuari kryeministër, në raportin tuaj nuk ekziston asnjë analizë për shkallën e zbatimit të ligjeve në fuqi dhe kjo nuk parashihet të bëhet as në tremujorin e ardhshëm. Pa krijimin e kulturës së përgjegjësive institucionale, nuk mund të shpresohet për përparim të proceseve në asnjërin prej sferave të jetës shoqërore. Çështja e dytë ka të bëjë me pjesën e raportit tuaj që i referohet punës së Qeverisë në sektorin e shëndetësisë. Gjendja në këtë sektor të jetës shoqërore cilësohet me kontradikta të theksuara të cilat në raport nuk janë përmendura fare. Të përkujtoj gjendjen alarmante në furnizim me bama dhe grevën e punëtorëve të shëndetësisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës për shkak të kujdestarive të papaguara më shumë se gjashtë muaj në fillim të mandati tuaj. Nga raporti është e evidente se për problemet e grumbulluara në këtë sektor, Qeveria e Kosovës për momentin nuk ka zgjidhje gjithëpërfshirëse. Për këtë arsye problemet paraqiten në mënyrë të përnjëhershme dhe zgjidhen me metodën e zjarrfikësit prej sot deri nesër. Raporti nuk merret fare me dy shkaqet kryesore të gjendjes së tanishme në një: financimi tejet i dobët, i ulët i sektorit të shëndetësisë dhe nën dy, menaxhimin i sektorit të shëndetësisë në mënyrë të centralizuar nga niveli i Ministrisë së Shëndetësisë. Nuk ekziston asnjë tregues, i cili do të jepte së paku shpresë se Qeveria ka zgjidhje sistemore për problemet e grumbulluara. Çështja e tretë, që dëshiroj sot ta ngrit ka të bëjë me mungesën e një strategjie e rrjedhimisht të aktiviteteve të Qeverisë në rrafshin ndërkombëtar me qëllim të krijimit të një imazhi të ri për Kosovën. Është mirë i njohur fakti se në ditët e sotme lufta për pozicionimin ndërkombëtar, në radhë të parë fitohet në mes fushatës së mediave. Ndodhemi në momentet më të ndjeshme të përcaktimit të statusit politik të Kosovës, ndërsa në Kosovë këto ditë kemi shumë pak ose asnjë gazetar të mediave të njohura botërore, elektronike edhe të shkruara. Para dy vjetësh isha pjesëmarrës së bashku me disa kolegë deputetë në tryezën e rrumbullakët të organizuar nga OSBE-ja, në të cilën prezantimin lidhur me rolin e marrëdhënieve me media dhe publikun në vitin 2006, e mbajti z. Xhemi Shija, ish-zëdhënës dhe tani drejtor në Zyrën politike të Sekretarit të Përgjithshëm të NATOS. E thashë në atë takim edhe po e përsëris edhe këtu se është shqetësuese shkalla e mosndjeshmërisë së Qeverisë ndaj këtij segmenti të angazhimeve të mundshme për çështjen e Kosovës. Pse Qeveria deri më sot nuk e ka formuar një qendër ndërkombëtare për media, që do të punonte 24 orë, 7 ditë në javë dhe të plasonte informata adekuate në opinionin ndërkombëtar për zhvillimet pozitive në Kosovë? Pse nuk ekziston strategjia me të cilën Qeveria e Kosovës, në mënyrë të planifikuar dhe sistematike do të krijonte një imazh pozitiv ndërkombëtar për Kosovën

duke i angazhuar në dialog mediat më të rëndësishme ndërkombëtare, me informata të sakta, të ndershme, të hapura dhe pozitive. Mendoj se është e domosdoshme që në mënyrë urgjente nëpërmjet një fushate mirë të organizuar në mediat ndërkombëtare të krijohet imazhi i shtetit të sigurt, dinamik dhe reformues të Kosovës. Njëkohësisht të mbështetur nga Qeveria e Kosovës konsideroj se ekspertët kosovarë duhet të jenë shumë më prezentë në arenën ndërkombëtare në këtë kohë. Konsideroj se nuk duhet lënë pa pjesëmarrje asnjë konferencë të nivelit rajonal apo më të gjerë ndërkombëtar, ku mund të dëgjohet fjala për shtetin e pavarur të Kosovës. Nga raporti shihet se ky dimension i angazhimit të planifikuar qeveritar mungon qartë dhe që është më brengosës se aktivitetet në këtë drejtim nuk parashihen as në periudhën e ardhshme tremujore. Mendoj se Qeveria duhet të ndërmarrë masa urgjente për tejkalimin e gjendjes së pasivitetit në këtë aspekt.

Për fund konkludoj se raporti, përkundër rezultateve dhe përpjekjeve individuale të bëra nuk reflekton angazhime gjithëpërfshirëse dhe profesionale të Qeverisë, krahasuar me seriozitetin e momentit aktual, social, ekonomik dhe politik dhe për këtë arsye konsideroj se Qeverinë e pret një punë shumë më e madhe në qoftë se dëshiron të realizojë së paku minimumin e synimeve të saj. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj. Le të përgatitet deputetja Zahrije Jusufi

DEPUTETJA SANIJE ALIAJ - I nderuar z. kryetar, I nderuar kryeministër, ministra dhe ju kolegë të nderuar,

Raporti i punës 100 ditësh i Qeverisë së Kosovës të udhëhequr nga z. Çeku paraqet një zhvillim të tërësishëm pozitiv të standardeve si rezultat i angazhimit të shtuar të Qeverisë në periudhën mars – qershor që është konfirmuar dhe përkrahur në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të mbajtur më 20. qershor 2006, ku është përshëndetur progresi i arritur në implementimin e standardeve si dhe vendosmëria e Qeverisë Çeku për një jetë më të mirë të qytetarëve të Kosovës, e në veçanti për krijimin e mirë dhe besimit ndërmjet komuniteteve. Në këtë raport të arriturat janë evidente në të gjitha fushat apo detyrat e parashtruara nga bashkësia ndërkombëtare. Vlen për t'u theksuar, se përveç që paraqitet një pasqyrë për punën e bërë, përfshinë prioritetet dhe sfidat e Qeverisë për tremujorin e ardhshëm të këtij viti që nënkupton përkushtim të vazhdueshëm dhe transparent të Qeverisë, duke marr shembullin e vendeve me demokraci të konsoliduar e duke e zhvilluar vendin tonë si demokraci në tranzicion duke rritur përkushtimin në lidhje me fazë përfundimtare të procesit të statusit final të Kosovës.

Unë do të ndalem në pjesën e raportit nr. 5, qeverisja e mirë, e cila mundëson ndërtimin e mirëbesimit qytetar i realizuar nëpërmes respektimit të të drejtave të njeriut, luftës kundër korrupsionit, transparencës, llogaridhënies, kujdesit për personat me aftësi të kufizuar, respektimit të barazisë gjinore, paanshmërisë dhe marrëdhënieve me qytetarë. Si përkushtim për të krijuar një shoqëri të lirë e demokratike në Kosovë, nëpërmjet të së cilës do t'u garantohet qytetarëve lëvizje e lirë, komunikimi i lirshëm në gjuhën e tyre, trajtimi i njëjtë dhe pa dallime në punë, në rrugë, të jenë të barabartë para ligjit, integritim dhe qasje në institucione e dokumente zyrtare, kthim të qëndrueshëm i të zhvendosurve,

shtëpitë dhe pronat e tyre, duke nxjerrë dokumente dhe mekanizma përkatës për realizimin e këtyre synimeve.

I nderuar z. kryeministër, korrupsioni është termi më i përfolur në çdo pore të shoqërisë, me të cilin sot lidhet ryshfeti, keqpërdorimi i detyrës, keq menaxhimi i buxhetit dhe abuzimet në detyrë, prandaj themelimi agjencisë kosovare antikorrupsion si mekanizëm është shumë i nevojshëm në

Parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni ndihmon në zhvillimin ekonomik dhe demokratik në Kosovës, sepse obligimet e kryera ndaj institucioneve kthehen në shërbime shumë të domosdoshme dhe të nevojshme për ta, për një jetë më të mirë. Kjo shihet dhe preket kudo në Kosovë edhe pse nevojat edhe më tej janë të shumta. Hartimi i strategjisë për ngritjen e numrit të pozitës femrave në institucionet e Kosovës 2006-2015 lenë një shpresë për një perspektivë më të mirë të avancimit të pozitës së femrës në institucionet vendimmarrëse, por natyrisht duhet hartuar, miratuar dhe zbatuar programet për barazi gjinore nëpër të gjitha fushat, sepse Kosova nuk do të jetë demokratike pa iu dhënë vend i merituar femrës, prandaj z. kryeministri kërkoj nga ju angazhim serioz në këtë drejtim dhe rezultate e punë konkrete.

Ajo çka vlen për t'u theksuar mirë është angazhimi i Qeverisë për një qeverisje transparente. Vizitat me karakter punc në vendbanime të caktuar nga kryeministri dhe ministrat vlen për t'u përshëndetur, sepse kontakti me qytetarë dhe njohja, incizimi i problemeve të përditshme të tyre rezultojnë me marrjen e masave konkrete. Si aprovimi i Udhëzimit administrativ për zbatimin e Ligjit qasjen në dokumente zyrtare si dhe Ligjit kundër diskriminimit. Botimi i Gazetës Zyrtare i mundëson qytetarit realizimin e së drejtës për t'u informuar dhe të ketë qasje të drejtpërdrejtë ndaj ligjeve dhe rregulloreve të Qeverisë, që qeverisë jetën e vet si mjet konsultimi për t'i adresuar shqetësimet dhe propozime e tij në institucionet përkatëse.

Tryeza për komunikim me qytetarë, zyra e ankesave, interpelanca e kryeministrit dhe i ministrave dhe përgjigjet e tyre në pyetjet e deputetëve, e sidomos fjalimet javore të kryeministrit në Radio Kosovë janë në funksion të krijimit të transparencës, llogaridhënies dhe ndërtimit të mirëbesimit. Në këtë raport ka ide e veprime konkrete, ka gatishmëri dhe vullnet për të ofruar të mira për zhvillimin e proceseve në Kosovë dhe mirëqenies së qytetarit. Mirëpo, z. kryeministër, në raport është dashur të paraqiten edhe pengesat dhe sfidat që paraqesin të tjerët në realizimin e standardeve shumë të kërkuara në këto faza, nëpër të cilat po kalon Kosova.

Sfidë për Qeverinë konsideroj se është, që edhe më tej të punoj në hartimin e ligjeve që në shërbim të qytetarit dhe në realizim të standardeve. Kompletimi i kornizës ligjore për zhvillimin ekonomik të një ekonomie të tregut të lirë dhe realizimi i projekteve që mundësojnë zhvillimin ekonomik. Këtu punohet me seriozitet edhe më të madh deri në kthimin e të zhdukurit të fundit, të ndërtohen politika për siguri dhe lëvizje të lirë të komuniteteve, duke bërë vetëdijësimin politik për të tolerancën dhe mirëkuptimin, të punohet edhe më tej për kthimin e serbëve në institucione, të shpërndahen ligjet e miratuara në Parlamentin e Kosovës të nënshkruara nga Përfaqësuesi Special, në komunat: Laposaviq, Zubin Potok dhe në Zveçan, si dhe prioritet kryesor i Qeverisë të jetë zbatimi i politikave për bashkimin e Mitrovicës dhe realizimin e trembëdhjetë pikave si standarde nga Grupi i Kontaktit. Përparimi që bë në përmbushjen e këtyre synimeve do të jetë bazë e shqyrtimit e realizimin e statusit final në këtë vit. Gjatë ecjes

ka vështirësi, por me vullnet dhe seriozitet në punë, idetë dhe projektet shndërrohen në vepra. Ju faleminderit shume!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit zonja deputete! Fjalën e ka deputetja Zahrije Jusufi, përgatitet deputeti Hajredin Kuçi

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë,

Raporti 100 ditësh i Qeverisë në sferën e politikave sociale thotë: Kryeministri ka emëruar një këshilltar të posaçëm për përkrahjen ndaj vlerave të luftës dhe janë mbështetur aktivitetet në këtë drejtim. Familjet e dëshmorëve, të invalidët e luftës dhe të pjesëtarët e UQK-së, nuk e meritojnë vetëm emërimin e një këshilltari për përkrahje 7 vjet pas luftës ata nuk e meritojnë simulimin e nënshkrimin e Ligjit para kamerave. Qeveria dështoi në plotësimin e obligimit institucional ndaj kategorive më meritore të cilave u kemi borxh të gjithë. Edhe pse Projektligji u miratua, Qeveria nuk ishte e gatshme as pas 7 vitesh ta pësojë edhe pse Projektligji nuk është i përsosur dhe nuk i plotëson as nevojat minimale të gjendjes tepër të rëndë të familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës duhet të jetësohet sa më parë si obligim institucional për ta lehtësuar jetën e tyre.

Raporti vazhdon, ka vazhduar puna në mbështetjen e qëndrueshme financiare të qytetarëve duke zbatuar kritere të ligjshme. Për pensionistët nuk mjafton vetëm përkrahja morale, nuk vërehet asnjë hap konkret për përmirësimin e të drejtave të tyre. Rekomandimet e Kuvendit mbeten në Kuvend pa u shqyrtuar më tutje, ndërkaq është numër i madh i personave që paguhen pa arsye për asistencë sociale, për pensionet e parakohshme. Sa rëndohet buxheti i Kosovës nga pagesat e paarsyeshme. Në raportin 100 ditësh të punës së Qeverisë në sferën e shëndetësisë thuhet: "Qeveria është fokusuar në strategji për avancime në shëndetësi" ishte strategjia joefikase njëri ndër indikatorët kryesorë dhe njëri prej kontribusve më të mëdhenj të gjendjes së rëndë në shëndetësi. Munguan politika dhe strategji për ta tejkaluar gjendjen. Janë shqetësimet e arsyeshme të profesionistëve për mbikëqyrjen e institucioneve për planifikimet e gabuara. Pa u respektuar prioritetet për shpenzimet e pakontrolluara, pa kriter, pa bërë analiza, indiferentë ndaj kërkesave të mjekëve për ngritjen e cilësisë së shërbimeve të shëndetësore, dijagnostifikim adekuat, mbikëqyrje profesionale. Në programin e Qeverisë thuhet: "Është siguruar furnizimi i rregullt dhe i qëndrueshëm me barëra, me material shpenzues, preparate imunobiologjike për laboratorë dhe hemodializë". Në praktikë gjatë monitorimit të Ligjit për Shëndetësi u konstatua gjendje tejet e rëndë, asnjëherë më e rëndë se gjer me tani. Është problem kronik mungesa e sigurimit dhe e furnizimit me barëra të listës esenciale, me material sanitar, mungojnë mjete më elementare për dijagnostifikim, mjekët ballafaqohen me probleme të mëdha për trajtimin e të sëmurëve, sidomos për trajtim të rasteve emergjente, kur gjendja e të sëmurit është e rëndë e gjendja nuk pret që familjarët t'ua blejnë barërat e domosdoshme. Kujdestaria për mjekët paraqet stres nga pamundësia e trajtimit të pacientëve, nga se mungon gjithçka për trajtim adekuat.

Për të sëmurët që nuk kanë përcjellës gjatë natës, mjekët përpos vizitës mund t'ua dëshirojnë vetëm shpresën, e kuptojmë se mundësitë për ndryshim radikal për t'i plotësuar standardet në shëndetësi në këtë fazë, janë të kufizuara. Buxheti për barëra u

zvogëluar në mënyrë drastike, nga 13 milion - 6.9 milion €. Pse nuk ndërrohet qasja aty ku ka nevojë për përkrahje plotësuese. Kjo tregon seriozitetin e pamjaftueshëm për t'i analizuar dhe plotësuar nevojat. Kufizimet buxhetore nuk janë arsye që të sigurohet minimumi i pakos për nevoja emergjente, të sigurohen barëra të domosdoshme, material sanitar, aparate për dijagnozifikim, pa të cilat nuk mund të funksionojë sistemi shëndetësor? Pse nuk përkrahet decentralizimi i furnizimeve me barëra esenciale sipas prioriteteve të institucioneve. Është tejte e rëndë situata në Sektorin e farmacisë, sistemi farmaceutikë punon pa standardizim, ma vonë do ta paguajmë shtrenjtë. Sistemi farmaceutik i rregulluar është standard evropian. Në Kosovë hynë në mënyrë zyrtare dhe ilegale, barëra me cilësi të dyshimtë, barëra të falsifikuar regjistruhen barëra pa kriter dhe rregull, me çmime të ndryshme. Nuk përcillet efikasiteti dhe kualiteti i barërave. Mungon laboratorit për kontrollimin e cilësisë së tyre Pse nuk kontrollohet KPK-ja, është absurd ku shtrenjtë financohet nga buxheti i Kosovës, e vetmja rrugë për të tejkaluar gjendjen është angazhim më serioz për planifikim, menaxhim më efikas të buxhetit të limituar.

Në raport më tutje thuhet: "Është përfunduar shqyrtimi i listës së pagesës të shërbimeve shëndetësore, participimi " Pse nuk zbatohet ligji për shëndetësi neni 27.3, sipas të cilit kujdesi shëndetësor sigurohet 24 orë pa ndërprerje, duke organizuar punën në ndërrime në sistemin e kujdestarive. Në institucionet shëndetësore nuk ka monitorim të buxhetit për shërbime të pakontrolluara dhe shkelet Urdhëresa administrative për bashkë pagesa. Gjatë monitorimit u konstatua se ato ishin jo unike. Sipas dëshirave të menaxherëve është absurd se në institucionet shëndetësore ku bashkë pagesat ishin më të larta, shuma e mjeteve të derdhura në buxhet nga bashkë pagesat ishte më e butë. Nuk zgjidhen problemet në shëndetësi pa u shqyrtua plani legjislativ, intenca e Ministrisë të Shëndetësisë për të nxjerrë sa ma shumë ligje, që në çdo fushë të nxjerrë ligje është e gabuar, ndërkaq mungon ekspertiza e zbatimit së ligjit bazik për shëndetësi dhe ligjeve tjera. Ligjet vonohen në procedurë, si për shembull Ligji i duhanit nuk nënshkruhet. A interesohet Ministria për fatin e ligjeve të veta? Në Kuvend sillen ligjet sekondare dhe terciare, si Ligji i promovimit të qumështit të gjirit, i cili mund të ishte akt nënligjor i ligjeve të tjera të proceduara, ndërkaq nuk implementohet ligji bazik. Propozojmë që strategjia legjislative të ndryshohet. Propozojmë që Qeveria në Kuvend të procedojnë ligje bazike, si Ligji për sigurime shëndetësore, Ligji për punën, Ligji për pensione, Ligji për sigurim social.

Për funksionim më të mirë të institucioneve shëndetësore dhe financim të qëndrueshëm kosto efektiv të përshpejtohet Ligji për shërbime shëndetësore. Lista e barërave esenciale të revidohet sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve në konsultim me specialistët e fushave të ndryshme. Propozojmë të rishikohet buxheti për përkrahje shtesë, për ta siguruar minimumin e pakos për funksionim të institucioneve shëndetësore. Të decentralizohet blerja e barërave sipas prioriteteve të institucioneve, të zbatohet neni 27.3 i Ligjit për shëndetësi, që kujdestaria të paguhet nga linja buxhetore jo nga bashkë pagesat, ato janë, të jenë unike, jo sipas dëshirës të menaxherëve, të kontrollohet destinimi i bashkëpagesave, të motivohen punëtorët shëndetësorë, të përmirësohet strategjia e zhvillimit të resurseve humane, planifikimi i specializimeve dhe subspecializimeve sipas nevojave të institucioneve, të bazohet neni 94 i Ligjit për shëndetësi për ngritjen e cilësisë të kujdesit shëndetësor. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputete. Fjalën e ka deputeti Hajredin Kuçi le të përgatitet deputetja Zylfije Hondozi

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Ju faleminderit z. Kryesues, i nderuar Kryeministër, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,

Që në fillim duhet ta falënderoj kryeministrin për vullnetin e mirë që të raportojë për 100 ditshin e punës së tij në Kuvendin e Kosovës, edhe pse ky nuk është obligim kushtetues i tij, por ka treguar një vullnet të mirë dhe ndoshta mund të bëhet vërejtje pse ky koalicion qeverisës nuk ka raportuar në Kuvend për mbi 600 ditët për punën që e ka bërë në Qeverinë e Kosovës. Sido që të jetë, më lejoni që të tentoj t'i bëjë disa shqyrtime të mija parimore duke tentuar që ta analizojë raportin e punës dhe tërë punën e Qeverisë për këto 100 ditët e kaluara.

Nëse lexohet me vëmendje Raporti, unë mendoj që në fillim, ndoshta edhe puna e Qeverisë mund të vërchet se këtu kemi një qasje më shumë teknike dhe administrative, ndoshta nuk është kuptuar mirë nga ky raport apo edhe nga puna e Qeverisë, se puna e Qeverisë është në realizimin e politikave të caktuara e më pak në përshkrimin e punës që bëhet si rutinë. Pse po e them këtë, kam lexuar me kujdes në kohën e fushatave elektorale Programin apo programet e partive në koalicion, i kam rilexuar edhe në këto ditë, e kam lexuar me kujdes edhe programin e Qeverisë dhe mund të them se asnjëra e as tjetra nuk është hasur që është bërë në këto 100 ditët e kaluara. Me fjalë tjera, kemi pasur një punë rutinore prej ditës në ditë dhe jo mbi bazën e filozofisë politike që do të bazoheshin në atë që janë premtuar qytetarëve të Kosovës.

Unë nuk kam mundur që në raportin e Qeverisë të dallojë mirë ndoshta nuk kam mundur ta dallojë as punën e Qeverisë në kuptimin të tri E-ve përmendura, të shtuara në plus një, e para për arsye se ne nuk kemi parë projekt për këto dhe e dyta nuk kemi parë as punë. Në kuptimin e shqyrtimit të këtij raporti, në aspektin metodologjik ndoshta më lejohet që të bëjë një vërejtje. Raporti duket që është bërë nga disa veta dhe këtu mund t'i bëjë dy vërejtje E para metodologjike duket që është më shumë kopje e pestë apo me i marrë kopjet dhe me i dërguar në një vend dhe nuk është i hartuar nga një dorë mund ta quaj kështu, dhe e dyta, raporti është i bërë apo hartuar nga shërbyes civilë. Shërbyesit civil duhet të sjellin informata, por raportin duhet ta bëjnë personat me përgjegjësi politike dhe mendoj se kryeministri është dashur që ta gjejë një person të tillë që ta bëjë raportin dhe ai, i cili do ta tregonte, jo sa takime janë bërë apo edhe në anën tjetër nuk do të tregonte se është sukses se një ministri nga kati 11 ka zbritur në katin e 9-të. Kemi gjëra të tilla edhe në raport, besoj se do t'i lexoni, konkretisht në faqen 70, nëse dikujt i intereson. Sido që të jetë më ka lënë një përshtypje në raport po edhe gjatë prezantimit sot. Sot kryeministri u fokusua në status dhe në standarde. Mendoj që kjo është jo e mirë, asnjë qeveri që të fokusohet në veçanti se është meritë e tyre statusi. Meritë e qytetarëve të Kosovës, e angazhimit të tyre prej viteve të '90-ta dhe më pastaj të kulmuar me luftën për çlirim të Kosovës dhe tani me një bashkëpunim të shkëlqyeshëm në Grupin Negocioator dhe më Grupin politik janë vënë bazat për statusin e Kosovës. Nëse Kosovës i janë vënë bazat për 100 ditë dhe do t'i bëhen apo do të përfundojnë këto baza në 100 ditshin e ardhshëm, unë do t'i përgëzoj njerëzit, por besoj se edhe historia e tyre personale nuk do të dukej e mirë. Sido që të jetë, besoj se asnjë qeveri në botë dhe as kjo qeveri nuk ka nevojë që të deklarohet për gjërat e tilla, jemi në kohën historike, vitin historik, të gjitha energjitë i kemi bërë për standarde e kështu me

radhë. Kjo i përngjan ndonjë raporti të ndonjë fushate elektorale që mund të bëhet në një fshat po e zëmë në fshatin tim të lindjes. Një çështje tjetër, mendoj se është tendenca e Qeverisë që çdo gjë të duket prefekt apo çdo gjë e përkryer. Do të ishte joserioze me thënë unë, që asgjë nuk ka punuar Qeveria, por pa aq jo serioze është se shumë fish më serioze, është nëse thuhet se çdo gjë ka funksionuar si duhet. Është një mungesë e guximit, në radhë të parë po i quaj intelektualë dhe qytetarë dhe pastaj e mungesës së guximit politik, por edhe mbështetjes politike. Pse po e them fillimisht e mbështetjes politike, duket se dikush ka marrë detyrë shtëpie me thënë se Qeveria është e suksesshme, është krejt njerëzore me thënë kemi dështuar dikund dhe çdo punë, çdo raport, unë nëse do të raportoja për punën time në Kuvendin e Kosovës me siguri do t'u thosha qytetarëve të Kosovës ose dikujt tjetër në parti prej nga kam ardhur, ka pasur raste kur nuk kam qenë në nivelin e detyrës, me gjëra të tilla besoj se kemi qenë të njohur të gjithë ne. Nuk mund të quhet mungesë e përgjegjësisë politike ose edhe guximit nëse thuhet se ne kemi dështuar, po e zëmë në planin e shëndetësisë, kemi dështuar në planin e auditimit të përgjithshëm, kemi dështuar në ndaljen e veprimeve apo të dukurive negative, për arsye objektive ose subjektive nuk është shumë me rëndësi, por mendoj se këtij raporti i mungon edhe kjo pjesë. Në veçanti edhe punës së Qeverisë edhe raportit u mungon ndarja e përgjegjësisë politike dhe asaj penale mund ta quaj. Përgjegjësia politike është ajo, që mund ta merr kryeministri, Qeveria, Kuvendi apo dikush tjetër. Përgjegjësinë penale e vërteton gjykata dhe nëse do të pret kryeministri për ministrat e vet që të vendos gjykata, atëherë me siguri se kjo pritje do të jetë edhe pas skadimit të mandatit të tij dhe përgjegjësia politike vjen në shprehje, në rast se kur supozohet se ka veprime të tilla të inkriminuara dhe kemi raporte të tilla të auditimit. Nuk më ka pëlqyer tendenca e ministrave që kanë qenë që nga fillimi, të cilët kanë tentuar ta bëjnë një shkëputje të punës së tyre prej ditëve paraprake, thua se mandati i tyre ka filluar në 100 ditshin e fundit. Unë po ju them, janë ministrat e mirë ose jo prej ditës kur janë emëruar, janë në 100 ditshin e fundit dhe nuk kanë nevojë që ta mohojnë bile shumë investime, shumë angazhime dhe shumë projekte të realizuara apo të parapara në këtë raport, kanë filluar më herët nuk kanë filluar në 100 ditshin e fundit. Nëse i shihni investimet, po e zëmë në fushën e sportit, sa sallat sportive janë bërë në 100 ditshin e fundit, unë do të isha shumë i lumtur. Po, në anën tjetër mendoj se ato janë projekte të filluara qysh më herët, por edhe nëse dikush e ka pre shiritin atyre projekteve nuk do të thotë që ka qenë rezultat i punës së tij.

Vëllimi i raportit 74-faqesh me siguri që, unë nëse do të analizoja dhe bashkërisht me ju do t'i heqim disa vizita protokollare apo edhe disa çështje teknike dhe administrative do të lëkurej dukshëm. Nuk ka qenë keq që të shikohet raporti në ndonjë vendi apo i ndonjë qeverie demokratike në botë si i asaj i Zvicrës ose i Suedisë, por i ndonjë qeverie rajonale dhe të shihet. Marrim shembullin Qeveria e Maqedonisë, ajo mundet ta ketë raportin për punën 60 faqesh, për punën njëvjeçare dhe ne duhet të jemi të kujdesshëm. Këtu duhet të pasqyrohet ekzekutimi i filozofive politike të partive në koalicion dhe jo punët e përditshme se me kënd janë takuar, në sa seminare kanë shkuar, me sa vet janë takuar e kështu me radhë apo në raport kemi edhe gjëra që nuk janë në kompetencë të Qeverisë. Kemi një pjesë të raportit, nuk më kujtohet faqja saktësisht, thuhet që OKB-ja në mbledhjen e saj e kështu e kështu me radhë ka marrë vendim pozitiv ose negativ. Thua se Qeveria e Kosovës e ka realizuar mbledhjen e OKB-së, ndërsa ata kanë marrë vendim ose puna për TMK-në. TMK-ja me gjithë respektin

ende nuk është nën kompetencat e Qeverisë së Kosovës, ndoshta krejt në fund të tentoj t'i bëj dy vlerësimet e mija personale. E para, unë mendoj që njerëzit që janë në këtë Qeveri përfshirë edhe kryeministri në vitet që do të vijnë me siguri do t'i shkruajnë memoaret e tyre edhe unë besoj si qytetar ose deputet. Po e them shumë sinqerisht unë do të kem problem me e mbaj në mend në memoaret e mija këto 100 ditët të qeverisë të udhëhequr, dhe krejt në fund, në ditën e parë të emërimit të kryeministrit kam pasur një konstatim që për atë kohë dikujt ju ka dukur pak sa i vrazhdë, i kam thënë z. kryeministër ju po e bartni autoritetin tuaj në këtë Qeveri dhe nuk do të fitoni autoritet nga kjo Qeveri, fatkeqësisht apo fatmirësisht unë nuk e di, kështu ka dal, dhe krejt në fund po e them si qytetar – një pjesë e qytetarëve, duhet të jem shumë korrekt i ka besuar ardhjes së kryeministrit Çeku për ndryshime pozitive dhe ka pasur shpresë, fatkeqësisht pas 100 ditësh nuk e ka as atë shpresë sido që të jetë. Unë mendoj se Qeveria jo vetëm që duhet të analizohet dhe vlerësohet, por duhet të ndihmohet, në radhë të parë nga koalicioni qeverisës, të cilët funksionojnë dhe pastaj edhe nga të gjithë të tjerët përfshirë edhe Kuvendin e Kosovës. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet. Fjalën e ka Zylfije Hondozi, le te përgatitet deputeti Gazmend Muhaxheri

DEPUTETJA ZYLFIJE HONDOZI - Z. kryesues, z. kryeministër, ministra prezentë, kolegë deputetë,

Nga raporti për 100 ditët e Qeverisë së Kosovës mund të kuptojmë se Qeveria e ka pranuar me seriozitet t'i përmbushë detyrat sa më mirë, një qasje serioze dhe përcaktim dhe aktivitete të shumta dhe të rëndësishme. Njëra prej prioritetet të Qeverisë ishte dhe bashkëpunimi rajonal. Në këtë mënyrë, Qeveria për këto 100 ditë ka vepruar duke ua bërë me dije të gjithëve se ajo angazhohet për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim bilateral, si në rrafshin politik ashtu edhe ekonomik, kulturor dhe të sigurisë. Në këtë drejtim Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë ka nënshkruar shumë marrëveshje të bashkëpunimit me vende fqinje, siç është për mbrojtjen reciproke të investimeve Kosovë – Turqi. Në fushën e turizmit Kosovë-Shqipëri, arritja e liberalizimit të tregtisë Kosovë- Shqipëri. Një intensifikim të punës në këto ditë ka bërë edhe Ministria e Shëndetësisë, e cila ka hartuar disa projektligje të cilat kanë kaluar dëgjimin e parë në Parlament dhe janë përpunuar nga ana e Komisionit për Shëndetësi. Ministrisë së Shëndetësisë i mbetet që edhe më tutje ta intensifikoj punën e saj, pasi që situata reale në shëndetësi është e rëndë. Ligjet që janë në fuqi, si për shembull Ligji për shëndetësi, që është ligj bazik është nënshkruar në gusht të vitit 2004 dhe në te përfshihen që të hartohen shumë akte nënligjore që do ta funksionalizojnë këtë ligj, por Ministria e Shëndetësisë nuk i ka përpiluar as gjysmën e akteve normative, pasi që kjo punë nuk është kryer te ligji bazik, për ligjet të tjera nuk ka nevojë as të flitet. Kjo gjë e vështirëson zbatimin e këtij ligji në institucionet shëndetësore.

Barërat nga lista esenciale dhe materiali shpenzues në institucionet shëndetësore mund të gjinden vetëm në sasi prej 20 deri 30%. Shkaqet për këtë janë të shumta, njeri prej këtyre është që buxheti i ndarë për barërat nga lista esenciale në këtë vit është 47% më i vogël se në vitet e tjera dhe donacionet në këtë drejtim janë zvogëluar ose nuk ekzistojnë fare, por shkaqet tjera, si mënyra e furnizimit dhe shpenzimit të barërave janë faktorët në të cilët Ministria e Shëndetësisë ka mundur me ndikua me një menaxhim më të mirë.

Ka edhe shumë probleme të cilat nuk po i përmendi për arsye se Komisioni i Shëndetësisë e ka përpiluar raportin për punën që e ka bërë duke monitoruar Ligjin për shëndetësi dhe ka dhënë rekomandime për Ministrinë e shëndetësisë, e cila ka një bashkëpunim të mirë me Komisionin për Shëndetësi dhe besoj që problemet ekzistuese gradualisht me punë dhe përkushtim të të dyja palëve do të eliminohen. Njëri prej premtimeve të përmbushura të Qeverisë është ai i transparencës, gjë që reflektohet në raportin e Ministrisë së Kulturës ku koston e investimeve në infrastrukturën sportive dhe në riparimin e objekteve kulturore e paraqet me shifra konkrete me këtë raport. Një kohë në sferën e çështjeve sociale nuk ka pasur ligj për punë dhe pensione. Muajt e fundit, Ligji për punë dhe pensione është hartuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe tani po kalon në dëgjimin publik. Me këto dy ligje shumë të rëndësishme do të mundësohet se shumë probleme që kanë ekzistuar gjër me tani, në sferën e çështjeve sociale do të përmirësohen e çka është më me rëndësi do të evitohen keqpërdorimet sidomos në sferën e punësimit. Edhe pse nuk ka kohë që të flitet për aktivitetet e secilës ministri veçmas, në përgjithësi, puna e 100 ditsh e Qeverisë mund të vlerësohet si pozitive edhe pse në të ardhmen e presin punë dhe sfida të shumta. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet. Fjalën e ka Gazmend Muhaxheri le të përgatitet deputeti Ragip Zekolli.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. kryesues,

Ish - kryeministri Kosumi, në programin qeveritar pat paraqitur se në qershor të vitit 2006, Kosova do të ketë të aprovuar planin hapësinor, tash jemi në korrik të vitit 2006. Plani hapësinor as që ka ardhur në Kuvend, ndoshta timonieri i Qeverisë është ndërruar, mirëpo ekipi qeveritar ka mbetur i njëjtë, d.m.th a i ka harru Qeveria objektivat e vet që i ka pasur në programin e saj të punës. Në planin qeveritar ka qenë edhe që Kosova do të ketë strategjinë zhvillimore të saj të hartuar. Qeveria e re na informon se për hartimin e kësaj strategjie ka aktivizuar 143 anëtarë në 22 grupe punuese. Mirëpo, nuk e informon Kuvendin, në çfarë baze ligjore është nisur hartimi i strategjisë zhvillimore dhe nuk e informon se ky numër prej 143, çfarë kualiteti ka, a janë njerëzit të janë të angazhuar me punë këtë strategji zhvillimore. Ekspertë të lëmisë për ta krijuar strategji, a kanë bërë strategji zhvillimore të ndonjë firme prej 100 personave dhe a janë të aftë me ba strategji për një shtet 2 milionësh? A janë krijuar strategjinë ndonjë shteti në transicion që është rreth nesh dhe a ka pasur rezultate konkrete strategjia e hartuar nga këta njerëz. Qeveria do të japë 2 milion € për hartimin e kësaj strategjie dhe pas 8 muajve, kur të zgjidhet qeveria e re, asgjë nuk e obligon atë qeveri të re me iu përmbajtur strategjisë për të cilën janë dhënë këto para Qeveria po mburret se në Ministrinë e Kulturës ka bërë shumë investime edhe i ka ndarë investimet në salla ndërtimore. Po them, se Qeveria ka shkuar me një strategji ose me Ministria e Kulturës, në vend që të ndërtojë një qendër dhe ta përfundojë, parat i ka shpërndarë në katër qendra, kështu që në katër komuna do t'i kemi katër objekte, mirëpo të cilat nuk do të përfundohen ndoshta gjatë mandatit të kësaj Qeverie, e mund të ndodhë që as gjatë mandatit të qeverisë së ardhshme, d.m.th. është dashur t'i informonte se parat e dhëna janë apo nuk janë punë projektesh në fazën fillestare apo është duke i përfunduar këto projekte. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet. Fjalën e merr deputeti Ragip Zekolli, le të përgatitet deputetja Fatmire Mulhaxha Kollçaku

DEKPUTETI RAGIP ZEKOLLI – I nderuar kryeministër, ministra dhe kolegë deputetë, Më lejoni që shkurtazi të prek një nga çështjet më të rëndësishme që kur lexova raportin me kujdes, mendoja se të paktën në pjesën e tretë ku janë standardet për Kosovën, do të përmendi, është fjala për plagën më të rëndë në Kosovë, për plagën e personave të pagjetur. Mirëpo, për fat të keq nuk është edhe një fjali e vetme lidhur me këtë çështje. Po e përmendi për dy arsye: e para, sepse Serbia deklaroi që për të njëzetën herë tha se të dorëzuar në Beograd janë mbetjet e fundit mortore, që mund të kthehen nga atje, për çështjen e dytë për arsye se ka filluar që një pjesë e kompetencave nga UNMIK-u të kalojë në organet vendore dhe çka është më e rëndësishmja, e treta, që familjarët po e humbin gjithnjë durimin dhe kjo plagë nuk mund të shërohet e as Kosova nuk mund të ketë një ardhmëri të lumtur pa zgjidhjen e saj.

Z. kryeministër, ju kisha lutur, që mundësisht brenda kësaj periudhe të shkurtër të paktën të bëhen dy- tri gjëra që mund të lëvizin në këtë drejtim për arsye se vërtet situata është tejte e rëndë. Kemi rreth 800 mbetje mortore, të cilat ende ndodhen në Morgun e Rahovecit, presin rezultatet e ADN-së, ndërsa Raporti apo faji të them herë hedhet në zyrën e UNMIK-ut e herë në UNDP-i. Një çështje tjetër, për të cilën u brengosa

atëherë fillohet që të fajësohet është kjo pjesë dhe të paktën po them në raportin e Qeverisë ishte edhe një çështje që thuhej që nga Kosova do të përgatiten lëndët lidhur me këtë çështje. Janë tri gjëra të mëdha të cilat mendoj se mund ta shtojnë presionin. Presioni duhet shtuar gjithsesi mbi Beogradin, sepse ka qenë e organizuar kjo çështje dhe vërtet më nuk presim që të kemi takime as në Meje, që të kemi takime as në Izbicë e në vende tjera, andaj mendoj se, do të ishte shumë e rrugës që gjithsesi kjo çështje të zënë prioritet në Qeveri dhe ju kisha lutur që mundësisht në kontaktet tuja diplomatike me dy shtete fqinjë mund të nënshkruani dy memorandume mirëkuptimi, që do të ndihmonin në sjelljen e trupave të më të dashurve tonë që ende ndodhen në Bosnje dhe në Kroaci.

Me qenë se Kosova ka filluar të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi tash çdo mbetje mortore për t'u kthyer nga Bosnja dhe Kroacia është dashur të kthehet qoftë nëpërmjet Serbisë apo të mbetet atje, andaj nënshkrimi i një memorandumi të mirëkuptimit lidhur me këtë çështje vërtet do të ndikonte dhe sado pak ardhja e atyre trupave do t'i ndihmonte familjarët!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet. Fjalën e ka deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku, le të përgatitet deputeti Gjergj Dedaj.

DEPUTETHA FATMIRE MULHAXHA – KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. Kryesues, Para neve deputetëve, pasi që e morëm këtë raport 100 ditore të Qeverisë, është paraqitur një sfidë a e bëjmë vlerësimin e punës të 100 ditsh të kryeministrit apo e bëjmë vlerësimin e punës së Qeverisë, se në fakt po qe se është kjo e dyta atëherë është e pamundur të shkëputet, sepse kjo në fakt është një Qeveri e kontinuitetit me disa ndërrime të vogla për këto, ta themi diku 600 ditët e kaluara.

Kisha fillua me fjalën e kryeministrit për çështjet e shëndetësisë, dhe mund të them se që në fillim u zhgënjeva. Vetëm tri katër fjali me një minutash shumë të shkurtër diku prej 1 minuti të kushtuar në raportin të prezantuar gojarisht sot në seancë. Mendoj se kjo edhe vet raporti ku e kemi një faqe e gjysmë, assesi gjithëpërfshirës i vlerësimit punës të Ministrisë të shëndetësisë. Vetëm fjalia të cilin e ceku edhe kolegia e mëparshme z. Zahrije, ku thuhet se është siguruar furnizimi i rregullt dhe i qëndrueshëm me barëra dhe materiale shpenzuese. E vënë në pyetje besueshmërinë edhe pjesës tjetër të raportit, sepse kjo nuk ka të bëjë fare me të vërtetën, mjafton që, pasi veç u përmend se nuk e kam pasur mendimin sot ta ceku që jemi, dhe që e kemi bërë monitorimin e zbatimit të Ligjit për shëndetësi, dhe në kuadër të saj shumë vizita në terren dhe është, ndoshta një fakt i qëndrueshëm që të prezantohet këtu, se jo vetëm që jemi larg prej kësaj që është shkruar këtu, por kjo nuk ka të bëjë fare me të vërtetën, sepse ai mungojnë edhe ato që janë më elementare. Unë mendoj se kjo është një mënyrë e mirë e komunikimit me Qeverinë dhe mendoj se vërejtjet që dëgjohen këtu duhet të merren si konstruktive, se në esencë edhe nëse vi nga opozita qëllimi ndoshta është i përbashkët që të përmirësojmë diçka, dhe mendoj që nuk duhet nisemi gjithnjë se janë qëllim këqija. Ato janë diçka që është faktike. Besoni që ne nuk i prezantojmë mendimet tona personale se edhe nuk kemi të drejtë ndoshta në raste të veçanta. Kryesisht i prezantojmë mendimet e një grupi më të madh të njerëzve, dhe perceptioni i tyre a ka ndërrua diçka në jetën e tyre për këto 100 ditë, ndoshta është e pamundur për 100 ditë, por ndoshta ishte dashur me qenë e mundur për gati një vit e gjysmë e më tepër që është kjo Qeveri, sepse është Qeveri e kontinuitetit me një program të njëjtë, ndoshta dinamizmi të cilin e ka imponua Kryeministri është për t'u përshëndetur, por ku janë rezultatet në ato sfera për të cilat unë sot do të flas.

Përveç kësaj për shëndetësi po e preku çështjen e procedimit të Ligjit për sigurime shëndetësore. Të gjithë duhet të pajtohemi se pa një sigurim shëndetësor në Kosovë nuk është i mundur të funksionojë sistemi shëndetësor si duhet. Komisioni parlamentar e ka krye Ligjin dhe e ka procedua në Komision për Buxhet, kjo i drejtohet direkt ministrit për financa i cili është sot prezent, sepse edhe më parë është shtruar kjo disa here në këtë Kuvend kjo çështje.

Kryetari i Komisionit parlamentar për Buxhet dhe Financa e ka shtruar çështjen në pamundësisë së konstituimit të fondit dhe si pengesë e ka parashtruar një ligj tjetër që është Ligji për menaxhimin e financave publike. Unë nëse jo sot, por këtu një pyetje publike që është sugjerim për Qeverinë çka do të bëhet dhe a është paraparë themelimi i fondit, pse është i pamundësuar, sepse unë e shoh që ligji është i pamundësuar për procedim, për lexim të dytë, jo duke ju falënderua Komisionit funksional, sepse tani do ta kemi edhe Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor që është aktualisht në procedim dhe është si një meritë e kësaj Qeverie aktuale, procedimi i ligjit. A do të mund të themelohet edhe ai fond?

Çështja tjetër për Ministrinë e Shëndetësisë. Së shpejti këtu do të jetë në miratim edhe Ligji për ushqim, me një lehtësi të pakuptueshme. Një ligj më par i votuar në Kuvend Ligji për inspektorat sanitar i cili një departament i tërë i takon Ministrisë së shëndetësisë, me një lehtësi amputohet nga Ministria e shëndetësisë dhe tentohet të kalojë në Ministri të Bujqësisë. Këto janë probleme me të cilat do të merret në 100 ditët e ardhshme Qeveria, dhe i kisha lutur ministrat që t'i kursejnë buzëqeshjet ironike, sepse me të vërtetë i irritojnë deputetët gjatë fjalimeve. I falënderoj gjithnjë Kryeministrit për

një përqendrim dhe vëmendje gjatë diskutimeve të deputetëve se ka të bëjë me punën e Qeverisë edhe me 100 ditshin dhe 600 ditshin. Sa i përket procedimit të projektligjeve po flas prapë konkretisht në këtë rast për Ministrinë e Shëndetësisë, fakti që atje mungojnë zyrtar ligjor e pamundëson edhe pjesën tjetër monitorimin e zbatimit të ligjeve. A ka zyre të veçantë apo zyrtar ligjor të cilët merren konkretisht me monitorimin e zbatimit të ligjeve edhe në bazë të një shqyrtimi që e ka bërë edhe OSBE-ja, është parapara që duhet të bëjnë edhe raporte periodike tremujore të zbatimit të ligjeve nga vetë Qeveria, nga ministrinë, konkretisht në këtë rast po e marr të shëndetësisë dhe Qeveria t'ia paraqet Kuvendit Raportin njëvjeçar për zbatimin e monitorimin e zbatimit të ligjeve. Problemet e tjera që kisha potencuar është edhe njëherë kryeministri që, në, posa e kishte marrë detyrën i kam sugjeruar që të bëjë një rishikim. Sa i përket Ministrisë të Shërbimeve Publike konkretisht dymbëdhjetë udhëzimeve administrative, të cilat janë nxjerrë, a po zbatohen? Çështja e shërbyesve civilë sa janë sot të sigurt edhe nxjerrja e kontratave. E kam theksuar edhe një herë, pas kontratës dyvjeçare shërbyesit civil i lëshohet kontrata tremujore - gjashtëmujore. A është bërë diçka në këtë drejtim? Sot punojnë zyrtarët dhe në poste të larta pa kontrata, ose si ushtrues detyre pa pafundësi.

Si çështje e fundit, përveç asaj mos t'i ceku, mos t'i përsërisim edhe gjatë këtij 100 ditshi po lulëzojnë pompat e benzinës. Sot ardhja Pejë - Prishtinë e shohim që po rindërtohen, po rindërtohen a kriter, a po i rishikon dikush, ndërsa rruga mbetet e njëjtë e pasigurt, rrugët në cilat qarkullojmë, ndërsa këtu i falënderoj ministrin për Transport dhe Komunikacion, sepse gropat në Grykun e Llapushnikut janë riparuar dhe pak ma sigurt jam duke ardhur në Prishtinë, ndoshta duke iu falënderuar edhe vërejtjes sime këtu në Kuvend një herë që e pata cekur. Si e fundit, me qenë se kam qenë në Merdare në pritjen e mbetjeve mortore, ku sipas Qeverisë së Beogradit ishim mbetjet e fundit mortore që pritet të vijnë në Kosovë, ndërsa ne e dimë të gjithë se sa persona, fati i sa personave është ende i pazbardhur Fotografia të cilën e kam parë aty nuk ishte aspak inkurajues për Qeverinë, qëndrimi i familjarëve ishte shumë i rëndë në aspekt të vërejtjeve ndaj Qeverisë, prandaj i sugjeroj që detyra e Qeverisë që ishte të funksionalizojë atë komisionin e ashtuquajtur, të cilët të gjithë duhet të pajtohemi se aspak nuk ka qenë funksional. Prolongimi i shndërrimit të atij komisioni në zyre dhe me të vërtetë çka do të bëjë Qeveria, por këtu më vonë i shtrohet çështja dhe Kuvendit dhe cila është strategjia tash e tutje në këtë drejtim. Këtë po e bëj gjithashtu, sepse kam qenë e involvuar në shumë takime edhe me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar edhe këtu në Kuvend kam qenë e interesuar që kjo çështje normal të gjithë të merremi dhe të shikojmë se çka do të bëjmë tani e tutje në zbardhjen e fatit të personave të pagjetur. Ju falënderoj për vëmendje.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Gjergj Dedaj, le të përgatitet deputeti Enver Hoxhaj

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Ju faleminderit z. kryesues, i nderuar z. kryeministër, ministra, deputetë,

Do të përpiqem vetëm të jap një kontribut këtij debati që mendoj se edhe ashtu sikur disa debate që i kemi pasur për decentralizimin, që në fund d.m.th. veç është hapur dera dhe kemi shkuar në shtëpi dhe nuk është marrë asnjë vendim, asnjë qëndrim edhe

për Universitetin . Ky debat do të përjetoj fatin e njëjtë, megjithatë kur është zgjedhur z. Çeku kryeministër i Kosovës, Grupi Parlamentar Për Integrim kemi pas abstenu dhe kam pasë thënë atëherë se ju jeni një pilot i mirë që keni ardhur ta drejtoni një aeroplan defekt pa motor, d.m.th e, shikoni, atë e kam thënë, kjo është vërtetuar për këto 100 ditë. Kemi shumë argumente. Mos mendoni që po bëjmë hajgere, e mos mendoni se nuk kemi argumente dhe mos mendoni që kemi gabuar ose kemi pasur d.m.th emocione ose tendenca kur kemi thënë që disa nga ministrat, unë personalisht kam thënë dhe po e përsëris në Kuvendin e Kosovës duhet me shkuc në Dubravë. Kemi argumente zotrinj edhe zonja shumë të nderuara dhe këtu kur të vie momenti do t'i bëjmë publike, d.m.th. kam respekt për një pjesë të ministrave dhe jo për lajka, kam respekt të veçantë për z. Çeku, por si deputet jo si delegat shumë kam respekt për Kosovën, kështu që z. Çeku vjen si kryeministër i një koalicioni që në zgjedhjet e vitit 2004 kishte premtuar gjatë fushatave zgjedhore – votoni për ne do ta bashkojmë Mitrovicën, z. Çeku nuk besoj që mundet me shkua çlirshëm pa një eskortë të fortë ose d.m.th me përcjellje të mëdha të forcave të ndryshme në Mitrovicë as me pi kafë. Pat thënë ai koalicion që tash është në pushtet votoni për ne se do të hapim vende të reja të punës. Në asnjë raport për këto 100 ditë nuk është përmend asnjë numër sa vende të reja të punës janë hapur në Kosovë përveç e di se janë hapur disa vende të reja të punës si bodigard të ministrave ose të shoferëve të xhipave të ri e të zi e të shtrenjtë që na vijnë përditë në Kosovë, edhe ajo është një zbutje e vendeve d.m.th. e papunësisë në Kosovë. Kanë thënë se nëse keni harruar thënien nëse votoni për ne në vitin 2005 do ta bëjmë realitet pavarësinë e Kosovës, tash jemi në vitin 2006. Një herë m'u kanë pas hidhëruar kur ish-kryeministri Kosumi tha që në qershor të vitit 2006 do të bëhet pavarësia, unë e pata pyetur në sa ora, d.m.th edhe ajo nuk ndodh as në qershor të vitit 2006. Tash kryeministri Çeku thotë se 100 ditët e ardhshme mund të vijë pavarësia e Kosovës. Do g'u lutesha të jemi më serioz dhe në deklaratimet e tilla të mos luajmë me ndjenjat e qytetarëve të Kosovës, sepse keni thënë edhe statusi është i panegociushëm, nuk ka bisedime me autoritetet e Beogradit për statusin e Kosovës e sipas të gjitha gjasave keni me bisedua, e është mirë që t'ua thoni të vërtetën qytetarëve të Kosovës, mos të hyjmë në çështje të tjera, sa premtime një katalog premtimesh që janë bërë dhe mundeni me marrë prej 1 deri në 50-të premtime që janë bërë dhe mund të them që asnjëra prej tyre nuk është arritur të prekshme. Tjetër gjë është të përshkruhet dhe të shkruhet në formën e dëshirueshme të pakryer në raportin 100 ditor, por nuk kemi rezultate të prekshme. Është e vërtetë se në aspektin e integritetit të Kosovës është hapur një zyr, edhe ka qenë hapur një zyre e Kosovës në Washingtonin ,por vetëm me fjalë para tri katër vjetësh kur nuk ka funksionuar,por tash po thonë se është hapur një zyre e Kosovës në Bruksel edhe në shenjë të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian, kryeministri me kabinetin e tij i mbollën 25 pisha në Qendrën Universitare, të cilat janë tharë të gjitha , sepse askush më nuk ka menduar për to as nuk i ka ujitur edhe kjo është një simbolikë se sa jenti të interesuar dhe serioz për integrimin në strukturat euro-perëndimore. Është folur shumë për të drejtat e minoriteteve .unë nuk kam parë deri me tash, me qenë se në Grupin Për Integrim që e kemi të fokusuar çështjen e respektimit të të drejtave të minoriteteve që keni bërë një respektim d.m.th. sa i përket minoriteteve vetëm atyre verbale dhe për nevoja të Qeverisë, kur kemi takime me ndërkombëtarët, ndërsa në praktikë minoritetet janë po ashtu gjithnjë të mbesin një kategori e dytë e qytetarëve të Kosovës pa drejtë lëvizjeje, pa drejta të informimit, pa të drejta të mediave edhe kështu me radhë mos t'i

përmendin padrejtësitë që bëhen ndaj tyre. Në një vizitë që kisha në Tiranë, një regjisor i njohur me tha që ka siguruar disa mijëra € ma vonë është e mundshme edhe do të, nëse dikush e kërkon qoftë edhe kryeministri nëse ka kohë me na pritë se na kemi bërë disa here kërkesa, nuk ka pasur kohë me na pritë neve nga Grupi Për Integritim, e tha se kam bërë me telefon nga Praga disa miq, kanë thënë njërit prej ministrave të Qeverisë së Kosovës pse nuk po e jep një sasi të hollave për ta kryer një projekt të filmit të përbashkët të Shqipërisë dhe Çekisë dhe për çudi tha ata miq me telefon e urdhëruan ministrin në Prishtinë dhe regjisori ka ardhur nga Shqipëria dhe i ka marrua të hollat menjëherë përmes asaj telefonate në Prishtinë dhe për këtë kemi argumente faktike, dhe nuk e di a janë këto të holla të ministrave që ua ka lënë familja? A janë të holla të prindërve të tyre? A janë të holla të tatimpaguesve të Kosovës? A janë të holla edhe të Bashkimit Evropian edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës që i japin për me i ndihmuar ndërtimit të Kosovës, sepse shumë ministra me të holla e qytetarëve të Kosovës, me taksa paguesve të Kosovës sillen si me qenë, me ato sikur me ia pas lënë baba i tyre amanet me bo çka të donë me to. Kështu që, për me mujtë me bë një vlerësim të përgjithshëm këtij raporti, mendojnë se duhet me shumë kohë. Unë nuk du me u marr kohë, sepse dje kur kemi kërkuar që debati të bëhet 10 minuta, ka pasur vërejtje, është shqyer për sot. Unë dua me u ndalë vetëm me kaq dhe dua me i thonë zotit kryeministër se na patë premtua se e ke bërë një marrëveshje me koalicionin e qeverisë se kur dush mundesh me i ndërrua ministrat, unë po të tregoj këtu shumë haptas në Parlament të Kosovës se nuk ki me mund me i ndërrua asnjë prej ministrave, sepse Qeveria e Kosovës udhëhiqet me plot të drejtë nga nëntoka politike dhe ju z. kryeministër d.m.th nuk jeni fajtor për këtë, faji është diku tjetër, herëve të tjera do ta bëjmë publike dhe do të jemi shumë të ndërgjegjshëm që këto t'i bëjmë me argumente, sepse nuk flasim përmendsh, por kemi argumente dhe këtë do ta bëjmë para opinionit dhe para Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Fjalën e ka deputeti Enver Hoxhaj, le të përgatitet Xhevdet Neziraj

DEPUTETI ENVER HOXHAI - I nderuari z. Kryesues, i nderuar z. Kryeministër, të nderuar ministra,

Në parim jcm pasdite dhe debati është shndërruar në racion të tillë ku shpeshherë partitë të cilat e formojnë këtë koalicion qeverisës nuk dimë se a janë pjesë e pozitës dhe opozitës, ata të cilët e ndijën vetën në opozitë i ftoj të na bashkohen ata të cilët e jetojnë botën reale, i ftoj që të kthehen në botën reale si të tillë, por në të njëjtën kohë i ftoj edhe për një sinqeritet para vetë qytetarëve të Kosovës. Kjo çka përmban ky raport, puna e Kryeministrit, puna e ministrave dhe raporti janë tri realitete të cilat asnjë here nuk takohen me njëra tjetrën dhe të cilat asnjëherë nuk janë realiteti i Kosovës.

Raporti dhe realiteti, jeta e njerëzve në Kosovë janë me mija vjet dritë prej njëri tjetrit. Më lejoni vetëm të them që Qeveria e Kosovës ka 14 ministra, ne sot debatojmë për mos punën e kësaj Qeverie, për dështimet e kësaj Qeverie dhe të pranishëm në sallë janë vetëm 6 ministra, të tjerët nga 14 nuk janë këtu dhe nuk e ndiejnë të nevojshme që të paraqiten të paktën edhe në këtë Kuvend dhe të japin llogari qoftë edhe simbolike para qytetarëve të Kosovës. Unë e kam ndërmend vetëm në një formë shumë të shkurtër t'i them disa fjali faktike, e ftoj edhe Kryeministrin, e ftoj edhe Ministrin e Arsimit, që vërtet nëse kanë përgjigje konkrete në këtë sallë që sot pas dite t'i thonë përgjigjet

konkrete dhe nëse prezantimet e mija janë të gabuara, atëherë t'i përmirësojmë si të tilla. Ndër dështimet kryesore të Qeverisë Çeku është fusha e arsimit edhe pse arsimit dhe edukimi janë prioritet i Qeverisë së tij. Në raportin shumë narrativ i cili nuk ka të bëjë fare me realitetin, e përmendët se si Ministria e Arsimit ka pasur për objektiv standardet në arsim, kthimin e ligjshmërisë së plotë në Universitetin e Prishtinës dhe organizimin e zgjedhjeve të lira, mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe të gjitha këto. Unë nuk do të jem në gjendje nxjerrjen e bilancit për gjithë këtë mospunë të Qeverisë, e kanë ndërmend vetëm të kërkoj vërtet llogari prej Ministrit të arsimit për disa gjëra shumë konkrete. Ndër tjera thuhet kështu: "Është organizuar mbajtja e tekstit kombëtar pas klasës së nëntë", pse ministri i Arsimit nuk tregon para këtij Kuvendi që teksti kombëtar është mbajtur në dy faza dhe në fazën e parë 45.7% kanë ngelur a nuk është dështim ky? Ose gjysma, pse ky raport nuk e ka një të dhënë të tillë? Në fazën e dytë, të një tekstit kombëtar, mirë, mirë 600 ditë, në fazën e dytë një rezultat është kështu: 41.3% kanë ngelur, a nuk është shqetësuese për ju?

Profesor Sabri, nëse nuk është e tillë, mirë, unë nuk kam fare problem me këtë punë. Ndër dështimet e kësaj Qeverie është edhe çështja e institucioneve private dhe në këtë sallë dhe në këtë Kuvend dëshiroj jo nga perspektiva e opozitës edhe një here ta ngrit çështjen e institucioneve private të arsimit dhe të universiteteve private si të tilla. Për Ministrinë e Arsimit se çka është institucion privat jo profitabil që ekzistojnë edhe në vendet e tjera të botës dhe çka është institucion privat profitabil nuk ka ndonjë dallim. Mendoj që Kosova ka nevojë për institucione të arsimit privat, po Kosova ka nevojë për institucionet e tilla të arsimit privat, të cilat janë në shërbim të studentëve. Institucionet e arsimit privat do të ishin në shërbim të studentëve dhe nëse janë institucione jo profitabile, të cilat nuk marrin shumën të cilën e marrin prej studentëve, të cilët kontrollohen dhe të cilat ofrojnë një kualitet në arsim. Këtu thuhet në këtë raport, është bërë licencimi i institucioneve private të arsimit të lartë. Kush e ka bërë këtë licencim? Në raport thuhet janë kryer të gjitha përgatitjet për themelimin e Agjencisë të Akreditimit, ish- ministri Rexhep Osmani para disa muajsh ka deklaruar në një intervistë që në kohën e tij, përgatitjet janë bërë për diçka të tillë. A nuk ju duket ky dështim? Ky është një dështim dhe çmimin të cilin në fund të fundit do ta paguajnë vetë qytetarët e Kosovës.

Ndër të drejtat themelore është e drejta në arsim. Konkursi aktual i cili është shpallur nga Universiteti i Prishtinës ofron 6.825 vende. Në Kosovë çdo vit 18.000 njerëz përafërsisht plus – minus janë të moshës 18- vjeçare. Nëse Universiteti i Prishtinës dhe kjo Qeveri nuk është në gjendje t'i ofrojë kushte dhe vend për studim këtyre njerëzve, këta i kanë dy rrugë ose institucionet private, të cilat duhet të kenë një kualitet më të mirë ose që mbesin në rrugë. Është detyrë e kësaj Qeverie nëse arsimin e ka prioritet thjesht t'ia krijojë një vend studimi çdo kujt i cili dëshiron të studioj. Është çështje e politikës në arsim ku institucionet publike marrin një përgjegjësi të tillë: Te maturantët, tekstin e maturës i ftoj për debat, e ftoj edhe ministrin e ftoj edhe kryeministrin, teksti i maturës është mbajtur nga 7.950 maturantë, të cilët i ka Kosova këtë vit 7.692 ju kanë nënshtruar tekstit të maturës, nga këta deri me tash 4.671 kanë kaluar 40% prej tyre kanë ngelur.

Të nderuar kolegë deputetë, nëse edhe ky nuk ju duket dështim, unë e kam ndërmend këtë dështim t'u ilustroj me një dështim tjetër.

Kosova këtë ë vit për herë të parë në historinë e saj ballafaqohet me ministri. Në vendet perëndimore ose ka tekst të maturës dhe njerëzit kanë të drejtë në tekst të maturës, të regjistruhen automatikisht në universitet me ndonjë ese ose diçka tjetër ose kanë provim pranues dhe nuk kanë test të maturës.

Kjo Qeveri për herë të parë ka organizuar dy provime paralele. Testin e maturës dhe provimin pranues në Universitet. Për një dështim të tillë, mendoj që edhe partitë në koalicion do të duhej ta kërkojnë dorëheqjen e kryeministrit se është dështim i cili thjeshtë nuk i falct. Dhe në fund, këtu jepet një listë e aktiviteteve të tjera të ministrit për vizitat jashtë Kosovës. Është vetëm një aktivitet ku ministri ka komunikuar në rangun e ministrave dhe tutje ka pa lloj-lloj njerëz që kanë pozita të drejtorëve, udhëheqës të fondacioneve, shoqërisë civile ose diçka njëjtë të vendeve të ndryshme të botës edhe përfaqësues të ndryshëm të Bankës Botërore ose diçka të njëjtë. Mu më ka ra, që disa nga këta drejtorët evropian, po e ruaj emrin dhe mbiemrin dhe përkatësinë e tij nacionale ta përmendi që e ka taku edhe vet ministrin e Arsimit. E dini një gjë, jo vetëm që prioritetet e Ministrisë të Arsimit në Kosovë nuk i njohin, nuk i dinë, por këta thjeshtë nuk janë në gjendje as emrin dhe mbiemrin e ministrit ta mbajnë në mend, dhe vazhdimisht synonte njëri prej bashkëbiseduesve ta fillojë emrin e ministrit me D jo me Agim Veliu por me D, dhe unë me sarkazëm e sipër atij nuk mund t'ia thosha, po ju them sot juve emri i tij është Dështim Veliu, sepse ka dështuar në çdo fushë të arsimit dhe vazhdon të dështojë Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj, përgatitet deputeti Xhavit Haliti, me një lutje deputetëve që mendoj, që edhe dy orë e gjysmë të ardhshme debat që janë veç të paraqitur, të mos paraqiten tash sërish se po ka edhe 2-3 deputetë. Ju i keni paraqitur emrat për fjalë dhe besoj se do t'i prmebahemi asaj.

Deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën le të përgatitet Xhavit Haliti

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – I nderuari z. drejtues i seancës z. Maloku, i nderuar Kryeministër, ministra dhe deputetë të nderuar,

Përshëndesim gatishmërinë e z. Çeku, që sot raportojë për 100 ditët e punës të Qeverisë para Parlamentit.

Premtimi i dhënë se Qeveria e udhëhequr nga Ju do të jetë qeveri e qytetarëve të Kosovës dhe do të punoni për qytetarët e Kosovës, po jetësohet qe sot, sepse një Qeveri në demokraci nuk ndërtohet vetëm për efikasitet, por më tepër për përgjegjshmëri, dhe këtë përgjegjshmëri po e tregoni sot para Kuvendit e Kosovës me Raportin e juaj. Unë do të ndalem në pikën për ndërtimit të besimit në mes të komuniteteve dhe përgëzojë punën që e keni bërë në këto 100 ditët për integrimin e të gjitha komuniteteve, që këto 100 ditë janë të pakta që mund të bëhen për disa komunitete me të cilat nuk është punuar vite dhe dekada të tëra. Prandaj, përgëzoj gjithë punën, mundin dhe sakrificën që jeni duke bërë.

Unë do të kisha sugjeruar se në Raportin, në faqen 12, në fshatrat dhe vendbanimet ku i keni vizituar të gjitha minoritetet, besoj se dominojnë vizitat te komuniteti serb, unë besoj se në të ardhmen do të gjeni kohë dhe do të vizitoni edhe komunitetet, edhe

komunitetin boshnjak, edhe komunitetin egjiptas edhe komunitetet tjera, me qëllim që mos të hetojnë se janë të pa interesuar nga ministri dhe Qeveria.

Do të ndalen edhe në faqen 13 dhe 15 ku në raport është paraqitur komuniteti RAJ që unë si komunitet egjiptas do të kundërshtoj dhe e kam kundërshtuar, se nuk ka komunitet RAJ, por ka komunitet, pjesëtarë të komunitetit rom, hashkali dhe egjiptian dhe RAJ mund të ndodhë se është Agjencion evropian i rindërtimit, mund të ndodhë të jetë hipermarket prandaj nuk ka shkurtesa të komuniteteve. Komuniteti egjiptas ka origjinë egjiptas, gjuhë amtare – gjuhë shqipe, tradita dhe zakone shqiptare, dhe ky është letërnjoftimi i këtij komuniteti, prandaj nuk duhet të lejohet dhe të merren disa të dhëna të disa institucioneve edhe ndërkombëtare, të cilët me qëllim të RAJ, mundohen të bëjnë plasim dhe t'i diskriminojnë disa komunitete. Bie fjala, nëse e punësojmë një të komunitetit egjiptian thonë po është pjesëtar edhe i komunitetit Rom dhe i komunitetit aashkali, do të thotë luajnë në atë letër që Qeveria nuk duhet të lejoj. Unë do të besoj që, edhe në kuadër të Ministrisë të juaj z. Habit Haradinaj i cili është duke qenë i pranishëm për qeverisje të mirë, që këtë termë ta hejë nga terminologjia e tij. Në një aspekt tjetër që do të ndalem është edhe në sferën e punësimit, unë besoj që në disa komuna është numri shumë i vogël i pjesëtarëve të komuniteteve minoritare, edhe pse ministri i pushtetit lokal ka bërë urdhëresë që të bëhet pranimi i disa pjesëtarëve, ata edhe pas shpalljes të konkursit e kanë eliminuar atë konkurs gjëja se ka mungesë të buxhetit, ndërsa në anën tjetër shpallin konkurse për pranimin e të tjerëve, do të thotë edhe këtë lojë z. Kryeministër duhet ta shikoni nëpër disa komuna. Unë do ta marr shembull komunën e Rahovecit ku është një zyrtar këtu. Ishin 20 pjesëtarë të komunitetit serb në komunën e Rahovecit dhe thoshin: Komisioni për komunitete nuk jemi të integruar, ndërsa pjesëtarët e komunitetit egjiptian nuk kishte asnjë pjesëtar të punësuar në komunë dhe thoshin jam i integruar në shoqërinë kosovare, d.m.th. një paradoks, prandaj duhet t'ju ndihmohet komuniteteve, të cilët gjithmonë e kanë dashur Kosovën dhe do ta donë.

Një sfidë tjetër që do të jetë para Qeverisë është edhe zhvillimi ekonomik dhe privatizimi. Unë di që, privatizimi është detyrë e AKM-së dhe nuk mund ta fajësojë asnjë ministër, por do të kishte qenë, që t'u mundësohet se shitja e ndërmarrjeve të bëhet në bazë të projekteve, në bazë të planit të biznesit që ofron njeriu dhe jo se sa japin çmim ma të madh, dhe t'i jepet atij personi i cili do të premtoj, jo vetëm të premtoj, por do të punësojë një numër më të madh të punëtorëve dhe të bënë një dinamikë më të madhe të investimeve për arsye se Kosova ka nevojë për një shkallë më të madhe të punësimit.

Këto janë sfida, unë di që ke fituar shumë beteja dhe do t'i fiton edhe këto beteja. Integrimi i komuniteteve dhe zhvillimi ekonomik janë dy sfida që e qojnë Kosovën në pavarësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet, fjalën e ka deputeti Xhvit Haliti, le të përgatitet deputeti Behxhet Brajshori.

DEPUTETI XHAVIT HALITI – Z. Kryesues, Kryeministër, deputetë,

Me vëmendje dëgjova diskutimet e parafolësve të mijë, kritikën dhe sugjerimet, të cilat janë në interes të çuarjes përpara të punëve të Qeverisë, ashtu siç edhe kritikën me vend për disa çështje me të cilat nuk mund të shkohet më tutje

Nga Raporti që dëgjova, nuk jam nuk jam shumë optimist në punën e Qeverisë për faktin se nuk dëgjova askund mundësinë e rritjes së buxhetit të Kosovës, mundësinë e rritjes së financave të Kosovës dhe nuk dëgjova askund shtimin e të punësuarve në Kosovë, e cila realisht po hyn në fazën kritike të krizës së rëndë ekonomike. Megjithatë, unë desha atë ndalem në disa çështje, të cilat kanë të bëjnë me mundësitë tona dhe për të cilat prapë po them që nuk po shoh që Qeveria aktuale ka impenjim. Jemi duke jetuar në një krahurë arkitektonike të të gjitha qyteteve të Kosovës dhe në veçanti të Prishtinës, të padurueshme e cila është shndërruar deri në katet e treta të banesave në dyqane dhe për çudi edhe mbindërtimet kanë arritur deri në tre dhe katër kat dhe për këtë çështje askush nuk përkujdeset.

Më ka ra në sy një çështje shumë e rëndësishme, sepse Kosova është e njohur për natalitetin dhe lindshmërinë e lartë që kemi, dhe kemi miratuar ligje mjaft të rëndësishme edhe për nënat edhe për lehonat, edhe për fëmijët, por shumë interesat se në qytetin e Prishtinës dhe në qytetet e tjera nuk po shoh asnjë nënë me fëmijën e saj në karrocë duke e shtyrë nëpër qytet, dhe po e pyes vetën pse, sepse trotuarët e qyteteve të Kosovës nuk janë normalisht të ndërtuara dhe askush nuk mund ta shtyjë karrocën me fëmijë. Prandaj, kjo është një çështje, në dukje ndoshta për buxhetin buxhetor dhe Qeverinë e parëndësishme, dhe mund ta fajësojmë edhe pushtetin lokal, por është një çështje me të cilën jo vetëm Prishtina, por të gjitha qytetet e Kosovës janë të ballafaquara. Unë i përmenda nënat, të cilat shohin me karroca, por Kosova ka edhe të verbër, vallë në këtë krahurë ku një tretuar është gjysmë metra – njëqind metra me ecë, gjysmë metra e ke trotuarin më lartë se tjetrin, a mund të ecën një i verbër me shtagën e tij nëpër qytetin tonë? Dhe besoj pretendimet tona për të hyrë në Evropë kanë një domethënie dhe këtë aspekt sepse ju e keni pa që atje rrugët janë të ndara bile bile këmbësorët respektohen ma shumë se makinat duke përfshirë këtu edhe makinat tona qofshin ato me targa 00 të Qeverisë ose të Parlamentit.

Është diskutuar shumë Ligji i luftës, dhe përkujdesja për invalidët dhe familjet e tyre, dhe unë e pata bërë një propozim që Qeveria të bëhet realiste dhe të del publikisht dhe të sqarojë, besoj se do të kuptohet se buxheti i Kosovës nuk e përballon këtë. Shumë, por mendoj që Qeveria e Kosovës duhet të mendoj që të grumbulloj taksa në një mënyrë apo në tjetrën legale, që kësaj kategorie t'i shkojë në ndihmë dhe të ketë përkrahjen e ngrohët në bazë të mundësive që ka edhe të një programi nga taksat e grumbulluara për këtë çështje përmes ligjit ose përmes të një vendimi të Qeverisë i cili mund të merret.

I kam kritikuar antenat e Mobitelit të Serbisë, të Malit të Zi 1, 2, 3, 4, privat, gjysmë privat nëpër antenat e shtëpive në Pejë. Çuditërisht jam informuar që në qytetin e Pejës nuk lejohen të vendosen antenat e Valës 900 nga Kuvendi komunal, unë nuk e di pse, të paktën nuk po e kontestoj se është e shtrenjtë, por Vala 900 është kompani e Kosovës dhe nuk do të duhej Kuvendi komunal i Pejës të nxjerr telashe dhe mos të lejojë të vendos antenat, të cilat qytetarët duhet t'i përdorin, lidhjet e tyre t'i kenë të siguruara. Qytetet tona janë në një situatë mjaft të rëndë ekologjike do ta quaja për faktin se asnjë qytet i Kosovës nuk ka impiant të djegësës të plehrave të cilat vërtet po e ngulfatin jetën e njerëzve normal dhe është normale që po shfaqen sëmundje të ndryshme, të cilat më herët nuk kanë qenë të paraqitura dhe nuk kanë qenë fenomen në Kosovë, sepse pothuaj se ¼ e Kosovës kanë qenë ambient ekologjikisht i pastër duke përjashtuar dy – tre qytete që kanë qenë me mbingarkesë industriale dhe ekologjikisht jo aq në nivel. Prandaj, mendoj se Qeveria nga buxheti i saj do të duhej që menjëherë të ndante ose të gjcinin

mundësinë për marrjen e kredisë për t'i ndërtuar impiante për djegien e plehrave ashtu siç do të duhej të ndërmerre hapa konkret për ndërtimin e impianteve për pastrimin e ujërave të zeza pa të cilin realisht nuk mendohet kërkund në Evropë sot, që nuk llogaritet që mund të ketë një ambient të pastër ekologjikisht.

U tha që Qeveria ka program për mbështetjen e prodhimeve bujqësore ashtu siç u tha nga ~~panofolësit e mi dhe shtë ngritur~~ disa here pengesa e madhe që është për prodhuesit vendorë. Unë po e thjeshtësoj, në Kosovë bujqit prodhojnë, tash kanë filluar edhe dredhëza me shumicë, po prodhojnë specë, domate, lakra, mollë. Këto janë prodhimet e Kosovës. Janë një muaj, dy muaj, treg të cilin Kosova mund ta mbulojë tregun e brendshëm, nuk ka kapacitete për eksport dhe mendoj ka pasur edhe përpara propozime për ta miratuar një ligj të tillë dhe kemi vendosur këtu diçka në Kuvend, por deri më tash nuk është vërejtur ndonjë përkrahje konkrete për prodhuesit bujqësorë, ata janë të lodhur, nuk kanë mbështetje as nga Qeveria, nuk kanë subvencione për plehra, për lavërtari, për asnjë prodhim të tyre dhe realisht i kanë edhe ata hallet e tyre, kanë hallet e shkollimit të fëmijëve të tyre, kanë hallet e jetës së tyre dhe ne ndoshta një pjesë që jetojmë në kushte më komode në qytet dhe kemi rroga pak ma të mira, ndoshta nuk jetojmë aty, por do të ishte mirë që t'i prekim realisht hallet dhe problemet e tyre. Si çështje tjetër do të thosha se kemi si problem çështjen e energjisë elektrike. Unë nuk jam ende i informuar zyrtarisht duke përfshirë planin strategjik, të cilin e kam parë, por ka mendime të ndryshme dhe ka, ta quaj diversion të investitorëve të interesuar në Kosovë lidhur me atë në çka duhet të investohet në energji në Kosovë, energjia me qymyr apo energjia me gaz. Kush do të investojë? Kush do të kreditojë? Për këtë çështje mendoj se do të duhet të hapej debat në Kuvendin e Kosovës dhe t'i shohim edhe interesat e Kosovës të cilat janë. Përndryshe, duke e mbyll fjalën time, duke mos dashur ta kaloj edhe kohën, sepse po harxhohet edhe koha, mendoj që, përveç çështjeve të mëdha për të cilat po përmenden këtu vazhdimisht dhe e kemi gojën plot patriotizëm, unë jam që të merremi edhe me gjërat e prekshme, të cilat i kemi në këmbë për çdo ditë dhe të cilat po deshëm të angazhohemi pak ma shumë, mund t'i realizojmë edhe me punë vullnetare të qytetarëve edhe me ndihmën e tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi.

I lus deputetët që janë paraqitur për fjalë, të kthehen në sallë se më është dashur që dy here t'i kalojë deputetin: Nazim Jasharin, deputetja Teuta Sahtqija, ne i kalojmë. Behxhet Brajshori e ka fjalën

DEPUTETI - BEHXHET BRAJSHORI:

I nderuari zoti kryesues, z. kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputetë – fillimisht më lejoni që ta falënderoj kryeministrin për prezencën e tij dhe fjalën e tij të thënë sot në Kuvend, për raporti e punës së Qeverisë për tre muajt e kaluar. Më lejoni që në fillim të mund të vlerësoj se Qeveria ka bërë angazhim shtesë për të bërë progres pozitiv për këta tre muajt e kaluar, në veçanti do të bëjë një vlerësim të shkurtër në dy rrafshë: në rrafshin politik vlerësoj angazhimin e Qeverisë për përmbushjen e standardeve, angazhimet e Qeverisë me aktivitetet e saj për implementimin e planit të veprimit për partneritet evropian dhe aktivitetet e Qeverisë, në kuadër të mekanizmit

përcjellës të stabilizimit asociativ. Që të tria këto aktivitete, kanë dhënë një imazh të qartë për Qeverinë, me qëllim që të merren edhe vlerësimet e komunitetit ndërkombëtar në këtë drejtim, për të ardhmen e vendit tonë.

Në rrafshin tjetër më lejoni që të shfrytëzoj disa të dhëna se kanë të bëjnë me aspektin ekonomik të zhvillimit të vendit dhe pse është vështirë për të përcaktuar, edhe për të ndarë një periudhë tremujore, sepse këto lëvizje lidhen edhe me periudhat e mëparshme, përkatësisht me muajt e kaluar. Vështirë është që për një periudhë të shkurtër të jepem indikatorë të saktë nga Enti i Statistikës,.... të inkuadrua makroekonomik, se çfarë lëvizjesh. Megjithatë duke u bazuar në të dhënat të cilat ne disponojmë, vërejmë se ekziston një stabilizim i indikatorëve të caktuar ekonomik, gjatë gjysmës së parë të vitit 2006.

Të shkojmë radhazi, të dhënat rreth sektorit fiskal, flasin që të hyrat e realizuara gjatë kësaj periudhe, janë realizuar në vlerë 50.1% të planit buxhetor. Këtë e kemi edhe raportin e Qeverisë, por ajo që është me rëndësi, për të është se kemi një tendencë kërritjes së pjesëmarrjes, së grumbullimit të hyrave në vend, në krahasim me ato që i mbledhim në kufi. Dhe ky padyshim se, është një sinjal i mirë, që deri në fund të vitit, pra edhe plani i paraparë për grumbullimin e të hyrave, përkatësisht të hyrave buxhetore do të realizohet.

Në sektorin e jashtëm të ekonomisë, vërehen lëvizje pozitive, në drejtim të rritjes së eksportit të mallrave, edhe pse deficitit tregtar edhe më tutje mbetet një nga problemet, do të thosha e jo-stabilitetit makroekonomik të vendit. Këtë rast duhet përmendur që, shkalla e mbulimit të importit në eksport është rritë, nga 4%, sa ka qenë vitin e kaluar në 6%, në këtë periudhë për të cilën po debatojmë tani. Po ashtu vërehet një përmirësim në strukturën e mallrave të importuara, ku shënohet një zvogëlim i importit të mallrave ushqimore, dhe një rritje e mallrave për investime që paraqesin sinjal po ashtu pozitiv, për zhvillimin ekonomik të vendit. Më lejoni të përmend edhe disa indikatorë të tjerë, që kanë të bëjnë me shpenzimet buxhetore, për të mos u ndalur në tërësi në strukturën e të hyrave dhe në strukturën e shpenzimeve. Vërehet një rënie, përkatësisht një racionalizim i shpenzimeve. Deri më tani janë realizua 35.2%, të shpenzimeve të parapara për, – në planin vjetor. Po ashtu brenda kategorive, kemi një racionalizim të theksuar. Këtu duhet vërejtur një dukuri të shpenzimeve që kanë të bëjnë me investimet kapitale duhet pasur një dinamikë më të shpejtë, sepse deri në periudhën e tashme kemi një realizim 12.6%, në krahasim me atë që kemi bërë me planin vjetor. Natyrisht se, këtu janë disa procedura buxhetore, procedura të tjera që po rëndojnë në përgjithësi, realizimin e investimeve kapitale. Në këtë drejtim besoj se periudha e ardhshme do të përmirësojë edhe këtë indikatorë.

Në sektorin e depozitave të kredive, më lejoni që vetëm të bëjë disa krahasime, muaj për muaj, në vitin 2006, jo vit për vit, prej vitit 2000, deri në vitin 2005. Në janar të vitit 2006, krahasuar me 2005-shin, kemi një rritje të depozitave, kemi rritje të depozitave po ashtu në muajin shkurt, krahasuar me muajin janar dhe kemi një stabilizim të depozitave në muajt mars, prill dhe maj. Nuk kam të dhëna për muajin qershor. Një dukuri e këtyllë, ose një stabilitet i këtyllë paraqitet në sistemin kreditor, kemi rritje të kredive, kemi rritje

në muajin janar 1.2, në krahasim me vitin 2005, kemi rritje të kredive 2,5, në krahasim me muajin janar për vitin e shkuar, 4.2 në muajin mars për muajin shkurt dhe kështu me radhë, d.m.th. me fjalë tjera kemi një stabilitet dhe një dhënie të kredive, dhe nuk do të dua të hy në strukturën e kredive tash në destinimin që padyshim duhet analizuar. Disa indikatorë më kryesor që do të na ndihmonin po ashtu për të vërejtur se çfarë në të vërtetë jemi në gjendje aktuale ekonomike. Nuk them se çdo gjë është akoma krejt e përkryer, por me gjithat indikatorët tregojnë një stabilitet por që duhet pas vëmendjen në përgjithësi në hapat e ardhshëm dhe në periudhën e ardhshme për të ndikua në zhvillimin më të shpejtë ekonomik të vendit.

Në vitin 2006 rritja reale e GTP-së është 8% planifikuar, ju referohem të dhënave të Fondit monetar ndërkombëtar, të muajit maj 2006. Rritja reale e GTP-së do të jetë 3.3% gjatë vitit 2006. GTP-ja nominale e shprehur në €, po ashtu në milion €, po ashtu do të ketë një rritje pozitive, kurse rritja nominale e GTP-së, po ashtu shënon rritje pozitive, në krahasim me vitin 2005. për 1.8%. Importet komerciale, do të kenë një rritje të lehtë, kurse rritja e importeve shprehur në përqindje, po ashtu në vitin 2006, e vlerësuar, janë vlerësime të Fondit monetar ndërkombëtar, do të ketë një rritje të lehtë, krahasuar në vitin 2005. të gjitha këto të dhëna të nderuar kolegë, na bëjnë që të jemi të kujdesshëm, që shfrytëzojmë këta agregat, mos të mashtrohemi shumë se mund të jenë tepër të qëndrueshëm, për një periudhë të gjatë, andaj edhe unë propozoj që në të ardhmen bashkërisht t'i vejmë vëmendjen tonë në disa aspekte, më kryesore do të thosha:

De-blokimin e mjeteve të privatizimit, të fondit të privatizimit, të fondeve tjera, që do të na ndihmonin për të vu në funksion, të zhvillimit ekonomik të vendit. D.m.th. rritjen e investimeve, pjesëmarrjen e investimeve në GTP, pa dyshim duhet bërë në këtë drejtim diçka, duhet siguruar burimet e financimit, të brendshme dhe të jashtme, me qëllim që të kemi dinamikë më të shpejtë të zhvillimit ekonomik të vendit, i cili pa dyshim se do të jetë, një nga sfidat kryesore, në ditët e para menjëherë pas përfundimit të aspekteve politike, që kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit tonë. Prandaj unë mbështes punën e Qeverisë në këto aspekte, me gjithë nevojën e angazhimit më të menjshëm për të përmirësuar edhe parametrat tjerë, e të cilët do të ndikonin edhe në mirëqenien në përgjithësi popullatës në Kosovë.

Ju faleminderit!

KRYESUESEI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi, përgatitet deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI - XHEVAT BISLIMI:

Zoti kryesues, zotërinj deputetë, zoti kryeministër dhe zotërinj qeveritarë!
Raporti i kësaj qeverie, ose i kryeministrit, raporti 100 ditor, u tha edhe nga shumë parafolës, po e them edhe unë se është një 100 ditësh i ri, i dështuar i këtij koalicioni qeverisës. Por, për dallim prej qeverisjes së deritashme, pjesë e këtij dështimi të ri, është bërë edhe kryeministri, i cili po shpenzon për ditë e më shumë autoritetin e tij, me një kabinet tashmë të dështuar. Në raportin e kryeministrit, vend të rëndësishëm edhe kësaj

radhe kanë zënë standardet. Unë kam mendimin se gjithmonë është mirë të plotësohen standardet, që janë dhënë nga bashkësia ndërkombëtare. Për këto standarde do të bëhen përpjekje edhe prej shumë qeverive, që do të vijnë pas Qeverisë tuaj, por unë mendoj se kjo qeveri, ky koalicion qeverisës, ka ardhur në pushtet, e ka marrë votën e qytetarit të Kosovës, duke premtuar zbatimin e një krye-standardi për Kosovën, shpalljen e shtetit të pavarur të Kosovës dhe organizimin e referendumit, për Kosovën.

Më lejoni t'ju citoj nga programi elektoral i Aleancës, këtë program besoj kryeministri duhet ta ketë lexuar, meqë është bërë anëtar i Aleancës, ka qenë mirë me e lexua. Këtu thuhet: e drejta për të vendosur për fatin e vet politik e shtetëror u takon qytetarëve dhe kjo është e drejtë demokratike e patjetërsueshme. Vetë qytetarët e Kosovës, do të vendosin për fatin e vet dhe për statusin final të Kosovës. Kuvendi i Kosovës duhet ta shpallë shtetin sovran, të pavarur të Kosovës dhe të kërkojë njohjen ndërkombëtare nga qeveritë e shteteve të tjera. Te objektivat, te pika 8 thuhet: realizimi i referendumit për deklarinimin e qytetarëve, për shtetin sovran e tëpa-varur të Kosovës dhe pika 9, shpallja e shtetit sovran e të pavarur të Kosovës.

Ju zoti kryeministër, si i gjithë koalicioni qeverisës, keni harxhuar shumë energji, shumë letra, shumë ngjyrë, shumë buxhet nga taksapaguesit tanë, duke organizuar takime, duke bërë konferenca, duke bërë vizita, për çështjen e standardeve, por keni harruar, krye-standardin, për të cilin keni ardhur në pushtet dhe keni kërkuar votën e qytetarëve tanë. Unë këtu po flas kryesisht si qytetar i Kosovës, ta zëmë se më ra bingo dhe erdha këtu si qytetar të flas.

Një vend të rëndësishëm në raportin tuaj ka zënë, sikur edhe deri tani, në raportet e kësaj Qeverie dhe në dokumentet e saj, pakica serbe. Ju duhet ta keni të qartë, ashtu siç e ka të qartë e gjithë bota, se Kosova dhe populli shqiptar i Kosovës, nuk është në konflikt me pakicën serbe në Kosovë, prandaj mos harxhoni kot energji, mos harxhoni kot frymë, Kosova ka qenë dhe është në, - ishte në luftë tash është në marrëdhënie shumë këqija me Serbinë, e cila vazhdon të pretendojë se Kosova është pjesë e pandashme e Serbisë. Këtë deklaratë zoti kryeministër, se Kosova është pjesë e pandashme e Serbisë, e bëri Koshtunica mu në qendër të Kosovës, para hundës së Qeverisë, por jo para kryetarit, sepse kishte ikur në Tiranë që të shpallje doktor nderi i Universitetit.

Unë si qytetar i Kosovës, kam pritur që ju që keni mandatin të përfaqësoni dinjitetin e këtij populli të këtij vendi, do t'i thuani Koshtunicës dhe Qeverisë dhe mbarë botës se Kosova kurrë nuk ka qenë pjesë e Serbisë, nuk është pjesë e Serbisë dhe nuk do të jetë pjesë e Serbisë. Kosova ka qenë e pushtuar nga Serbia dhe gjatë pushtimit të saj, Serbia Kosovën e kishte shndërruar në një varr masiv dhe një oqean gjaku e lotësh, që derdhehin nga ky popull për lirinë e tij.

Në raportin tuaj kemi folur shumë për kthimin dhe unë si gjithë ju, si e gjithë bota demokratike, jam për atë që secili njeri mund të kthehet në shtëpinë e tij. Por ju keni harruar të përmendni afër 1 milion shqiptarë që janë shpërngulur me dhunë, nga Kosova dhe askush nuk flet për kthimin e tyre, askush nuk mendon që të iniciohet dialogu, bisedimet, nismat për kthimin e familjeve të shpërngulura me dhunë nga Kosova, që dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Që të krijohen kushte për kthimin e atyre shqiptarëve,

që ndoshta dikush tashmë i konsideron të shpërngulur njëherë e përgjithmonë nga Kosova.

Mërgatat shqiptare siç e dini edhe ju, siç e di çdo qytetar i Kosovës, e ka mbajtur frymën e Kosovës, për vite të tëra. Mërgata e Kosovës ishte ajo që mbushi radhët e UÇK-së, mërgata e Kosovës është ajo që po e mban frymën e Kosovës edhe sot. Janë paratë e kësaj mërgate, që po na mbajnë gjallë se përndryshe këtu do të krijohet një Bangladesh i ri në Ballkan. Prandaj të mos thuhet qoftë edhe një fjalë, për mua është e pa pranueshme. Kësaj mërgate përkundrazi, madje janë vendosur edhe sanksione, është miratuar një rregullore e UNMIK-ut, e cila nxjerr 100 telashe që për ardhjen e mërgimtarit, që dëshiron të vijë në shtëpitë e t vet.

Dhe unë pyes kryeministrin dhe koalicionin qeverisës, çfarë kanë bërë që të pengohet miratimi i kësaj rregulloreje. Çfarë po bëjnë që të pengojnë zbatimin e kësaj rregulloreje, e njëjta rregullore lejon hyrjen dhe daljen sa herë t'ua dojë qejfi qytetarëve serbë e malazez. Por nuk lejohen ata që u dëbuan me dhunë të kthehen këtu, të paktën për vizita, në familje të tyre. Çfarë kanë bërë që Qeveria që, të ndalojë agjencitë e udhëtimit, agjencinë turistike që, me matrapazllëqet e tyre sa herë vjen koha për të ardhur mërgimtarët tanë në Kosovë i pesëfishojnë çmimet, dhe shumë familje duhet të harxhojnë kursimet e vitit vetëm për të ardhur në Kosovë. A duhet të kenë një platformë për këto agjenci, për këto çmime, apo është vendosur një monopol për një agjenci të caktuar dhe mund të bëjë çfarë të dojë dhe mund të shfrytëzojë dëshirën për të ardhur mërgimtarët këtu edhe ta paguajnë me 5-fish. E njëjta gjë me kompanitë e sigurimeve që sivjet i kanë dyfishuar çmimin për veturat e mërgimtarëve tanë, të cilëve nuk ua pranojnë sigurimet nga vinë, por edhe i kanë dyfishuar çmimet e sigurimit për të hyrë në Kosovë. A thua këto janë gjopa, janë ndëshkime, për mërgimtarët që po na mbajnë, edhe çfarë janë këto masa.

Më tej në raport flitet për respektimin e të drejtave të njeriut, barazinë gjinore. Ju lutem shumë, a mund të ketë respektim të drejtave të njeriut, a mund të ketë të drejta të njeriut në një vend ku 70%, e popullsisë janë papunë. A mund të ketë të drejta të njeriut e respektim të tyre një vend ku sundohet nga terri kryesisht. Edhe tash me siguri gjysma e Kosovës është në terr dhe pa drita. A mund të ketë të drejta të njeriut në një vend ku arsimtari është kthyer në rast social, sepse 190 €, të arsimtarit janë një ndihmë sociale dhe nuk mund të ketë arsimtar që mund ta mbajë familjen e tij me 190 €. Edhe për këtë, programi zgjedhor i Aleancës tuaj ka pasur premtime bukur të bujshme për t'u rritë rolet e arsimtarëve, njësoj ka bërë edhe partia tjetër në koalicion.

A mund të flitet për barazi gjinore në një vend, ku 90% e grave është e pa punë. Ju lutem t'i lëmë ato, të paktën të mos bëjmë shpenzime të buxhetit me trajnime, me takime, me improvizime të kota, sepse barazi gjinore për një grua që është 90%, e pa punë nuk mund të ketë. Kjo është diçka fiktive, diçka e imagjinuar, diçka nëpër letra, nëpër strategji, nëpër plane, nëpër programe që bëjnë ata zyrtarët tuaj, nëpunësit tuaj që nuk kanë çka të bëjnë dhe nxjerrin nga kompjuteri strategji, plane për kthim, për ta kaluar kohën.

Energjia elektrike, zoti Kryeministër, ju keni ardhur ka tash tre muaj, - 100 ditë, aleanca e juaj me programin zgjedhor ka pas premtuar, stabilizim dhe furnizim të rregullt, me energji elektrike. Jemi dëshmitar se për këto 5 - 600 ditë, jo që nuk ka pasur stabilizim po është keqësuar gjendja.

Qytetari i Kosovës, tregtari i Kosovës, familja e Kosovës, sot është e obliguar të (ndërhyrje kryesuesi - i vazhdohet fjala deputetit ju lutem) - ju faleminderit zoti kryesues. Ju lutem, ju lutem qetësi, vazhdim - është i ngarkuar buxheti i familjes ekonomia e Kosovës, tregtari i Kosovës, është i ngarkuar me shpenzime të dyfishta - trefishta. Nga njëra anë, nga taksapaguesit financohet KEK-u, nga xhepat e qytetarit tonë. Në anën tjetër, çdo familje, çdo biznesmen, është i detyruar të shpenzoj për agregat, për derivate të naftës, për të mbajtur dritat për të mbajtur ekonominë, për të mbajtur aparaturën. Plus të paguaj për rrymën që nuk e shpenzon, nuk ka tarifë më të shtrenjtë në Evropë, 50 €, 60€, për familje në Kosovë, dhe të njëjtën kohë nuk ka rrymë, askush nuk i ka bërë një komision për të hetuar sa janë dëmtuar familjet e Kosovës, sa është dëmtuar Kosova, sepse po të bëhej një komision, po të ishte një Qeveri, që mbron interesat e qytetarëve, do të merrte mundimin për të mbronte këto interesa të qytetarëve, të shikonte cili është dëmi, që i shkakton përditë mungesa e energjisë elektrike, familjes shqiptare, ekonomisë shqiptare, e jo të gjobiten ato familje vazhdimisht, tu ndërpritet rryma, të bëhet presion të bëhet fushatë, të bëhet propagandë mbi ta, dhunë psikologjike mbi ta, tuaj se ata nuk janë qytetarët tanë, kush e di prej kah kanë ardhur këtu dhe duhet neve të na mbajnë.

Një çështje tjetër është decentralizimi, që dikush këtu e tha se jemi pas pajtuar të gjithë, e unë po e them se nuk jemi pajtuar të gjithë. Ne kemi pas kërkuar që decentralizimi të mos ndahet me Qeverinë e Serbisë, por të bëhet pasi të zgjidhet statusi i Kosovës, pasi Kosova të bëhet shtet, sepse është çështje e Kosovës.

Ju në programin tuaj keni thënë: në diskutim janë paraqitur disa modalitete të decentralizimit, të cilat në vend që të ndërtojnë kohezionin institucional të Kosovës, shkojnë në drejtim të institucionalizimit të enklavave dhe të ndarjes së vendit në vija etnike, strukturave paralele dhe involvimit dhe Qeverisë së Serbisë, në punët e brendshme të Kosovës.

AAK është kundër decentralizimit në baza etnike dhe konsideron se, do të implikonte dhe të sillte pasoja të konsiderueshme, politike dhe organizative. Për të realizuar formën më të thella të decentralizimit, së pari duhet të realizohen këto parakushte thoshte AAK-ja. Kontrolli administrativ i territorit të Kosovës, nga ana e Qeverisë, faktorizimi maksimal i Kosovës dhe definimi i statusit të Kosovës. Ju lutem shumë përpikuni ti përmbaheni premtimeve elektorale, që i keni bërë publikisht, botërisht pa presion të askujt.

Çështje tjetër janë edhe trashëgimia kulturore, unë mendoj që Qeveria e Kosovës, nuk duhet të vazhdojë me këto politika, sepse po vendos mina, në territorin e Kosovës. Çfarë do të ndodhte sikur qindra xhamia turko-arabe, të kërkonin zona speciale. Çfarë do të ndodhte sikur dhjetëra kisha romake, të kërkonin zona speciale. Çka do të bëhej me Kosovën? Prandaj mendoni mirë, hiqni dorë nga këto praktika, nga këto politika, thellësisht kundër-Kosovës dhe kundër-atyre që i keni shpallë ju, dhe të gjitha partitë

politike. Botërisht qe shtat vite, edhe në krejt në fund të ligjit për vlerat e luftës zoti kryeministër, ka qenë skandali i parë më i madhi i Juaji, që keni bërë, ka qenë mashtrimi publik që keni bërë ndaj kategorive më të ndjeshme të këtij vendi, dhe unë mendoj që ju në atë kohë, jo pse aktualisht jam opozitë e juaja, por në të vërtetë duhet të jepni dorëheqje. Unë mendoj edhe sot që, në qoftë se nuk jeni i zoti me i ndalë këto politika, këto praktika kundër-Kosovë, më mirë lëreni mandatin ,shkoni...

KRYESUESI – NAIM MALOKU:

Zoti deputet të jeni të mirësjellshëm dhe na lironi nga tortura dhe keqpërdorimi që ju po i bëni foltores së këtij Kuvendi.

Ky Kuvend është duke instaluar metodë dhe parime demokratike të komunikimit dhe ju lus, ju i keni shfrytëzua 15 minuta kohë, për t'i torturua kolegët tuaj deputetë të këtij Kuvendi. Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti për replikë është më duket se ndërhyri diçka

DEPUTETI - SABRI HAMITI:

Jo jo unë nuk kamë replikë, unë u paraqita siç kamë të drejt, si çdo deputet në çdo kohë, brenda seancës t'ju tërheq vëmendjen që ta ushtroni saktësisht Rregulloren e Kuvendit. Zoti kryesues, ne kemi kalua mbi një vendim me një marrëveshje të përgjithshme që, strikt të ushtrohet Rregullorja e Kuvendit e cila thotë: çdo deputet për një temë mund të flasë deri në 10 minuta. Ju lus shumë, që ta respektoni këtë rregull, për ndryshe nuk kemi arsye që të dëgjojmë diskutime përtej 10 minutave.

KRYESUESEI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zoti deputet, fjalën e ka deputeti Nazim Jashari, përgatitet deputeti Mazllum Kumnova.

DEPUTETI – NAZIM JASHARI:

I nderuari zoti kryesues, zoti Kryeministër, ministra, të nderuar kolegë deputet, e kemi një rast të mirë, edhe të parin, që nga konsideromi i këtij koalicioni qeveritar, që të bisedojmë për punën e Qeverisë. Qeveria është konstituua me 3 dhjetor të vitit 2004, të gjithë jemi dëshmitar, kryeministri i parë ishte i penguar që të raportoj 100 ditshin, kryeministri i dytë, nuk e pa të arsyeshme të raportoj 100 ditshin, i treti shpyr zotit duel para Kuvendit, edhe së paku në asketin formal, procedural është për ta përgëzuar dhe është për ta përshëndetur, sepse në një mënyrë po përpiqet që të instalojë rregulla të qarta, të funksionimit demokratik të institucioneve të Kosovës, qoftë në mënyrën si po i trajton obligimet e veta formale, qoftë në mënyrën se si po i detyron ministrat që të rrinë këtu në seancë, të dëgjojnë kritika, sepse jam shumë i sigurt që shumë prej tyre nuk do të kishin qenë këtu tërë kohen me ne. Diku në fillim të marsit ky Kuvend, e pati një testim demokratik, ashtu u quajt aso kohe edhe ndodhi ndërrimi në dy pozicione kryesore ose në dy nga pozicionet kryesore të institucioneve tona. U ndërrua kryetari i Kuvendit, edhe u ndërrua kryetari i Qeverisë.

Sot pas 100 ditësh ne mund ta bëjmë njëjar mënyre një bilanc të punës, qoftë njëjtë institucion, qoftë tjetrit institucion, edhe pse nuk e kemi temë punën e Kuvendit, po megjithatë më duhet ta përgëzoj zotin Kolë Berisha, por mirë që nuk është këtu, për punën edhe për kushtimin që ta ndryshojë atmosferën, që ta ndryshojë frymën e punës në Kuvend. Ku Kuvend së paku në periudhën që unë jam në të, nuk ka qenë më i bashkuar në aspektin e funksionimit të tij, kurrë nuk kemi vërejtur ndarje partiake, më pakë se sa gjatë kohës që zoti Kolë Berisha është në krye. Rastin më të freskët e kemi përplasjen e djeshme, një mikro-përplasje e cila po ashtu me vullnetin e zotit Kolë Berisha, u tejkalua në mënyrën më të mirë të mundshme, për hir të Kuvendit dhe për hir të institucioneve tona të Kosovës. Mendoj se, kjo mënyrë e punës shpresoj shumë, që do të jetë parim i tij, deri sa të je në krye të këtij Kuvendi, edhe të pasardhësve tij që të përpiqemi që Kuvendin ta bëjë me të vërtetë Kuvend, dhe që deputetët të kenë mundësi që të shprehen, me të gjitha çështjet që ata e mendojnë edhe pikërisht, duke i respektuar normat dhe rregullat e punës, të cilat i kemi ofruar bashkërisht me pajtueshmëri maksimale. Në rend të ditës pra është Qeveria dhe më duhet të them këtu menjëherë, që zoti Kryeministër, Agim Çeku e ka përmirësuar imazhin e Qeverisë së Kosovës, këtë duhet ta konstatoj.

Imazhi i Qeverisë së Kosovës është i përmirësuar dukshëm, dhe atë është i përmirësuar pikërisht për arsye se zoti Agim Çeku është një politikan serioz, i cili përpiqet që fjalën e vetë ta thotë me peshë, dhe mos të ndodhë tij, që një deklaratë të dhënë drekë, ta mohon në darkë. Pra përveç një gafit të vogël politik, me rastin e nënshkrimit të një ligji, aksidentalisht mendoj se veprimet tjera kanë qenë së paku në aspektin formal, kanë qenë veprime që atë i kanë bërë nderë kësaj Qeverie, dhe kur them kësaj Qeverie, e theksoj posaçërisht se, Qeveria është, të nderuar kolegë deputet është një ekip, dhe është organ kolektiv i udhëheqjes, Qeveria nuk është Agim Çeku, po është Agim Çeku është kryetar i kabinetit që përbëhet nga ministrat e tij, dhe ministrat e Agim Çekut nuk janë ministra të rinj, janë ministra të njëjtë, që i ka patë edhe zoti Bajram Kosumi, edhe zoti Ramush Haradinaj, dhe punën e tyre nuk mund ta mbyllim me 100 ditë. Fatkeqësisht nuk mund ta mbyllim, e kemi perceptimin e qytetarëve të Kosovës të vërtetuar në këtë 100 ditëshin e fundit, i cili çka është e vërteta, nuk është shumë i ndryshëm prej 100 ditëve të para. Kur thash se zoti Agim Çeku, e ka përmirësuar imazhin e Qeverisë së Kosovës, imazhi i Qeverisë së Kosovës shihet në Bruksel, shihet në Washington, po qytetarët e Kosovës i shohin rezultatet e Qeverisjes, ata rezultatet e qeverisjes i matin me kuletën e tyre, i matin me vendet e tyre të punës dhe fatkeqësisht duhet ta pranojmë që kjo Qeveri, as në këto 100 ditë, nuk ia ka dalë ta përmirësojë produktin qeverisës, që është kualiteti i përmirësuar i jetës së qytetarëve të Kosovës. Produkti qeverisës në Kosovë ka mbetë i njëjti, si në kohën e zotit Bajram Kosumi, si në kohën e zotit Agim Çeku, imazhi është diçka krejt tjetër, Qeveria e Kosovës mund të duket më e bukur, buzët më të kuqe mund t'i duken thash se përpara, mirëpo, produkti qeverisës i sajë mbetet vazhdimisht të le shumë për të dëshirua, i mangët. Si mund të përmirësohet ky produkt qeverisës, ky produkt qeverisës mund të përmirësohet, po qe se zoti Agim Çeku ja del ta imponoj, përveç autoritetit të vetë, në rend të parë, ja del ta marr një autorizim nga partitë politike që kanë formua koalicionin, edhe që autoritetin e vetë, të cilin e ka vendosë në këtë Qeveri, ta fillojë ta zbatojë edhe me ndëshkime.

Nuk mjafton të thuhet: p.sh. tek pasusi i luftës kundër korrupsionit, që është formua Këshilli i Agjencisë Anti-Korrupsion, i cili i ka miratua rregulloren e çka po di unë, është organizuar në punëtori, e cila i ka trajnuar zyrtarët për rreziqet nga korrupsioni, e ku ta di unë, po duhet të hyhet në analiza të vërteta reale, ka apo nuk ka korrupsion në Qeveri të Kosovës dhe siç e dimë ne, para ca muajsh këtu në këtë foltore, kemi pasur problematike edhe një ministri, e cila është thënë që ka bërë me para të ministrisë çka ka dashtë, dhe unë atëherë pata thënë që për derisa ai ministër është i pakicave, do të shërbej si model që t'i kalojnë krizat të gjithë ministrat tjerë, pastaj se ai sigurisht nuk do të preket. Realisht nuk po ngjet, fushata ndaj këtij ministri u ndal, dhe në një far mënyre gjithë ministrat tani janë në një qetësi absolute, se askush nuk i prek më.

Nuk mundën raportet e auditimit të cilat sillen, për punën e institucioneve tona të bëhen çështje e prokurorisë, para se të bëhen çështje e përgjegjësisë politike. Askund në botë nuk mund të qëndroj kjo, duhet, më së pari të qëndron përgjegjësia politike e tek më pastaj vjen përgjegjësia ligjore, nuk mundet (Qeveria ligjore), përgjegjësia ligjore t'i paraprijë përgjegjësisë politike. Përgjegjësia politike gjithmonë ka përparësi, po qe se fillojmë rend të përmendim ministrat e këtij kabineti, do të shohim që pak nga aga janë të përkushtuar për përgjegjësinë që kanë marrë përsipër, pak nga ta janë për mos të thënë asnjë nga ata, sepse kemi disa të ri që akoma nuk i dinë mirë detyrat e punës, nuk janë në një nivelin e përgjegjësive, të cilat shkojnë bashkë me emrin ministër. Këtu me një kolegë deputet i koalicionit Qeveritar, pak më parë bisedonim më hollë, pse në hollë deputetët shprehen më lirshëm se sa në foltore fatkeqësisht, e i cili më tha se edhe me lënë Qeverinë e Kosovës dy muaj pa ministra funksionon në të njëjtin ritëm, në të njëjtën mënyrë, pa asnjë problem, siç funksionon edhe me ministra, pse sepse ministrat realisht, efekti i dorës së ministrave, nuk vërehet në punën e Qeverisë, edhe zyrtarët e ministrive e kryejnë punën e ministrave pa asnjë problem.

Seanca e punës së ministrave nuk është shtimi i problemeve, diskutimi i problemeve, dhënia e ideve, që të gjedhen problemet, aso në këtë Qeveri fatkeqësisht nuk ka, prandaj zoti Agim Çeku me përgjegjësinë e vetë, nuk munda ta kompensojë këtë mungesë. Po e nisim radhazi, prej ministrit për Ekonomi dhe financa, zotit Haki Shatri, i cili është ministër i një sektori shumë të rëndësishëm, sektorin i cili ka të bëjë me mbushjen e buxhetit të Kosovës, dhe ne të gjithë jemi absolutisht të bindur që në Kosovë ka edhe vazhdon fuqishëm fiskal, në Kosovë ka arbitraritet në mënyrën e ushtrimit të detyrës së AQF-së zoti ministër.

Bizneset tona ngarkohen në mënyrë arbitrare nga kontrollorët. Kemi me qindra miliona para të pa inkasuara nga dënimet që i kanë shqiptuar agjentëve të huaj të AQF-së në kontroll dhe detyra arbitrare, bëjnë analiza si të ju teket, dhe sipas atyre analizave që ata i bëjnë siç u teket, e ngarkojnë biznesin me taksa. Nuk e them se biznesi është lule, dhe i biznesi i shfrytëzon hapësirat që ia lejon ligji, po duhet gjithsesi të shkohet dhe të operohet me ligj. Ne nuk jemi të sotshëm në këtë, para këtij pushteti në këtë vend, ka ushtruar një pushtet i cili ka qenë i dhunshëm, po përkundër dhunës që ka pas, edhe përkundër të gjitha të këqijave që ka pas, ata normë e kanë pasur aktin, letrën, shkresën, nuk kanë hy në fantazira. Pavarësisht që ka qenë pushtet i instaluar dhunshëm. Nuk kanë hy në fantazira, në nënshkrimin e njerëzve, po përkundrazi, e kanë pas shkresën dhe në shkresë, janë mundua ti gjejnë gabimet.

AQF-ja jonë është AQF, e cila shih ëndrra natën dhe i zbaton në mëngjes. Ministri për Tregti dhe industri zoti Dugolli, mund t'i thuhet lirisht ministri për licencimin me tregti dhe industri. Nuk është ky ministër për tregti dhe industri. Është zoti ministër licenca. Në Kosovën pa licencë e kemi një ministër që ekziston licenca. Dhe a e dini pse? licenca është reket zonja dhe zotërinj Reket, qiti kaq pare e merr licencën, s'i qet kaq pare nuk e ke licencën. Po është fjalë e thënë nga njerëzit që kanë pasur përvojën, janë rrëfye si deputet. Ministri për energji dhe miniera, zoti Ethem Çeku, u dhanë gjithë ato para për .(ndërhyrje -

KRYESUESI - NAIM MALOKU:

ju faleminderit zoti deputet) fjalën e ka deputeti Mazllum Kumnova, përgatitet deputetja Teuta Sahatqia.

DEPUTETI - MAZLLUM KUMNOVA:

Zoti kryesues, kryeministër, ministra, kur ju shohë kështu përballë komplet, duke debatuar për punën e juaj, besoni se e ndiej vetën shumë mirë. Për mua tregues nuk do të jetë se kryeministri a ka rrëzua ndonjë ministër, as recitimet optimiste, e as sa faqe ka raporti, as programet zgjedhore. Unë mendoj se diskutime për këtë raport të Qeverisë, për 100 ditët e para, është një formalitet, që ndoshta këtë kohë mund ta shfrytëzonim për çështje tjera. Por përkundër sajë, le ta diskutojmë edhe pse në disa interpelanca, sidomos në scancat e fundit, është shpalosur puna e Qeverisë, në këtë mandat, në disa aspekte. Së pari duhet pranua se Qeveria e ka arritur të ruajnë një vazhdimësi, të bëjë një dinamizëm të kërkuar në realizimin e standardeve, ka bashkëveprua me grupe nogociuese dhe ka bërë përpjekje më këmbëngulëse për krijimin e besimit të minoriteteve, sidomos atij serb edhe pse ky i fundit nuk është mërzi të fort për këtë angazhim, bile ka fishkëlluar dhe ka sharë. Mirëpo, në situatë çfarë ndodhet Kosova, ky prioritet i imponuar, për dimensione të angazhimit të Qeverisë, mjaftë është sforcuar dhe ka reflektuar pa mjaftueshëm në angazhime tjera, sidomos në zhvillimin ekonomik, në transferimin ose marrjen e kompetencave nga UNMIK-u, dhe shqetësime tjera të qytetarëve shumicë të Kosovës, pra pak kanë lëvizur, pse jo edhe hartimi, dhe miratimi i dokumenteve strategjik afatmësëm dhe afatgjatë, përveç për energji, miniera, planifikim hapësinor mjedis, nisma për strategjinë e zhvillimit ekonomik të arsimit e të tjera, që kanë shënuar një sukses të mirë. Jo pse nuk ka qenë vullnet i kabinetit Çeku, të punohet edhe në prioritete tjera, por fuqia e situatës politike ia ka imponuar një prioritet tjetër, të merret më tepër me pakica, mirëpo në këtë raport, nuk shohë dhe më shqetëson çështja, se sa jemi të përgatitur në ofertat tona për fazën pas shpalljes së pavarësisë. Kërkimi i donacioneve, kredive, dhe mbështetjeve tjera financiare, është një veprim i domosdoshëm, ndërsa përgatitja e projekteve të tilla, për një fazë që së shpejti duhet të ndodhë, është një dimension tjetër i zgjidhjes së problemeve aktuale.

Duhet pranuar angazhimet e Qeverisë në përgatitjen e projektligjeve, por edhe në këtë çështje, unë kamë shpresuar më tepër sidomos, një analizë se sa janë pranuar, të zbatueshëm ligjet e miratuara. Kjo çështje kuptohet i takon edhe Kuvendit. Ne kemi miratuar ligje për mbrojtje të mjedisit të ujërave të mbetura, mbeturinave, në mbrojtje të

pyjeve të tokës bujqësore, e të tjera, por në praktikë degradimet po vazhdojnë. Ka shenja inkurajuese në efikasitetin e administratës në përgjithësi ngritjes së përgjegjësisë, kompetencave, transparencës, uljen dhe vënien nën kontroll të shpenzimeve etj. çdo përpjekje për të kualifikuar, apo për të vlerësuar një Qeveri për 100 ditë, në rrethana çfarë kanë kushtëzuar suksesin, ose mos suksesin, nuk e di sa do të ishte reale. Krahas sajë ka vlerësime pozitive, dhe përkrahje nga bashkësia ndërkombëtare për punën e Qeverisë, e cila për procesin që gjendet Kosova është shumë domethënëse. Kështu vlerësimi i këtij raporti duhet vendosur në kontestin e kohës, dhe procesin që kalojmë, dhe ajo çfarë na pret të përballemi. Në rrethana tjera, vlerësimi me siguri do të ishte pak më ndryshe. Mendoj se, diskutimi duhet orientuar kah inkurajimi i Qeverisë dhe jo kah abuzimi, këtë të dytën mund ta bëjmë kur të duam ose me të drejtë, kur jemi të bindur se një veprim i tillë është për të mirën e përgjithshme. Kështu, apo për-afërsisht në këtë qasje do të diskutoja edhe sikur ne, në debatin e sotëm do të kishim raportin e 100 ditëshit të kabinetit të qeverisjes së mirë.

Përfundimisht, për situatën që ndodhemi Qeverisa si pjesë e procesit, e ka bërë punën e sajë, ka qenë në funksion të këtij procesi.
Ju faleminderit!

KRYESUESEI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zoti deputet! Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqia, përgatitet deputeti Zef Morina.

DEPUTETJA – TEUTA SAHATQIA:

Ju faleminderit zoti kryesues!

I nderuari zoti kryeministër, ministra të nderuar, kolegë deputet, sa i përket raportit të Qeverisë dhe 100 ditëve të Kryeministrit Çeku.

Më kujtohet dita kur është bërë zgjedhja e Qeverisë, dhe e kryeministrit. Atë ditë e kisha një dilemë, e kisha një dilemë a jemi mirë a duhet të votojmë për, apo nuk duhet të votojmë për këtë Qeveri. Të gjithë e dinim se Qeveria është ajo e njëjta, ndryshimi i vetëm ishte Ju, zoti Kryeministër. Duke pas parasysh respektin që e gëzoni dhe duke pas parasysh personalitetin e Juaj, e kisha atë dilemë, edhe sot pas 100 ditëve po e shoh se përsëri mendimi ka qenë, vendimi ynë ka qenë në rregull. Përkundër atyre mendimeve që kryeministri i ri, do të ketë kompetenca më të mëdha, do të ketë kompetenca që të kërkojë punë prej ministrave, që të kërkojë përgjegjësi dhe t'i ndëshkojë, apo t'i shpërblejë ministrat të cilët i kryejnë, gjegjësisht të cilët nuk e kryejnë punën, deri më sot nuk patëm rastin të shohim diçka prej asaj. Gjatë fjalimit të Juaj, ju përmendët krijimin e institutit sizmologjik. Unë ju përgëzoj për këtë, sepse çdo institut në Kosovë do të jetë, është një fitore e re për Kosovën. Por zoti kryeministër dëshiroj të ju përkujtoj, gjë e cila edhe u përmend na kolegu im i grupit parlamentar, që institutet dhe ato organizma të cilët i kryejnë punën e instituteve do të duhet të ju kushtohet një rëndësi e veçantë. Në këtë rast po e përmendi Institutin e metrologjisë, Institutin të cilin edhe me ligjin, të cilin e punoj edhe i ripërpunoj, e shqyrtoj, Komisioni për Tregti dhe Industri, i epet një rëndësi, fatkeqësisht, nuk e di sa jini në ngjarje, po punëtorët e institutit dhe pajisjet prej institutit,

janë bartë me polici dhe janë bartë në Prishtinë. Me këtë shihet që, një institut i cili 60 vjet ka funksionuar, vitin e ardhshëm ndoshta nuk do të ekzistojë më. Në atë kohë ky institut sizmologjik do të jetë 1. vjeçar. Mendoj që, ky nuk do të duhej të kishte qenë një gjë e cila do të mbetet si mos-sukses gjatë këtyre ditëve të Qeverisë së Juaj, por kjo do të mbetet dhe do të mbahet mend si një degradim maksimal, i një instituti i punëtorëve të cilët kanë punua aty, që mbas 60 vjetëve ky institut do të shuhet në kohën e Qeverisjes së Juaj.

Gjithashtu sa i përket privatizimit, edhe para jush, menjëherë pas luftime, kanë kalua shumë ministra, shumë kryeministra, por çështja e privatizimit në Gjakovë mbeti aty ku është, dhe për çështjen e privatizimit, edhe gjatë këtyre 100 ditëve, nuk ka ndodhë asgjë e re. Gjakova vazhdon të mbijetojë, vazhdon të kalojë, një papunësi tepër të madhe dhe një kohë jashtëzakonisht të vështirë, për qytetin, për shkak të këtyre shoqërive aksionare dhe për shkak të ekonomisë së degraduar deri në maksimum, e cila as gjatë qeverisjes së juaj nuk u përmirësua aspak. Ju e dini që janë dy kompani, është, dy kompani për të cilat qind për qind, është vërtetua në AKM, në Ministri, që i plotësojnë të gjitha kushtet, për t'u miratua statusi i tyre, sepse me ligje jo-diskriminuese, me vendimet e gjykatave, statusi i tyre është pranua. Ndërsa gjendja aktuale për të cilën shumë parafolësit e mijë folën, ajo cila shihet te njerëzit, te qytetarët tonë, te xhepi i tyre, te vendet e punës së tyre, nuk ka kurrfarë përmirësimi. Në qoftë se flasim për sundimin e ligjit, atëherë, a është ky sundimi i ligjit? A është kjo mosrespektim i të gjitha këtyre vendimeve, a mund të llogariten si sukses në standardin nr. 1. në standardin e sundimit të ligjit.

Gjithashtu do të isha qenë shumë e çuditur që, në AKM zoti Ryker edhe të tjerët, të cilët vijnë prej vendeve demokratike në të cilat sundimi i ligjit as që diskutohet, si mund të anashkalojnë këtë dhe të vazhdojnë me këtë anashkalim maksimal, të sundimit të ligjit. Sa i përket biznesit evazioni fiskal fatkeqësisht vazhdon, edhe sot edhe nesër, gjithashtu vazhdon edhe mos-stimulimi i kompanive vendore, si në pjesëmarrje në tender, si në eksport, si në mbrojtje të tyre prej importeve dhe prej evazioneve tjera kjo vazhdon. Kjo është arsyeja pse buxheti zvogëlohet çdo vit. Kjo është arsyeja pse rritet numri i të pa punëve, kjo është arsyeja pse nuk mund të mbijetojnë firmat tona dhe të vazhdojnë ta rrisin buxhetin, ta rrisin punësimin, edhe ta nxisin atë zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Për të pa gjeturit folën parafolësit e mijë, mendoj që edhe kjo është një varrë, e cila nuk po vazhdon, fatkeqësisht në Mendare, me datën 30 crdhën mbetjet e fundit mortore, por kjo nuk do të thotë që, kjo punë ka mbarua dhe për këtë punë do të duhej një angazhim më i madh, dhe një zgjidhje më e madhe, një zgjidhje më fatlume për familjarët e këtyre të zhdukurve.

Në qoftë se flasim për suksesin e këtyre 100 ditëve, mendoj që sukcesi i vetëm i këtyre 100 ditëve, jeni Ju, zoti Kryeministër, sjellja e koalicionit, sjellja e juaj, nga partnerët e koalicionit, për të mund që mbas jush të mbrohet kjo Qeveri e shumë qindra ditëve.
Ju faleminderit!

KRYESUESEI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zonja deputete! Fjalën e ka deputeti Zef Morina, ju njoftoj se deputeti Ymer Halimi e dorëzon fjalën e tij me shkrim. Ju faleminderit!
Deputeti Zef Morina fjalën përgatitet deputetja Flora Brovina.

DEPUTETI – ZEF MORINA:

Ju faleminderit zoti kryesues, i nderuari zoti kryeministër, të nderuar ministra, zonja dhe zotërinj deputet, raporti 100 ditësh i Qeverisë, mund të vlerësohet pozitiv, edhe pse është gjithëpërfshirës, bazuar në programin e Qeverisë. Më lejoni të paraqes disa vërejtje, të cilat besoj se do të ndihmojnë në përmirësimin e punës së Qeverisë në të ardhmen. Nuk e kamë të qartë, përse mungon gatishmëria e Qeverisë për marrjen e kompetencave nga UNMIK-u, në raport mungon një analizë e Qeverisë, për gjetjen e arsyes së keqësimit të situatës ekonomike, të qytetarëve të Kosovës e cila dita ditës po bëhet më e pa durueshme.

Shumë pak rëndësi, i është dhënë përmirësimit të kushteve të agrobiznesit, kur dihet që pjesa dërmuese e qytetarëve të Kosovës merret me këtë lëmi, infrastruktura rrugore, ajo hekurudhore dhe telekomunikacioni, nuk janë në një gjendje të kënaqshme, gjë që dukshëm po ndikon, dhe po vështirëson jetën e qytetarëve të Kosovës. Ekzistojnë shumë projekte prioritare në Ministrinë e Transportit, por, po i paraqes disa më kryesore, për të cilat në raport nuk janë përfshi. Projekti nacional i autostradës Prishtinë – Durrës, gjegjësisht Merdare – Vërmnicë, ideator i së cilës ishte presidenti i ndjerë dr. Ibrahim Rugova, është përmendur vetëm shkel e shko, nuk e kamë të qartë, ku është arsyeja, që një projekt i cili do të ndikonte dukshëm në zhvillimin ekonomik të vendit, të anashkalohet dhe vetëm të përmendet si punë e kësaj Qeverie.

Dëshiroj të pyes Qeverinë, a është e njoftuar Qeveria dhe Ministria, për pjesën e kësaj rruge në territorin e Shqipërisë, dhe e çfarë kategorie është duke u ndërtuar ajo pjesë e rrugës. Pasi që kjo është një segment i cili segment do të ishte shumë e nevojshme të jetë e një kategorie. Sa jam unë në dijeni, pjesa e rrugës në territorin e Shqipërisë, nuk do të jetë me parametra të kategorisë së autostradës, por thjeshtë, si magjistralë, gjë që do të ndikojnë negativisht dhe do të pamundësoj ndërtimin e pjesës në territorin e Kosovës.

Në qershor të vitit 2002, në takimin që kishim në konferencën pikërisht për këtë rrugë në Tiranë, Qeveria e Shqipërisë, e udhëhequr nga zoti Majko, ishte pajtuar me Qeverinë e Kosovës, që kjo rrugë, kurdo që të ndërtohet duhet të jetë e të njëjtës kategori. Pra të jetë autostradë dhe assesi mos të ndërtohet në parametra të ndryshëm, sepse do të ishte e pa vlefshme, qoftë për ne, qoftë edhe për vetë Shqipërinë. Po bëhen dy vite që janë bërë përgatitjet për ndërtimin dhe shndërrimin e aeroportit të Gjakovës, nga ai ushtarak, në atë civil, ndërsa Ministria e ka eliminuar nga prioriteti, me arsyetimin se është kompetencë e rezervuar. Mund të them që të gjitha përgatitjet janë bërë në vitin 2004, bashkë me shtyllën e IV, dhe AKM-në, që Aeroporti i Prishtinës, nga projekti i cili është, ekziston, të shndërrohet në aeroport civil, si aeroport alternativ, duke pas parasysh kushtet klimatike në Kosovë, sidomos gjatë vjeshtës dhe dimrit, që qytetarët të mos jenë të detyruar të

udhëtojnë qoftë në Shkup, besa edhe të kthehen mbrapsht, kur nuk kanë mundësi të aterojnë në Prishtinë. Gjendja në sektorin e telekomunikacionit është në kaos, ekzistojnë shumë operator pirat të cilët janë duke vepruar në Kosovë, dhe duke e dëmtuar buxhetin e Kosovës, në raport nuk tregohet që çfarë hapa janë marrë, për largimin e këtyre kompanive ilegale.

Nuk është thënë se kur do të kemi operatorin e dytë legal të telefonisë mobile, të cilin qytetarët janë duke e pritur me padurim. Këtu po e shoh që me 8 dhe 9, qershor të vitit 2006, është nënshkruar marrëveshja e SETO-s, në Luksemburg. Ndoshta nëse është gabuar data, se kjo marrëveshje është nënshkrua 11. qershor të vitit 2004. Nuk është dhënë në raport asnjë fjalë për hekurudhat e Kosovës, edhe pse kjo është rezervuar, por Qeveria ka obligim që të shikoj gjendjen e hekurudhave, të cilat çdo ditë e më tepër janë duke u shkatërruar. Besoj se, vërejtjet e bëra nga deputetët do të ndikojnë që, raporti gjashtë mujor i Qeverisë të jetë shumë më pozitiv.

Ju faleminderit.

KRYESUESEI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Flora Brovina, të përgatitet deputeti Xhelal Canziba.

DEPUTETJA – FLORA BROVINA:

I nderuari Kryeministër, i nderuari kryesues, ministra, kolegë dhe kolege, edhe pse në opozitë Partia demokratike, edhe unë personalisht, jam shumë e interesuar për një sukses të madh të Qeverisë së Kosovës, njësoj sikur edhe partitë e koalicionit qeverisës. Kur ju zoti Kryeministër erdhët në krye të Qeverisë së Kosovës, Qeveri të shumë kritikuar, e cila dhe shkaktoi, kjo kritikë shkaktoi ndërrimet, për mua ishte befasia më e madhe, se ju murrët postin, e timonin udhëheqës, por asnjë ndryshim qeveritar atje edhe u votuat me shumicë votash pa prezantuar një program konkret.

Sot është vështirë të vlerësojmë punën tuaj, dhe mbasi nuk kemi pasur asnjë premtim, por nuk është vështirë të konstatojmë se, gjatë këtyre 100 ditëve të udhëheqjes suaj, gjegjësisht 500 ditëve të kabinetit tuaj, kemi stagnime, kemi rënie, kemi keqësim të gjendjes në disa sektore. Në raport gjërat duken më bukur, ato shprehim dëshirën tonë dhe jo realitetin. Realiteti është ndryshe, do të veçoja këtu sidomos dy lëmi, lëmin e shëndetësisë, dhe atë të mbrojtjes sociale. Raporti i Juaj, në këto dy lëmi është shumë formal dhe i cekët, lëvdohen mandej ministrinë për nxjerrjen e,- për formimin e një Komisioni, p.sh. për dhënien e licencave, ose diçka e ngjashme, që nuk mund të jetë një sukses, ajo është punë e përditshme e ministrisë, dhe e punëtorëve aty. Nuk flet asgjë por kamuflon situatën, në këto dy lëmi.

Gjendja është e keqe në shëndetësi dhe me këtë nënkuptoj, menaxhimin e dobët dhe të gabuar, në këtë lëmi, nënkuptoj mungesën e barërave dhe mjeteve sanitare, nënkuptoj menaxhimin e dobët të resurseve njerëzore, ju e dini se shumë mjek që kanë tituj dhe specializime janë në rrugë. A neve kemi nevojë për kadro të tilla në reparte të ndryshme.

Ministria e shëndetësisë nuk kontrollon tërë territorin e Kosovës, nuk e kontrollon, as ligjet nuk funksionojnë në tërë territorin e Kosovës, e kamë fjalën për enklava dhe Mitrovicën, madje as Komisioni jonë nuk ka pasë mundësi që të vizitojë këto dy qendra, këto institucione shëndetësore. Me një fjalë ligji themelor i shëndetësisë nuk funksionon dhe nuk zbatohet tërësisht. Në veçanti do të ndalem për gjendjen në mbrojtjen sociale, që është gjithashtu shumë e rëndë, veçmas për disa kategori të qytetarëve. Shkalla e varfërisë po shtohet, dhe po shtohet edhe pakënaqësia. Ju, personalisht Ju, para disa kohësh u tallët me këtë kategori, me kategorinë më të rëndësishme të qytetarëve, me veteranët e luftës, invalidët e luftës, me familjet e dëshmorëve, por publikisht nënshkruat, edhe pse se kishit ligjin për luftën, e për veteranët e luftës, d.m.th. vërtetë ju kërkuat falje për këtë lojë, por gjendja e rëndë e tyre po vazhdon, po vritet edhe ndërgjegjja jonë, dhe kujtoj edhe e juaja, që udhëhiqni Qeverinë dhe e ministrave tuaj. Kjo ndërgjegje duhet të jetë e zgjuar. Në raport flitni për mbrojtjen e fëmijëve të Kosovës, e veçmas të fëmijëve bonjak. Ju nuk e cekët veçmas mbrojtjen e fëmijëve bonjak të luftës, e të cilët janë në gjendjen më të rëndë. disa nga ata madje nuk kanë mundësi as të shkollohen, edhe pse ekziston ligji për shkollimin e obliguar dhe të garantuar të tyre, nuk kamë fakte, dhe mund të dëshmoj çdo herë dhe kur Ju të doni.

Në ditën kur fëmijët bonjak të Kosovës deshën të shpallin, dhe e shpallën 20 majin ditën e fëmijëve bonjak të Kosovës, ju ishit të ftuar, kujtoj që ata deshën të ju respektojnë që të merrni pjesë dhe kjo ditë të shënohet nën patronatin tuaj, Ju as nuk erdhët, as nuk i përshëndetët, dhe e quaj një gabim tuajin në këtë aspekt.

Ju folët për paraqet memoriale, por harruat se, ekziston një projekt i parkut memorial të Reçakut, një legjendë e jona reale pra, që e meriton një kujdesje institucionale tuajën, kujtoj që duhet ta veni edhe këtë në agjendën tuaj. Çka bërë dhe cili është rezultati i zyrës për personat e zhdukur. Në zbatimin e Rezolutës së aprovuar para sa vitesh në këtë Kuvend, në mandatin e kaluar në këtë Kuvend, çka ka bërë Qeveria e Juaj, që të merr kompetencat e zyrës se personat e zhdukur të UNMIK-ut, mbasi që është formuar Ministria e Drejtësisë. Çka ka bërë Qeveria e Juaj, që të ngritët niveli i bisedimeve teknike për personave të zhdukur në një nivel çfarë e meriton kjo çështje, kujtoj që duhet bërë më shumë. Kamë pritur nga Ju zoti Agim Çeku, kryeministër, se do të bëni më shumë dhe do të keni një sens më të mirë për shfrytëzimin e kapaciteteve profesionale dhe politike edhe të gjinisë femërore. Ju propozuat dy ministra, dhe disa zëvendësministra të gjithë meshkuj. Me këtë keqësuar pozitën e gruas në vendim – marrje dhe në udhëheqje. Megjithatë në raportin e juaj, Ju u thirrët në sukseset që keni arritur në barazinë gjinore, nuk e di çka keni menduar me këtë, dhe kujtoj se nëse ju keni parasysh, planin aksional për veprim, atëherë duhet ta dini, dhe të jeni të informuar se, ky plan ka qenë i përgatitur, në mandatin e kaluar nga gratë politikane, të partive politike dhe organizatat jo-qeveritare, dhe i është dorëzuar kryeministrit Bajram Rexhepi. Ndërsa, sa i përket ligjit për barazi gjinore, gjithashtu është shkruar dhe përpiluar nga Komisioni për barazi gjinore, në mandatin e kaluar, dhe që të dy këto dokumente, ligji dhe dokumenti, nuk zbatohet si duhet.

Zoti Kryeministër, Ju thatë vetë se, kushtet dhe rrethanat të cilat vepruat janë shumë të vështira, kjo është e saktë, por Ju patët rastin, pikërisht ju patët rastin, që t'i përmirësoni

këto kushte dhe të korigjoni këtë Qeveri, që ti përmirësoni pra këto rrethana, Ju këtë nuk e bëjë, prandaj vërtetë e keni vështirë, keni po atë Qeveri dhe po merren mbi vete këto mos-suksese. Nëse Ju këto mos-suksese i quani suksese mendoj se, keni pasur kërkesa të vogla për qeverisjen e Kosovës
Ju faleminderit!

KRYESUESEI-NAIM MAOKU:

Ju faleminderit, deputeti Xhelal Canziba, e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Nimon Alimusaj.

DEPUTETI - XHELAL CANZIBA:

Ju faleminderit i nderuari kryesues, i nderuar kryeministër, ministra dhe ju kolegë deputetë!

Gradualisht për të gjithë është duke bërë qartë se pavarësia në Kosovë nuk do të zgjidhë problemet ekzistuese, ekonomike e sociale. Për më tepër pas zgjidhjes së statusit, ku edhe masat e gjëra të popullatës do të binden, se pavarësia nuk e sjell, automatikisht edhe mirëqenien. Ato do të fillojnë të shfaqin pakënaqësitë e tyre, për nivelin e larat të papunësisë e të varfërisë. Për gjendjen e vështirë sociale dhe mungesën e perspektivave për të rinjtë. Kjo gjë rrjedhimisht krijon një refleks negativ, në gjendjen e përgjithshme të sigurisë. E kaluara dëshmon se një Kosovë jostabile, është njëherësh edhe gjenerator jo-stabiliteti për region. Kjo megjithatë nuk përkon me dëshirën e askujt, e as të popullatës Kosovare, as të faktorit ndërkombëtar. Që Kosova të gjenerojë stabilitet të mendshëm e të jashtëm, e pse jo dhe të marrë rrolin e siguresës së regjionale, të sajë dhe popullit të saj, duhet një perspektivë e qartë integruese në bashkësinë Evropiane. Para që gjithash, një terapi e menjëhershme dhe e fuqishme për luftimin e problemeve ekonomiko-sociale, si pjesë e vendimeve përfundimtare, të procesit shtet-formues. Problemet aktuale të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, bazohen në vështirësitë financiare, si pasojë e kushteve të vështira kredituese. Dihet se ku do në botë ndërmarrje të vogla dhe të mesme janë bazë e zhvillimit të ekonomisë së një vendi. Ato i përshtaten shumë më lehtë ndryshimit, të jashtëm dhe paraqesin bazën kryesore të targa-mbledhjes. Andaj zhvillimi i tyre duhet të ndihmohet përmes ofrimit të kredive të buta nga institucionet ndërkombëtare, përmes sistemit bankar Kosovar, si dhe përmes transferimit të dijeve dhe teknologjisë nga vendet e BE-së.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë ato që do të barten në barrën e zhvillimit dhe të sektorit privat bujqësor, dhe në lidhje të ngushtë me të edhe të industrisë ushqimore. Përpos kësaj ndërmarrje të vogla dhe të mesme, do të jenë ato që do të ofrojnë edhe punësimin e të rinjve, dhe njëherësh do të absorbojnë masat e gjëra të papunëve, duke iu ofruar atyre perspektiva të reja. Në këtë aspekt rëndësia e veçantë duhet të kushtohet zhvillimit të bujqësisë, fillimisht duke ngritur kapacitetet prodhuese për përmbushjen e nevojave të brendshme dhe duke zëvendësuar eksportet.

Vlerësohet se sektori i bujqësisë mund të punësojë deri në 150 mijë njerëz, që janë hiq më pak se gjysma e të papunëve, të regjistruar në Kosovë. Domosdoshmëria e fillimit të

përmirësimin të gjendjes ekonomike, duket se është reduktuar në nevojën e përmbushjes së standardit për ekonomi, i cili më pas, bashkë me pavarësinë si një shkop magjik, do të zgjidhë të gjitha problemet ekonomike, sociale të Kosovës. Realiteti megjithatë është pak më ndryshe.

Së pari zhvillimi i mirëfilltë ekonomik nuk ka qenë kur në rend të ditës, as për UNMIK-un, as për Qeverinë e shkuar, as për këtë të sotmen.

Së dyti për hallet e qytetarit të thjeshtë nuk është i interesuar askush në instancë të udhëheqësit të vendit. As udhëheqësit të institucioneve as njerëzit përreth tyre, nuk kanë dalë jashtë zyrave të tyre, për të parë se ç'po ngjet për rreth, e në çfarë vështirësisë përballet qytetari i thjeshtë. Kosova është vendi me shkallën më të ulët të investimeve të huaja, direkt në Evropë, dhe ndoshta në mbarë botën. Rrjedhimisht pa investime nuk ka as transferim të dijes e teknologjisë moderne. Nuk ka kapital të freskët, vende të reja të punës, e prodhim vendor, përkundër ekzistimit të një legjislacioni relativisht stimules, edhe angazhimeve sporadike të UNMIK-ut, dhe institucioneve të Kosovës, për të bërë diç më shumë në ndryshimin e kësaj gjendje alarmante, Kosova ende mbetet larg shijimit të përparësive që sjellin investimet e huaja. Udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, përmendi çështjen e statusit si pengesë për investitorët e huaj, por kjo nuk është e vetmja pengesë. Arsytet për mungesë të investimeve janë shumë më komplekse. Që të zbutet gjendja e rëndë ekonomike – sociale, përfshirë këtu gjendjen edhe në industri, bujqësi, e në sektorin e shërbimeve, e që të krijohen kapacitete prodhuese, të hapen vende të reja të punës, e të sigurohet kapitali i freskët, nevojiten investime të huajve. Që të ketë investime të huajve, duhet bërë stimulimi i organizuar e sistematik i ndërmarrësve të huaj, mu nga këto vende që sot janë duke pushtuar tregjet e Evropës lindore.

Për të investuar në Kosovë, informimi i mirëfilltë për sektorë më tërheqë për investime, dhe paraqitja sa më e denjë e përparësive të investimit në Kosovë. Përmes një marketingu profesional të zhvillohen në vende perëndimore, është një rrugë që, e sigurt e tërheqjes së investitorëve të huaj. Vetëm nxjerrja e ligjeve nga ana e Kuvendit pa implementime, dhe aplikim në praktikë, nuk është e mjaftueshme. As deklaratë ishte për gatishmërinë institucionale, për të përkrahë iniciativën që, këto drejtime nuk mjaftojnë. Angazhimi i sinqertë serioz dhe profesional i përfaqësuesve të institucioneve dhe veprat e tyre konkrete, mund të dëshmojnë përkushtimin që kanë, për zhvillimin ekonomik të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI - NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Nimon Alimusaj, përgatitet deputetja Hatixhe Hoxha

DEPUTETI – NIMON ALIMUSAJ:

Ju faleminderit zoti kryesues, i respektuari zoti kryeministër, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë!

100 ditë më parë, me rastin e inaugurimit të tij për kryeministër, zoti Çeku dha disa premtime, të cilat nuk ishin as të tepruara, as të pa arritshme, dhe bëri mirë që bëri kështu, sepse me të drejtë thuhet se dy gjëra janë të pa ndara nga të pavërtetat. Premtimi i tepërt dhe arsyetimi i tepërt. Menjëherë duhet të konstatoj se nuk qëllon, nuk qëndron konstatimi i disa parafolësve të mijë, se këtë dokument që pas 100 ditësh Qeveria e prezantoi me hiq më pak se 90 faqe, është vetëm një dokument për shkrues, përkundrazi, ky dokument është plotë e për-plotë fakte dhe i dokumentuar mirë, dhe fakte që janë sjellë këtu, mu më kanë bindë të konstatoj se Qeveria për këtë 100 ditësh ishte jo vetëm e suksesshme por mjaftë e suksesshme.

Është krejt e natyrshme që optika e opozitës, çdo herë e shikon rrejshëm suksesin e qeverisjes së pozitës, dhe kjo është e mirë për derisa ka synim të zbulojë dhe të s'madhoj dobësinë me kusht që ta shtyjë Qeverinë përpara, por kur ajo mohon çdo gjë, komplet çdo gjë, dhe e sheh për sukses vetëm se një ministër paska prej Qeverisë në shtëpinë e vetë me veturë private, të vogël private, kjo bëhet e dëmshme, jo vetëm për Qeverinë për edhe për Kosovën në përgjithësi, dhe këtë dua ta argumentoj me dy konstatime: ne duke mohuar çdo gjë, çdo punë në udhëheqjen e Qeverisë, synon të nxjerr konstatimin para faktorit ndërkombëtar se, kësaj Kosove nuk mund ti jepet besimi për një qeverisje, se po ndërton tri qeveri krejtësisht të pa vlefshme, dhe nuk mund të qeverisë vetë veten, dhe e dyta, duke mohuar edhe ato synimet dhe arritjet Qeverisë, për standardet, nxjerr imazhin se Kosova nuk është e përgatitur t'i respektoj ato kushte që i ka shtrua para saj faktori ndërkombëtar lidhur me standardet.

U akuzua Qeveria për këtë dokument se nuk na qenka autor i këtij dokumenti dhe kjo për mua është çështje më qesharake që kamë mund ta dëgjoj gjatë seance.

U akuzua Qeveria se nuk paska përmend asnjë pengesë që e ka pasur në këtë qeverisje 100 ditësh. Unë dua të sjell një pengesë që është kalua me shumë sukses, nga sfera e arsimit, anëtari i komisionit i së cilës jam. Në njërin nga seancat e këtij Kuvendi para pak ditësh, e kishim temë debati universitetin e Prishtinës. Atë botë nga shumë diskutues dhe nga materialet që i patëm përpara nga një grup ekspertësh vendor dhe të huaj, u konstatua se atje nuk kishte ligjshmëri të plotë, dhe në mungesë të kësaj aty kishte pa rregullsi nga më të ndryshmet, dhe aty asgjë nuk mund të mbaheshin me vjet të tëra. Ministria konsideroi si prioritet kthimin e ligjshmërisë së plotë, në Universitetin e Prishtinës, dhe organizimin e zgjedhjeve të reja të përgjithshme, çka opozita kundërshtoj fuqishëm dhe këtë e arriti për vetëm 30 ditë dhe kështu zgjedhjet kaluan fort mirë, për herë të parë pa influenca politike. Ishte një pengesë fort e madhe, bash e kësaj opozite, pikërisht në këtë Kuvend po kjo u arrit.

Janë arritur shumë rezultate që këtu u mohua tërësisht dhe u kërkuan dorëheqje nga ministri i arsimit, dhe në sferën e arsimit dhe disa nga to i përmendi zoti Yagcilar, të cilat janë të një rëndësie të veçantë, për momentin në të cilin ndodhet Kosova. Një punë e tillë e zgjedh se udhëheqjeve nëpër shkolla, do të duhej të bëhej edhe në shkollat fillore, e të mesme, po për çudinë më të madhe, sigurisht e keni parë të gjithë në shtyp, me ndonjë komunë siç është Malisheva, udhëheqë opozita, pengohet jo vetëm me shpalljen e këtij konkursi po te disa konkurse rreth, rresht për zgjidhjen e drejtorëve dhe atje nuk ju

mundësohet Ministrisë të zbatohet ligji. Janë këto elemente edhe shumë të tjera që tregojnë se ka pasur pengesa Qeveria po i ka kalua, se duhet t'i kalojë. Një ndër objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës, vazhdon të mbetet padyshim, përmbushja e standardeve, Ministria e kulturës mendoj se ka bërë një punë të madhe në këtë sferë, dhe këtu u diskutua me qeshje, jo kisha romake, jo xhamia turke, etj. kjo ishte e papërgjegjshme. Përveç një mohimi total të çdo gjëje të punës së Qeverisë, mua më qon peshë për të keq edhe ndonjë element tjetër nga disa diskutime.

Bashkë me mohimin përdoren fjalë e shprehje jo fortë të hijshme që nuk i bëjnë nder këtij Kuvendi. Për një parlament të një shteti fqinjë ku pati këso gjërash, këso shprehjesh, një jashtë më patë dhënë se të qon përshtypjen e një tubimi kalamajsh. Nuk është mirë t'i japim shkas që, me shprehje që nuk durohen, ky parlament që është për lavdi në krejt rajonin, të marrë ndonjë kahe jo të pëlqyeshme. Do ta përmbyllë atje ku fillova, dy gjëra janë të lidhura me të pavërtetën, premtimi i tepërt dhe arsyetimi i tepërt dhe Qeveria nuk ka nevojë të merret fortë me arsyetime, po i dëshiroj punë të mirë të mëtejshme dhe të suksesshme.

Ju faleminderit!

KRYESUESI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zoti deputet, deputetja Hatixhe Hoxha e ka fjalën, të përgatitet deputeti Mark Krasniqi. – Ius deputetët që nuk janë në sallë të kthehen, për shkak se zoti Mark Krasniqi është i fundit, i lajmëruar për fjalë, për debat dhe ne duhet të vendosim për rrjedhën e sencës, pauzën e pastaj vazhdimin e seancës e pikat tjera.

DEPUTETJA-HATIXHE HOXHA:

Zoti kryesues, të nderuar kolegë deputet, në raportin që na është dërguar nga Qeveria jam munduar të ndalem te Ministria e transportit dhe post-telekomunikacionit dhe të përqendrohem në fushat që mbulon kjo Ministri. Po të lexohet me kujdes ka raport fitohet përshtypja se çdo gjë në këtë ministri po të realizohet ashtu siç është më së miri, mirëpo gjendja faktike nuk është e tillë. P.sh. vetëm po te ndalemi te infrastruktura rrugore do të shohim që të paktët janë rrugët të cilat nuk janë të dëmtuara dhe të cilat paraqesin shumë vështirësi në komunikacion, si për sigurinë e qytetarëve, ashtu edhe shkaktojnë dëme të mëdha materiale, në raportin 100 ditësh te pjesa e ministrisë së transportit dhe post telekomunikacionit, në fillim të tij, flitet për efikasitetin e kësaj Ministrie, në sanimin dhe hapjen e rrugës Prishtinë – Hani i Elezit. Mirëpo asgjë nuk thuhet për faktin se, kjo arterie me shumë rëndësi që lidhë Kosovën me jashtë, për muaj ishte me mbyllur dhe ministria e juaj zoti Ahmeti, nuk arriti me kohë të menaxhonte situatën dhe të sanonte sa më shpejtë gjendjen. Do të dëshiroja vetëm të kujtojë se bllokimi i kësaj rruge, i kushtoj shtrenjtë ekonomisë edhe ashtu të brishtë të Kosovës. Humbjet nga bllokimi i rrugës janë llogaritur në 3.4 milion €. Në gjendje të mjerueshme është veçmas infrastruktura hekurudhore, në raportin e Komisionit evropian të vitit të kaluar thuhet se sektori i hekurudhave ka nevojë për investime të konsiderueshme dhe se revitalizimi i sajë është ende në fazë kritike. Edhe gjatë këtij 100 ditëshi të kësaj Qeverie, asgjë nuk është bërë në përmirësimin sadopak të këtij segmenti me rëndësi.

Kjo shkallë jo e kënaqshme e zhvillimit të infrastrukturës rrugore, e veçmas e asaj hekurudhore po na kushton shtrenjtë për faktin që kur mund të përfitojmë nga lidhjet me transportin rajonal dhe atë trans-evropjan. Kosova ka mbetur jashtë planeve për lidhjen e vendeve të Ballkanit me Evropën, përmes korridoreve rrugore E-8 dhe E-10, sepse asnjëri nga këto korridore nuk do të kalojë nëpër Kosovë.

Ministrin Ahmeti e pyes edhe për një çështje, sepse është prishur në mënyrë të njëanshme marrëveshja në institutin e inxhinierisë mekanike, i cili deri më tani ka bërë atestimin e automjeteve pa treguar as.. të Qeverisë në AKM. Institucion ky që është përgjegjës për administrimin e ndërmarrjeve publike, heshtin. Derisa ngjarjet në lëmin e telekomunikacionit po zhvillohen në anarki të plotë. Ministria që drejtoni ju zotëri Ahmeti, nuk shprehi asnjëherë shqetësimin e qytetarëve të Kosovës, për zhvillimet e fundit në aeroportin e Prishtinës, apo në PTK. Zakonisht duke u thirrur në atë se a janë kompetenca të rezervuara. Dëshiroj të theksoj se edhe gjatë këtij 100 ditëshi nuk është pamundësuar operimi i lirshëm, i operatorëve e pa licencuar që edhe më tej vazhdojnë të përdorin në hapësirën e Kosovës, për përfitime të mëdha. Pa asnjë detyrim nga vendit tonë, duke pasur parasysh faktin se ata nuk derdhin asnjë cent në buxhetin e Kosovës. Është thënë se administrata tatimore e Kosovës, po bënë një far llogaritje, për kohën sa Mopteli është duke operuar në Kosovë, e kanë hapur një dosje për këtë. Por deri më tani, ata nuk kanë dhënë asnjë informacion të vetëm, se cila është gjendja reale e borxheve të këtij operatori ndaj ATK-së.

Zoti ministër Ahmeti edhe gjatë kësaj periudhe vazhdon të funksionoj bordi i ART-së, vetëm me 4 anëtar. Dhe ju nuk keni ndërmarrë asgjë për të emëruar anëtarin e 5-të. Përse? Ndërsa sa i përket PTK-së, mbasi mjaftojnë vetëm informacionet e fundit, në masmediat tona, ku flitet aq shumë për fshirjen e tatimit e me këtë jepen shifra marramendëse. Zoti kryeministër Çeku, si e shpjegoni faktin e këshilltari i juaj për çështje të telekomunikacionit është drejtor menaxhues i PTK-së, a nuk mendoni se këtu kemi të bëjmë me konflikt interesash.

Dëshiroj të ndalem dhe të çështja e privatizimit. Sipas disa të dhënave, AKM-ja deri tash ka privatizuar 250 ndërmarrje shoqërore në Kosovë. E prej tyre vetëm 15 ndërmarrje, kanë marrë 20% i cili u takon punëtorëve. Për mos përmbushjen e obligimeve që dalin nga kontrata, ka reaguar edhe bashkimi i sindikatave të pavarura të Kosovës, si dhe komuniteti i biznesit. Dëshiroj tija përkujtoj me këtë rast ministrit Dugolli, se edhe gjatë këtij 100 ditëshi, nuk u përmirësua asgjë nga shqetësimi që patëm ngritur në një seancë për vatin e ndërmarrjes "Ballkan" të Therandës. AKM-ja dhe ndërmarrja e privatizuar "Ballkan" e Therandës nuk kanë përmbushur obligimet me kontratë, punëtorët nuk kanë marrë 20% nga fondi i privatizimit. Edhe pse ju patët premtuar se, do të përcillni me vëmendje të shtuar, gjendjen në këtë ndërmarrje dhe në ndërmarrjet e tjera të privatizuara.

Ju faleminderit!

KRYESUESI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, deputeti Mark Krasniqi e ka fjalën,

DEPUTETI- MARK KRASNIQI:

Ju faleminderit zoti kryesues, i nderuar kryeministër, ministra dhe deputet, dihet se çdo Qeveri kritikohet nga opozita, por kur konstatohen mangësitë ose keqpërdorimi i tyre, atëherë duhet të kemi të gjithë opozitë. Ta luftojmë personin, jo Qeverinë an-blllok. Qeveria përbëhet prej njerëzve, përbëhet prej shumë njerëzve, prandaj Qeveria, nuk ma merr mendja si kolektiv mund të gabojë, edhe me qëllim mund të gabojë, prandaj çdo njeri e ka emrin e mbiemrin e vetë, e në qoftë se ai ka bërë një gjë, duhet të kritikohet, ati ti thuhet emri dhe mbiemri. Kjo sidomos kur të vijë rasti i korrupsionit, i gjërave tjera, si u përmenden atje e këtu. Qeveria është si një familje e madhe e jona patriarkale, ku i zoti i shtëpisë është përgjegjës, për çdo gjë. Kështu është edhe një far analogjie me Qeverinë, kryeministri është ai që përgjigjet për veprimet dhe për Qeverinë në tërësi. Mirëpo, nuk është kryeministri fajtor gjithmonë në qoftë se ministri ose disa ministra nuk i kryejnë punët e tyre. Sigurisht se ai duhet të marrë masa kundër tyre, por jo edhe kërkohet tash si u bë disa raste këtu edhe dorëheqja prej tij, sepse janë disa gabime që mund të përmirësohen, disa mund të falen, edhe disa tjera duhet të ndëshkohen. Unë desha të them se për 100 ditë, nuk mund të bëhet kushedi ndonjë punë aq e madhe, sidomos jo në kushtet e tona. Ta kishim ne Qeverinë shtetin në realitet, të konsoliduar që sa vjet ose shekuj, punët do ti kishim ndryshe, sigurisht edhe sot do të kishim këso vërejtjesh, edhe këtë diskutim kaq të gjatë. Mirëpo gjithmonë për çdo veprim, duhet parlamenti të merret parasysh koha, edhe kushtet në të cilat është krijuar ai veprim.

Qeveria ka bërë një punë shumë të madhe, për këto 100 ditë, edhe unë vetëm mund përuroj gjithë ata ministra të cilët e kanë kuptuar, që sot janë shumë hapat e fundit, ku duhet pasur shumë përgjegjësi, secili, jo vetëm ministri po edhe njerëzit që janë në pozita shumë më të vogla, po kanë disa punë që duhet t'i kryejnë në favor të shtetit. Unë me këtë rast desha të them se, nuk është vetëm Qeveria gjithmonë për disa gjëra fajtoare, jemi fajtor edhe ne, ne këtu në parlament, të cilët i bëmë, si i bëmë këto ligje, të cilat duhet të jetë të arsyeshme, duhet të jenë të aplikueshme, duhet të jenë gjithmonë në favor edhe në shërbim të Qeverisë, edhe të popullit dhe të shtetit në përgjithësi. Me këtë rast desha të them se kaluan 100 ditë, atë ditë po kalojnë shumë shpejt, sidomos kur janë punë, kur ka punë shumë, dhe këto ditë kanë kalua sigurisht me vështirësi shumë të mëdha, kjo punë, se ne çdo gjë, për çdo gjë i drejtohem financave, ministrit të financave, ai boll i vogël është këtu, po ka shumë telashe të mëdha me ne edhe me vetë-veten, sepse buxheti i Kosovës e dimë çfarë është.

Kaluan 100 ditë, edhe është bërë një punë e madhe në të gjitha fushat, por shumë gjëra kanë mbet pa u krye. Mirëpo, ne i kemi edhe 255 ditë përpara, edhe Qeveria do t'i shfrytëzoj sigurisht me të gjitha fuqitë që, këto 255 ditë të jenë të suksesshme e t'i kryejmë punët si duhet, kështu që mbas 255 ditëve ta kemi një seancë më gazmore, të themi më me shumë lavdata, e më me pakë ... Unë edhe këtë desha ta shtoj, do të ishte shumë e nevojshme, sipas mendimit tim, që një raport të tillë, që u dha sot këtu nga Kryeministri, të jep edhe Komisioni negociues i cili po përgatit, po negocion për fatin e Kosovës. Kjo është shumë ma me rëndësi, se sa a u krye një detyrë e një ministri apo jo, në këtë fazë të punës për formimin e shtetit. Tash negociohet për, dikush e përmendi këtu, për standarde po se po, e kemi të gjithë obligim, por edhe decentralizimi është shumë i

ndjeshëm, nëpërmes decentralizimit Serbia po përzihet në pavarësinë e Kosovës, decentralizimi me enklava etnike serbe, ose me kisha të cilat kërkojnë ta kenë territorin e vet, eksterritorial, d.m.th. shtet në shtet, ajo nuk është kurrfarë pavarësie. Ato kisha i kemi ruajt 500 vjet, do t'i ruajmë edhe tash e mbas, pa kurrfarë territoresh eksterritoriale. Unë me kaq kisha përfundua duke i urua kryeministrit, edhe gjithë ministrave punë të mbarë, dhe mbas 255 ditësh mirupafshim.

Ju faleminderit!

KRYESUESI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit zoti deputet, ju njoftoj se Ymer Halimi fjalën e tij e dorëzoi me shkrim:

I nderuar kryetar Berisha,

I nderuar kryeministër dhe ministra, të
nderuar deputetë

Nga 'Raporti 100 ditësh', do ta quaja i Qeverisë Çeku, mund të nxjerrim edhe vlerësime për punën e Qeverisë për këtë kohë. Vërtet vlerësimet mund të janë të ndryshme vareshmërisht nga shkalla dhe qasja e krahasimit dhe kjo është e natyrshme.

Mendoj po të ishte i shkruar në me pak faqe do të ishte me thëlbësor, do të pasqyronte profesionalizëm dhe kishte për të dhënë një imazh me të mirë për ministrinë.

Kjo mund të vërehej edhe nga fjala e kryeministrit Çeku.

Qeveritë e pasluftës në Kosovë, të dala nga vota e lire, në rrafshin e veprimeve të veta ngatërruan konceptin e platëformës politike për pavarësinë e Kosovës dhe qeverisjen administrative shtetërore. Vërtet këto koncepte kanë një interaksion por kanë edhe kufi ndarës. Ky koncept i pa qjartë vështirësoi qeverisjen aq me pare kur dihet mos përvoja e jonë. Në këto 100 ditë kjo ky koncept-i përzierjës me pak ndodhi.

Deputetë të nderuar, "gjërat tona na gëzojnë nëse nuk krahasohemi me te tjeret". Kësaj radhe të tjerët krahasojnë dhe vlerësojnë punën tone dhe Qeverisë Çeku. Ky është një vlersim pozitiv që vjen nga Bashkësia Ndërkombëtare dhe është shumë domethënëse.

Me gjithatë, ky është vlersim politik dhe duhet ta kemi të qartë të gjithë.

Në këtë periudhë 100 ditëshe është një konkluzion i pashmangshëm, besoj për të gjithë: *është trendi i një qeverisje relaksuese që të gjithë e kemi shpresuar dhe prekur*. Në këtë fazë do të thoja se proceset qeverisëse kanë marrë kahun e një veprimi të mbar. Kjo për procese shoqërore do të thotë shumë dhe është shpresëdhënëse.

Kryeministri Çeku, këtë te arritur e ka bërë me njohurin që ka një gjeneral i mirë, se vetëm veprimet janë ato që transformojnë një tërësi, siç ishte qeveria që e morri për ta udhëhequr. Kryeministri veproj në përmasën e ekuilibrit politik, por kjo i solli vështërsi. Për mua është fakt notar se disa veprime të qelluar mire të kryeministrit i janë te penalizuar në konstruksionin qeveritar, prandaj i ulën prestigjin që realisht Kryeministri mund ta kishte. Por, disa dikastier ministrore, që kishin në brendi ca

procese jo edhe të mira, ato tashmë shihen si të ngrira apo me mire me thënë janë në tkurrje e sipër.

Deputetë të nderuar, ne për here të pare, nga të gjithë kryeministrat që patëm, nga kryeministri Çeku dëgjuam një vizion të veprimit zhvillimor 3E, luftën kundër korupsionit dhe transparencën qeverisëse. Dhe mbi këto kryeministri po vepron.

E ja e energjetikës, e ka shiruar platformën e veprimit dhe në horizont po shihen veprime konkrete. Ndërsa sa i përket E-së se ekonomisë, të jemi të ndërgjegjshëm kjo nuk shtrihe në domenin e 100 ditëve. Vendosja e ligjëshmerisë në UP është një arritje e rëndësishme për shkollimin superior.

Në këtë periudhë 100 ditëshë, Kryeministri Çeku ngriti auditime me shumë se në tërë periudhën e qeverisjes së pasluftes. Por, veprimi i prokurorisë del si i ngathtë.

Në raport shihet një ulje e shpenzimeve në digastier ministrore që është një sinjal se institucionet po hyjnë në vijën e përgjegjësisë.

Në këtë raport të Qeverisë do të duhej të ishte një çik kritikë në funksionim e pushtetit lokal, i cili në disa fusha nuk është në nivelin e duhur. Shumë ligje, nga ministratë përkatëse nuk janë shoqëruar me urdhëresa administrative të mjaftueshme që pushteti loka të funksionoj me mire. Kjo ka bërë që disa nga këto ligje të janë jo funksionale. Sigurisht kjo informatë i ka munguar Kryeministrit.

Qeveria, besoj, në bashkëpunim me Kuvendin e Kosovës duhet të jëtë me e vëmendëshme në rastin e prioriteteve të nxjerrjes së ligjeve, sepse kemi nxjerrë ligje që kanë mundësi aplikim vetëm pas disa vitesh, ndërsa ka nevojë për ligje që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e njerzëve dhe nuk kanë kosto të lartë e lehtë mund të zbatohen.

Psh. mungon ligji i punës që do të mbëronte mija të punsuar në sektorë privat që po shfrytëzohen gati edhe si skllëvër.

Pastaj, do të duhej që Qeveria t'u kushtojë vëmendje më të shtuar zonave rurale. Për këtë ekzistojnë dhjetra arsye.

Po ceku një paradoks. Ne tash jemi me të varfërit në Evropë, por paguajmë me çmimin më të lartë për telefonin, rrymën, ujin, taksën e borllogut se shumë në disa vende të tjerë në Evropë.

Me të drejtë mund të them se, ne, sot konsumojmë ushqimin jo të sigurtë në cilësi, të cilën na e servojnë ca matrapaze. Mjafton ta keni një bukë në dorë dhe lehtë e vërtetoni.

Inspeksioneve të disa resoreve të pushtetit lokal dhe ministrive duhet ngritur shkallën e përgjegjësisë.

Këto 100 ditë qeverisjeje kishin një dinamik që premtojë për një qeverisje të mire në vazhdim.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI – NAIM MALOKU:

Nëse dëshiron mund të marrë fjalën .E ka fjalën kryeministri Agim Çeku. Urdhëroni,

DEPUTETI – AGIM ÇEKU:

I nderuari kryesues, të nderuar deputet, të nderuar ministra, duam fillimisht që ta falënderoj Kryesinë e Kuvendit, ju deputet që e vendosët këtë pikë të rendit të ditës, dhe që organizuat këtë debat, debat të cilin e vlerësoi se ka qenë shumë konstruktiv dhe ka qenë korrekt. Ka pasur vlerësime të mira për punën e Qeverisë, ka pasur edhe vërejtje e sugjerime shumë konstruktive, dhe të vlefshme për punën e Qeverisë, në të ardhmen. Ne kemi qenë dhe jemi, dhe kemi qenë të vetëdijshëm për punën tonë. Jemi të vetëdijshëm që në këtë debat, kur e kanë kërkuar që të dalim para parlamentit, kemi qenë të vetëdijshëm se nuk do të dëgjojmë vetëm lavada për punën tonë, po do të dëgjojmë edhe kritika, do të dëgjojmë edhe sugjerime. Këtë e kemi deshtë dhe e kemi pritë, dhe këtë e morëm nga ky parlament. Është ky një vlerësim i drejtë që iu ka bërë Qeverisë së Kosovës dhe është ky një gjë e mirë që e ka prurë, Qeverinë e Kosovës në pozitë që para parlamentit, para qytetarëve, të japë llogari për punën e vetë. Më duhet të them që pati konstatime të paqëndrueshme, dhe pati edhe shumë pyetje të cilat me shumë vëmendje i kamë shënua, dhe të gjitha do t'i marrim në konsideratë. Por është fat i mirë që parlamenti me punën e vetë, ka vendosur që çdo seancë të ketë pyetje, përgjigje, jam kah anoj që të gjitha pyetjet tu konfirmoj gatishmërinë time Qeverisë, që të përgjigjet në të gjitha këto pyetje. Por edhe ne ministrat do ta kemi rastin që t'i mohojnë disa konstatime që nuk kanë qenë, nuk përkojnë me realitetin.

Unë e kisha përmend këtu një konstatim që assesi nuk kamë dashur ta imponoj këtu që Qeveria ka marrë pronësinë, apo e përvetëson disa punë të përbashkëta. Unë në faqen e parë të paraqitjes sime thashë se, këto rezultate, në fakt janë të arriturat tona të përbashkëta, dhe kështu konsideroj, sidomos kur ke çështja të statusi, unë e thashë shumë qartë që, Qeveria e Kosovës ka kontribuar në procesin e statusit. Jo Qeveria e Kosovës e ka udhëhequr apo ka pretendua që ta marrë pronësinë mbi procesin e statusit. Duam si përfundim, mos ta zgjasë, t'ju falënderoj për vëmendjen edhe një herë t'i falënderoj për kontributin, dhe si përfundim që unë e kisha nxjerrë është që ky debat edhe një herë e konfirmoj atë që e kemi thënë në fillim, që puna e Qeverisë në këto 100 ditët e para ka qenë e suksesshme por gjithashtu, ka identifikua edhe shumë fusha, shumë veprime, që Qeveria duhet t'i marrë në të ardhmen. Këto sugjerime të juaja do t'i kemi në konsideratë, e falënderoj zotin Mark që na i dha 250 ditë, kjo është një dhuratë shumë e madhe,

Ju faleminderit!

✶ KRYESUESI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, konstatoj se me këtë debati për pikën e tetë të rendit të ditës, do të thotë debati për raportin 100 ditësh të Qeverisë mori fund. Mbetet vazhdimi i seancës, unë propozoi që një gjysmë ore pauzë e pastaj të vazhdojmë me seancën, kemi kërkuar.

Unë lus të vendosim për seancën, kryeministri me ministrat janë të lirë, ne vazhdojmë me punën, unë ju falënderoj zoti kryeministër, falënderoj ministrat, për prezencën tuaj dhe për gatishmërinë që të jeni në dispozicion të Parlamentit.

Unë lus shefat e grupeve parlamentare që merren vesh për rrjedhën e mëtejshme, kemi dhe dy pika të rendit të ditës, d.m.th. pika 9 dhe 11.

DEPUTETI – JAKUP KRASNIQI:

Ju faleminderit kryesues, ne biseduam me shefin e grupit të lidhjes demokratike dhe jemi të mendimit që seanca të vazhdojë të hënën në orën 10.

KRYESUESI – NAIM MALOKU:

Ju faleminderit, seanca vazhdon të hënën në orën 10. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Vazhdojmë punën e Seancës Plenare, me një sqarim se kryetari i Kuvendit është në takim të grupit negociator

Unë propozoj që si pikë e parë e rendit të ditës për sot, të jetë pika e 11 e rendit të ditës.

11. Shqyrtimi i rekomandimit të kandidatëve për drejtor të Agjencionit Kosovar të Antikorrupsionit.

Paraprakisht para se të hyjmë në sallë, me dy shefa të grupeve parlamentar të LDK-së dhe të PDK-së u morëm vesh dhe u dakorduam, në qoftë se nuk ka vërejtje në këtë dakordim, a pajtoheni që të fillojmë me pikën e 11 të rendit të ditës. Kush është për: shumica absolute, faleminderit, a ka kundër që kërkojnë që të jetë pika e 9 e para, një është kundër, ju faleminderit. Prezent janë, për momentin, 76 deputetë. Para se të kalojmë me shqyrtimin e pikës së 11 të rendit të ditës për fjalë janë paraqitur 2 deputetë. Xhevat Bislimi e ka fjalën. Urdhëroni.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryesues, unë e kam pritë që sot do ta kryesojë këtë seancë kryetari, por meqë nuk është këtu, unë do të shprehë një vërejtje timen, edhe njëherit edhe protestë për anëtarët e Kryesisë që vijnë nga pozita që mos ta shfrytëzojnë karrigen e kryetarit për t'i vlerësuar diskutimet e deputetëve, për të dhënë nota, se nuk janë mësues të katundit, por le ta ruajnë atë pozitë që kanë. Kur duan me marrë fjalën le të dalin poshtë, le ta marrin fjalën dhe le të thonë çka kanë për të thënë, se unë nuk flasë as për qefin e Naimit, as atij tjetrit. Flasë atë që unë dua të flasë. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ta dëgjojmë edhe deputetin Sabit Rrahmanin, dhe pastaj do të merrni përgjigje.

DEPUTETI SABIT RAHMANI – Nuk flasë në emrin tim personal, flasë në emrin e Grupit Parlamentar për Integrim. Grupi Parlamentar për Integrim është i interesuar të dijë, cilat janë arsyet pse nuk janë konsultuar gjithë shefat e grupeve parlamentare.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit, zoti Sabit. Unë e qita prapë në votim marrëveshjen dhe nuk pat kundër, Ju keni mundur në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, edhe grupet tjera parlamentare pra kanë mundur me dhënë vërejtje apo sugjerime. Mendoj se proceduralisht ne e filluam sot rendin e ditës, që do të thotë me pikën e 11 të rendit të ditës. Sa i përket ndërhyrjes së deputetit Xhevat Bislimi, unë muaj me e shfrytëzua foltoren atje, pasi që po kërkon që mos të shfrytëzojë foltoren e kryetarit.

Debati për 100 ditshin e qeverisë ishte ashtu si ishte. Më lejoni ti drejtohem edhe Xhevat Bislimit, edhe opozitës, që një vit e gjysmë prej që është instaluar sistemi pozitë opozitë në këtë Kuvend të Kosovës, më kot mundoheni që të instaloni në këtë Kuvend, do të thotë zhargonin e rrugëve, zhargonin me fyerje, sharje dhe të pa vërteta. Ne nuk jemi partner për një zhargon të tillë, pra jemi partner për rivalitet në paraqitje të programeve, vizioneve, jemi partner për dialog konstruktiv, por jo me atë qysh po tentoni. Kjo është përgjigjia ime Xhevat. Ju e keni keqpërdorë foltoren e Kuvendit, ju e keni keqpërdorë atë ditë do të thotë, ne mundemi me shikua edhe transkriptin, pra ju e keni keqpërdorë, ua kam lejua 15 minuta kohë, pesë minuta kohë shtesë, dhe kjo është ajo. Nazim Jashari e ka fjalën

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Ju faleminderit z. kryesues. Edhe unë jam për replikë. Meqenëse kryesuesi Naim Maloku aktualisht foli në cilësinë e deputetit dhe e futi me një thes opozitën për të gjitha fyerjet, ose fjalët e rrugës, siç tha ai. Kisha dashur që z. Naim Maloku herave tjera të jetë më i prerë, dhe më i qartë në kënd mendon. Nuk është e mundur që opozita këtu ka ardhur për të përdorë fjalë të rrugës, dhe për të fyer, dhe për të denigruar njerëz. Opozita këtu përpiket që të flasë në emër të grupit parlamentar ORA, përpiket që në mënyrë sa më konstruktive dhe me vërejtje sa më konstruktive, të përmirësojë cilësinë e ushtrimit të pushtetit nga ana e Qeverisë. Pra, ti fusësh të gjithë me një thes, edhe atëherë kur nuk ke të drejtë, mendoj se është krejtësisht jo parimore dhe jo korrekte nga ana e juaj.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Deputet. Xhevat Bislimi e ka një minutë.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Zotëri, e para punë këtu, askush nuk ka dëgjuar as një sharje as një fyerje për askënd. Prandaj, kërkoj që t'i kërkoj falje opozitës ose ta lëshosh atë vend, sepse unë e di se nuk është faji te ti, është faji te shkolla që ke bërë, por përpiku ta reformosh veten dhe mos shpif, mos akuzo, mos u merr me gjëra që nuk të takojnë me u marrë. Unë kërkoj që të kërkoj falje, kërkoj edhe nga grupi ynë që të insistojë që t'i me kërkuar falje dhe deri atëherë nuk vazhdon seanca për mua.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Deputet. Jakup Krasniqi e ka fjalën

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryesues, unë si shef i Grupit Parlamentar të PDK-së, partisë më të madhe opozitare, protestoj ndaj diskutimit tuaj, për faktin se ju duhet ta argumentoni dhe ta thoni, cilat kanë qenë fyerjet, shpifjet, dhe fjalët e rrugaçëve që e ka përdorur opozita në Parlament. Ju nuk e thatë as edhe një fjalë të vetëm për të

argumentuar për atë që e thatë. Nëse mendoni që opozita duhet ta ketë rolin për të mbështetë keq qeverisjen dhe keq drejtimin që bëjnë institucionet e Kosovës, gaboni. Opozita është për të kërkuar qeverisje më të mirë, për të kërkuar drejtim më të mirë të institucioneve, dhe ju nëse kërkesat tona për të qeverisur ma mirë, për të drejtuar institucionet më mirë, i quani fjalë të rrugëve, këto fjalë do të jenë të përditshme në Kuvendin e Kosovës brenda dhe jashtë tij. Prandaj, kisha dëshiruar që vërtetë ta kuptoni në thellësinë e saj demokracinë, nuk ka demokraci pa opozitë, mendoj që këtë që nuk keni arritur ta kuptoni deri më tani është mirë ta mësoni.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Deputet. Hydajet Hyseni e ka fjalën.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Të nderuar deputetë, nuk e prisja këtë nisëm të punës së sotme të Kuvendit, nuk prisja që do të ndjehem i fyer që në fillim të seancës, dhe më besoni sinqerisht jam edhe i fyer edhe i befasuar, e tepruat z. Maloku. Ishte një vërejtje që mund të kalojë fare lehtë pa asnjë kundërshtim. Nëse ju e hapni debatin, do të na jepni mundësinë që tash të flasim. Ka deputetë që kanë diskutuar në mbledhjen e kaluar dhe ka që nuk kanë diskutuar fare. Unë skam diskutuar fare. Me çfarë të drejte tash të futemi gjithë në një thes, kurse edhe ata që kanë diskutuar nuk kanë dhënë në asnjë rast pretext për kualifikime, diskualifikime e fyerje tjera.

Z. kryeministër në fjalën e tij të mbylljes, e vlerësoj debatin si të përgjegjshëm, konstruktiv dhe të dobishë. Me ç'të drejt tash ju i jepni një ton krejt tjetër. Z. kryesues ju duhet të keni burminë dhe t'i kërkonti falje gjithë Kuvendit, dhe veçanërisht opozitës për atë gaf. Ndodhin, mund të jenë efektive, por megjithatë besoj që është e patolerueshme, dhe mendoj në kuptim të plotë edhe me rregullat tona të procedurës edhe me praktikën tona parlamentare.

Ju jeni të ulur në atë vend, për të moderuar, për të përmbajtur Kuvendin, jo për të ndezur, jo për të hedhur hidrogjen. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Hydajet. Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – I nderuari z. kryesues, ministër, deputetë të nderuar.

Unë besoj se të gjithë jemi këtu për rendin e ditës, më lejoni t'ju tërhiq vëmendjen se rregulla 22.7 thotë se diskutimi lidhur me rendin e ditës nuk zgjatë më shumë se dy minuta. Prandaj z. kryesues ju lus që ta vazhdojmë punën. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Flora Brovina e ka fjalën,

DEPUTETJA FLORA BROVINA – z. Maloku sot ju na ofendua., Kërkoj që të tërhiqeni nga kryesimi i mbledhjes dhe të vendoset dikush tjetër që sot ta udhëheqë mbledhjen. Ju faleminderit.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit zonja deputete. Nëse më lejoni që unë prapë si deputet, pra të kufizohem nga posti ose roli i kryesuesit, ashtu edhe ishte reagimi

im, por ishte si deputet, jo si kryesuesi i Kuvendit se ishte e drejtuar personalisht për mua kritika. Reagimi ishte si deputet i Kuvendit të Kosovës, jo si kryesues zonja Flora. Unë nuk fyej, as natyrën nuk e kam të tillë që të fyej dikën, ishte një reagim në fjalën e deputetit Xhevat Bislimi. Ishte replikë e imja në te, në reagimin e tij këtu. E ndjeva veten të detyruar të dalë para Kuvendit dhe të them se marrja e fjalës që ndodhi në rolin e kryesuesit herën e kaluar, që ia mora fjalën zotit deputet, pra ishte iniciuar nga fjala e tij. Nëse dikush e ka ndierë veten të fyer, unë vërtetë nuk e pata at qëllim, isha si deputet. Nëse dikush e ka ndier veten të fyer, nuk ishte ai qëllim nga deputeti Naim Maloku, jo nga kryesuesi, për atë edhe dola këtu.

Unë propozoj që të mbyllet ky deba. Ka pas fjalë të cilat kanë kërkuar reagime edhe nga pozita atë ditë, mundemi me marrë edhe transkriptin, pra nuk janë me qëllim, mendoj se as Grupi Parlamentar i AAK-së, ne e kemi shqyrtuar qëndrimin tonë edhe në pauzë të vazhdimit të seancës së të premtes, dhe nuk jemi lëshuar në debatet e tilla, unë lus pra si deputetë i këtij Kuvendi që të vazhdojë me rendin e ditës. Ju faleminderit.

Shkojmë me pikën e 11 të rendit të ditës dhe Hajredin Kuçi e ka fjalën.

DEPUTETI HAJREDIN KUÇI – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë, nuk e kam pas ndërmend me fol, edhe kjo rrjedhë e Kuvendit për mua është e pakuptimtë. Si do që të jetë dua t'ia kujtojë kryesuesit të këtij Kuvendi, se në grupin opozitar ka njerëz të cilët identifikohen me luftën për çlirimin e Kosovës, ka njerëz që identifikohen me dijen e Kosovës, ka njerëz që identifikohen me ardhmërinë e Kosovës dhe mendojmë deputetët janë të gjithë ata të cilët mendoj, janë përfaqësues të qytetarëve të Kosovës. Nëse ju e fitoni të drejtën ti quani ashtu, le të mbetet në ndërgjegjen dhe moralin tuaj. Por opozita nuk do të pranojë asnjëherë shabllonet e tilla, ndoshta ka pas të tillë në kabinetin qeveritar që kanë merituar fjalë të tilla, unë sua kam thënë asnjë herë, nëse dikush e ka thënë ka mundur të thotë si individ, si do që të jetë, unë mendova që do të kërkonte falje dhe duhet të kërkonte, së paku për hir të qytetarëve të atyre që kanë votuar për ne. Si do që të jetë Grupi Parlamentar i PDK-së nuk pranon të rri në seancë, ku ju do ta udhëhiqni, deri sa të kërkonte falje.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ramë Buja e ka fjalën.

DEPUTETI RAMË BUJA - Unë konsideroj që ato që u dash të thonë u thanë, por z. Naim fort haptë i ke dhënë kosës dhe po më vjen keq si koleg që jemi të Kryesisë, dhe po e përsëris nëse nuk kërkonte falje ne nuk kemi çka rimë se thjeshtë jemi ndier dhe ndihemi të fyer, se kemi merituar këtë, por, le të jetë në ndërgjegjen tënde.

KRYESUESI, NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. Ramë. Unë prapë më lejoni që të dal si deputet, se replika ishte, se kundër replika ishte kundër deputetit. Dëgjoni, unë e thashë, nëse më lejohet nga ky vend, por duke u kufizua nga roli i kryesuesit.

Të nderuar deputetë reagimi ishte thjeshtë personal, ishte si një deputetëi Kuvendit të Kosovës. E ndjeva veten të provokuar dhe reagova. Do të thotë, nuk kam pas për qëllim me fye kënd, nëse dikush e ka ndier veten të fyer, unë kërkoj falje personalisht si deputet

i Kuvendit të Kosovës. Besoj që në mënyrë të komunikimit që e kam pas deri më tani, do ta vazhdojë edhe në të ardhmen. Ishte një reagim në provokimin që e mora si të tillë nga deputeti në fjalë, por edhe nga fjalët, ndoshta të shumë deputetëve të tjerë në debatin e kaluar. Reagimi ishte thjeshtë si deputet i Kuvendit të Kosovës, jo si kryesues, ju mund të vendosni si të doni, mund të propozoni si të doni, në ju është që të vendosni, por unë propozoj që të kalojmë në rendin e ditës dhe të vazhdomë me seancën plenare. Ju faleminderit.

A mund të vazhdojmë z. Jakup Krasniqi, vazhdojmë me, Sabri Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Zotëri kryesues i seancës, në këtë rast po i drejtohem PDK, sepse megjithatë dialogu u bë me ta. Ky dialog që u bë sot në mes të kryesuesit të mbledhjes dhe Grupit Parlamentar të PDK-së, është njësoj si gjithë dialogjet që janë bërë në këtë seancë, as nuk është më i mirë as më i keq. Mirë që sot po tëhollohen kuptimet dhe është mirë që në Kuvendin e Kosovës më në fund të maten fjalët, formulimet dhe kuptimet, dhe në këtë vështrim unë e pranoj këtë mënyrë të bisedimit qysh ka ndodhur sot.

Unë dëgjova që kërkuan dhe insistuan me të madhe që të ndihet formulimi kërkim falje. Unë për vete sa dëgjoj mirë z. Maloku kërkoi falje dhe them që s'ka kurrfarë argumenti që të vazhdohet ma kjo mënyrë e bisedimit për këtë problem. Unë mendoj që është koha që të vazhdojmë punën sipas orarit. Ju faleminderit.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit, vazhdojmë 15 minuta pauzë.

Të nderuar deputetë vazhdojmë seancën. Deputeti Jakup Krasniqi e ka fjalën,

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryesues Grupi Parlamentar i PDK-së konsideron se kjo që ndodhi sot, nuk është dashur të ndodhë, e pranojmë si kërkim falje, ajo është si një gjysmë kërkimi falje, por e pranojmë si të plotë, kurse për drejtimin ose mos drejtimin e seancës vendosni ju z. kryesues.

KRYESUESI NAIM MALOKU – Ju faleminderit z. deputet. Unë lus të vazhdojmë me pikën e 11 të rendit të ditës, që është shqyrtimi i rekomandimit të kandidatëve për drejtor të Agjensionit Kosovar të Antikorrupsionit. Është pika e rendit të ditës me kërkesë të kryetarit të Kuvendit që për shkak të mungesës së tij prej 1 ore, kërkoi dhe luti që të shqyrtohet sot si pikë e parë e rendit të ditës. Konstatimet hyrëse, në pajtim me nenin 10.3 të Ligjit kundër korrupsionit, këshilli i Agjensionit Kosovar i Antikorrupsionit pas aplikimit të procedurës së konkursit i ka rekomanduar Kuvendit dy kandidatë të mundshëm për postin e drejtorit të agjensionit.

Kuvendi duhet të emëron njërin nga kandidatët e propozuar.
Kandidatë të rekomanduar janë:

1. Hasan Preteni dhe Ruzhdi Sefa, rekomandimi i këshillit të Agjensionit bashkë me biografite e kandidatëve u janë shpërndarë të gjithë deputetëve, Në pajtim me

rregullën 31.3 të Rregullores së punës, vendimmarrja në Kuvend kërkon shumicën e votave prej deputetëve të pranishëm.

Meqë mënyra e votimit nuk është definuar shprehimisht me Rregullore, e as me ligj, i propozohet Kuvendit që emërimi të bëhet me votim të fshehët.

Për mbarëvajtjen e votimit do të përkujdeset komisioni nga tre zyrtarë të departamentit ligjor, në monitorimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Ju lus deputetët të deklarohen a jemi që mënyra e votimi të bëhet me votim të fshehët. Kush është për: shumica, a ka dikush që kërkon mënyrë tjetër të votimit, jo nuk ka. Lus shefat e grupeve parlamentare që të caktojnë nga një vëzhgues i cili do të vëzhgon procesin e votimit dhe të numërimit të votave. Pra ndërkohë ju mund t'a emëroni nga një anëtar.

1. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së , Naim Jerliu
2. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Selvije Halimi
3. Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së Mazllum Kumnova,
4. Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, Sabit Rrahmani,
5. Në emër të Grupit Parlamentar ORA, deputeti Genc Gorani,
6. Në emër të Grupit Parlamentar 6+ deputetit Husnija Beshkoviç

Vazhdojmë me procesin e votimit. Të nderur deputetë në sallë janë prezentë 77 deputetë dhe mund të kalojmë në procesin e votimi. Më lejoni që t'i ftojë nga dy deputetë të cilët marrin fletëvotimet, votojnë dhe në këtë mënyrë kryhet procesi i votimit.

Në sallë janë 80 deputetë të pranishëm. Ju lutem:

1. Afrim Arzuallxhiu
2. Agim Krasniqi
3. Ali Sadriu
4. Alush Gashi
5. Bajram Kosumi
6. Bajram Rexhepi
7. Bajrush Xhemajli
8. Behxhet Brajshori
9. Berat Luzha
10. Besa Gaxheri
11. Bislim Hoti
12. Brikenda Kryeziu
13. Bujar Dugolli nuk është i pranishëm
14. Demir Lima nuk është i pranishëm
15. Dragisha Krstoviq nuk është
16. Drita Statovci nuk është
17. XHezair Murati
18. Emin Krasniqi
19. Emrush Xhemajli, mungon
20. Enver Hoxhaj, mungon
21. Et'hem Çeku, mungon

22. Fadil Gashi
23. Fadil Geci
24. Fadil Kryeziu,
25. Fatmir Rexhepi
26. Fatmire Mulhaxha - Kollçaku
27. Fehmi Mujota
28. Fehmi Vula
29. Ferid Agani
30. Fetah Berisha
31. Flora Brovina
32. Gani Geci
33. Gazmend Muhaxheri
34. Genc Gorani
35. Gojko Saviq, nuk është këtu
36. Goran Bogdanoviq, nuk është këtu
37. Gjergj Dedaj
38. Guylshen Berisha
39. Gjylnaze Syla
40. Hajredin Hyseni
41. Hajredin Kuçi
42. Hashim Thaqi, nuk është në sallë
43. Hatixhe Hoxha
44. Husnia Beshkoviç
45. Hydajet Hyseni – Kaloshi
46. Ibush Jonuzi
47. Ilaz Pireva
48. Ilmi Ahmeti
49. Jakup Krasniqi
50. Jonuz Kastrati, nuk është këtu
51. Jusuf Sutaj mungon
52. Kamber Kamberi
53. Kolë Berisha, mungon
54. Lulzim Zeneli
55. Lumnije Hyseni
56. Lutfi Zharku, mungon
57. Mahir Jakgjillar
58. Mark Krasniqi
59. Mazllom Kumnova
60. Melihate Tërnkolli
61. Milazim Haliti, nuk është këtu
62. Myrvete Dreshaj-Baliu
63. Nafije Berisha
64. Naim Jerliu
65. Naim Maloku, le të përgatiten Nait Hasani, nuk gjendet këtu
66. Naser Osmani nuk është
67. Naxhije Doçi

68. Nazim Jashari
69. Nekibe Kelmendi, mungon
70. Nerxhivane Dauti
71. Nexhat Daci, mungon
72. Nexhat Rexha
73. Nimon Alimusaj
74. Numan Baliq
75. Nuran Malta, mungon
76. Nurishahe Hulaj
77. Oliver Ivanoviq, mungon
78. Qibrije Hoxha
79. Ragip Zekolli, mungon
80. Ramadan Kelmendi
81. Ramadan Musliu
82. Ramë Buja
83. Rangjel Nojkiq, mungon
84. Remzije Nimani
85. Rifat Krasniq, mungon
86. Rudina Bukoshi
87. Rustem Ibishi, mungon
88. Sabit Rahmani
89. Sabri Hamiti
90. Sadudin Berisha
91. Safete Hadergjonaj
92. Sala Ahmetaj
93. Sala Shala, mungon
94. Samije Zeqiraj
95. Sanije Alijaj
96. Sasha Gjokiq,
97. Selvije Halimi
98. Sllagjan Iliq, mungon
99. Snezhana Miliq, mungon
100. Sokol Bashota, mungon
101. Shaban Halimi, mungon
102. Shpresa Murati, mungon
103. Teuta Hadri
104. Teuta Sahatqija, mungon
105. Vesna Jovanoviq, mungon
106. Veton Surroi, mungon
107. XHavit Haliti, mungon
108. Xhelal Canziba
109. Xhevat Bislimi
110. Xhevdet Neziraj
111. Ylber Hysa
112. Ymer Halimi
113. Ymer Muhaxheri

- 114. Zahrije Jusufi
- 115. Zef Morina, mungon
- 116. Zlatica Kujungjiq, mungon
- 117. Zyhrrije Maloku
- 118. Zylfi Merxha, mungon
- 119. Zylfije Hundozi, dhe
- 120. Enver Hoxhaj

Konstatohet se procesi i votimit përfundohet. Ftojë komisionin dhe vëzhguesit që të kryhet procesi i numërimit të votave.

Më lejoni që të komunikoj rezultatin e votimit:

Në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë.

Për Hasan Preterin kanë votuar 57 deputetë,
Për Ruzhdi Sefën kanë votuar 21 deputetë

Të pa vlefshme janë 5 fletëvotime. Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me rregullën 31.3 të rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës, konstatohet se Hasan Preteni është zgjedhë dhe emëruar Drejtor i Agjencionit Kosovar të Antikorrupsionit.

Më lejoni që në orën 12 të japim pauzë, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Mirë se keni ardhur në seancë. Mund të fillojmë.

Në radhë është pika e fundit.

9. Shqyrtimi i Raportit me rekomandimet e Kryesisë për Qendrën Administrative Protokollare në Gërmi.

Në Seancën Plenare të mbajtur më 14 shkurt të vitit 2006 me rastin e shqyrtimit të Qendrës Administrativo-Protokollare në Gërmi, Kuvendi i Kosovës nxori përfundimin me të cilin ngarkoi Kryesinë e Kuvendit që të rishqyrtojë dhe Kuvendit t'i paraqet raport me rekomandime.

Raporti i Kryesisë u është shpërndarë të gjithë deputetëve. Arsyetimin për të përforcuar raportin dhe rekomandimet e Kryesisë do t'i paraqes anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, deputeti Naim Maloku.

Në sallë momentalisht janë 67 deputetë.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Faleminderit z. Kryetar. Të nderuar deputetë ne e kemi pasur një seancë plenare me kërkesë të grupit parlamentar Ora dhe të mbështetur nga 42 deputetë që është shqyrtuar çështja e vilës protokollare në Gërmi. Nga ajo seancë plenare është ngarkuar Kryesia e Kuvendit që të rishqyrtojë materialin dhe Kuvendit t'i drejtohet me rekomandimet që ajo i nxjerr. Kryesia e Kuvendit e ka pasur në rend të ditës temën në fjalë 3 herë. Në mbledhjen e fundit të Kryesisë që është shqyrtuar kjo temë, është mbajtur

mbledhje e veçantë e Kryesisë, në të cilën është shqyrtuar kjo pikë e rendit të ditës që është edhe sot.

Më lejoni që në emër të Kryesisë së Kuvendit, Kuvendit t'i drejtohem me arsyetimin dhe variantet që Kryesia e Kuvendit i ka pasur gjatë shqyrtimit të materialit në fjalë.

Së pari të nderuar deputetë kjo çështje sipas Kryesisë ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë është çështja procedurale që ka të bëjë me rezultatin e auditimit të jashtëm të Kuvendit të Kosovës dhe çështjet të cilat janë ngritur në debatin në fjalë në shkurt të këtij viti në këtë Kuvend, pra nuk mund të marrim përgjigje nga ky raport dhe nga Kryesia e Kuvendit për arsye se raporti i auditimit për momentin nuk mund t'u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Pjesa e dytë në të cilën është përqendruar Kryesia e Kuvendit është çka duhet bërë me pronën dhe çka me objektin në fjalë dhe ka konstatuar si vijon: Objekti është pronë e Kuvendit të Kosovës, mjetet e shpenzuara deri më tani janë: projekti 98.500 €, për punë kryerësit ju kanë paguar deri më tani nga buxheti i Kuvendit 1.651.832 €, mbikëqyrja e projektit dhe realizimit të punimeve deri më tani është paguar 23.000€ nga 45.000 sa është kontrata me REGALLIN që është edhe kontrata mbikëqyrëse e mbikëqyrësit dhe realizimit të Projektit.

Gjithsej janë shpenzuar deri më tani 1.773.332 €. Mjetet e siguruar nga buxheti i këtij viti dhe i cili ka kaluar në Kuvend janë rreth 1.600.000€, të cilat janë ende të pashfrytëzuara dhe nëse nuk shpenzohen së paku një pjesë gjatë këtij muaji ato mjete mund të kthehen dhe duhet t'i kthehen Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Në pyetjen çka me objektin të nderuar deputetë, Kryesia e Kuvendit ka shqyrtuar 4 variante të mundshme se si të veprohet me objektin dhe më lejoni që t'ua sqaroj të gjitha variantet që i ka pasur në shqyrtim Kryesia e Kuvendit.

Varianti i parë, të vazhdohen punimet me të njëjtin mbikëqyrës, mbikëqyrësi të jetë nën kontrollin e divizionit teknik të Kuvendit.

Për të realizuar këtë variant duhet të kryhen disa punë përgatitore apo veprime përgatitore. Të verifikohen punët e kryera se a janë adekuate me pagesat e bëra, të fillon shpenzimi mjeteve të dedikuara nga buxheti i këtij viti, të bëhet aneks kontrata me vlerë të saktë të kostos së aneksit "C", të sigurohen mjetet në buxhetin e vitit të ardhshëm dhe mundësia e marrëveshjes edhe me Qeverinë për participim në mënyrë që të shfrytëzohet objekti pasi të ndërtohet.

Në kuadër të këtij varianti të nderuar deputetë Kryesia e ka paraparë se pasi të kryhet objekti mund të veprohet me të sipas dy nënvarianteve.

Të qitet në tender për menaxhim me dedikim të vetëm për Kuvend dhe Qeveri ose të krijohet divizion i protokollit së bashku me Qeverinë dhe të menaxhohet objekti. Kjo është pasi të kryhet objekti.

Kryesia e ka identifikuar edhe një variant që do të ishte të ndërpriten punimet, që do të thotë ndërprerja e kontratave me punëkryerësin dhe mbikëqyrësin pasi të jetë vlerësuar vlera e saktë e punimeve të kryera.

Lidhja e kontratës me Shërbimin Policor të Kosovës për sigurimin e objektit deri në vendimin tjetër që duhet marrë për atë objekt dhe gjetja e objektit tjetër për shpenzimin e mjeteve të dedikuara për këtë vit për objektin në fjalë. Kryesia për këtë variant i ka identifikuar edhe pasojat. Humbjet e shkaktuara nga shpenzimi i mjeteve për sigurimin e objektit që janë me vlerë 19.200 € në vit, një parashikim në bazë të vendeve të rojës,

punëtorëve etj, koha e pacaktuar e objektit pezull, koha e shkurtër për të hartuar projekt tjetër, për shpenzimin e mjeteve të siguruara për objektin në fjalë për këtë vit dhe kthimi i tyre në MEF. Rinisja e punëve të nderuar deputetë me projekt të çfarëdo forme dhe për çfarëdo dedikimi nuk mund të bëhet pa pa ritenderim, që do të kërkon edhe shpenzime shtesë, pra herdokur që ky Kuvend të vendos që të rinis punën apo të bën diçka me atë objekt, ato duhet të bëhen me anë të ritenderimit dhe i cili do të kërkonte edhe shpenzime shtesë.

Kryesia e ka shqyrtuar edhe një variant, varianti i tretë, shitja e objektit në këtë gjendje, pra në gjendjen siç është objekti, posedon pëlqimin për ndërtim, posedon lejen për ndërtim, posedon të gjitha lejet për ndërtim, përveç se në Kuvend dhe në Kryesi të Kuvendit nuk është marrë vendimi. Ajo është çështje tjetër Ramë, janë lejet për objekt, ato ekzistojnë sa i përket ndërtimit edhe pëlqimit.

Më lejoni të nderuar deputetë që në kuadër të variantit të 3 Kryesia kishte me parapa procedura të hapjes së tenderit dhe të sigurimit të ofertuesit më të mirë. Kryesia ka identifikuar disa fakte të paqarta. A do të lejon Komuna e Prishtinës që të bartet e drejta e pëlqimit në ndërtim, leja e ndërtimit si dhe leja për shfrytëzim të tokës për 99 vite me palën e tretë dhe kjo, në rast të këtij varianti, duhet të jetë marrëveshje me komunën. Kryesia e Kuvendit e ka parapa si të përcaktueshme këtë variant.

Të nderuar deputetë Kryesia e ka shqyrtuar edhe një variant të fundit, variantin e katërt. Demolimi i objektit dhe kthimi i hapësirës në gjendjen e mëparshme, pasojat e mundshme do të ishin: humbja e të gjitha investimeve të deritashme dhe shpenzimet shtesë për demolim, bartje dhe largim të mbeturinave dhe rregullimit të territorit dhe kthimi në gjendjen e mëparshme. Duke i shqyrtuar të gjitha këto variante, secilën veç e veç, me të mirat dhe pasojat që i bartë secili variant, të nderuar deputetë Kryesia e Kuvendit me shumicë të votave të anëtarëve të Kryesisë i ka sugjeruar Kuvendit ashtu siç e keni marrë sugjerimin në raportin e shkruar dhe drejtuar Kuvendit.

Më lejoni t'ju them të nderuar deputetë se Kryesia e Kuvendit e ka pasur fuqinë e vendimmarrjes për këtë objekt dhe ka mund. Mirëpo e kemi pa më të arsyeshme dhe unanimisht kemi qenë në këtë vendim të gjithë anëtarët e Kryesisë që kjo çështje dhe në formë të rekomandimit t'i kthehet edhe njëherë Kuvendit dhe të vendosim së bashku. Më lejoni të nderuar deputetë që edhe në emër të grupit parlamentar të AAK-së të jap mendimin dhe mendojmë se varianti i parë, që objekti të vazhdohet me punë, por duke i kryer të gjitha veprimet që janë të parapara brenda raportit, do të ishte varianti më i lirë dhe më pak i kushtueshëm, duke mos hyrë në procedurat që lidhen me auditimin e jashtëm të Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Maloku. Fjalën e ka përfaqësuesi i LDK-së z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Znj. dhe zotërinj deputetë në një nga seancat plenare të fund vitit 2005 si dhe në fillim të vitit 2006 kemi kërkuar raport lidhur me çështjen që është në rend dite sot. Deri sa të tjerët kanë kërkuar komision hetimor, LDK-ja ka mbështetur dhe i mbështet angazhimet për përmirësim të infrastrukturës së institucioneve demokratike të Kosovës në kuadër të saj edhe ndërtimin e objektit që është çështje e debatit në Kuvend dhe jashtë Kuvendit, por me këmbëngulje kërkon respektim të plotë të procedurave dhe ligjeve në fuqi. Kryesia edhe në emër të saj Kryetari i Kuvendit z. Kolë

Berisha na ofron për shqyrtim dokumentin n.r 022291 të 23 qershorit 2006 me titull Raport i cili është i ndarë në pjesën e parë me konstatime se nuk ka vendim valid për ndërtim dhe se ka pasur konflikt interesash dhe në pjesën e dytë ofron rekomandime në mesin e të cilave vazhdimin e ndërtimit të objektit, si dhe ekspertizë për kërkesë të punë kryesit për mjete shtesë. LDK-ja, Grupi Parlamentar i LDK-së kishte me e mirëpritur argumentimin me shkrim të konstatimeve dhe rekomandimeve, argumentim siç e dëgjuam sot nga z. Maloku në formë gojore. Z. kryetar edhe me këtë rast rikujtojmë përcaktimin tonë për përkushtim për ndërtim të objekteve qeveritare dhe kërkojmë transparencë të plotë në zbatim të Ligjit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Gashi. Fjalën e ka përfaqësuesi i PDK-së z. Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë ne e falënderojmë Kryesinë e Parlamentit për konstatimet që i ka bërë në lidhje me ndërtesën administrative të Parlamentit në Gërmë. Por që në fillim dua të them se Grupi parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar këtë çështje ose këtë pikë të rendit të ditës me vëmendje të shtuar dhe jemi të bindur se konstatimet janë në shpërputhje me rekomandimet, prandaj qëndrimi i grupit parlamentar të PDK-së ka qenë që të formohet me kohë një komision hetimor për të hetuar shfrytëzuesit e Buxhetit të Kosovës se sa po i respektojnë ligjet dhe sa po i respektojnë procedurat ligjore që edhe ne vetë i kemi miratuar. Kjo nuk ka ndodhur. Keqpërdorimet kanë vazhduar, prandaj ne e mbështesim konstatimin nr. 2 të Kryesisë së Kuvendit për t'i ndërpre punimet në atë ndërtesë për faktin se lënda është në gjyq dhe ne si Parlament, çdo vendim që do ta merrim do të binte ndesh me ligjet në fuqi. Grupi Parlamentar i PDK-së ka qëndrim, nëse lënda është në gjyq, ne duhet ta presim vendimin e gjyqit dhe duhet ta respektojmë vendimin e gjyqit, për ndryshe nëse janë shkelur të gjitha procedurat dhe ka parregullsi që shihet, ne mendojmë se punimet duhet të ndërpriten dhe duhet të kërkojmë sqarime shtesë.

Në fjalën e tij anëtari i Kryesisë që e dha një raport të Kryesisë thotë se për ndërtesën janë harxhuar mbi 1.600.000€, ndërsa punimet që janë kryer në atë ndërtesë janë më pak se 1.000.000€ edhe kjo flet se këtu kemi shkelje tjera edhe të ligjeve edhe të procedurave, prandaj, ne konsiderojmë që vendimi më i drejtë dhe që do ta ketë mbështetjen e plotë të Grupit Parlamentar të PDK-së është që të ndërpriten punimet, që gjyqi ta thotë fjalën e vetë dhe të respektohet vendimi i gjyqit, Çdo vendim tjetër që merret nga ky Parlament është ndërhyrje në sistemin e drejtësisë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Krasniqi. Replikë ka z. Maloku.

DEPUTETI NAIM MALOKU – Ne nuk e dimë se sa janë kryer punët, në çfarë vlere, nuk ishte pjesë e sqarimit tim që punët janë kryer një milion euro. Unë thash vetëm sa janë paguar deri më tash mjete, mirëpo çdo veprim i mëtejshëm kërkon paraprakisht të verifikohen punët e kryera në fazën e tanishme, a janë në përputhje me pagesën që është bërë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Unë mund të pajtohem me fjalën e anëtarit të Kryesisë, por edhe kjo është një dëshmi tjetër se atje punimet duhet të ndërpriten.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Fjalën e ka Gazmend Muhaxheri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Faleminderit z. Kryetar. Të nderuar deputetë Grupi Parlamentar Ora përkrah plotësisht konstatimet e Kryesisë së Kuvendit, por vlerëson se rekomandimet e Kryesisë për seancën bien ndesh me këto konstatime. Grupi parlamentar Ora vlerëson se rekomandimet që dalin nga konstatimet e Kryesisë duhet të jenë këto:

1. Të pezullohen, përkohësisht të ndërpriten punimet dhe të bëhet ekspertiza financiare e tenderit në tërësi dhe e punëve të kryera deri më tani në veçanti, sepse ka një shpërputhje të madhe në mes pareve që janë dhënë dhe punëve që janë kryer në objekt.
2. Të ngritët një komision hetimor parlamentar që do t'i konstatonte përgjegjësitë institucionale dhe individuale, të cilat kanë mundësuar të ketë shkelje të këtilla në Parlamentin e Kosovës. Siç e dini Parlamenti i Kosovës me veprimet e kryera nga ish kryetari i Kuvendit është shndërruar në objekt hetimi të organeve të policisë, dhe
3. Kuvendi i Kosovës i thërret zyrtarisht organet gjyqësore për të filluar hetimet lidhur me rastin "Gërmia".

Këto janë rekomandime që duhet të dalin nga konstatimet. Problemet që dalin para institucioneve janë gurë sprove për të dëshmuar se institucionet janë të gatshme për t'u përballuar me to dhe për t' i tejkaluar. Ne duhet sot të dëshmojmë se si Kuvend jemi të aftë me zgjidh dhe me pru vendime valide.

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

DEPUTETI RAMË BUJA – I nderuari z. kryetar unë nuk do të përsëris kolegët e mi që folën përpara, por dua të sqaroj se në një mbledhje më herët, jo të fundit, si Kryesi jemi dakorduar që të bëjmë atë sugjerim që u përfol për Kuvendin. Në mbledhjen e fundit kur është folur për vilën "Gërmia" unë e kamë ndarë mendimin siç e dini ju vetë, kur keni thënë ju se lënda i ka kaluar gjyqësorit, unë kamë shprehur mendimin dhe qëndrimin tim se tani më nuk do të duhej të ndeshet legjislativi me gjyqësorin, duhet të presim që gjyqësori të bëjë punën e vetë dhe pastaj ne të merremi me atë çështje që na takon neve si legjislativ, për ndryshe nëse gjyqi do të konstatoj diçka tjetër dhe ne sot marrim vendim për diçka tjetër, ku do të mbetet pozicioni i Kuvendit të Kosovës, andaj, po ju sugjeroj se do të ishte mirë, bile do të ishte krejtësisht logjike që ne të presim se çfarë do të thotë gjyqi për këtë çështje dhe pastaj të bëjmë punët tona. Për ndryshe nëse ne sot mbas debatit që do të bëhet do të vendosim për diçka, gjyqësori do ta lëviz këtë gjë dhe ku mbetemi ne dhe ku mbetet gjyqësori ynë, andaj kishim kërkuar që ne të presim gjithsesi fjalën e fundit që do ta thotë gjyqi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati.

POSLANIK DËZAZAIR MURATI - G. Predsedniče dozvolite da vas pozdravim i takodje i kolege i ministre koji su prisutni danas ovde. Naša grupa je takođe se bavljalo ovim problemom i mi nakon iscrpnih informacija koje smo dobili od predsedništva, nakon sastanka sa šefovima parlamentarnih grupa, takođe ipak smatramo da nisu relevantne informacije za ovaj slučaj donete i mislimo da je najbolje kako su i drugi preporučili da kad je već predmet došao do pravosudnih organa da sačekamo neko stručnu ekspertizu kako ne bi smo prejudicirali odluke. Hvala vam.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. kryetar. Znj. dhe z. Deputet., përsëri po ndodhemi në një situatë të pakëndshme në të cilën çka do që të thuash në një farë mënyre rrezikon që të kuptohesh keq. Por si do që të jetë, besoj se do të jetë edhe një shembull se si nuk duhet vepruar. Do të isha i lumtur sikur nga krejt kjo të rezultonte një përfundim i tillë dhe mendoj se pikërisht Kuvendi duhet të jap shembullin e ndërprerjes së qartë të praktikave të tilla të parregullta. Kuvendi duket sikur është peng i parregullsive që janë tash më evidente dhe për mendimin tim nuk mund të zgjidhen situata të tilla duke i toleruar, duke i amnistuar në një farë mënyre dhe duke bërë përpjekje për t'i relativizuar në emër të uljes së kostos. Për ne mbi të gjitha duhet ta kem parasysh a ka pasur, apo nuk ka pasur shkelje. Tashmë është konstatuar se shkelje të procedurave të Kuvendit ka pasur, por mendoj se do të ishte e gabueshme që ne të kufizohemi vetëm në këtë çështje dhe tani të vazhdojmë praktikën e gabuar të paligjshme, por me një qasje tjetër. Për mendimin tim ka rëndësi jo vetëm a janë respektuar procedurat e Kuvendit edhe atë në çdo aspekt, jo vetëm në vendimmarrje, por edhe në aspektin financiar dhe ato tjerat si shkojnë, ka rëndësi a janë respektuar ligjet, a janë shkelur ligjet, kontesti ka qenë pikërisht këtu, sepse me vendim janë shkelur disa ligje, madje edhe dispozita kushtetuese dhe së dyti, a janë respektuar rregullat tjera. Këtu u përmend se mund të vazhdohet me të njëjtat leje, pikërisht janë këto leje që janë të kontestueshme dhe ka gjasa serioze, indicje serioze se edhe ato janë shkelje, unë prandaj mendoj se, nëse nuk duam të vazhdojmë parregullsitë dhe të marrim një përgjegjësi të madhe si institucion, ne duhet të konstatojmë gjendjen dhe për të konstatuar gjendjen siç është thënë edhe në fillim ka një rrugë për Parlamentin tonë, hetimin parlamentar. Institucionet tjera gjyqësore le të bëjnë punën e vetë në linjën e vet, por ne jemi të obliguar që të hetojmë nga aspekti i ynë institucional. Unë mendoj se kjo do të nënkuptonte propozimin për ndërprerjen e punimeve, ju e dini se ka pasur propozime të tilla muaj më parë dhe dëmet do të ishin më të vogla dhe vështirësitë tona për të riparuar gjendjen do të ishin më të vogla, sikur ne do ta kishim respektuar këtë propozim qysh me kohë që nuk është respektuar. Nuk do të duhej të vështirësojmë gjendjen me tolerim të mëtejshëm. Kjo mendoj se do ta bënte të panevojshëm diskutimin e mëtejshëm se çka më tej, por me që u hap kjo çështje unë dua ta them qëndrimin tim të qartë dhe të shkurt. E konsideroj shumë të gabuar dhe të rrezikshme vazhdimin e të njëjtës parregullsi tani vetëm pak a shumë të kamufluar ose të modifikuar, mendoj se nëse konstatohet se ka

pasur shkelje të ligjeve, se nuk janë respektuar çështjet procedurale edhe rreth ndërtimit, madje edhe çështjet pronësore, Kuvendi duhet të jap shembullin e zbatimit të ligjit, shembullin e mbrojtjes së ligjit dhe për mendimin tim ajo që nuk u theksua duhet të jetë shumë e rëndësishme dhe të kihet parasysh mbrojtja e ambientit, mbrojtjen e mushkërive të Prishtinës. Ju e dini çka do të thotë Gërmia, nga vendimi ynë do të varet e ardhmja e Gërmisë dhe më lejoni të them se për mendimin tim edhe e ardhmja e dy qarqeve tjera. Unë mendoj se neve na duhet logjika, ta them figurativisht, e Edi Ramës, nëse janë parregullsi, nëse dëmtojnë ambientin, le të rrënohet, na kushton, unë e di dhe nuk e nënçmoj koston, por në fund të fundit fiton Kosova, fiton ligji, fiton ambienti, prandaj le të gjejmë burimet, le të gjejmë donacionet, por le ta kthejmë gjendjen në gjendjen në të cilën ka qenë dhe le të japim mesazhin para të gjithëve se Gërmia, parqet, ambienti i mbrojtur nuk bën të cenohen dhe ne kemi një procedurë ligjin për parqet nacionale. Nëse ne lejojmë abuzimet që në start, atëherë mos të aprovojmë ligje të tilla fare, sepse do të shkilen dhe për këtë ju siguroj unë. Prandaj që më parë deklarohej dhe angazhohej për sundim të ligjit, për mbrojtje të ambientit, për mbrojtje të interesave të qytetarëve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Hyseni. Fjalën e ka deputeti Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI – Faleminderit kryetar. Më vjen keq që keni lejuar që kjo çështje të diskutohet në këtë mënyrë dhe të shndërrohet në çështje politike. Para neve është dashur të ketë një vendim të Kryesisë se a i nevojitet ky objekt këtij Parlamenti apo jo. Ne jemi duke krijuar shtet dhe shtetin duhet ta ndërtojmë me institucione të mirëfillta, se e di saktë se si të dalim prej kësaj sale të gjithë deputetët kanë me kërkua hapësira dhe kushte më tumira të punës, ndërsa këtu deklarohen ndryshe. Çështja e ruajtjes së ambientit duhet të vlejë edhe për objektet tjera dhe asnjë fjalë nuk thuhet se biznesi është veç duke u zhvilluar në Gërmia. Nëse kafiteritë, e disa njerëzve nuk po e rrezikojnë ambientin, atëherë si e rrezikon shtëpia e Parlamentit. E vërteta është që ne duhet të marrim qëndrim të prerë që objekti i nisur duhet të përfundoj, kur të përfundoj objekti atëherë mund të diskutojmë se çka më tutje. Janë para të mëdha, diku 3.4 milion parashihet që objekti të kryhet sipas variantit të ofruar dhe nja 1.300.00 për aneksin "C" dhe kjo duhet të jetë temë e diskutimit. E keni shtruar çështjen për çështje procedurale se a duhet të ndërprehet objekti. Unë mendoj se për çështje procedurale merren organet kompetente, ka qenë auditori i jashtëm, gjykata, mirëpo vendimin për ndërtimin e objektit nuk mund ta bëjë asnjë gjykatë. Vendimin e objektit e bjen Kuvendi dhe ju propozoj që sot të marrim qëndrim të prerë a ta vazhdojmë ndërtimin apo jo, në mënyrë recidive për arsye se mua më duhet me i parapa investimet kapitale për buxhetin e vitit të ardhshëm për Kuvend, këtë sasi të mjeteve, dhe nëse nuk e parashohim faktikisht e kemi humbur edhe një vit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit i nderuari z. kryetar, ashtu siç foli edhe z. Naim Maloku ku shihet se ai ka bërë një analizë të thuktë dhe të hollësishme të

problemit për ndërtimin e qendrës administrative protokollare në Gërmi, gjithashtu brenda grupit me shumë vëmendje dhe kujdes të posaçëm e kemi shqyrtuar dhe përkrahim rekomandimin e z. Maloku. Me gjithë atë me që mungon një ekspertizë, propozojmë që gjithashtu të bëhet një ekspertizë e pavarur për të vlerësuar punën e gjertanishme dhe pastaj edhe vazhdimin e punës në të ardhmen. Sa i përket komisionit hetues, konsiderojmë se nuk ka komizë ligjore për hetimet parlamentare, prandaj e bënë të paparashikueshme suksesin e këtij komisioni edhe pse sipas rregullës 50 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi mund të vendos që të ngris Komisionin hetimor, por procedura e ngritjes së komisionit nuk është e paraparë. Kjo procedurë duhet të rregullohet me akt të veçantë juridik dhe në fund komisioni hetues nuk mund të ketë asnjë lloj pushteti gjyqësor dhe konsiderojmë se është mirë që të vendosim sot dhe duhet të jemi të përgjegjshëm të marrim mendimet e të gjitha grupeve dhe të vihen në votim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë, nuk e pata mendjen me diskutua, por më shtyri Gjylnaze Sylja me diskutua, ta kthejmë seriozitetin. Ne jemi Kuvendi i Kosovës dhe si Kuvend i Kosovës miratojmë ligje për të gjitha instancat e pushtetit në Kosovë dhe nuk paskemi bazë ligjore për të iniciuar një hetim parlamentar. Nuk e di znj. e nderuar a e di se je deputete apo nuk e di, puna e parë, e dyta, për derisa e di se je deputete duhet ta dish se çdo vendim në këtë Kuvend ka fuqinë ligjore, prandaj nëse ne marrim vendim për të formuar komision hetimor parlamentar, nuk ka kush që e pengon Kuvendin për me e ekzekutuar atë vendim. Sa i përket asaj që u tha deri më tani z. Osmani është pjesë e kësaj parregullsie, duhet të thuhet troç, është pjesë e kësaj parregullsie. Vendimin për ta ndërtuar këtë vilë e ka marrë Isuf Demaj, nuk ka instancë tjetër që e ka marrë vendimin. Pra në qoftë se ne tash e vazhdojmë vendimin e Isuf Demajt ose e bëjmë të plotfuqishëm vendimin e Isuf Demajt është çështje tjetër, vetëm se vendimin për ndërtim e ka marrë Isuf Demaj dhe çka kërkohet prej nesh si Kuvend, aktualisht është vetëm një mundësi, duhet të stopohet ndërtimi si punë e parë për të konstatuar shkeljet, gabimet të cilat gjithmonë binë në domenin e funksionimit të Kuvendit, aspekti ligjor është aspekt ligjor ne as nuk mund të gjykojmë njerëz, as nuk mund të dënojmë njerëz, ne mund të konstatojmë përgjegjësitë nga domeni i funksionimit tonë, nga domeni i rregullores së punës dhe domeni i ligjeve, të cilat i kemi miratuar këtu e që kanë të bëjnë me funksionimin e institucioneve ekzekutive ose edhe ligjvënëse të Kosovës. Pra puna e parë do të duhej të ndërprehej puna edhe përkohësisht, pa e ndërpre asnjë kontratë, deri sa të mos konstatohet gjendja faktike edhe nga propozuesi në fillim. Pra duhet të konstatohet gjithçka që ka të bëjë me këtë rregullsi ose parregullsi e tek më pastaj të dalim me rekomandime, qoftë për ta vazhduar punën, për të marrë vendim tash, qoftë për ta rrënuar që po kërkon z. Hyseni që unë nuk jam parimisht me të se Kosovës i duhen institucione përfaqësuese, aty jam me Naserin plotësisht, por me gjithë atë Kosovës i duhet rregullsi i duhet bazueshmëri në ligje që këtu në këtë rast e kemi të huqur fare, pra është shkuar krejtësisht me vendime private. Ne tash po dëshirojmë që ato vendime private t'i përlligjim e kjo nuk shkon dhe të nderuar deputetë është absurd i

absurdeve që ky Kuvend të manifestoj një mungesë gatishmërie për t'u marrë me obligimet dhe detyrat që i ka sipas Kornizës kushtetuese. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Faleminderit z. Jashari. Për replikë lajmërohet Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Unë e argumentova me argumente edhe me rregullat në fuqi dhe e shpjegova shumë mirë, jam deputete dhe jam krenare që jam deputet. Kuvendi asnjëherë nuk ka ndërhy gjatë debatit për buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2005. Këshillit Ekonomik Fiskal i cili e ka përcjellë për së afërmi draftimin e procedurave të buxhetit asnjëherë nuk ka ndërhy, PSPP-ja e ka aprovuar buxhetin e 2005-shit, me këtë dua të them se përgjegjësia për këtë është e të gjithëve, prandaj edhe e shtrova arsyetimin, që natyrisht ka të drejtë sipas rregullës së 50-të Kuvendi ta bëjë Komisionin, por nuk ekziston procedura për ngritjen dhe nuk ka akt të veçantë juridik, procedura për ngritjen bëhet me akt të veçantë juridik.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, për replikë është paraqitur Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI – Kishte qenë fer nga kolegu që të thotë se jam pjesë e parregullsisë, të thotë se çka është ajo pjesë e parregullsisë, çka ka ajo të bëjë me mua, nuk ka qenë pjesë e projektit që jam marrë ndonjëherë, mund të jetë kjo nga pjesa e kulturës apo e edukatës familjare që dikujt t'ia gjuajë kështu ndonjë akuzë dhe tërhiqet, mirëpo do të ishte fer me tregu publikisht çka ka të bëjë Naser Osmani me këtë projekt.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Po ashtu replikë ka kërkuar Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. Kryetar. Unë dua ta sqaroj qëndrimin tim të apostrofuar. Nëse është shkelur ligji, ligji nuk mund të rivendoset me shkelje të reja. Nëse janë shkelur dispozitat tjera pronësore, procedurale nuk mund të mbrohen duke vazhduar, duke i legjitimuar ato. Pa një hetim parlamentar ne nuk mund të vendosim as ashtu e as kështu, prandaj për mendimin tim duhet hetimi parlamentar, ekspertiza parlamentare, siç u kërkuar. Për hetim parlamentar ne kemi bazë ligjore dhe kemi edhe një përvojë, ne e kemi formuar një komision hetimor parlamentar dhe mbi këtë bazë ne do të sigurojmë qasjen institucionale se cili do të jetë përfundimi, unë nuk dua ta prejudikoj, por nëse përfundim do të ishte se janë shkelur ligjet se janë shkelur edhe interesat e qytetarëve për mbrojtjen e Gërmisë, ju lutem të mos përzihen ndërtimet e forta me montazhe, që çdo kund lejohen dhe mund të hiqen, me këtë ndërtim janë hapur çështje të mëdha edhe ligjore edhe kushtetuese sistemore, prandaj mendoj se çdo vendim tjetër, që do të anashkalonte hetimin parlamentar, do të jetë i njëanshëm ose i gabueshëm, natyrisht që unë nuk do të dëshiroja të marrë pjesë në vendime të tilla që do të dëshimohen shumë shpejtë se kanë qenë të dëmshme dhe do ta dëmtojnë gjithë Prishtinën, gjithë Kosovën, ju siguroj zotëri. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, për replikë është paraqitur Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryetar, nuk ishte intenca ime që as kultura ime familjare e as edukata nuk më lejon ta fyej askënd. Z. Naser Osmanin e pashë në kontekstin e punës së tij në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe duke qenë se Komisioni për Buxhet dhe Financa sipas Kornizës Kushtetuese është e paraparë saktë se çfarë përgjegjësish ka, prandaj në atë kontekst e pashë edhe përgjegjësinë e z. Osmani. Nuk jam këtu që askujt t'i vë kryqin në shpinë, por që të konstatohen përgjegjësitë institucionale të të gjitha segmenteve të pushtetit. Jam për atë, në atë komision jam edhe unë, prandaj edhe unë e kamë një pjesë të fajit, por z. Osmani është kryetar, kështu që ishte për... pa dashur ta fyej, nëse e ka ndier veten të fyer unë i kërkoj falje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Jakup Krasniqi.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, nëse vërtetë shtrohet pyetja se a i duhet Parlamentit dhe institucioneve një ndërtesë, i duhet, por a duhet që ky Kuvend ta merr një vendim për ta legjitimuar të paligjshmen, mendoj se këtu duhet të jemi të qartë dhe diskutimi ynë dhe kërkesa jonë është të ndërpritet puna dhe gjyqi le të vendos për vazhdimin ose ndërprerjen e punimeve në atë ndërtesë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

DEPUTETJA BESA GAXHERRI – Faleminderit z. kryetar, kolegë të nderuar. Nuk është hera e parë që vendimet ndoshta të një zërit të Kryesisë së Kuvendit, kur vijnë në seancë përdoren për çështje politike, ndryshohen. Kjo nuk më befason, por më shumë më befason që ne si subjekt, që kemi shumicën në Kuvend që ndonjëherë japim mundësinë dhe hapësirën ta teprojë opozita në këto çështje dhe unë mendoj se duhet t'ia bëjmë të dijshme apo ta vetëdijësojmë opozitën se nuk mund të vendos për çështje të rëndësishme, aq më shumë Orën me 7 vota. Për asnjë çështje të rëndësishme në Kosovë nuk mund të vendos Ora, vendos natyrisht shumica dhe unë dua ta ritheksoj se vendimi kur është marrë për të filluar me e ndërtua këtë qendër, kemi qenë qeveri e koalicionit të gjerë dhe e përsëris ndoshta kolegen Gjylnazën që ky Kuvend ka marrë Vendim për t'i ndarë mjetet për këtë Qendër protokolare dhe nuk ka pasur kundërshtime, mendoj se kjo temë është shterur, sepse kemi pasur debat të gjerë për këtë çështje, në vend se të vendosim si Kuvend, a të ndërtohet kjo qendër apo të mos ndërtohet, ne prapë merremi me çështje procedurale të cilat nuk na takojnë neve, janë organet të cilat merren me çështje procedurale, ndërsa ne si Kuvend duhet të vendosim a na nevojitet ky objekt apo nuk na nevojitet, ndërsa LDK-ja, si subjekt shumicë në Kuvend, ne e kemi parashikuar në programin e LDK-së këtë objekt dhe ky objekt duhet të ndërtohet. Gjithashtu edhe vendimi edhe mendimi i grupit parlamentar të LDK-së është për vazhdimin e punimeve në këtë qendër. Faleminderit z. kryetar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit. Fjalën e ka Safete Hadërgjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADËRGJONAJ – Faleminderit z. kryetar. Unë desha vetëm t'i rikujtoj Gjylnazes që pak më parë foli, që tha se veç e kemi miratuar buxhetin e vitit 2005 dhe unë doja t'i thosha se përgjegjësia nuk është e të gjithë neve që e kemi miratuar buxhetin e vitit 2005, po është përgjegjësia e atyre që e kanë miratuar këtë buxhet, kurse ne nuk e kemi miratuar këtë buxhet dhe reagimet tona kanë qenë edhe kur është miratuar buxheti që mos të miratohet kjo shumë dhe njëkohësisht jeni në dijeni që kemi pasur reagime edhe ndaj pozicioneve, kodeve buxhetore të Kuvendit të Kosovës, siç ka qenë kodi buxhetor për kryetarin, i cili ka ra ndesh me kornizën kushtetuese dhe kemi pasur amendament të posaçëm si grup parlamentar dhe nuk është marrë parasysh asnjëherë në këtë Kuvend, kështu që përgjegjësia nuk është e jona që nuk e kemi miratuar buxhetin, por përgjegjësia është e atyre që e kanë miratuar buxhetin. Nëse ne dom të veprojmë kundër ligjeve, atëherë të marrim vendime sipas partive politike që i shkelin ligjet, kurse mendoj se ne në radhë të parë duhet ta respektojmë ligjin.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit, Gjylnaze Sylja e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLJA – Unë desha t'ja kujtoj koleges që vendimi për Qendrën nuk është marrë tash, por është marrë në kohën e bashkëqeverisjes, kur edhe PDK-ja ka qenë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Lulzim Zeneli

DEPUTETI LULZIM ZENELI – I nderuari z. kryetar, më lejoni të shprehë një çështje e cila nganjëherë po harrohet nga ana e jonë dhe pikërisht kur ka të bëjë me raportin që e ka dorëzuar shumë më herët administrata e Kuvendit në këtë Kuvend, dhe e kemi shqyrtuar, dhe ajo ka të bëjë pikërisht me procedurat të cilat janë ndjekë. Unë vetëm dua ta theksoj mendimin tim, se këtu pak më herët u fol për rregullat dhe ligjet për shkelje të procedurale.

Çështja e procedurave dhe inicimi i projektit që nga fillimi i saj, dhe në vazhdimësi dua tua kujtoj se në raportin që kemi pasur shumë herët më parë, këtu ka qenë në mënyrë eksplicite e theksuar edhe involvimi subjekteve tjera të cilat e demantojnë atë çka thuhet tash, dhe pikërisht ka të bëjë me Ministrinë e Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor, të cilët e kanë dhënë pëlqimin, po ashtu edhe Kuvendi komunal i Prishtinës, dhe gjitha procedurat të cilat kanë qenë nga faza e inicimit dhe në realizim e sipër, është theksuar shumë çartë në raport. Nga disa deputetë janë harruar këto elemente, që duhet të ritheksoj se kjo çështje ekziston dhe mund të dokumentohet edhe në të ardhmen, mirëpo ajo çka është esenciale theksohet tash se gjithë po e ndiejmë nevojën e ndërtimit dhe realizimit e këtij objekti, ndërsa për çështjet procedurale janë organet kompetente të cilat merren me to dhe ky Kuvend ka qenë i hapur vazhdimisht ndaj organeve të tilla dhe nuk mund të jenë pengesë e realizimit të projekteve të cilat janë aq të nevojshme dhe ky Kuvend ka

dhënë mbështetje, ka dhënë mbështetje në debatin që kemi pasur shumë herët më parë, prandaj kujtoj se çdo evaluim i elementeve të cilët mund të hasin në dilema dhe në ngjarje të mëtutjeshme nuk janë produktive, sidomos në këtë aspekt, kur është aq e nevojshme Qendra administrative protokollare. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bajram Rexhepi.

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – Ju faleminderit z. kryetar, unë nuk e kisha ndër mend që të diskutoj, për arsye se parafolësit diskutuan mjaft në lidhje me këtë problematikë., por edhe pse nuk u përmend në mënyrë eksplicite, u përmend se vendimi është marrë në kohën e bashkëqeverisjes së gjerë edhe them me përgjegjësi para jush, se Qeveria në atë kohë nuk ka marrë asnjë herë as vendim as që ka diskutuar në lidhje me Qendrën protokollare. Prandaj nëse është marrë në parlament, unë përkufizohem se nuk e di se si ka rrjedhë, por në Qeveri e di se asnjë herë as nuk është diskutuar, as nuk është marrë vendim, këtë e thashë vetëm sa për sqarim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Replikë ka Besa Gaxheri,

DEPUTETJA BESA GAXHERI – Jo zoti kryetar, nuk kisha thënë replikë, por vërtetë në qoftë se doni me u shfaqësuar që Qeveria s'ka marrë vendim, pse paska lejuar atëherë, a vërtetë qenka dashur me ardhë ORA me ju tregu, ose me na tregu neve që paskam shkëlur ligjet, pas katër viteve, ju lutem shumë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Të nderuar kolegë deputetë, i nderuari kryetar, unë vetëm desha t'ju ceku në një moment se në korrik të vitit të kaluar, pikërisht këtu është diskutuar për këtë çështje ku ka ndodhur ngatërresa gjatë ndërtimit të Qendrës protokollare, me punëtorë që kanë ndërtuar dhe protestuesit që me i mbrojtë zonat e gjelbëruara apo zonat me interes të veçantë. Unë vetëm desha t'ju them se këtu po përmendet ambienti, vendime ç'vendime, procedura jo procedura, asgjë të keqe nuk ka sikur të ndërpriten punimet, edhe pse është vonë, por kanë mundur të ndërpriten vjet, sepse të gjithë e kemi ditur se nuk ka pasur vendim nga Kryesia e Kuvendit që do të marr vendim apo t'i përcaktojë hapësirat çfarë objekte i duhen edhe sa i duhet hapësirë për deputetët e vetë apo për institucionet tjera, ndoshta edhe Qeveria, ndoshta edhe ato gjyqësore..... kështu që ne jemi duke e ripërsëritur edhe duke e kaluar ndoshta në momente të caktueme edhe në replika apo duke tentuar që t'i personalizojmë gjërat për këtë apo për atë, nuk është fer të shkojmë kësi soji, sepse vendime, është pëlqimi nga Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, mirëpo është pëlqim pa procedurë, është dhënë një pëlqim nga personi që nuk ka qenë i licencuem në bazë të udhëzimit që del nga ligji për mbrojtjen e mjedisit, se ata duhet të licencohen e më pastaj të bëjnë raport për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Dmth. këtu është shkëlje e ligjit edhe e udhëzimit që e interpreton atë ligj më tutje, pastaj, është fakt që janë lëshuar lejet nga Kuvendi

Komunal i Prishtinës, mirëpo edhe aty ka pas hapësirë që të interpretohen apo të nxiren vendime për këtë ose atë qëllim tjetër, duke ndërruar edhe destinacionin, hapësirën dhe duke lejuar nga një hapësirë që është kërkuar paraprakisht shumë e vogël, është liru një hapësirë shumë e madhe. Tash është një fakt që vendimin, edhe rekomandimet e juaja edhe materiali që na është prezantuar këtu, kur pastaj ka kërkuar ORA debat këtu. Po edhe materialin që e keni dhënë shtesë për anëtarët e Kryesisë së Kuvendit që të vijjnë deri te këto rekomandime, e që fatbardhësisht e kamë pasë në dorë atë material, e kam vërejt që ka shkelje në procedurë dhe ka konflikt interesi. Mirëpo, mos të jemi ne ata që të marrim rolet e institucioneve tjera, por të propozojmë që të ndërpriten punimet pikërisht që të sqarohen këto e mos të mbetet as lavdi as fajësia kurrkund tjetër pos aty ku ekziston. E atë nuk mund ta konstatojmë ne sot me debate. Le ta konstaton gjyqësori, për atë punë është. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Replikë ka kërkuar Bajram Rexhepi.

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – Edhe pse nuk jam përkrahës i replikave e nuk ishte qëllim i shfajësimit, për fat të mirë ekzistojnë edhe transkriptet edhe procesverbalet edhe vendimet e ish qeverisë, prandaj kush është i interesuar ato mund t'i sheh në mënyrë transparente, prandaj nuk e di arsyen pse kolegja Gaxheri që tha dom me u shfajësuar, s'kam arsye me u shfajësuar, ekzistojnë dokumentacione dhe ajo mund të përmbillet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ramë Buja e ka kërkuar fjalën

DEPUTETI RAMË BUJA – Z. Kryetarë, është mirë që të sqarohen edhe deputetët, që të mos bëjmë fjalë për asgjë se Kryesia e Kuvendit ka konstatuar se vendim të Kryesisë së kaluar nuk ka për tu nisur dhe për të vazhduar punimet në Qendrën protokollare të Gërmisë, kjo është shumë e qartë, ne kemi kërkuar 600 ose 700 faqe sa kanë qenë dhe s'kemi gjetur një vendim legjitim të Kryesisë për të filluar punimet në Qendrën protokollare Gërmia, kjo është e qartë, andaj kolegët e mi le ta gjejnë një kopje të vendimit të tillë që ka marrë Kryesia dhe unë po e respektoj çfarë do qoftë ajo, ne kemi konstatuar që s'ka vendim të Kryesisë për të filluar punimet në Qendrën protokollare, dhe nuk kemi pse të bëjmë fjalë për këtë çështje. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Samije Zeqiraj

DEPUTETJA SAMIJE ZEQIRAJ - ju faleminderit z. kryetar, unë do të jem shumë e shkurtër dhe mundohem me qenë parimore, vërtetë se për leje të objekteve të rëndësishë së veçantë nuk kërkohen. Këto janë çështje të disa strukturave në nivel shtetëror që vërtetë ata marrin këto vendime dhe nuk ka leje për këto, këto janë p.sh. nevojat e mbrojtjes së TMK-së nevojat e punëve të brendshme, nevojat e hekurudhave, as një herë nuk lypet leje ku duhet të ndërtohet hekurudha apo për autostrada dhe objektet të veçanta të nevojave të veçanta të Qeverisë, të Parlamentit ose të institucioneve tjera të Kosovës,

Prandaj, mendoj se nuk ekziston një leje parimore se ky objekt ka qenë i nevojshëm për shtetin e Kosovës dhe ne shumë mjete kemi derdhur në republikat tjera si në Maqedoni e në vendet tjera për mungesë të lokalit dhe më vjen shumë mirë që prona është e Kuvendit komunal, është vërtetuar se është e Kuvendit të Kosovës dhe pyes, shfrytëzoi rastin të pyes se ku janë edhe shumë prona të tjera të këtij Kuvendi të Kosovës, që vërtetë janë të uzurpuara që edhe deputetët nuk kanë as banesa, as garsoniera as ku të vendosen, e mos të flasë për zyre e për gjëra tjera që ka filluar të bëhet një zgjidhje.

Unë mendoj se për këtë vërtetë po del se është akuza politike dhe nuk është mirë, ne duhet të ndërtojmë edhe plotë objekte tjera si kjo ndërtesa administrative protokollare e sa i përket vendit ku është ndërtuar, mund ta shtrojmë një pyetje, a kemi guxuar të marrim ndonjë vendim që ta rrëzojmë atë objekt që ka qenë aty i ndërtuar, edhe ai objekt që ka qenë i ndërtuar që është bombarduar nga NATO-ja nuk e ka penguar ambientin e Kosovës, prandaj të jemi pak më të korigjuar edhe të mendojmë pak më parimisht, për procedurat e prokurimit duhet të ndiqen, aty nuk jam që të bëjë lëshime, të ndiqen, ndërsa për këto objekte mos bëjmë shumë llafe, leje nuk lejohet se edhe ligj për kërkimin e lejeve për objekte të veçanta nuk ka. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Unë do ta shfrytëzoj rastin ta përdori këtë foltore tash. Natyrisht se në mbrojtje të raportit ose të rekomandimit të Kryesisë së Kuvendit, para se gjithash dua të them se as Kryesia askush nuk ka pretendime që ta rehabilitojë ose të kamuflojë diçka në këtë drejtim.

Secili përgjigjet për veprën që e kryen, secili do të dënohet për veprën ose do të shpërblehet për veprën që e kryen dhe këtu nuk është qëllimi, as i Kryesisë, as i askujt tjetër që ta mbrojë dikën apo ta akuzojë dikën në qoftë e nuk ka elemente. Po them, qëndrimi i Kryesisë është që jo ta rehabilitojë personin ose personat as të kamuflojë në këtë propozim veprimet e kryera deri më tash. Qëndrimi i Kryesisë është nisur prej asaj se shkeljet në procedurë do të thotë duhet ta kuptojë se procedura ligjore është diçka tjetër ndërtimi i ndërtesës dhe vazhdimi i ndërtesës është diçka tjetër kështu duhet të merret. Procedurat në qoftë se ka shkelje ka organe që ndjekin ato dhe janë në veprime sipër dhe ne nuk kemi nevojë të merremi me atë, është çështje e Kuvendit që të vendos të vazhdojë punimet në ndërtimin e atij objekti apo jo, e unë jam se duhet të vazhdojë, duhet të vazhdojë për shkak se janë investuar mjete në te, janë investuar një shumë e madhe mjetesh në te, dhe po që se çdo vendim tjetër kundër kësaj, këtij vendimi, do të vie deri te një shumë më e madhe e shpenzimeve të panevojshme. Konsideroj se ne, si Kuvend, ta marrim vendimin që të vazhdojnë punimet e ndërtesës dhe natyrisht pjesën tjetër të punës të shkeljes ose të procedurës, organet tjera e kanë kompetencë.

Nuk është qëllimi i kamuflimit të diçkafes, prandaj ju propozoj që të mos e zgjasim shumë, janë edhe dy kandidatë që kanë kërkuar fjalën dhe tani të shkojmë në votim, fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – ju faleminderit! I nderuari kryetar, të pranishëm tjerë, vërtetë u tha ajo që përafërsisht e konceptova si të tillë, por unë mendoj se po i ngatërrojmë proceset ligjore me ato politike, çka nuk shkon në favor të sqarimit të

situatës, vendimet për procedurën paraprake ekzistojnë, por vlerësimet për ato nuk jemi kompetent t'i bëjmë ne si po i bëjmë këtë po thirrëmi në ligj, por nuk po e citojmë asnjë ligj, asnjë dispozitë ligjore dhe si Kuvend nuk po na takon kështu, dhe çka është përfundimtare, vazhdimi i punimeve nuk e përjashton mundësinë e vlerësimit të ligjshmërisë së punës, prandaj është e arsyeshme ajo që ju theksua dhe kërkua nga ne. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Harrova të them këtë se ky Kuvend për dy vite me radhë i ka ndarë mjetet për këtë ndërtesë, fjalën e ka deputeti Xhavit Bislimi

DEPUTETI XHAVIT BISLIMI – Ju faleminderit z. kryetar, unë e falënderoj kolegën për informatën e fundit sipas të cilës vendimi nuk qenka marrë as në Kryesinë e Kuvendit, as në Qeveri, por qenka marrë në parti, dmth. partia që ka pak ma shumë deputetë. Mua më mbetet vetëm të kërkoj që të di si deputet nëse ky vendim është marrë në Kryesi, apo në Këshillin e përgjithshëm të partisë, dhe mbledhjen e ardhshme të Kuvendit ta shqyrtojmë këtë vendim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Për cilin vendim e keni fjalën zotëri, nuk është marrë në parti, unë nuk kam nevojë për replikë të mëtutjeshme, ju thashë atë çka është e vërteta. Fjalën e ka deputeti Fadil Geci.

DEPUTETI FADIL GECI – Unë desha vetëm nja dy fjalë me komunikua me Bajram Rexhepin dhe Hydajet Hysenin, për mua është interesant, ka qenë ish kryeministër edhe më intereson a kanë menduar se ndoshta kanë harruar në transkript Bajrami ose Hydajeti në kohën në mandatin që ka qenë, a kanë bisedua ndonjë herë për këtë problem që u kanë në interes tonë të përgjithshëm edhe është mendua që Kosova ka nevojë për objekte të tilla dhe e dimë që në Gërmë ka qenë një objekt i bombaarduar dhe ka qenë objekt i Kuvendit të Kosovës.

Kisha dashur Hydajetit kryesisht, se Bajramin veç e dëgjova, ndoshta ka harru edhe se me siguri edhe ky ka biseduar edhe me ndërkombëtar, por edhe vetë ka menduar që Kosovës i duhet një kësaj objekti, po Hydajeti ka qenë anëtarë i Kryesisë edhe ne me siguri më kujtohet ajo punë që është diskutua, kanë menduar kanë biseduar me ndërkombëtarë se ku të gjejmë hapësirë zgjerimi, ku të gjejmë objekte që janë të nevojshme për Kuvendin e Kosovës, prandaj kisha dashur të jetë i sqartë dhe të thotë atë çka ka qenë aty në ato ngjarje, se tash për momentin po e shohim se ku është qëllimi dhe ku është interesi. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Deputeti Bajram Rexhepi,

DEPUTETI BAJRAM REXHEPI – Kisha dashur një përgjigje të shkurtër, jo pse nuk është interes i institucioneve që të kemi objekte, por në kohën kur kemi qenë jemi ballafaquar me hapësirë, kurse shumica e ministrive si e dini, me qira kanë marrë objekte, edhe ma tutje vazhdohet në atë drejtim, prandaj në lidhje me këtë nuk kemi diskutuar dhe

ju kemi përmbajtur përgjegjësisë që ka qenë përgjegjësi e Ministrisë së Shërbimeve Publike, ata e kanë një departament të caktuar të inxhinieringut të cilët kujdesen për objektet të cilat ju nevojiten institucioneve, prandaj ne e kemi ndjek vetëm atë vinë institucionale, pa dash me interferu.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Deputeti Hydajet Hyseni, replikë një minutë.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit, në Kryesi nuk është marrë vendim, kjo është thanë disa herë dhe është e vërtetë, muhabete rrugëve mund të ketë pasë, vërejtje janë bërë në vazhdimësi prej fillimit, edhe në seancë plenare, edhe në Kryesi, edhe në çdo rast, dhe kanë qenë kryesisht parimore, kanë pas të bëjnë me shkeljen e ligjit me shkeljen e një sërë ligjesh, me shkeljen e procedurave, me ndërrim të pronësisë që është çështje shumë e madhe me kontestim të kompetencave tejkalim të kompetencave, ndërtesa nuk ka qenë e Kuvendit, por ka qenë e Qeverisë, dhe ka pasë madje edhe falsifikime. Unë prandaj nuk jam pajtuar asnjëherë me këtë nismë, po besoni, i kuptoj arsyet tuaja, i duhet Kosovës ma shumë hapësirë dhe ndërtim edhe Kuvendit i duhet ma shumë ndërtim, po a veç Gjermia është për te a, i duhet Kosovës edhe ma shumë.....

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fetah Berisha

DEPUTETI FETAH BERISHA – Ju faleminderit z. Kryetar, të nderuar deputetë. Të gjithëve na është e njohur se me datën 14. shkurt 2006, mu në këtë Kuvend, në seancën e radhës, pika e 13-të e rendit të ditës, është debatuar për ndërtimin e Qendrës protokollare administrative Gjermia dhe çështja është ngritur nga partia ORA në dhjetor të 2005-tës. Në atë seancë u bë një debat i ashpër, mirëpo aspak konstruktiv. Atëherë jo për ndërtimin e kësaj Qendre, por edhe për shpenzimet buxhetore u debatua këtu, mandej për procedurën, transparencën, mandej punën e Kuvendit dhe të tjerë, atëherë nuk ka dalë se këtu në këtë Kuvend se ky ndërtim i kësaj ndërtese institucionale nuk ka pasë vendim. Pastaj këtu, në këtë Kuvend, është dalë edhe dokumentacioni i plotë që e pati sjellë në atë kohë sekretaria çdo deputeti, pastaj edhe një informacion këtu brenda për brenda Kuvendit dhe këto që thuhet sot nuk janë transmetuar atëherë, edhe sot në këtë seancë kemi para veti raportin e Kryesisë në të cilën ngërthehen konstatimet dhe rekomandimet, arsyetimin e të cilave e dha edhe z. Maloku edhe sot këtu në këtë seancë shihet apo nënkuptohet ashtu se ka diskutime të cilat do riaktivizojnë fushatën si ka qenë edhe më përpara, tani vihet pyetja se ky objekt i duhet Kosovës apo nuk i duhet, atëherë jemi pajtuar të gjithë se i duhet Kosovës se është një institucion i shtetit të Kosovës, a sa i përket procedurave sa i përket jo të mirave, le të merret dikush tjetër, prandaj këtu sot është mirë që të merret qëndrimi ashtu si e ka dhënë Kryesia, ja pse në raport pra, në konstatime është thënë në një vendim valid. Në pikën 2 është thënë se ka pasur konflikte interesash, nëse ka pas konflikte interesash le të gjinden konfliktet e interesave e jo të torturohemi ne këtu. Pastaj këtu është thënë kështu, nuk ka qenë objekt i miratimit në Kuvend vetëm aneksi C, nuk është thanë se s'ka pas në Kuvend vendim, ose rekomandimi p.sh. të vazhdohet me ndërtimin e qendrës, dakord, le të vazhdojë procedura, sa bukur është thënë në pikën e 2 të bëhet ekspertiza për këtë kërkesën e

punëkryesit për mjetet shtesë 34 % të aneksit 3, po të stopohet objekti, mos të ndërtohet, ma merr mendja se nuk ka logjikë.

Sa i përket asaj se në këtë Kuvend është hera e dytë që përmendet Edvin Rama, nuk ka nevojë ky Kuvend këtu p.sh. e Edvin Ramës, sepse ai me siguri është një sinonim i të keqes, tjetër, natyrisht, unë mendoj z. kryetar, edhe z. Rexhepi ish kryeministri i dikurshëm tha atë ata të cilët dyshojnë dhe bëjnë kështu, unë e kam këtë mendim

1. Është mirë këtu në Kuvend që të ngritet edhe një herë çështja e deklarimit të pasurisë, duke filluar nga kryetari i Parlamentit dhe për çdo deputet gjithashtu e ngre çështjen që të monitorohet qeveria Rexhepi, me të gjitha ministrinë e asaj kohe dhe të monitorohet edhe pasuria dhe veprimet e partisë ORA. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Z. Muhaxheri keni replikë.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – z. kryetar i Kuvendit, konstatimi i dytë i Kryesisë së Kuvendit se ka pasë konflikt interesash është konstatim që sipas ligjit për prokurim publik paraqet vepër penale, dmth. ne po dom me legjitimu diçka që nesër ka me u bë objekt i trajtimit penal.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Berat Luzha.

DEPUTETI BERAT LUZHA- z. kryetar, është konstatuar edhe nga Kryesia edhe nga referuesi se nuk ka vendim për ndërtimin e Qendrës si po quhet protokollare, madje nuk ka vendim as të Qeverisë, as të Kryesisë së Kuvendit as të Kuvendit, do të thotë është bërë krye në veti, nga ndonjë person, i caktuar në mënyrë private. A është institucion ajo qendër, unë mendoj se ma shumë është një hotel me 5 yje, ku ka bazena dhe ka sauna të cilat për momentin nuk i duhen Kuvendit të Kosovës, Kuvendi i Kosovës nuk i ka plotësuar ende kushtet për punën e deputetëve, deputetët nuk kanë ende zyre, nuk kanë ku të punojnë dhe mendohet që të ndërtohet një hotel i kategorisë A për të bërë qefe. E dyta është se ka diskrepancë mes të parave që janë paguar dhe punëve që janë kryer aty. Deri sa të sqarohet kjo çështje sa janë shpenzuar dhe sa është ndërtuar nuk duhet vazhdohet me ndërtimin e atij objekti. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Kërkoj nga deputeti Fetah Berisha që fjalën rreth kualifikimit Edi Ramës në Kuvendin e Kosovës ta tërheqë, nuk na bënë nderin neve si Kuvend, prandaj duhet të tërhiqet ajo fjalë. Fetah Berisha urdhëroni.

DEPUTETI FETAH BERISHA – z. Kryetar, unë thashë vetëm kaq, në këtë Kuvend është hera e dytë që përmendet emri i Edi Ramës, kështu e thashë dhe tjetër thashë: që ky Kuvend nuk ka nevojë të përmendet emri i Edi Ramës këtu dhe të merret si shembull. Kaq, natyrisht unë e kam atë mendim dhe kam të drejtë me pasë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Keni të drejtë ta thoni mendimin, por jo ta thoni kështu , fjalën e ka deputeti Ymer Muhaxheri

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Kuvend i ndërruar, z. kryetar, po më vjen keq që kësaj radhe po e marr rolin e njeriut parimor, por zakonisht sjelljet, veprimet eventualisht vendimet e njeriut shikohen nga aspekti i kushtëzimit, shkakut dhe pasoja nëse është konstatuar atje se ka pasë shkelje procedurale apo diçka edhe më e rëndë, e pasojë është interesimi i organeve hetuese, çfarëdo argumenti që paraqitet këtu është i pa fuqishëm. Këtij Kuvendi i takon me marrë vendimin me e ndërpre punimet nëse donë me qenë nivel të atij emisioni që Kuvendi e ka, ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Mark Krasniqi

DEPUTETI MARK KRASNIQI – I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë. Këtë debat që po e bëjmë sot këtu në Kuvend është dashur ta bëjmë në fillim të punimeve ose pa filluar punimet fare, pa filluar themelet e jo sot kur presim që të vihet edhe kulmi i këtij objekti. Ky objekt nuk është objekt privat, është objekt i këtij Parlamenti edhe është shumë i nevojshëm që ta kemi, nuk mund të jetojmë ne as edhe në qytet, lere ma në këto institucionet e mëdha që i kemi, në ato ndërtesat e shekullimit të kaluar ose pa to fare. Këtu u propozuan nga Kryesia e Kuvendit disa varianta, varianti më i keq më i dëmshëm është vendimi për rrënimin e këtij objekti, i dëmshëm shumë për Kosovën, i dëmshëm sidomos për buxhetin e Kosovës, varianti tjetër që të shtyhen këto punimet deri sa të marrë gjyqi vendimin e vet, gjithashtu është i dëmshëm sepse në në qoftë se nuk kryhen nuk përdoren këto mjete që janë të caktuara deri në datën e caktuar, kjo më duket një muaj a nuk di sa që u tha këtu, ato duhet të kthehen mjetet, t'i kthehen Ministrisë së Financave, gjithashtu është dëm. Unë them që tash përpiqemi këtu që disa lëshime procedurale t'i ndreqim edhe t'i kritikojmë dhe t'i diskutojmë. Është puna se më duket se duhet të votojmë dhe të përcaktohem tash për dy , jemi për rrënimin e këtij objekti apo jemi për vazhdimin e punimeve edhe ta kemi këtë objekt në favor tonin d.m.th. të Parlamentit, por edhe të Kosovës, ku do të jetë sigurisht një qendër e rëndësishme administratës edhe ndoshta e mysafirëve të mëdhenj që do t'i vinë Kosovës, sigurisht vendosja e tyre edhe pritja e tyre në atë objekt atje do të jetë shumë i këndshëm edhe shumë i dobishëm, prandaj unë propozoj që ne të votojmë: ata që janë për shtyrjen e punimeve ose për rrënimin e objekteve dhe votat që janë për vazhdimin e punës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Z.Hyseni, replikë po

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Po e shfrytëzoj të drejtën për replikë. Unë e theksova dhe e përmenda dhe e thashë në mënyrë figurative qasjen e Edi Ramës. Edi Rama, si e dini është shpallur në mesin e dhjetë prefektëve më të respektuar të botës, është shpallur.. Unë po e arsyetoj, sepse pati kualifikime të diskutimit tim, është shpallur pikërisht pse mbronte parqet, bulevardët , mbronte hapësirën e gjelbër, vetëm këtë thashë ka pasë edhe Shqipëria, ka pasë edhe ajo nevojë për ndonjë ndërtim por kurrkush s'ka kontestuar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! fjalën e ka Gjylshen Berisha.

DEPUTETJA GJULSHEN BERISHA – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë, të nderuar ministra, do të doja këtu një sugjerim, të tregohemi të përgjegjshëm si Kuvend, sepse nuk është diskutimi apo debati rreth kësaj pike për herë të parë, sepse ne e dimë që tri ditë radhazi kemi aprovuar edhe disa deputetë, shumica e deputetëve që kemi qenë edhe në mandatin e parë kemi aprovuar buxhetin të cilin e ka planifikuar vetë Qeveria atëherë dhe unë nuk di se si ka mundur Qeveria të lejojë mjete për diçka që nuk ka pasur leje.

2. Nuk pajtohem kurrsesi me rrënimin, sepse po më duket se e kemi atë mitologjinë tanë që vazhdimisht të rrënojmë në vend që të ndërtojmë, se duhet të ndërtohet dhe të kryhen punët, është e padiskutueshme sepse ndoshta dikush ka hotele private ende duhet t'i qojë mysafirët nëpër ato hotelet private, por kjo do të jetë një shtëpi e të gjithëve dhe e qytetarëve besoj dhe të ndërpriten këto fushata politike të orkestruara, ne të bëjmë punën tonë, është diskutuar pajtohem plotësisht me rekomandimet të cilat i ka dhënë Kryesia e Kuvendit, që i ka bërë gjitha ato analiza dhe mendoj në fund vërtetë rekomandimet janë shumë me vend, i përkrahi ato dhe mendoj se çka do që të flasim më tutje do të jetë një debat pa përgjigjeje. Ashtu mos të jetë si debati që ishte herën e kaluar, flitnim të gjithë një lloj monologu, edhe mendoj që kur të flisni duhet të keni një përgjigjeje, përgjigjja është këtu, rekomandimet t'i votojmë apo jo, është çështje e jona edhe kryetarit të Kuvendit i propozoj këtë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Edhe vetë po e shihni që vetëm po përsëritën gjërat që kanë filluar në fillim. I kemi dy kandidatë që janë paraqitur për fjalë dhe mendoj që duhet të shkojmë në votim. Fatmire Mulhaxha Kolçaku le të përgatitet, Teuta Hadri

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA KOLLÇAKU – Duke mos e vu fare në pyetje nevojën apo jo për ekzistimin e një institucioni të tillë ne sot jemi para një përgjegjësie shumë të madhe si një institucion me përgjegjësi të cilën e kemi. Është konstatuar se ka shkelje të mëdha procedurale, ka dyshime të bazueme në shkeljet e ligjeve në fuqi, në lidhur me gjitha procedurat rreth këtij objekti, u tha edhe nga parafolësja, si ka mundur Qeveria t'i ndajë mjetet, do të thotë si një institucion me përgjegjësi të lartë, a do të jemi shembull apo do të jemi inkurajim për të gjitha objektet që sot ndërtohen pa leje në Kosovë, për pompat e shumta të benzinës që lulëzojnë si lule në pranverë, për mbi ndërtimet a do t'i shikojmë si do t'ia vejmë kulmin e pastaj të marrim vendime, apo të shikojmë, do të thotë si deri më tani, në mënyrë injoruese këtu, apo do të japim shembull. Është konstatuar shkelja, u përmend që ka konflikt interesi, ligjet fuqi janë duke u shkelur, këtu nuk ka dyshime, për neve së paku jo, t'ia lëmë edhe gjyqësisë ta bëjë të veten por ne ta nxjerrim përgjegjësinë politike këtu së pari, një vendim për me ndërtua, për me vazhdua ndërtimin, në këtë moment, ju lutem, për çdo qytetarë sot në Kosovë, dijeni çfarë efekti do të ketë, do të ketë efekte të legalizimit të parregullsive dhe shkeljes së ligjit. Të jeni të sigurt.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri dhe e fundit

DEPUTETJA TEUTA HADRI – E tha edhe parafolësja z. kryetar, ky Parlament sot ka ra në provim para qytetarëve tanë, se në emër të votës dhe përqindjes së votës po urdhërohen institucionet ekzekutive, institucionet më të rëndësishme të Kosovës ato që bien drejtësi, e tha edhe Fatmirja se paramendoni veten sikurse na sot ta bëjmë këtë akt, gjithë qytetarët tanë që i kanë dorëzuar lëndët e veta dhe kanë bërë shkelje të ligjit janë mbetur pezullim, ju dhe Parlamenti jonë sot po del me këtë akt, atëherë do të jetë mundësia që përsëri do ta shkelin ligjin dhe do të ndërtojnë prapë pa leje. Prandaj jemi një shembull shumë i keq, ju lutem t'i respektojmë institucionet që vetë i kemi formua, siç janë ato gjyqësore.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Dhe i fundit Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit, kolegë të çmuar dhe të ndëruar, ky është një problem dhe kjo është një temë për të cilën kemi biseduar kaq shumë, brenda muajve të fundit, hera e dytë në seancë plenare, u tha këtu edhe tri herë radhazi edhe në Kryesinë e Kuvendit, një herë vetëm për këtë pikë. Ju dëgjua këtu përafërsisht saktësisht të paraqitura qëndrimet që kanë dalur në variantin në Kryesinë e Kuvendit të cilat i paraqiti, unë po them mjaftë saktësisht kolegu Maloku, dëgjuam këtu edhe varianta të interpretime të ndryshme të kolegëve të Kuvendit, disa me parashenja edhe politike, Kuvend politik është ky dhe kjo nuk është çudi, ka edhe mendime që harrojnë evidencat që kanë dalë para këtij Kuvendi, unë po ju them që Kryesia ka pasë një dokumentacion shumë të madh në dorë në tri mbledhjet, por mos harroni që esencën e atij dokumentacioni e keni pas edhe ju, por dikush me gjasë se ka lexuar as atëherë, s'e lexon as tash dhe nuk ka evidencat të vërteta çka ka ndodhur.

Si do që të jetë, ne sot jemi para një akti, Kryesia e mandatuar nga ajo në mbledhjen tjetër ka sjellë një raport që ka edhe konstatime edhe rekomandime. Të gjithë radhazi, unë sa dëgjova, i pranojnë pjesën e konstatimeve që janë të tri, d.m.th. të gjitha grupet parlamentare. Varianti i pajtimeve dhe mospajtimeve del në këto që quhen rekomandime dhe kemi diskutime që shkojnë në disa drejtime me argumentimet e veta secili natyrisht. Ne jemi sot në një gjendje, kur diçka do të vendosim. Do të vendosim sepse ky Kuvend Kryesinë e ka autorizuar që të vjen me një mendim, Kryesia ka ardhur, një dokument e kemi përpara dhe ne sot do t'i themi po ose jo. Natyrisht, do t'i themi me votë, sepse koncensus as nuk ka pasë kurrë rreth këtij problemi ashiqare, as s' do të ketë as sot këtu, diskutimet po thonë që nuk ka. Unë vetëm po ritheksojë dy tri gjëra të cilat po ju them haptas, ju që keni qef të lexoni çka thuhet këtu, t'i merrni gjitha listat prej ditës së parë kur është diskutuar, unë kam thënë: ndërtimi i një shtëpie të tillë për nevojat e institucioneve të Kosovës, po, nuk kam ndëruar mendim, as kur kam shkuar në Kryesi as në mbledhje të kryesive, as në mbledhjen e fundit dhe as nuk e kam ndëruar mendimin tue zbrit shkallëve, si ndodhë këtu shpesh herë, pra kjo i bien që edhe këto rekomandime që i keni përpara unë i kam votua në Kryesi, çka do të thosha tjetër

normalisht që do të thosha që do t'i votoni edhe ju, sepse kam votuar, nëse e lypni mendimin tim.

2. Duhet të diferencohen dy probleme, sepse nuk po diferencohen mirë, Kuvendi ka të drejtë të merr vendime dhe ta harxhojë buxhetin e vet. E drejta e Kuvendit nuk i pyet gjyqet a i harxhon parat e veta apo jo, është punë tjetër, gjyqet do të merren me të drejtën e tyre që procedura të ndiqet dhe në asnjë moment në asnjë sekond, as Kryesia as kryetari Berisha, as eks kryetari Daci nuk kanë pasë intencë ta mohojnë këtë gjë. Ky, zotëri dhe zonja, ky problem neve na është trashëguar. Kjo Kryesi që jemi tash, mua më duket vetëm njeri prej tyre ekziston në atë kryesinë e cila ka marrë ose nuk ka marrë vendim, si po thonë. Ne e kemi trashëguar problemin, e kemi në dorë dhe ne nuk mund të abstenojmë, e nuk ishim atëherë e ne nuk e trashëgojmë, këto janë probleme të Kuvendit dhe Kuvendi do ta zgjidh këtë problem, qoftë Kryesia e parë ose e pesta, e treta. Në këtë rast unë them që çka ka ndodhur në këto variante të diskutimeve, kanë ndodhur gjëra të reja, dhe kanë drejtë deputetët se në diskutimet e para, as unë si deputetë nuk e kam ditur a ekziston vendim formal për ndërtimin, ju lutem shumë në kërkimet e mëvonshme kanë dalë që nuk ekziston vendim formal i Kryesisë dhe këtë evidencë duhet ta sqarojë unë të gjithëve këtu sot, prandaj e kemi vu në pikën e parë të raportit.

Ekziston, thonë gjithë aktorët, bisedë e gjatë rreth këtij problemi, koncensus total thonë, gojarisht ka ndodhur, po që vendim formal s'u bë dhe tash njerëzit mund t'i hanë edhe fjalët e veta, sepse nuk shkruhet, pra nuk ekziston vendim i shkruar i Kryesisë së Kuvendit, zonja dhe zotërinj, kjo është e evidente.

Neve na mbetet të vendosim, jemi në një situatë jo inicuese, jemi në një situatë ku gjërat kanë ecur përpara, jemi në një, si kemi merak të themi, në një realitet të ri, të krijuar rreth kësaj shtëpie, janë marrë lejet, ka filluar ndërtimi dy herash, buxheti i Kosovës ka orientua mjetet e veta për këtë ndërtim dhe ne jemi në vitin e dytë, i treti është nëse kërkohen shtesa, në ndërkohë është kërkuar një plan C, që kërkojnë shtesa, mirëpo, unë po ju them, ekspertët e kësaj shtëpie kur kanë dëshmuar në Kryesi kanë thënë, ngadalë unë kam qenë ai që kam kërkuar shpjegime të mëdha për atë C, në një moment njeri ka dalë dhe ka thënë, se ajo C mund të mos ndërtohet, pra kemi elemente të reja që hyjnë në diskutim.

Një plan ekziston, një shtëpi ka shkruar deri në nivel të ndërtimit, rreth 1 milion e 700 mijë, ky Kuvend i ka pagua për atë shtëpi, ka ndarë edhe pjesën tjetër për ta kryer planin A dhe B, pra ne sot duhet të marrim vendim a të vazhdohet ndërtimi apo jo, kjo është themelore.

Pika e 2-të e rekomandimeve, të cilën unë tash këtu, para jush, pas dëgjimit të gjitha diskutimeve me vëmendje, kujtoj që të riformulohet dhe të bëhet të kërkohet ekspertizë për të gjitha punimet e deritashme dhe për kërkesën e punëkryerësit të mjeteve 34% etj. ndërsa dy pikat tjera të mbeten. Në këtë situatë unë mendoj që në vërtetë nuk kemi çka zgjasim bisedën më tutje, sepse janë thanë, janë rimarrë, janë përsëritur të gjitha gjërat dhe fundi i fundit është ky Kuvend që do të vendos, nuk do të vendos gjyqi për te, do të vendos Kuvendi, gjyqi i ka detyrat tjera që i përcjellë dhe sigurisht do t'i përcjellë.

Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit deputetë, shkojmë në votim, lus deputetët dhe regjinë të përgatitet për votim, së pari vjen në votim propozimi, respektivisht rekomandimi i Kryesisë së Kuvendit.

Raporti i rekomandimit për Qendrën administrativo protokollare në Gërmi

Votojmë Tash

Në këtë moment në sallë i kemi 79 deputetë

Konstatoj se me 52 vota për dhe 18 kundër kalon propozimi, respektivisht aprovet rekomandimi, bashkë me raportin e Kryesisë,

Të vazhdojnë punimet natyrisht, ky ishte rekomandimi i Kryesisë.

Ju faleminderit! Me kaq seanca përfundon.